


MARTIN LUTERI

HISTORIA E JETËS



JIM CROMARTY



Martin Luteri
(Nga portreti i Lucas Cranach, pikturuar më 1543)

MARTIN LUTHER

Historia e Jetës

Jim Cromarty

Titulli: Martin Luteri (Historia e Jetës)

Autori i origjinalit: Jim Cromarty
Titulli original. A Mighty Fortress is Our God

Përktheu: *Florenc Mene*
Redaktoi dhe pajisi me shënime: *Agesil Qiriazi*

Boton në shqip: AEM-Misioni Ungjillor
Shtyp: Vernon Publishing SH.P.K
Të drejtat të rezervuara © AEM-Misioni Ungjillor,
Shtator 2017

Botuar me lejen nga *Evangelical Press*
Grand Close, Faverdale North Industrial Estate, Darlington,
Co. Durham, DL3 0PH, England

Adresa: Rruga e Barrikadave, Nr. 125, Tiranë, Shqipëri
Adresa Postare: K.P. 119, Box.#70, AEP, Tiranë, Shqipëri
Web: <http://aemission.al>
Email: office@aemission.al

ISBN. 978-9928-1047-3-1

Përmbajtja

Parathënie

Hyrje

1. Jeta në familje

2. Vitet e shkollës

3. Vitet e universitetit

4. Jeta në manastir

5. Udhëtimi në Romë

6. Në kërkim të paqes me Perëndinë

7. Teceli dhe ndjesat

8. Tezat e Luterit

9. Reagimi ndaj tezave

10. Tubimi në Hajdelberg

11. Luteri takon kardinalin Gaetano

12. Debati publik me Johan Ekun

13. Ngjarjet që çuan në Vorms

14. Gjithë rrugët çojnë në Vorms

15. “I burgosuri” Në Vartburg

16. Trazirat civile

17. Martesa dhe jeta familjare

18. Dietat e Shpajjerit

19. Një takim me reformatoret zviceranë

20. Në Augsburg

21. Vitet e fundit

Bibliografia

Parathënie

“Ju do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t’ju bëjë të lirë.” Gjoni 8:32

Ky libër, i cili botohet me rastin e 500-vjetorit të Reformacionit, e rinjeh lexuesin shqiptar me një nga figurat më të njohura të historisë europiane dhe botërore. Jeta e tij është një burim shprese për këdo, është inkurajim dhe nxitje për të kërkuar dhe njohur të vërtetën, për të ecur në dritën e Perëndisë dhe për të jetuar një jetë të lirë.

Në fakt, ky libër nuk botohet për herë të parë në shqip. Ai është botuar së pari në vitin 1997 nga Fondacioni Kristian Humanitar “Kontribut për Edukimin” me titullin “Martin Luter Reformatori”. Tani vjen në shqip në një variant më të plotë dhe me një përkthim të ri.

Jeta e Martin Luterit mund të përshkruhet edhe si një udhëtim drejt së vërtetës dhe lirisë. Jeta e tij i ngjan njeriut që përshkruhet në shëmbëlltyrat te Ungjilli i Mateut, i cili gjen një thesar të fshehur në një arë dhe nga gëzimi që ka shkon, shet gjithçka që ka dhe e blen atë arë. Ky thesar ishte Fjala e Perëndisë. Ai e gjeti Biblën, Vugatën latinisht, për herë të parë në bibliotekën e Universitetit të Erfurtit, ku studionte jurisprudencë, kur ishte 20 vjeç. I bëri shumë përshtypje dhe shkonte shpesh për ta lexuar, madje i lindi dëshira që ta lexonte në gjuhët origjinale.

Kur mbaroi universitetin, mori gradën “Doktor në Filozofi” dhe filloi të jepte mësim. I ati krenohej me të birin dhe tashmë e thërriste “Ihr” (Ju). Mirëpo Martini, për habinë e të gjithëve, shiti gjithçka, krenarinë, pozitën dhe të ardhmen e shkoi ta blinte atë thesar.

Hyri në manastirin e Shën Augustinit dhe filloi të bënte jetën e thjeshtë të murgut. Shumicën e kohës e kalonte duke studiuar Biblën, Etërit e Kishës, shkrimet e Augustinit dhe duke iu lutur Perëndisë. I vetëdijshëm se ishte mëkatar, shpresonte të pendohej mjaftueshëm, përpiquej të bëhej njeri më i mirë dhe kështu t’i pëlqente Perëndisë. Ai besonte se zbatimi i drejtë e i përpiktë i ritualeve do ta qetësonte Perëndinë e zemëruar. Mirëpo shpirti nuk i gjente prehje. A arrihej dot shenjtëria me veprat dhe vetëmohimet që bënte?

Në kulmin e dëshpërimit, Perëndia solli në jetën e tij Johan fon Shtaupicin, mëkëmbësin e peshkopit të augustinianëve në Gjermani, i cili iu bë udhërrëfyes. Ai i shpjegoi Luterit se Perëndia me dashurinë e Tij i ka falur

mëkatarët e penduar, nëpërmjet veprës shpëtuese të Birit të vet, Zotit Jezu Krisht, i cili vdiq në kryq për ne të gjithë, për të paguar në vendin tonë atë çmim që duhej të paguanim ne për shlyerjen e mëkateve tona dhe se na ofron lirinë nga mëkati me anë të gjakut të Tij. Luteri e kuptoi se falja e mëkateve është dhuratë prej Perëndisë dhe jo diçka që ne e meritojmë. Ajo është falas për këdo që e beson Atë dhe Jezu Krishtin që Ai ka dërguar dhe nuk blihet me vepra të mira. Apostulli Pal në “Letrën drejtuar Efesianëve”, shkruan: “Sepse, me anë të hirit jeni të shpëtuar, nëpërmjet besimit; dhe kjo jo prej jush, por është dhurata e Perëndisë, jo prej veprave, që askush të mos mburret.” (Efesianëve 2:8-9)

Iu desh kohë e gjatë për ta kuptuar, por më në fund Perëndia ia kishte hapur sytë. Thesarin e kishte në duar.

Kur kuptoi këtë gjë, ra në konflikt me doktrinën e papatit, e cila shpallte se papa, si “zëvendësi” i Krishtit në tokë, mund t’ia falte mëkatet kujtdo, mjaft që të paguante. Madje kjo doktrinë që bënte objekt adhurimi njerëzit dhe paranë shpallte se papa falte jo vetëm mëkatet e të gjallëve, por edhe të vdekurve, duke i çliruar shpirtrat e atyre që vuanin nga flakët e pastrimit në purgatorin e sajuar nga mendjet djallëzore, mjaft që të afërmit e tyre të paguanin dhe, sapo monedhat tringëllinin në fund të arkës, shpirti linte menjëherë purgatorin.

Luteri e denoncoi me guxim këtë doktrinë që ishte në kundërshtim me atë që thoshte Bibla. Klerikët, të dërguarit e papës plot grada dhe ofiqe që u përballën me të, nuk e kundërshtuan dot me argumenta nga Bibla. Ata u munduan t’ia mbyllnin gojën, duke e kërcënuar me autoritetin e papës, me shkishërim dhe eliminim, por zëri i Luterit, tani që kishte gjetur shpëtimin dhe të vërtetën, u bë edhe më i fortë dhe u dëgjua anë e mbanë Gjermanisë. Konflikti me papatin u ashpërsua, por ai nuk i druhej askujt, veç Perëndisë. Shumë njerëz të thjeshtë e mbështetën. Udhëheqësit politikë që gjetën aty çlirimin shpirtëror, por edhe politik, e përkrahën dhe e mbrojtën. Ai nuk u ndal për asnjë çast së shpalluri të vërtetat biblike me anë shkrimesh e pamfletesh. Madje përktheu dhe vetë Biblën në gjuhën gjermane që të gjithë t’i lexonin të vërtetat e saj, me qëllim që të gjithë ta njihnin dashurinë dhe dhuratën e Perëndisë, ta pranonin dhe të çliroheshin nga skllavëria e mëkatit dhe të bëheshin vërtet të lirë.

Luteri shpalli se nuk ka autoritet tjetër veç Biblës, Fjalës së Perëndisë; nuk ka rrugë tjetër që njeriu të shpallet i drejtë para Perëndisë, përveçse me anë

të besimit; shpëtimi është dhuratë (që ne nuk e meritojmë) nga hiri hyjnor i Perëndisë; Krishti është i vetmi ndërmjetës midis nesh dhe Perëndisë; dhe gjithë lavdia i takon Perëndisë. Asgjë nuk vjen për shkak të meritave tona, por vjen nga dashuria dhe mëshira e Perëndisë.

Ai ndezi një zjarr që ndriçoi dalëngadalë gjithë Europën. Shkëndija të këtij zjarri ranë edhe në Shqipëri, ku vetëm pak vjet më vonë Gjon Buzuku botoi librin e parë në gjuhën shqipe “Mesharin”, ndonëse rrethanat politike ishin disi të ndryshme, për të vazhduar me Matrëngën, Budin, Bogdanin, Dhaskal Todrin, Meksin e Kristoforidhin e për të mos u shuar kurrë. Vetë jeta e Luterit, siç e lexojmë në këtë libër, na flet sot edhe ne shqiptarëve dhe na tregon të vetmen rrugë që duhet të ndjekim. Le të mos lodhemi së ndjekuri pas të vërtetën, e cila ka fuqinë të na çlirojë nga çdo prangë skllavërie dhe të na bëjë të lirë, së pari si individë e pastaj si komb.

Agesil Qiriaz

Hyrje

Përpara se të shqyrtojmë jetën e Martin Luterit, duhet t'i hedhim një sy gjendjes së Evropës në fundin e shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Kishte dy fuqi të mëdha: njëra, Perandoria, ndërsa tjetra, papati.

Perandori Romak

Më 1519-n, kur u zgjodh perandor, Karli V u bë kreu i pothuajse gjithë Evropës. Çdo komb i drejtonte vetë marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të shumta qenë luftërat që u kryen dhe aleancat që u nënshkruan.

Megjithatë, ishte një fuqi që kishte ndikim edhe më të madh, dhe kjo ishte Roma papnore. Me kalimin e viteve, pushteti i saj shpirtëror kishte fituar autoritet dhe zotërim mbi kombet, që do të thoshte se sundimtarët dridheshin përballë kërcënimeve të Romës.

Perandoria e lashtë e Romës ishte ndarë në dy pjesë; e para ishte pjesa lindore, nën sundimin e turqve, që kishin një makineri të madhe lufte dhe përbënin kërcënim të vazhdueshëm për Evropën perëndimore. Ndërsa pjesa tjetër ishte bota e krishterë, e cila, në thelb, ishte bërë konfederatë shtetesh të pavarura nën kryesinë e një Perandori të zgjedhur.

Gjermania ishte federatë shtetesh të vogla, e drejtuar nga sundimtarë të pavarur, dhe e gjitha pjesë e perandorisë. Në vitin 997 pas K., papa Gregori¹ caktoi shtatë elektorë² ose zgjedhës, nga një për secilën pjesë të Gjermanisë. Tri pjesë ishin nën sundimin e klerikëve: kryepeshkopi i Trierit³, kancelar i Francës; kryepeshkopi i Maincit, kancelar i Gjermanisë; kryepeshkopi i Këlnit, kancelar i Italisë. Katër të tjerët nuk ishin drejtues të klerit, por laikë. Këta ishin mbreti i Bohemisë, duka i Saksonisë, konti palatin i Rinit⁴ dhe markonti⁵ i Brandenburgut.

Zgjedhja e perandorit ishte në dorë të kryepeshkopit të Maincit, i cili ishte përgjegjës për asamblenë e sunduesve, që të zgjidhnin një prej anëtarëve të tyre në këtë post. Ishin përcaktuar rregulla të forta për këtë zgjedhje, e cila duhej të kryhej në Frankfurt-mbi-Majin. Kur elektorët hynin në qytet, nuk u lejohej të kishin me vete më tepër se dyqind kalorës dhe vetëm pesëdhjetë syresh mund të ishin të armatosur.

Pasi të mbahej mesha, zgjedhja duhej të kryhej brenda tridhjetë ditësh. Për t'u siguruar që zgjedhja të përfundonte shpejt, elektorët duhej të ushqeheshin vetëm me bukë dhe ujë, pas tridhjetë ditëve që lejonte zgjedhja.

Në kurorëzimin e perandorit kryhej betimi, ku ai premonte të mbështeste dhe të mbronte besimin katolik të Romës. Po kështu, detyrohej të përdorte forcat e tij, për të mbrojtur papën dhe të drejtat e privilegjet e papës në të gjitha shtetet që përbënin perandorinë, si dhe të luftonte kundër kërcënimit turk, që ishte gjithmonë i pranishëm.

Perandorit nuk i lejohej të dekretonte ligje pa miratimin e shumicës së elektorëve, princave dhe sunduesve të shteteve të ndryshme. Ai s'kishte financa në dispozicion, gjë që ia kufizonte disi autoritetin dhe pushtetin për të zbatuar dëshirat e tij.

Gjithsesi, dy forca bënin të mundur ruajtjen e strukturës së perandorisë. Forca e parë ishte përparimi i vazhdueshëm i ushtrisë turke, që kërkonte përpjekjen e përbashkët të Evropës perëndimore për të mbrojtur tokat e veta. E dyta ishte fuqia e papatit, që ishte forca përbashkuese që mbante shtetet të lidhura me njëra-tjetrën.

Kur Karli mori ofiqin e perandorit, pati mundësinë që të ushtronte pushtet të madh. Ai ishte mbreti i Spanjës dhe asokohe Perandoria e Spanjës ishte e shtrirë së tepërmi dhe kishte pasuri të pamata. Kolombi pati zbuluar një botë të re me pasuri të mëdha dhe kjo ishte në dispozicion të Karlit, i cili kishte nën urdhrat e veta ushtri të tëra dhe një flotë të konsiderueshme, që i përdori me shumë sukses.

Papati

Sunduesi i dytë i madh i Evropës ishte papa i Romës, pushteti dhe ndikimi i të cilit ishte rrënjësor në të gjitha shtetet e perandorisë. Përfaqësuesit e tij në vendet e Evropës nuk ishin atje për të drejtuar urdhrat fetarë, por për të sunduar mbi pushtetet e përkohshme. Ligjet e shteteve të ndryshme nuk kishin autoritet në oborret fetare të ngritura nga përfaqësuesit e papës, që donte të thoshte se ekzistonte një mbretëri brenda mbretërisë e sunduar nga përfaqësuesit e papatit.

Papa deklaronte të drejtën e vendimit për çdo çështje divorci, që nënkuptonte pushtetin për përcaktimin e sunduesve dhe pasardhësve të tyre në fronet e Evropës. Papati zotëronte sipërfaqe të mëdha toke; si rrjedhojë, nga shtetet e perandorisë rridhnin lumenj parash drejt financave të Romës.

Papës i lejohej që të vendoste taksa dhe madje vendosi një taksë një peni për çdo shtëpi në Francë dhe Angli. Me raste të veçanta mund të vendoste dhe taksa të tjera.

Sidoqoftë, pushteti më i madh Romës i vinte nga pretendimi i saj se ishte rruga e vetme e shpëtimit. Mësohej qartë se nuk kishte shpëtim jashtë Romës. Pretendohej se hiri i Perëndisë rridhte nëpërmjet priftërinjve dhe sakramenteve. Kështu, kërcënimi i shkishërimit mjaftonte që t'i kallte datën dhe sunduesit më trim, pasi kishte për të patur si përfundim të përjetshëm ferrin, nëse nuk gjunjëzohej para autoritetit papnor. Por ekzistonte dhe purgatori, vendi ku të gjithë të krishterët do të shkonin pas vdekjes, nëse kishin ende mëkate për të cilat dënimi nuk ishte shlyer. Flakët pastruese të purgatorit ishin flakë ferri që përdoreshin për të pastruar mëkatarët nga mbetjet e mëkatit. Pas një kohe mundimesh të tmerrshme, portat e parajsës hapeshin. Megjithatë, Roma pretendonte se kishte pushtet mbi purgatorin dhe të drejtën për të shpërndarë meritën e papërdorur të Krishtit dhe shenjtorëve, në mënyrë që të lehtësonte vuajtjen e shpirtave të besimtarëve nga vendi i mundimit. Me kalimin e kohës, Roma gjeti mënyrën për të fituar para nga purgatori dhe nga meritat shpirtërore; këto merita mund të shiteshin për çlirimin e shpirtit nga mundimi i flakëve të purgatorit.

Mes papatit dhe shteteve të ndryshme ishin dekretuar marrëveshje, sipas të cilave papës i ishte dhënë e drejta absolute për të përcaktuar se cilat ligje, fe dhe mësimë duheshin zbatuar. Kjo donte të thoshte se sunduesit dhe popujt e kombeve sundoheshin nga Roma.

Papa pohonte se ishte përfaqësuesi i Perëndisë në tokë dhe, në të vërtetë, ata që preokupoheshin për fatin e tyre të përjetshëm i druhashin atij më shumë se Perëndisë.

Adam Smithi shkroi kështu për papatin: “Kisha e Romës është kombinimi më i tmerrshëm që është krijuar ndonjëherë kundër autoritetit dhe sigurisë së qeverisjes civile, si dhe kundër lirisë, arsyes dhe lumturisë së njerëzimit.”

Pikërisht në këtë botë politike dhe shpirtërore lindi Martin Luteri.

1. Jeta në familje

Martin Luteri lindi në 11 të darkës, më 10 nëntor, por e ëma s'ishte kurrë e sigurt për vitin. Gjithsesi, anëtarët e tjerë të familjes ishin të sigurt se bëhej fjalë për vitin 1483. Martini lindi pa pompozitet apo ceremoni në një familje të varfër që jetonte në një shtëpizë të thjeshtë në Ajsleben, një fshat i vogël gjerman. Përpara kësaj, çifti i sapomartuar, Hans dhe Margaret Luter, patën jetuar pranë Ajzenahut, pak më poshtë se Vartburgu, që më vonë do të kthehej në një strehë të sigurt, kur Martinin do t'i vihej jeta në rrezik të madh.

Një familje e varfër

I ati, Johani (Hansi), ishte i vobektë. Nuk pati trashëguar asnjë copë tokë nga prindërit, pasi ligji vendas kërkonte që pronat e familjes t'i kalonin fëmijës më të vogël. E shoqja, Margareta, kishte pësuar të njëjtin fat, pasi nuk ishte më e vogla në familje. Kështu, Johan Luteri e nisi punën si druvar, ndërsa punonte dhe në minierat vendase të bakrit. Ishte shumë punëtor dhe arrinte të fitonte aq para, sa të kujdesej për familjen e tij të re, por, ndonëse arrinte të siguronte bukën e gojës dhe më vonë ia doli të blinte dhe shtëpi, nuk u konsiderua kurrë i pasur.

Më vonë Martini tha për prindërit e vet: “Prindërit e mi ishin shumë të varfër. Im atë ishte druvar i varfër dhe nëna mbartte shpesh dru në kurriz, që të fitonte aq para, sa t'i rriste fëmijët me një nivel të arsyeshëm jetese.”

Ndonëse i varfër, Johan Luteri e donte me shpirt arsimin dhe kishte dëshirën që të rrethohej nga librat dhe të shoqërohej me njerëz të arsimuar.

Ai ishte një njeri që, bashkë me të shoqen, Margaretën, jetonin me frikë (pothuajse në kufijtë e tmerrit) nga Perëndia që do të gjykonte tokën dhe shkonin shpesh në kishën katolike lokale. Sidoqoftë, ai s'donte ta shihte asnjë nga bijtë e tij të bëhej prift apo murg dhe u pezmatua pa masë kur Martini hyri në manastir.

Jeta fetare dhe lutjet zinin një pjesë të madhe të kohës në atë familje. Në shumë raste, Johani gjunjëzohej përbri shtratit të fëmijëve dhe lutej me zë të lartë që ata të rriteshin me frikën e Perëndisë dhe të bindur ndaj Kishës. Sigurisht, si anëtar besnik i Kishës Katolike, shumica e lutjeve të tij i drejtoheshin Shën Anës, shenjtores mbrojtëse të minatorëve, dhe Marisë, nënës së Zotit Jezu Krisht.

Fëmijët e familjes Luter u ushqyen me një frikë të tmerrshme ndaj Perëndisë. Tek e fundit, Perëndia e urrente mëkatin dhe ndëshkonte çdo mëkatar. Edhe Krishtit duhet t'i druhashin, sepse e konsideronin si Gjykatësin që do t'i flakte mëkatarët në ferr. Më vonë, Martini shkroi kështu për frikën që kishte nga Krishti: "Që nga vegjëlia, e dija se duhej të zbehesha sa herë të dëgjoja emrin e Krishtit; sepse më kishin mësuar që ta shihja vetëm si gjykatës të rreptë dhe të frikshëm." Kisha Katolike e Romës, përmes priftit vendas, mësonte se mëshira gjendej më së miri te Maria, nëna e Krishtit, si dhe te shenjtorët e tjerë të shumtë. Ata ishin në gjendje ta qetësonin Krishtin, gjykatësin e tmerrshëm. Martini i ri u rrit me të njëjtat bindje fetare që i patën mësuar prindërit dhe që besoheshin nga shumica e bashkëkombasve. Ai e dinte se duhej t'u bindej mësimëve të Kishës dhe se duhej të përkulej përpara kërkesave të papës së Romës.

E ëma e Martinit, Margaret Lindemani, i kishte prindërit nga fshati. Ishte grua vërtet e përshpirtshme dhe respektohej së tepërmi nga të gjithë ata që e njihnin. Ashtu si i shoqi, Margareta i druhej Perëndisë dhe ishte grua që lutej.

Feja e familjes Luter, si shumica e familjeve të tjera në Gjermani, ishte një përzierje e mësimëve të Romës me paganizmin gjermanik. Populli ende besonte se në ujë, në erë dhe në pyje jetonin elfë⁶, xhuxha, zana, shtriga dhe sirena meshkuj e femra. Këta njerëz besëtytë besonin se përmytjet, fatkeqësitë e tjera natyrore dhe të gjitha sëmundjet shkaktoheshin nga shpirtrat e këqinj. Margareta ishte e bindur se një grua vendase e atij fshati ishte shtrigë dhe e kishte mallkuar familjen e saj; dhe kjo bindje iu përforcua kur i vdiq njëri nga fëmijët. Ajo e dinte se fqinja "shtrigë" ishte në njëfarë mënyre fajtores për vdekjen e fëmijës së vet. Madje, Margareta besonte se nganjëherë shpirtrat i punonin rrengje, duke ia vjedhur qumështin dhe vezët.

Babai i Martinit ishte i bindur se aksidentet që ndodhnin në miniera ishin për faj të demonëve të ligj që banonin në atë zonë. Shpesh Johani u tregonte familjes dhe shokëve me të cilët pinte se, një herë, një nga shokët e tij në punë vdiq nga dhimbje të tmerrshme, pasi një demon ia shkuli lëkurën nga kurri. Për shkak të këtyre bindjeve, shumë herë historitë që dëgjonte Martini, para se të binte për të fjetur, flisnin për shpirtrat e këqinj dhe këto tradita patën ndikim gjithë jetën në mendimin e tij.

Pasi lindi, prindërit vendosën ta quanin Martin, sepse lindi në prag të ditës së Shën Martinit. Në Gjermani ishte e zakonshme që prindërit t'u vinin fëmijëve emrin e atij shenjtori që e kishte përvjetorin më pranë datëlindjes së fëmijës⁷. Një ditë pas lindjes, Martinin e çuan te prifti dhe e pagëzuan aty, në kishën e Shën Pjetrit.

Transferimi në Mansfeld

Pas gjashtë muajsh, familja Luter u transferua në Mansfeld⁸, ku Johani hapi një punishte të re. Peizazhi fshatarak rreth qytetit të tyre të ri ishte i bukur dhe nga jo shumë larg mund të shihej shpati kodrinor i Harcit⁹. Qyteti qarkohej nga pyje të dendura dhe fushat me bar ishin vend i përsosur, ku fëmijët e zonës mund të kalonin orë të tëra duke luajtur gjithë gëzim. Mbi një kodër me pamje nga komuna, dukej qartë kështjella e lashtë¹⁰ e fisnikëve që kishin patur dikur nën zotërim tokat e fshatit.

Johan Luteri ishte punëtor shumë i zellshëm dhe donte të çante në jetë. E nisi si punëtor kazme në minierat e bakrit dhe arriti deri aty sa u bë ortak në disa tunele të Mansfeldit. E njihte mirë jetën e vështirë, të rëndë dhe të rrezikshme të minatorëve. Shumë herë pati gërmuar nëntokë te ndonjë damar i vogël bakri, ku shpesh mund të punonte vetëm i kërrusur, pasi hapësira e tuneleve ishte tepër e ngushtë. Pronarët e minierave nuk merrnin asnjë masë sigurie dhe ishte gjithmonë i pranishëm rreziku i rënies së tavanit, përmbytja nga uji ose mbytja nga gazi.

Johani hapi një punishte të vogël shkrirjeje, bashkë me disa sipërmarrës të tjerë vendas. Në fund arriti të kishte tri pika të tilla shkrirjeje. Sigurisht, Johan Luteri duhet të ketë falënderuar shpesh Shën Anën për mbarësinë në sipërmarrjen e tij në minierë; në fund të fundit, ajo ishte mbrojtësja e gjithë minatorëve.

Fitimet nga kjo punë nuk ishin aq të mëdha dhe si rrjedhojë, e shoqja, Margareta, ishte e detyruar të mblidhte dru në pyll; shitja e tij i shtonte të ardhurat familjes dhe u siguronte një nivel më të mirë jetese. Përveç kësaj, siguronte dhe paratë e nevojshme që fëmijët të merrnin një arsim të mirë. Martini i vogël dhe fëmijët e tjerë shpesh ndiqnin nënën e tyre punëtore nëpër pyll, teksa mblidhte dru për zjarr. Pastaj, kur ktheheshin në shtëpi, kërcenin përmbri saj, duke mbartur ndoca shkarpa të vogla.

Johan Luteri e dashuronte arsimin, prandaj, për shkak të pozitës së tij të re, ishte në gjendje të shoqërohej me qytetarët më të arsimuar të Mansfeldit. Shumë herë në tryezën e tij uleshin prifti dhe mësuesit e shkollës. Ndërsa fliste me këta burra të ditur, mezi priste ditën kur dhe fëmijët e vet do të bëheshin po kaq të arsimuar. S'ka aspak dyshim se këta vizitorë patën ndikim të madh gjatë rritjes së Martinit. Johan Luteri fitoi respektin e qytetarëve të Mansfeldit dhe u zgjodh në këshillin bashkiak.

Disiplina në familjen Luteri

Prindërit e tij, si gjithë prindërit e tjerë të kohës, e merrnin shumë seriozisht fjalën e urtë: “Druri e bën fëmijën njeri.” Nganjëherë babai i tij ishte shumë i ashpër në disiplinimin e fëmijëve. Shumë herë nxirrte thuprën dhe i fshikullonte. Shpeshherë ndëshkimi e kalonte masën, por Martini s'pati kurrë mëri apo zemërim ndaj prindërve. Ishte djalë me vullnet të fortë dhe ndëshkimet e marra e mësuan t'u vinte fre energjive të papërmbajtura. Më vonë në jetë, Martini do të shkruante për babain: “Një herë, im atë më fshikulloi aq fort, sa ia mbatha dhe u zemërova me të, derisa u përpoq të më merrte me të mirë.” Pavarësisht përdorimit të thuprës, jeta në familje ishte e durueshme. Johani ishte baba i lumtur dhe gjente kohë për të luajtur me fëmijët. Sidoqoftë, ishte minator i ashpër dhe shumë herë kthehej në shtëpi disi i dehur, pasi kishte rrëkëllyer disa birra me shokët e minierës. Megjithatë, nuk ishte pijanec.

Shpesh, pasi e ndëshkonte i ati, Martini turrej për ngushëllim në krahët e hapur të nënës. Por edhe e ëma ishte grua e kohës dhe shpesh Martini ndiente dhe thuprën e zemërimit të saj. Nuk e harroi kurrë një herë, kur ajo e fshikulloi me kamxhik. Me sa duket, i kishte thënë Martinit që s'duhej të hante asnjë nga arrat që kishte mbledhur për të gatuar gjellën e darkës. Meqë ishte i vendosur të hante nja dy arra, hëngri disa pa leje. Kur u kthye e ëma, e gjeti duke ngrënë arrat e ndaluara, ndërsa lëvozhgat ishin të shpërndara në dysHEME. Kështu, mori kamxhikun dhe i hyri Martinit. Druri që i dha duhet të ketë qenë shumë i rëndë, pasi Martini s'e harroi kurrë atë ndodhi. Për atë rast, më vonë shkroi: “Një ditë, nëna më ndëshkoi aq rëndë për një arrë, sa që më rrodhi gjak.” Pa dyshim, atë ditë Martinit duhet t'i kenë rrjedhur lotët çurg. Më vonë, duke kujtuar ato ditë të hershme në familjen e vet, Martini tha këto fjalë për rreptësinë e prindërve: “Ata mendonin me gjithë mend se po bënë gjënë e duhur; por s'ishin në gjendje të kuptonin diçka të

domosdoshme: kur dhe si duhet dhënë ndëshkimi. Ndëshkimi është i domosdoshëm; por përbri thuprës duhet vendosur dhe molla.”

Margareta i mësonte fëmijët që të ishin të sjellshëm, të përlurur dhe të shfaqnin respekt ndaj të tjerëve. Shumë shpejt Martini arriti të mësonte një këngë të shkurtër që e ëma ia këndonte shpesh:

*“Nëse njerëzit s’na pëlqejnë,
Fajin te vetja duhet ta gjejmë.”*

Martini ishte djalë shumë energjik dhe, pavarësisht ashpërsisë së periudhës kur jetoi, iu mbijetoi goditjeve që do ta kishin shkatërruar një njeri më të dobët. Mirëpo kujtonte se shpesh dridhej nga fjalët e prindërve.

Më vonë, kur u martua dhe u rrethua nga fëmijët e vet, Martini tregoi se ishte baba i dhembshur dhe i dashur; shumë i ndryshëm nga prindërit e vet.

2. Vitet e shkollës

Prindërit e Martinit e respektonin së tepërmi arsimin, ndaj ishin të vendosur që fëmijët e tyre të merrnin shkollimin më të mirë të mundshëm. Ndërsa bashkëmoshatarët shijonin fëmijërinë duke ngarendur nëpër fusha, Martini shkonte në shkollën e qytetit, ku përballej me rutinën e latinishtes. Ishte djalë i vogël dhe shpesh në shkollë shkonte hipur në shpinën e të atit. Herë të tjera, radhën për ta çuar Martinin e vogël në shkollë e merrte një djalosh nga Mansfeldi, Nikolas Emler. Ky djalosh më vonë u martua me një nga motrat e Martinit.

Shkolla në Mansfeld

Shkolla bëhej në shtëpinë e mësuesit Giorg Emilius dhe aty Martini mësonte latinishten, gjuhën e ligjit, Kishës, udhëtimeve, arsimit dhe qeverisjes. Martini mësoi katekizmin, Dhjetë Urdhërimet, Besoren e Apostujve, Lutjen e Zotit, himne dhe disa lutje rituale. Meqë gjuha që flitej në klasë ishte latinishtja, nxënësit duhej të flisnin gjithë kohës latinisht.

Martini dhe nxënësit e tjerë duhej të mësonin përmendësh pjesë nga Shkrimet (nga Vulgata në latinisht) dhe të merrnin pjesë në korin e shërbesave të shkollës së të dielës, si dhe në mëngjesoret dhe mbrëmjesoret e përditshme.

Shpesh, që nxënësit të mësonin mirë, përdorej thupra. Në shkollën latinisht të Mansfeldit, djemve u uleshin pikët dhe në fund të javës nxirrej shkopi (një thupër mështekne e trashë sa koka e një fshese të vogël) dhe jepej ndëshkimi. Madje Martini kujton kur, një mëngjes, mësuesi e goditi 15 herë me thupër, ngaqë s'ë tha dot gramatikën e latinishtes. Sësstë habi që një herë tha se vitet e shkollës ishin si “purgator dhe ferr”, ku mësuesit ishin “tiranë dhe gardianë burgu”. Zakoni e donte që mësuesi të zgjidhte një djalë që të spiunonte shokët e klasës. Ky quhej “lupus” – “ujku”. Kur kapte ndonjë nga nxënësit duke folur gjermanisht, i jepte të vinte një maskë gomari në fytyrë. Nxënësi fatkeq e mbante maskën derisa gjente dikë tjetër që gabonte dhe fliste gjermanisht. Në atë çast, maska i kalonte këtij të fundit. Pa dyshim, djali që mbante maskën bëhej shënjestër talljesh dhe fyerjesh të vazhdueshme nga shokët e klasës.

Pavarësisht viteve të vështira në shkollë, nxënësit zotëronin latinishten dhe kështu ishin në gjendje të siguronin postet më të rëndësishme në shoqëri.

Shpesh Martini kujtonte me keqardhje që shkolla nuk u kishte mësuar fare gjeografi, histori ose matematikë. Ai s'ia kishte idenë historisë së Gjermanisë apo të botës në përgjithësi. Sa për gjeografinë, duhet të ketë njohur vetëm mjedisin që e rrethonte dhe duhet të ketë besuar se bota ishte disk i sheshtë, në qendër të të cilit ishte Roma ose Jerusalemi. Kur Kolombi përshkoi oqeanin Atlantik më 1492-shin, Martini s'duhet të ketë qenë në dijeni të kësaj ngjarjeje historike. Kaq i kufizuar ishte programi mësimor, sa që dhe gjuha gjermane përgjithësisht anashkalohej.

Nisi të mësonte llautën dhe iu ngjall një dashuri e madhe për muzikën. Më vonë do të këndonte në korin e manastirit dhe do të shkruante himne, shumë prej të cilave përdoren ende në adhurimin e Perëndisë.

Kohë të vështira në Magdeburg

Kur mbushi katërmëdhjetë vjeç, i ati i dha dum që t'i jepte fund shkollimit të Martinit në Mansfeld. Kështu, më 1497-n, Martini adoleshent u nis për në shkollën françeskane të Magdeburgut¹¹. Ishte përvojë e re për të dhe tani ishte fillikat. Arsimi në shkollë ishte falas, por Martini dhe nxënësit e tjerë vareshin nga prindërit për paratë e nevojshme, që të përballonin shpenzimet e jetesës.

Shumë shpejt Martini kuptoi se jeta në Magdeburg ishte tejet e vështirë. Jetonte me nxënës të tjerë në një dhomë të vogël; flinte në dyshek me kashtë. Mirëpo, që të mbijetonte, kishte nevojë për shumë ushqim dhe paraja e paktë që i dërgonte i ati nuk ia siguronte dot kurrësi bukën e përditshme. Kështu, bashkë me nxënësit e tjerë, shtrëngohej të lypte te banorët e qytetit për t'u ushqyer. Kjo gjë nuk konsiderohej e turpshme për nxënësit, pasi lypja shihej si profesion i nderuar. Manastiret mbijetonin nga veprimtaritë lypëse të priftërinjve dhe murgjve, dhe ata që kishin para u jepnin lirisht atyre që u trokisnin në derë.

Martini s'e harroi kurrë një ekspeditë të tillë lypjeje. Ai shkroi: "E kisha zakon të lypja bashkë me shokët për pak ushqim, që të mbushnim barkun. Një ditë, në kohën kur Kisha kremton festën e lindjes së Krishtit, po endeshim nëpër fshatrat aty pari, po shkonim shtëpi më shtëpi dhe po këndonim me katër zëra këngët e zakonshme për foshnjën Jezus që lindi në Betlehem. U ndalëm përpara shtëpisë së një fshatari, që ndodhej më vete në kufi të fshatit. Bujku, i cili na dëgjoi duke kënduar këngët e Krishtlindjes, doli me ca ushqime që donte të na i jepte dhe bërtiti me zë të lartë dhe të

ashpër: 'Çuna, ku jeni?' Të frikësuar nga këto fjalë, ia mbathëm me sa na hanin këmbët. S'kishim pse të trembeshim, pasi bujku na ofroi ndihmë me dashamirësi të madhe; por zemrat tona, pa dyshim, na ishin mbushur me frikë nga kërcënimet dhe tirania me të cilën sundonin asokohe rëndom mësuesit mbi nxënësit, kështu që shpirtin na e mbërtheu një panik i papritur. Mirëpo, më në fund, pasi bujku vazhdoi të na thërriste, ndaluan, e harruam frikën, u turrëm me vrap drejt tij dhe morëm nga dora e tij ushqimin që na kishte taksur."

Martini vuajti sërish për shkak të mësuesve, të cilët e përdornin pa teklig thuprën për të nxitur nxënien. S'ka dyshim se karakteri shpërthyes ia shtoi telashet Martinit në shkollë.

Librat ishin të rrallë dhe, kur Martini pa një "postil", pra, një libër me pjesë biblike që përdorshin në shërbesat e kishës, vendosi ta shtinte në dorë. Kurseu paratë e xhepit dhe bëri punë të ndryshme, me qëllim që të fitonte paratë e nevojshme për ta blerë.

Ajzenahu dhe familja Kota

Kur i ati mësoi për vështirësitë e të birit, mori vendimin që ta transferonte në një shkollë në Ajzenah, ku jetonin disa kushërinj. Pa dyshim që ai mendonte se të afërmit do të kujdeseshin siç duhej për Martinin.

Mirëpo edhe aty Martini e pati shumë të vështirë jetesën. E donte shumë jetën shkollë, por e pati sërish të domosdoshme të lypte për ushqim. Çdo ditë përshkonte rrugët, duke kënduar dhe lypur. Meqë në rrugë qarkullonin shumë lypës dhe shumica e popullit ishin të varfër, shumë pak dyer hapeshin, që t'i jepnin një kothere bukë.

Martinit po i soste durimi. Derdhi shumë lot dhe pa dyshim iu lut Marisë për ndihmë dhe ngushëllim. Madje po bëhej gati të kthehej te prindërit dhe të punonte me të atin në fonderi, kur iu hap dera e një qytetari të kamur dhe doli një grua e këndshme, e cila e ftoi brenda në shtëpi dhe i dha të hante.

Ajo grua ishte Ursula Kota, e shoqja e të pasurit Konrad Kota. Babai i saj ishte kryetari i bashkisë së Ilfeldit¹². Ajo e kishte parë Martinin në kishë dhe i pëlqente shumë zëri i tij i ëmbël në korin e kishës. Po kështu, e dinte që ishte nxënës i shkëlqyer dhe ishte e vendosur t'i jepte Martinit gjithë ndihmën e nevojshme për ta përfunduar shkollimin.

Kur i shoqi, Konradi, u kthye në shtëpi nga puna, u gëzua nga vendimi i së shoqes, që ta ndihmonte Martinin. Aty për aty morën masat që Martini të

jetonte në shtëpinë e tyre. Këtej e tutje s'kishte për të vuajtur nga mungesa e ushqimit; tani do të kishte një shtrat të ngrohtë e të butë, ushqim të mirë e të bollshëm dhe një familje të dashur që përkujdesej për të. Ishte familje e mbushur me dashuri mes gjithë pjesëtarëve që jetonin nën atë çati. Po kështu, Kotat kishin dashuri të vërtetë për Perëndinë.

Në shtëpinë e Kotave Martinin e mësuan për anën elegante të jetës. I mësuan etiketën dhe rregullat e shoqërisë fisnike. Ajo ishte shumë e ndryshme nga jeta e vështirë e komunitetit minator ku ishte rritur. Martinin i hyri menjëherë në zemër nëna birësuese, Ursula Kota, dhe i shoqi i saj zemërdhembshur. Si shpërblim për mirësinë e tyre, ai kaloi shumë orë duke u dhënë mësim fëmijëve të tyre.

Martini e dinte se ishte Perëndia Ai që e kishte ndihmuar në sprovën dëshpëruese me të cilën ishte përballur, ndaj tani filloi të lutej si kurrë më parë. Etja për njohuri iu përforcua dhe, për shkak të sigurisë së sapogjetur, shkollimi i tij përparoi me ritëm të jashtëzakonshëm.

Martini s'i harroi kurrë vitet si nxënës, kur lypte. Më vonë, do të thoshte: “Mos i përçmoni djemtë që këndojnë nëpër rrugë duke lypur për një copë bukë, për hir të Perëndisë; edhe unë të njëjtën gjë kam bërë. Është e vërtetë që, disi më vonë, im atë më mbështeti me shumë dashuri dhe mirësi në Universitetin e Erfurtit, duke më mbajtur me djersën e ballit; por dhe unë kam qenë lypës varfanjak.”

Martini jo vetëm që shkëlqeu në latinisht, por njohu thellë shkrimet filozofike të mjeshtërve të tillë, si Aristoteli, Tomazo d'Akuini¹³, Danzi¹⁴ dhe Okami¹⁵. Dhe s'ishte thjesht dituri përmendësh; ai arriti ta kuptonte me rrënjë logjikën e shkrimeve të tyre.

Një mësues që fitoi menjëherë respektin e Martinin ishte i njerëzishmi Johan Treboni, i cili i nxiste gjithmonë nxënësit që të mësonin shumë. Kur hynte në klasë, e përshëndeste klasën duke prekur majën e kapeles. Mësuesit e tjerë s'e bënin kurrë këtë, por Treboni i respektonte nxënësit dhe, një ditë, kur e pyetën pse e hiqte kapelen para “nxënësve të pavlerë”, u përgjigj: “Mes këtyre djemve ka burra që një ditë Perëndia do t'i bëjë kryetarë bashkie, kancelarë, mjekë dhe gjykatës. Ndonëse ende s'arrini t'i shihni me shenjat e dinjitetit që do të kenë, është e drejtë që t'i trajtoni me respekt.”

Martini e vazhdoi mësimin e flautit dhe llautës bashkë me këngën. Familjes Kota i pëlqente shumë aftësia muzikore e mysafirit të tyre dhe

shpesh Martini jepte shfaqje muzikore përpara tyre si familje.

Vitet në familjen Kota ishin ndër më të këndshmet në jetën e tij. Arriti të ndihej si në shtëpinë e vet, mes prindërve birësues, të cilët i donte me shpirt. Më vonë në jetë, duke kujtuar Ursula Kotan dhe mirësitë e saj, shkroi: “S’ka gjë më të ëmbël mbi dhé se zemra e një gruaje ku banon perëndishmëria.”

TanibMartini kishte mbushur 17 vjeç dhe viteve të shkollës po iu vinte fundi. I ati kishte shumë dëshirë që ta shihte student jurisprudence në universitet. Martini kishte treguar tashmë se ishte i shkëlqyer nga ana akademike, ndaj i ati kishte shumë shpresa që një ditë ta shihte të birin duke përshkuar korridoret e pushtetit. Ishte gati të bënte sakrifica financiare që Martini të bëhej njeri i madh.

Kështu, u mor vendimi që Martini të niste studimet në universitetin e mirënjohur dhe të respektuar të Erfurtit¹⁶.

3. Vitet e universitetit

Erfurti ishte qytet i këndshëm universitar, i rrethuar prej pyjesh. Jashtë mureve të qytetit rriteshin vreshta dhe pemishte, ndërsa fushat ishin të mbuluara me lulet vendase blu dhe të verdha. Llullaqet, që rriteshin pa masë, mblidheshin dhe u shiteshin atyre që merreshin me industrinë e bojërave. Majat e katedraleve dhe universitetit ngriheshin drejt qiellit mbi lartësinë e mureve të qytetit.

Student në Erfurt

Martini hyri në auditorët e respektuar të nxënies në Universitetin e Erfurtit në prill të vitit 1501; në atë kohë universiteti kishte rreth njëqind vjet që ishte hapur. Asokohe kishte rreth dy mijë studentë. Universiteti i Erfurtit kishte emër të shkëlqyer në botën akademike dhe mburrej me mësuesit e vet të mirënjohur. Martini kishte etje për dije dhe këtu shpresonte se do ta përmbushte. Meqë Johan Luteri donte që i biri të studionte për jurisprudencë, ishte i gatshëm të bënte sakrificat e nevojshme financiare që ta mbështeste të birin e shkëlqyer.

Popullsia studentore jetonte nëpër bujtina të ndryshme, kështu që Martini gjeti një vend të tillë për të qëndruar, i njohur me emrin “Bierstasche” (“Poçja e birrës”). Aty jetonte bashkë me studentë të tjerë të varfër. Pa dyshim, emri tregonte se ishte vend që njihej për faktin se studentët mblidheshin aty dhe pinin birrën vendase. S’duhet të mendojmë se studentët ishin thjesht një turmë pijanecësh të nivelit baçelor; birra ishte pija kombëtare dhe zakonisht pihej çdo vakt. S’ka të dhëna që Martini të ketë marrë pjesë nëpër gosti për t’u bërë tapë apo në teprime të tjera të jetës studentore, pasi, më vonë, s’pati asnjë kritikë për vepritarinë e tij gjatë viteve universitare.

Studentët e universitetit visheshin me uniforma që tregonin bujtinën ku qëndronin dhe shumica prej tyre mbanin nga një shpatë të vogël në rrip, të cilin e vinin rreth uniformës. Shpatat nuk ishin thjesht për bukuri, pasi smira dhe rivaliteti mes studentëve çonin në shumë duele.

Në rini, Martini ishte djalosh me trup të lidhur, disi i shkurtër, por me kokë të bukur dhe flokë të dredhur, fytyrë të gjerë dhe sy depërtues. Nuk ishte studenti më i bukur i universitetit, por ishte pa dyshim djalë fshati simpatik. Lëkura e tij shfaqte ngjyrën e jetës që kishte bërë në natyrë.

Ndjenjën e humorit e kishte të zhvilluar mirë; kishte vullnet të fortë dhe ishte shumë popullor ndër shokët e universitetit. Kishte mendje kureshtare dhe kujtesë të fortë; më vonë, shoku i vet, Filip Melanktoni¹⁷, tha: “Luteri shkëlqeu në vitet e hershme. Gjithë universiteti e admironte për gjenialitetin e tij.”

Martini e nisi jetën e universitetit siç bënin dhe studentët e tjerë. Si simbol i ndryshimit të jetës që do të ndodhte pas pak, ai dhe studentët e tjerë u veshën me një kësulë qesharake me brirë; mbi kësulë ishin vendosur dy si veshë gomari. Pastaj një nga studentët e vjetër ia grisi kësulën dhe e zhyti në një vaskë me ujë. Kjo ceremoni inaugurimi shënonte fundin e jetës së vjetër, të vështirë dhe të paarsimuar dhe rilindjen e jetës së kulturuar të studentit universitar.

Studimet në Erfurt

Sigurisht, latinishtja zinte vend qendror në të gjitha studimet, pasi literatura e disponueshme gjendej vetëm në atë gjuhë të lashtë. Studimi i detyrueshëm i veprave të Okamit, Danz Skocezit, Bonaventurës¹⁸ dhe Tomazo d'Akuinit i zinte një pjesë të mirë të kohës, por Martini lexoi gjerë e gjatë edhe urtësinë e epokave. Ciceroni, Virgjili, Livi¹⁹ dhe të tjerët ishin shoqëruesit e tij të pandërprerë. I pëlqente shumë dhe urtësia që gjente në fabulat e Ezopit dhe më vonë në jetë i përktheu disa syresh në gjermanisht. Shumë pak shokë të tij të universitetit zotëronin libra, kështu që Luteri kalonte shumë orë në bibliotekën e universitetit, duke studiuar dorëshkrimet që gjendeshin aty. Studimet do ta pajisnin Martinin për shërbesë në kishë, si dhe për një jetë të tërë në jurisprudencë. Megjithatë, gjithë synimi i mësimdhënies ishte të ngjallte te studenti një frikë të tmerrshme nga Perëndia dhe një respekt të përhershëm për Kishën dhe papën.

Jeta frymërore e Luterit në këtë kohë

Çdo ditë niste me një kohë lutjeje dhe, kur ishte e mundshme, shkonte në kishën e universitetit. Martini ishte tejet i vetëdijshëm se duhej të mbështetej te Perëndia për gjithçka në jetë dhe shpesh thoshte: “Kur lutesh si duhet, ke bërë gjysmën e studimit.”

Mësimi i fortë i Kishës për ferrin dhe purgatorin i tmerronte njerëzit e zakonshëm. Ata jetonin nën frikën e vazhdueshme të ferrit dhe ideja e epokave që do të kalonin në purgator për të pastruar njollën e mbetur të

mëkatit ua shuante gëzimin për t'i shërbyer Krishtit. Sigurisht, marrja e ndjesave përmes veprave të mira ose pelegrinazheve u jepte njëfarë shprese, por kjo situatë u dukej pothuajse e pashpresë atyre që i druhashin përballjes me gjykimin e Perëndisë së zemëruar. Mirëpo Kisha mësonte se një mënyrë e sigurt për të fituar të drejtën e hyrjes në qiell ishte jeta si murg. S'kishte dyshim se këto çështje i rëndonin së tepërmi në zemër Martinit, teksa vazhdonte studimet për jurisprudencë.

Në atë fazë të jetës ishte shumë i vetëdijshëm se ishte mëkatar, por s'ndihej fajtor për ndonjë mëkat të veçantë. Që nga fëmijëria kishte mësuar se trupi ishte mëkatar dhe se dëshirat e mishit duheshin shmangur me çdo kusht. Këtu nuk përfshiheshin vetëm dëshirat seksuale, por gjithë jeta: ushqyerja, puna dhe pija. Martini dhe jetën në botë e shihte si diçka të mëkatshme. Donte me gjithë shpirt të pastrohej, por shpesh, kur lante duart me studentët e tjerë, thoshte: "Sa më tepër lahem, aq më të papastër bëhem". Ashtu si shumë të tjerë në kohën e vet, Martini mendonte se e vetmja mënyrë për të gjetur paqen e vërtetë me Perëndinë ishte vetmia: arratisja nga bota dhe hyrja në jetën murgërore. Mirëpo, pavarësisht ndjenjave të mëkatit, Martinit i pëlqenin vitet moskokëçarëse studentore me shokët e tij të gëzuar.

Gjatë rritjes Martini kishte parë murgjit që endeshin nëpër rrugë duke lypur ushqim dhe para. Në sytë e tij dhe të banorëve të qyteteve, murgjit ishin shenjtore që i shërbenin të Plotfuqishmit, përmes jetës murgërore.

Madje Martini kishte parë dhe princin Vilhelm të Anhaltit²⁰, i cili i pati kthyer kurrizin jetës së rehatshme, ishte bërë frat dhe lypte për të siguruar jetesën. Për këtë njeri, Luteri shkroi: "E pashë me sytë e mi. Isha katërmëdhjetë vjeç në Magdeburg. E pashë teksa mbante thesin si gomar. E kishte rraskapitur kaq shumë veten nga agjërimet dhe lutjet, sa që dukej si personifikimi i vdekjes; ishte kockë e lëkurë. S'kishte njeri që e shihte dhe të mos i vinte turp për jetën e vet."

Luteri "zbulon" Biblën

Martinit ia zunë sytë për herë të parë Biblën në bibliotekën e universitetit, kur ishte njëzet vjeç. Kishte lexuar shumë pjesë të Shkrimeve, por tani sytë i mbetën te fjala e Perëndisë së gjallë, në gjithë plotësinë e saj. Tani mbante në duar Vulgatën latinisht, përkthimin e Shkrimeve nga Jeronimi. Ky ishte versioni i Shkrimeve që botohej asokohe, por ishte përkthim në latinisht, ndaj vetëm të arsimuarit mund ta lexonin.

Deri në atë kohë, Martini besonte se Bibla përbëhej nga pjesët e shkurtra që lexonte prifti të diel për të diel, por tani zbuloi se ato lexime ishin thjesht një pjesë e vockël e Fjalës së Perëndisë.

Me shumë kujdes dhe padurim, Martini hapi Biblën që mbante në duart që i dridheshin. Fletët u kthyen dhe u hapën në një pjesë të Shkrimit që iu ngulit në zemër. Aty, përpara syve të vet, pa historinë e Anës dhe Samuelit të vogël. Shpejt e shpejt e kaloi me sy gjithë historinë dhe u ngazëllye në zemër. Pas pak u detyrua të mbyllte faqet e këtij libri të paçmuar dhe u kthye në banesë. Mirëpo zemra e dridhur i ishte mahnitur kaq shumë nga kjo zbulesë, saqë u lut: “Ah, sikur Perëndia të më falë një libër të tillë”.

Martini shkante vazhdimisht në bibliotekën e universitetit për të studiuar faqet e Biblës që sapo kishte zbuluar. Në atë kohë, fjalët e saj mund t'i lexonte vetëm në latinisht, por zemra i ishte mbushur me dëshirën që ta lexonte në gjuhët origjinale: hebraisht dhe greqisht.

Martini duhet të ketë qenë plotësisht në dijeni të degradimit të Kishës Katolike në Erfurt. Ndërsa shumica e murgjve mezi siguronte bukën e gojës, krerët e Kishës njiheshin botërisht për standardin e lartë të jetesës. Në përgjithësi jetonin në apartamentet më të mira, hanin ushqimin më të mirë, visheshin me rroba të shtrenjta dhe shoqëroheshin me dashnore. Ndonjëherë në qytet vinte për vizitë ndonjë murg ose prift që predikonte për domosdoshmërinë e pendimit dhe besimit në Krishtin, por përgjithësisht Kisha ishte vend strehimi për ata që donin jetë të rehatshme.

Erfurti kishte tridhjetë e gjashtë manastire dhe kuvende, dhe s'besoj se mund ta përfytyrojmë larminë e jashtëzakonshme të veshjeve të studentëve të universitetit, personaliteteve kishtarë dhe popullsisë vendase.

Studenti i devotshëm

Vitin që zbuloi Biblën (1502), Martini mori dhe gradën e parë akademike, baçelorin e arteve. Nuk shkëlqeu vitin e parë të studimeve; doli i tridhjeti i klasës nga pesëdhjetë e shtatë studentë gjithsej. Megjithatë i pëlqeu kjo mënyrë e re jetese dhe iu përkushtua me gjithë shpirt studimeve.

Martini vuajti shumë nga shëndeti, për shkak të studimeve të pandërprera çdo ditë. Çdo minutë larg veprimtarive universitare e kalonte në sallat e errëta të bibliotekës, duke lexuar fjalën e Perëndisë.

U rraskapit aq shumë nga studimet, saqë disa shokë mendonin se do të vdiste. Një prift i moshuar e qortoi, kur Martini i tha: “Zoti do të më

thërrasë të largohem nga kjo botë.” Këtyre fjalëve, prifti iu përgjigj: “I dashur z. Baçelor, merr zemër; s’ke për të vdekur nga kjo sëmundje. Perëndia ynë do të të bëjë një njeri që do të ngushëllojë shumë të tjerë. Sepse Perëndia ua vendos kryqin mbi shpinë atyre që do dhe ata që e mbajnë me durim fitojnë shumë urtësi.”

Martini e mbushi mendjen me mësimin e Fjalës së Perëndisë dhe, gjatë kohës së mbetur në universitet, mendoj thellësisht për marrëdhënien me Perëndinë. Ishte i bindur se vullneti i zbuluar i Perëndisë, që gjendej në Shkrimet, ishte i denjë për t’u besuar.

Studimet filozofike arsyetonin se mund të kishe besim te vullneti njerëzor, kurse Luteri arriti në bindjen se vullneti i njeriut u shkatërrua kur Adami ra në mëkat në kopshtin e Edenit; por Shkrimet nuk u shprishën, pasi ishin të paprekura nga mëkati njerëzor! Fryma e Shenjtë ia mbushi zemrën dhe Martini u bind thellësisht për faktin se ishte mëkatar. Dëshironte që të gjente paqen me Perëndinë, por këtë s’e gjente dot përmes Kishës. Kështu e ktheu vëmendjen te studimet dhe, për njëfarë kohe, i mbyti tmerret e ferrit dhe purgatorit.

Gjatë kohës në universitet, Martinit i ndodhën disa ngjarje që çuan në vendimin për të hyrë në manastir.

Një hap larg vdekjes

S’do ta harronte kurrë Pashkën e vitit 1503. Pashka ishte festë e rëndësishme e Kishës dhe, meqë ishte kohë pushimesh, vendosi të kthehej në shtëpi dhe të vizitonte prindërit. Siç ishte zakoni i kohës, në brez mbante shpatën. Shumica e popullsisë mbante shpatë kudo që shkonte, pasi rrugët dhe xhadet ishin çerdhe kusarësh, të cilët s’e kishin për gjë të grabisnin dhe vrisnin udhëtarët. Teksa po ecte, shpata i ra nga brezi dhe ia preu thellë mishin. Iu ça një arterie dhe vetëm ndihma e menjëhershme e bashkëshoqëruesit ia shpëtoi jetën. Shoku i tij vrapoi për ndihmë, teksa Martini dergjej përtokë me gjakun që i rridhte çurg nga plaga e thellë. E përshkoi një ndjenjë tmerri dhe iu duk sikur po shihte vdekjen me sy. Ngriti sytë drejt qiellit dhe klithi: “O Mari, më ndihmo!”

S’kaloi shumë kohë dhe nga Erfurti mbërriti një mjek që ia lidhi plagën. Atë natë, kur plaga iu ça përsëri dhe i rodhi gjaku lumë, Martini i klithi sërish Virgjëreshës Mari për ndihmë. Më vonë në jetë, teksa kujtonte atë

ngjarje dhe lutjen drejtuar Marisë, tha: “Në atë kohë, duhet të kisha vdekur, për shkak të besimit të Maria.”

Gjatë periudhës së konvaleshencës²¹, ushtroi aftësitë për ta zotëruar më së miri llautën.

Suksesi akademik

Më 1505-n, studimet e Luterit arritën pikën kulmore dhe, më 7 korrik, u diplomua me gradën “Master i Arteve” dhe “Doktor i Filozofisë”. Doli i dyti në klasën me shtatëmbëdhjetë studentë. S’ishte bëmë e vogël për atë universitet të famshëm, ndaj Martini mori nderimin e bashkëstudentëve dhe mësuesve. Pati gëzim të madh dhe shumë festime për kremtimin e kësaj arritjeje. Martini u gëzua pa masë nga ajo që po ndodhte dhe për njëfarë kohe i dukej se jeta e jurisprudencës ishte pikërisht ajo që dëshironte. Kjo rrugë ishte dhe dëshira e prindërve të vet, sidomos e të atit, i cili i fali një kopje të shtrenjtë të librit të mirënjohur “Corpus Juris²²” – “Përmbledhje e Ligjit”.

Në të njëjtën kohë, në shenjë respekti, i ati e thërriste me “Ihr”, pra, “Ju”, për të nderuar statusin e tij të ri në jetë, dhe jo më me përemrin më të afërt dhe atëror “du” (“ti”). Ndoshta neve mund të mos na duket kushedi se çfarë kjo shprehje, por ajo ishte shenja universale e respektit që të paarsimuarit tregonin ndaj akademikëve të shkëlqyer.

Në kërkim të paqes me Perëndinë

Luteri, i mbiquajtur “Filozofi” ose “Muzikanti”, ishte djalosh që e donin të gjithë. Personaliteti energjik i tij u jepte jetë festave. I pëlqente shumë koha që kalonte me shokët studentë dhe shumë herë i kënaqte duke kënduar ose duke i rënë llautës.

Megjithatë, edhe në mes të gjithë këtij gëzimi, Martini e kishte zemrën të mbushur me frikën e tmerrshme të Perëndisë. I shihte mëkatet e tij si një pengesë që ia shkatërronte shpresën e jetës së përjetshme dhe paqes së shpirtit. Sa më tepër lexonte Shkrimet, aq më tepër i druhej shenjtërisë së Perëndisë së gjallë dhe vajtonte për mëkatet. Kërkonte pavdekësinë dhe mendonte shpesh për të ardhmen: do të zgjidhte jurisprudencën, siç kishte planifikuar i ati, apo kishën, që shpresonte se do t’ia qetësonte ndërgjegjen e torturuar?

Shpejt ndodhën disa ngjarje që e çuan në vendimin e palëkundur për të ardhmen. Mësoi se një nga shokët e ngushtë i ishte vrarë në duel. Duelet ishin shumë të zakonshme mes studentëve dhe shumica e tyre ecnin të armatosur me shpatë. Mendimet e vdekjes ia pushtuan sërish zemrën Martinit dhe, me mendjen e kredhur në frikë, pyeti veten: “Ku do të përfundoja po të vdisja papritur?”

Sërish, mendja e frikësuar i shkoi te shenjtëria e Perëndisë së zemëruar dhe te problemi i pajtimit me këtë Perëndi të fyer. Si mund ta gjente paqen me Perëndinë?

Kështu, Martini vendosi të kthehej në shtëpi gjatë pushimeve të universitetit dhe të merrte kohë e të diskutonte të ardhmen me prindërit. Johan Luteri u gëzua nga arritjet e të birit, sidomos pasi tani po jepte mësim në Universitetin madhështor të Erfurtit. Gjatë korrikut 1505, Martini mori rrugëtimin e gjatë më këmbë për në shtëpi, në Mansfeld. Nuk e dimë se ç'bisedoi babai me të birin, por Martini u largua nga shtëpia e prindërve i vendosur që të vazhdonte jetën si mësues në universitet. Mirëpo s'kishte për të ndodhur siç priste Martini dhe prindërit! Shpejt Perëndia do të ndërhynte, duke ndryshuar plotësisht drejtimin që do të merrte Martini për gjithë pjesën tjetër të jetës.

Furtuna dhe zotimi

Teksa i afrohej rrethinave të Erfurtit, mbi male shpërtheu një furtunë e furishme. I rrethuar nga vetëtimat e rrufeve dhe shpërthimet e bubullimave, zemra iu mbush me mendimet e vdekjes, gjykimit dhe përjetësisë. I dukej sikur nga çasti në çast do ta përpinin flakët e ferrit. Më vonë tha se ndihej sikur e kishte qarkuar ankthi dhe tmerri i vdekjes. Na mbetet vetëm ta përfytyrojmë se ç'i shkoi në mendje Martinit, ndërsa vazhdonte rrugën i rrethuar nga tërbimi i furtunës. Më vonë në jetë tha se në atë stuhi ndjeu zemërimin e Perëndisë. Druhej se mos Perëndia e rrëmbente nga toka dhe e nxirrte përballë gjykatës së Krishtit Mbret. Martini ishte shumë besëtyt dhe shumë prej bestytnive i pati gjithë jetën. Ai besonte se shumë vende banoheshin nga demonët, madje, thoshte se në Gjermani ishte një kodër e lartë, e quajtur Pubelsberg, në majë të së cilës ishte një liqen i stërmadh. Ai besonte se po të hidhje një gur në ujin e atij liqeni, do të shpërthente një furtunë e stërmadhe në gjithë vendin aty përreth. Dhe pse? Sepse besonte se shumë demonë mbaheshin robër në ujërat e atij liqeni. S'ka dyshim se

gjithçka që i kishin mësuar duhet t'ia ketë mbushur mendjen me frikë atë ditë fatndryshuese korriku.

Papritmas, tokën aty pari e goditi rrufeja dhe Martini u plandos përtokë. Iu duk sikur do ta rrëmbente djalli dhe do ta flakte në zjarrin e ferrit. Ngriti sytë nga qielli dhe i klithi shenjtores mbrojtëse të të atit: “Shën Ana, më ndihmo! Kam për t'u bërë murg!” Kjo ishte një pikë madhore kthese në jetën e tij.

I tmerruar, u zotua se, po t'ia kursente Perëndia jetën, do t'i përkushtohej gjithë jetën shërbesës së Tij.

Vendimi i Martinit për të hyrë në manastir ishte një vepër që Kisha mësonte se i jepte njeriut shpërblim të madh, madje e siguronte se do t'i kishte të hapura portat e qiellit. Sa më i madh vetëmohimi i murgut, aq më i madh shpërblimi.

Luteri, lektori i aftë i universitetit, i dashur nga studentët dhe lektorët e tjerë, dhe me të ardhme të madhe përpara, vendosi brenda një çasti që të hiqte dorë nga gjithçka dhe të bëhej anëtar i një manastiri, gjë që shumë e konsideronin si varrosje për së gjalli. Jeta e jurisprudencës u zhduk dhe u zëvendësua me jetën e varfërisë në një qeli manastiri. Mirëpo Martini ndihej i sigurt se kjo jetë do t'i siguronte shpëtimin e përjetshëm dhe paqen e mendjes.

Miq të dhe familja marrin lajmin

Për shkak se i ishte zotuar Perëndisë, e dinte se çfarë e priste, teksa kalonte portat e qytetit të Erfurtit. Si shiti kopjen e shtrenjtë të “Corpus Juris”, siguroi mjaft para për një festë lamtumire. Mblodhi shokët e vet për një darkë dhe u bë vërtet gjallëria e asaj feste. I ra flautit, këndoi këngë dhe u kënaq shumë me shoqërinë e miqve të tij të ngushtë, por kjo ishte një festë ku shpalli tërheqjen e vet nga bota. Shokët u shtangën kur iu shpalli vendimin e marrë. Disa nga të pranishmit u rrekën ta bindnin të ndryshonte mendje. Po ti u zotove nga nxitimi i çastit se do të hyje në manastir, i vunë në dukje ata! Disa të tjerë i thanë se ishte i detyruar ta përmbushte zotimin e marrë. Por ai e kishte ndarë mendjen. Do të bënte siç ishte zotuar.

Martinin iu deshën dy javë që të vinte punët në vijë dhe, kur i ati dëgjoi për vendimin e të birit, u tërbua. A s'ishte rrobëtuar që ta mbante me para të birin mosmirënjohës gjatë universitetit? Shpresa se Martini do kujdesej për

të në pleqëri iu bë copë e çikë në çast. I biri, krenaria dhe gëzimi i jetës së tij, e zhgënjeu.

Përmbushja e zotimit

Asokohe kishte gjashtë manastire rreth e rrotull Erfurtit. Martini duhej të zgjidhte mes manastireve të benediktinëve²³, domenikanëve²⁴, kartuzianëve²⁵, françeskanëve²⁶, servitëve²⁷ (që ishin shërbyes të Virgjëreshës Mari) dhe rendit augustinian²⁸. Ai zgjodhi manastirin augustinian, pasi ishte me nam si prijësi i jetës shpirtërore në atë qytet.

Kështu, më 17 gusht 1505, Luteri kaloi portat e manastirit të Shën Augustinit, ku shpresonte t'i shërbente Perëndisë si eremit.

I ishte mbushur zemra me vetëdijen e mëkatit dhe kërkonte çlirim nga zemërimi i Perëndisë së fyer nëpërmjet veprave të ligjit: pra, nëpërmjet jetës në manastir. Në hapësirën e qetë të mureve të qelisë, Luteri besonte se do të gjente shpëtimin. Aty shpresonte se do të gjente paqen me Perëndinë.

S'kishte për të ndodhur kështu. Çlirimi dhe shpëtimi mund të gjenden vetëm në Jezu Krishtin dhe izolimi nga bota nuk ishte rruga drejt qiellit. Kur la botën pas, Martini hyri në manastir me vetëm dy libra: veprat e Virgjilit dhe Plautit²⁹, një poemë epike dhe disa komedi. Në atë periudhë të jetës, Martini nuk kishte Bibël. S'i kishte ardhur ende koha!

4. Jeta në manastir

Martini u lidh përsëri me botën e jashtme vetëm pas një muaji; tani kishte marrë emrin e ri augustinian. Gjatë asaj kohe, rishtari Luter u dorëzua në urdhrin augustinian të Erfurtit. Duhet të ketë qëndruar në këmbë të shkallët e kishëzës, përpara altarit, dhe kryemurgu duhet ta ketë pyetur: “Çfarë po kërkon?”

Kësaj pyetjeje, Martini duhet t’i jetë përgjigjur: “Hirin dhe mëshirën e Perëndisë.”

Pas kësaj, kryemurgu duhet ta ketë pyetur nëse ishte i martuar, i kishte borxhe dikujt apo mbartte ndonjë sëmundje. Pasi Martini t’u përgjigjej me “jo” këtyre pyetjeve, kryemurgu duhet ta ketë këshilluar për jetën e vështirë që e priste. Jeta në manastir nënkuptonte veshje të ashpra, ushqim të pakët, lutje, përgatitje shpirtërore ditë e natë, punë të mundimshme, varfëri dhe lypje për ushqim e para. Përpos jetesës në varfëri ishte dhe izolimi i jetës në manastir. Kur e ka pyetur kryemurgu a ishte gati të sakrifikonte kënaqësitë e botës për një jetë të tillë, Martini duhet t’i jetë përgjigjur: “Po!”

Kjo nënkuptonte se ishte pranuar për vitin e provës, përpara se të kryente zotimet e fundit. Pastaj Martinit ia hoqën rrobat e zakonshme dhe ia zëvendësuan me mantelin e rishtarit. Pasi ia qethën kokën (ia tonsuruan³⁰), Martini u përgjunj, teksa kryemurgu i manastirit përsëriti këto fjalë: “Bekoje shërbëtorin tënd. Dëgjo, o Zot, lutjen tonë me gjithë zemër dhe prano që t’i dhurosh bekimin tënd këtij shërbëtori, të cilin në emrin tënd të shenjtë e kemi veshur me rrobën e murgut, që të vazhdojë me ndihmën tënde, besnik ndaj Kishës tënde, dhe të meritojë jetën e përjetshme, përmes Jezu Krishtit, Zotit tonë. Amen.”

Më tej, pas këndimit të himnit të fundit, Martini u shtri përtokë me duart e shtrira në formë kryqi. Pastaj, si e pranuan zyrtarisht në manastir, dëgjoi fjalët e kryemurgut: “Nuk do të shpëtohet ai që është nisur, por ai që duron deri në fund.”

Kështu, i veshur me rrobën e tij të bardhë, me kësulën e zezë në kokë, i lidhur me një rrip të zi lëkure, Martini nisi jetën si rishtar në manastir. Nën këto rroba Martini mbante veshur një këmishë leshi të bardhë për t’u ngrohur. Netëve duhej të vishte skapularin (zakonisht, një rrip i ngushtë rrobe që hidhej mbi shpatulla dhe arrinte pothuajse deri në shesh) me një kapuç të bardhë që i mbulonte kokën dhe këtë vazhdoi ta vishte si veshje

nate deri në fund të jetës. Asokohe në Gjermani shumica e njerëzve flinin pa rroba.

Babai i Luterit merr lajmin

Johan Luteri u tërbua kur mori vesh se Martini ishte bërë murg dhe aty për aty i shkroi të birit, duke i shprehur se ishte plotësisht kundër asaj që kishte ndodhur. E lajmëroi se nuk do të quhej më biri i tij. Shumë vetë i folën Johan Luterit, që t'ia qetësonin zemrën e lënduar dhe të zemëruar. Madje njëri i tha: “Nëse duhet t’i ofrosh një flijim Perëndisë, le të jetë ai që ti do më shumë dhe mëfort – biri yt, Isaku yt.”

Por këshilltari i bashkisë së Mansfeldit nuk pranonte ta qetësonin. Kishte filluar ta thërriste të birin me titullin e respektuar “Ihr”, por tani, nga zhgënjimi, nisi t’i drejtohej sërish me “ti” që përdorej rëndom. Edhe e ëma, nga zemërimi, tha se s’donte të kishte të bënte më me djalin e saj të pabindur. Ky qëndrim i babait të Martinut vazhdoi derisa dy djem të tjerë ia vrau murtaja. Vetëm atëherë ia dha pa dëshirë Johani Martinut miratimin për vendimin që të hynte në manastir.

Shumë nga shokët e Martinut u mblodhën jashtë portave të manastirit, në pritje që të flisnin me të, me shpresën se mos e mendonte dhe njëherë këtë punë dhe i kthehej jetës së universitetit, por nuk ndodhi kështu.

I shkolluari detyrohet të bëjë punë të rëndomta

Në manastir murgjit e pritën me gëzim Martinin. Për ta ishte fitore e madhe që në mes tyre hyri një doktor i shquar i universitetit. Megjithatë ishin të vendosur t’ia përulnin zemrën këtij studiuesi të madh, sepse besonin se duhej të ishte patjetër njeri krenar. Nganjëherë Martini shërbeu si derëtar i manastirit, që t’u hapte dhe mbyllte portat vizitorëve; mbante të kurdisur sahatin e kishëzës dhe i kërkohet që të kalonte shumë kohë duke fshirë kishën dhe duke pastruar qelitë (pra, dhomat ku rrinin murgjit).

Të shumta ishin rastet kur e urdhëronin që të merrte trastën e bukës dhe të ecte rrugëve të Erfurtit duke lypur për bukë dhe çdo ushqim që mund t’i jepnin qytetarët bujarë. Shpesh lypte prej atyre që e njihnin si studiuesin intelektual dhe lektorin e Universitetit të Erfurtit. Kjo detyrë ishte dhe më poshtëruesja. Pastaj kthehej në qeli për lutje dhe meditim. Martini s’kishte dëshirë që ta kënaqte mishin, por dëshironte me zjarr të gjente paqen me Perëndinë, duke kryer detyrat më poshtëruese që i caktonin murgjit e tjerë.

Sa herë i jepej mundësia, iu kthehej librave. Mirëpo shumë shpejt sivëllezërit murgj i dhanë fund dhe kësaj!

“Eja, eja!” - e thërrisnin. - “Murgu bëhet i dobishëm për manastirin duke lypur bukë, misër, vezë, peshq, mish dhe para, jo duke studiuar!” Kështu, Martini detyrohej të mbyllte librat, të merrte trastën e bukës dhe të fillonte sërish të lypte.

Puna ishte e mundimshme dhe shpesh poshtëruese, por kjo i zhvilloi një vullnet të fortë përmes detyrave të vështira që i caktonin. Martini duroi, pavarësisht se kjo i merrte kohën e librave.

Miqtë e Luterit në universitet u alarmuan nga punët e ulëta që i caktoheshin shokut të tyre të nderuar. Shkuan te kryemurgu i kuvendit dhe si rrjedhojë Martinin e çliruan nga kësi detyrash poshtëruese. Por kjo s’do të thotë se filloi të bënte jetë të këndshme – aspak. Më vonë shkroi kështu për kohën e vet si murg dhe prift: “Unë kam qenë vetë murg për njëzet vjet. E torturoja veten me lutje, agjërime, pagjumësi dhe kallkanosje nga i ftohti; dhe vetë ngrica mund të më kishte vrarë. Më shkaktoi aq dhimbje, sa s’do t’ia shkaktoj më kurrë vetes sërish, edhe po të mundja. E çfarë tjetër kërkoja duke vepruar kështu, përveçse Perëndinë, i cili duhet ta vërente zbatimin tim strikt të urdhrit murgëror dhe jetën time të vështirë? ... Gjithë këtë e bëra për hir të Perëndisë, jo për para apo katandi ... E rraskapita veten me agjërime dhe lutje përtej asaj që ishte normale.” Më vonë, tha: “Po të mundja ta fitoja qiellin me anë të agjërimeve, do ta kisha merituar para njëzet vitesh.”

Rutina e jetës në manastir

Martini iu përkushtua me mish e me shpirt jetës në manastir – madje dhe me zell të jashtëzakonshëm. Qelinë e kishte dy me dy metra. Dyshemeja dhe muret ishin ndërtuar me trungje, dhe vetëm një dritare e ngushtë lejonte që ca rreze drite të binin mbi tryezën e tij të vogël. Zotërimet e tij të pakta ishin karrigia dhe një dollap. Nuk lejoheshin zbukurime, madje as statuja shenjtoreësh – as ajo e Virgjëreshës Mari. S’kishte për të qenë jetë e lehtë në atë dhomë të vogël dhe të ftohtë që Martini do ta quante shtëpi për një kohë shumë të gjatë. Dera e qelisë, që kishte një vrimë të vogël vëzhgimi, nuk duhej kyçur dhe asnjë vëlla murg nuk lejohej që të shkonte për shoqëri në atë qeli. Netëve Martini flinte mbi një dyshek me kashtë dhe mbulohej me një velenxë të leshtë.

Mëkatet ia rëndonin pamasë shpirtin, por tani besonte se do të mund të gjente paqen me Perëndinë. Ai besonte se veprat e tij të drejta do ta qetësonin Perëndinë e zemëruar.

Jeta e manastirit ishte shumë ndryshe nga ajo e universitetit. Ai ishte larguar nga një shoqëri ku liria, të qeshurat dhe miqtë e mirë ishin normale, dhe kishte hyrë në jetën e kuvendit, e cila kërkonte disiplinë shumë të rreptë. Puna e anëtarëve të manastirit ishte qetësia, lutja, vajtimi për mëkatet dhe pritja në heshtje para Perëndisë.

Murgjit duhej të shkonin kudo në heshtje, me duar në mëngët e rrobës dhe me sytë e ulura përtokë. Nuk duhet të flisnin gjatë ngrënies së vakteve dhe, kur murgjit ngrinin gotën e verës ose birrës, duhet ta mbanin me të dyja duart – jo si të paperëndishmit, të cilët pinin me një dorë.

Mbikëqyrja ishte shumë e rreptë dhe çdo të premtë të gjithë murgjit mblidheshin për rrëfimin e mëkateve të kryera kundër rregullave të manastirit. Kur kryemurgu thoshte: “Le të shqyrtojmë mëkatet tona”, të gjithë murgjit shtriheshin barkas përtokë. Pastaj bëhej pyetja: “Çfarë po rrëfeni?”

Kësaj pyetjeje murgjit i përgjigjeshin: “Mëkatet tona.”

Pastaj të gjithë murgjit ngriheshin dhe fillonin t’ia rrëfenin mëkatet njëri-tjetrit: fjetja gjatë praktikës së korit, vonesa për lutje dhe veprimtari të tjera në manastir, gënjeshttrat, të folurit pa vend, guximi për të vështruar ndonjë grua, blasfemia, dehja, tregimi i mëkateve të rrëfestores, mosbindja ndaj mbikëqyrësit, apo dhe falsifikimi i dokumenteve të manastirit. “Shtatë mëkatet vdekjeprurëse” ishin gjithmonë të pranishme në jetën murgërore: krenaria, lakmia, epshi, zemërimi, grykësia, smira dhe përtacia. Pastaj caktoheshin ndëshkimet. Disa mëkate kërkonin që murgjit t’i hanin vaktet të ulur përtokë, ndërsa disa të tjera shlyheshin duke përsëritur pjesë nga psalmet. Ata që kishin bërë mëkate më të rënda ndëshkoheshin me rrahje, ndërsa ata që kishin bërë më të rëndat fare burgoseshin.

Paqe me Perëndinë

Martini e mori me shumë përgjegjësi zotimin e bindjes. Murgjve u ishte mësuar se belbëzimi gjatë thënies së lutjeve është mëkat; po kështu konsiderohej mëkat nëse harrohej një fjalë gjatë këndimit. Shumë murgj s’donin t’ia dinin për këto gjëra, por Martini e mori gjithçka seriozisht. Ai

tmerrohej nga mendimi se mund të përballej me Krishtin e zemëruar me mëkate të pafalura në ditën e gjykimit.

Për shkak të izolimit, Martini iu bë shumë e ndjeshme ndërgjegjja. Fryma e Shenjtë po punonte me hir në jetën e atij që do të ndryshonte botën. Martini shpresonte të gjente paqe me Perëndinë në manastir, por s'gjeti kurrësi qetësim shpirtëror aty. Ishte thellësisht i vetëdijshëm për mëkatet, por murgjit e tjerë s'ia kuptonin dot shqetësimin shpirtëror dhe s'ndihmonin dot për këtë trazirë shpirti. Studionte shkrimet e Augustinit, peshkopit të Hipos³¹, si dhe shkrimet e Zhersonit³² dhe Okamit, të cilët shkruanin kundër fuqive të përkohshme që pretendonte papa i Romës.

Pastaj Martini bëri një zbulim të mahnitshëm: gjeti Biblën e stërmadhe të manastirit, e cila ishte lidhur me zinxhir te foltorja e kishëzës. Ato fjalë të shkruara në latinisht ishin si ujë për shpirtin e tij të tharë. I lexoi dhe i rilexoi Shkrimet, duke mësuar përmendësh pjesë të shumta. Kaloi shumë e shumë orë duke medituar për fjalën e Perëndisë dhe duke u lutur për përndritje shpirtërore; dhe, teksa bënte kështu, filloi të zbulonte teologjinë e Augustinit në shkrimet e apostullit Pal.

Për ta kuptuar më mirë Shkrimin, filloi të studionte hebraishten dhe greqishten. Kaq thellë e studionte Fjalën e Perëndisë, sa filloi t'i anashkalonte kohët e lutjes dhe e pa të nevojshme që t'i kryente në një kohë të mëvonshme. Kaloi shumë kohë pa gjumë; një herë kaloi shtatë javë pa gjumë të rregullt. Ushqyerjen e nevojshme e anashkaloi dhe, në një rast, agjëroi për katër ditë rresht, pa ngrënë e pa pirë. Më në fund hëngri vetëm një copëz të vogël buke me një cironkë të vogël. Nga agjërimet e tepruara, filloi të ngjante si kufomë që ecte, me sytë e fryra që i mbante përtokë dhe me kocka të dala. Në një rast nuk shkoi për lutje dhe, kur të tjerët shkuan ta kërkonin, e gjetën pothuajse të pavetëdijshëm në dyshtemenë e qelisë. Lexojmë: "Një mëngjes dera e qelisë së tij nuk ishte e hapur si zakonisht dhe vëllezërit u alarmuan. Trokitën. S'pati përgjigje. E shpërthyen derën dhe e gjetën të gjorin frat Martin të shtrirë përtokë në gjendje dalldie; mezi merrte frymë dhe pothuajse po vdiste. Një murg ia mori flautin dhe filloi t'u binte dalëngadalë disa këngëve që Luteri i donte shumë, derisa e rimori veten."

Martini ishte murg shumë i shenjtë, por, pavarësisht çdo përpjekjeje për të gjetur paqen me Perëndinë, nuk ia doli. Nuk e kuptonte se shpëtimi është dhuratë falas nga Perëndia i hirit. Më vonë i shkroi dukës Giorg të

Saksonisë³³, ku i shpjegonte se kishte qenë murg i mirë: “Isha vërtet murg i përshtirshëm dhe i ndiqja rregullat e urdhrit tim me aq rreptësi, sa s’ shpreh dot me fjalë. Nëse do të kishte ndonjëherë një murg që mund ta fitonte parajsën me vepra murgërore, me siguri që këtë të drejtë do ta kisha dhe unë. Për këtë gjë mund të dëshmojnë gjithë fretërit që më njohin. Po të kisha vazhduar dhe shumë kohë, vetëmohimet do t’i kisha vazhduar deri në vdekje, nëpërmjet pagjumësive, lutjeve, leximeve dhe punëve të tjera.”

Martini e kuptonte se drejtësia e Perëndisë çonte në dënimin e mëkatarit, por s’ kuptonte dot se si mund ta shpëtonte Perëndia mëkatarin në “drejtësinë e vet [të Perëndisë]”, sepse drejtësia e Perëndisë kërkonte ndëshkimin e mëkatarëve. Nuk gjeti dot ndihmë te sivëllezërit murgj, por vazhdoi të lexonte Shkrimin dhe shkrimet e Etërve të Kishës, sidomos ato të Augustinit.

Sa më shumë i rëndohej në shpirtin e ndjeshëm vetëdija për mëkatin, aq më shumë i shtoej angështia shpirtërore. Shqyrtonte zemrën dhe mendjen për të zbuluar se ku kishte dështuar në detyrën e tij. Për këtë periudhë të jetës, dikur tha: “Pashë se isha mëkatar i madh në sytë e Perëndisë dhe nuk më dukej e mundshme që t’ia fashisja zemërimin me meritat e mia.” Pyeti veten: “Çfarë rregullash të urdhrit kam anashkaluar – ose, nëse kam dështuar në diçka, a nuk më janë fshirë mëkatet nga pendesa dhe lotët? Por, megjithatë, ndërgjegjja më thotë se mëkati nuk më është falur. Pse kështu? Mos vallë, tek e fundit, këto rregulla janë shpikur nga njeriu? Mos nuk arrihet dot shenjtëria me ato vepra që po mundohem t’i kryej dhe me ato vetëmohime, të cilave po iu nënshtrohem? Kam nevojë për ndryshim veshjeje, apo zemre?”

Në mundimin e vet shpirtëror, vazhdoi t’i këlthiste Perëndisë për urtësinë që i nevojitej për të kuptuar se çfarë mësojnë Shkrimet.

Mesha e parë si prift i shuguruar

Martini i kaloi një nga një hapat që çonin te shugurimi si prift. Në fillim e shuguruan nëndhjak, pastaj dhjak dhe në fund e shuguruan prift; kështu ishte në gjendje të drejtonte meshën. I lejuan të ftonte të afërmit dhe miqtë që të ishin të pranishëm në atë ngjarje të rëndësishme. Kështu veproi dhe, kur mbërriti ajo ditë, i ati mbërriti me kalë, i shoqëruar me njëzet miq dhe të afërm të Martinit. Johan Luteri ende ishte i pezmatuar nga vendimi i të birit

për të hyrë në manastir, por filloi sërish t'i drejtohej me fjalën më të respektuar "Ihr". Me atë rast i dhuroi njëzet gulden³⁴ manastirit.

Dhe, kështu, më 2 maj 1507, Martini u shugurua prift nga Jeronimi, peshkopi i Brandenburgut³⁵.

I ati ende i mbante mëri të birit për jetën e re që kishte nisur dhe i kujtoi se duhej t'i ishte bindur urdhërimit të katërt (në besimin protestant, urdhërimi për marrëdhënien mes prindërve dhe fëmijëve është i pesti) dhe të kishte respektuar dëshirat e babait dhe nënës, duke vazhduar studimet për jurisprudencë. Kur Martini i përmendi rastin e vetëtimës, i ati i tha se ndoshta kjo kishte qenë vepër e djallit. Kur Martini iu përgjigj se mund t'u shërbente të gjithëve me jetën e tij të lutjes dhe përsëritjes, i ati ia ktheu: "Mirë do ishte po të ishte e vërtetë." Martini u trondit nga fjalët e të atit dhe kjo çarje mes babait dhe të birit vazhdoi për shumë vjet. Madje, babë e bir u pajtuan vetëm pasi Martini u martua dhe lindi djalë. "Atëherë im atë më fali dhe u bëra sërish biri i tij i dashur", shkroi më vonë Martini.

Ndikimi i Shtaupicit

Martinit i rëndonte shumë në shpirt angështia shpirtërore. Kur arriti kulmin e dëshpërimit, në jetën e tij hyri një njeri që, nën Perëndinë, do ta udhëhiqte te drita shpirtërore – ai njeri, Johan Shtaupici³⁶, ishte vikar i përgjithshëm³⁷ (mëkëmbës) i peshkopit të augustinianëve në Gjermani. Ishte njeri i drejtë dhe shqetësohej nga ligësitë shpirtërore të kohës. Për Martinin hulumtues, ai ishte dritë shpirtërore në botën e tij të errët. Ishte ndër të paktët njerëz, të cilëve u ishte ripërtërirë zemra nga Fryma e Krishtit. Kur ai vizitoi manastirin e Erfurtit, vuri re trupin e rrënuar të një djaloshi shumë të trishtuar. Kuptoi se Martini ishte një njeri që po rrugëtonte në një shteg që e kishte përshkuar dhe ai vetë para shumë vitesh. Kështu bëri të pamundurën që të miqësohej me murgun e ri dhe të angështuar dhe, për të parën herë, Martini e kuptoi se kishte gjetur dikë që ia kuptonte gjendjen e vështirë shpirtërore. Ia zbrazti zemrën Johan Shtaupicit dhe i shpjegoi se ia kishte frikën Perëndisë, për shkak të mëkateve. I rrëfeu Shtaupicit se i thyente lehtësisht zotimet dhe se tmerrohej nga mëkatet e veta; i tregoi se dridhej me frikë, kur meditonte për shenjtërinë e Perëndisë. I tha se s'shihte fare mëshirë te Perëndia, por vetëm tmerrin e një dite të frikshme gjykimi. Vite më vonë, Martini do të thoshte: "Ia mbathnim nga Krishti si nga djalli

dhe vraponim te Virgjëresha Mari dhe Shën Barbara, sepse na mësonin se çdo njeri duhet të dalë përpara gjykatores së Krishtit me veprat e veta ... Shpesh tmerrohesha nga emri i Jezusit dhe, kur mendoja për të në kryq, më dukej sikur më godiste rrufeja. Kur dëgjoja që ia përmendnin emrin, mendoja se do ta kisha më të lehtë po të dëgjoja emrin e djallit, sepse besoja se vetëm me vepra të mira mund ta bëja Krishtin shokun tim të hirshëm dhe, në këtë mënyrë, mund të pajtohesha me Perëndinë e zemëruar.”

Kështu, dy miqtë vazhduan të kuvendonin dhe i mençuri Johan Shtaupici kuptoi se Martini kishte nevojë t’u kthente shpinën mëkateve dhe angështisë shpirtërore dhe të shkonte te Shpëtimtari, Jezu Krishti, dhe te drejtësia e tij.

“Pse e torturon veten me këto mendime? Këqyr plagët e Krishtit”, - i tha Shtaupici. - “Shih gjakun që Krishti derdhi për ty; aty do të të shfaqet hiri i Perëndisë.”

Martini iu përgjigj me pikëllim: “Nuk mundem dhe nuk guxoj të shkoj te Perëndia, pa u bërë njeri më i mirë; nuk jam penduar ende mjaftueshëm.”

“Njeri më i mirë!” - ia ktheu Shtaupici. - “Krishti nuk erdhi për të shpëtuar njerëzit e mirë, por mëkatarët. Duaje Perëndinë dhe ke për t’u penduar; nuk ka pendesë të vërtetë që nuk fillon me dashurinë e Perëndisë; dhe dashuria e Perëndisë nis kur kupton atë mëshirë që u ofron mëkatarëve lirinë nga mëkati me anë të gjakut të Krishtit!”

Në këtë mënyrë, Johan Shtaupici e drejtoi Martinin te I shenjtë që mund t’i jepte paqen në zemër, për të cilën kishte shumë nevojë. Përpara se të largohej nga manastiri, mëkëmbësi i peshkopit i dhuroi Martinit atë që do të bëhej zotërimi i tij më i vyer: një Bibël që mund ta quante të vetën. Kur i dha në dorë Biblën, Shtaupici e këshilloi: “Studimin e Shkrimeve bëje kohën tënde të preferuar.” Johan Shtaupici ishte një nga krerët e parë të një urdhri murgëror që u shpërndante falas Bibla murgjve nën mbikëqyrjen e vet.

Një rreze drite shpirtërore regëtiu në shpirtin e Martinit, por rruga drejt paqes shpirtërore kishte për të qenë e mundimshme. Pak kohë pasi Johan Shtaupici u largua nga manastiri, Martinit iu rikthye frika. U sëmur dhe e vizitoi një murg që ishte i krishterë i sinqertë. Murgu plak iu ul përbri shtratit dhe, me zë të ulët, i recitoi Besoren e Apostujve. Kur dëgjoji murgun plak të thoshte: “unë besoj në faljen e mëkateve”, Martini i përsëriti këto fjalë të çmuara.

“Jo,” - iu përgjigj murgu, - “ti nuk duhet të besosh thjesht në faljen e mëkateve të Davidit apo të Pjetrit; duhet të besosh në faljen e mëkateve të

tua.”

Këto fjalë e goditën drejt e në zemër Martinin. E kuptoi se falja nuk blihej dot me vepra. Po niste të kuptonte se Perëndia i kishte falur mëkatarët e penduar, nëpërmjet veprës shpëtuese të Birit të vet, Zotit Jezu Krisht; kështu, iu përmirësua shëndeti shpirtëror dhe u bë mirë edhe fizikisht. Sidoqoftë, përpara kishte ende një shtegtim të gjatë shpirtëror.

Një qëndrim i shkurtër në Vitenberg

Gjatë kohës në manastirin e Erfurtit, Shtaupici kishte vendosur që Martinin t'i jepej ndonjë detyrë e veçantë shpirtërore, që t'ia sprovonte mendjen. U vendos që, më 1508-n, një vit pas shugurimit prift, ta transferonin në Vitenberg, ku do të jepte mësim në universitetin e sapothemeluar aty. Vitenbergu ishte fshat me rreth dymijë banorë dhe studentë, i vendosur përbri lumit Elbë dhe, ndonëse zonë e varfër, kishte natyrë të bukur. Ajrin e kishte të pastër dhe të këndshëm për dikë që vinte nga një qytet i madh, por kushtet e pastërtisë ishin shumë të këqija dhe kishte shumë sëmundje të përhapura në popullsi.

Universiteti kishte njëzet e dy profesorë, shumica të urdhrit augustinian, të cilët u jepnin mësim rreth dyqind studentëve. Arsimi universitar në kohën e Martinin nuk ishte si sot. Studentët i nisnin studimet në moshën dymbëdhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjeç dhe kualifikimi për pranim në universitet nuk ishte shumë i vështirë. Broshura që reklamonte Universitetin e Vitenbergut lajmëronte se kostoja e jetesës ishte shumë e lirë: tetë gulden mjaftonin për të paguar shpenzimet e një viti.

Martini eci shumë kilometra derisa mbërriti në Vitenberg dhe udhëtimi ishte i rrezikshëm. Si murg, duhej të ecte me sytë e ulur përtokë dhe me duart në mëngët e rrobës. Rrugët ishin thjesht shtigje me brazda të thelluara, ku kishin ecur udhëtarë të tjerë. Nëpër shkurre zinin pusi kusarët, ndaj ecja në ato rrugë ishte shumë e pasigurt.

Kur Martini mbërriti në shtëpinë e re, profesorët e tjerë e pritën shumë ftohtë; aty për aty i dhanë për detyrë që të jepte mësim dhe leksione për shkrimet e Aristotelit (për të cilin ndiente neveri), si dhe lëndën e etikës dhe fizikës. Gjatë kësaj periudhe në Vitenberg, mori diplomën “Baçelor” të Biblës. Mirëpo pas pak, kohës së Martinin në Vitenberg i erdhi fundi. Dokumentet e universitetit shprehen se ai nuk e kishte bindur trupën mësimore të universitetit, kurse Martini thoshte se problemi i vërtetë ishte se

i mungonin burimet financiare për të siguruar jetesën. S'i kërkonte dot të atit ta ndihmonte; as manastiri i Erfurtit s'ishte në gjendje t'i vinte në ndihmë. Kështu, Martini u kthye në Erfurt, ku dha mësim dhe iu vu me mish e me shpirt studimit të hebraishtes.

Trazira në Erfurt

Pas kthimit të tij në manastir, në qytet u krijua njëfarë trazire civile. Disa këshilltarë bashkiakë s'arritën t'i administronin mirë financat e bashkisë; kështu, u rritën taksat për të mbuluar kreditë e marra. Disa nga studentët u përfshinë nëpër demonstrata dhe kjo çoi në trazira civile; si pasojë, u dogjën disa godina të rëndësishme të universitetit dhe u shkatërrua biblioteka. Shumë libra u dogjën dhe kjo gjë e shqetësoi së tepërmi Martinin. Edhe më shqetësuese ishin vdekjet që shoqëruan trazirat. Që prej asaj kohe, ai tmerrohej nga trazirat qytetare dhe shpesh argumentonte se nënshtetasit duhej t'i bindeshin gjithmonë qeverisë, përveçse atëherë kur ligjet e qeverisë binin ndesh me ligjet e Perëndisë. Ai shprehej se nuk kishte përligje për kryengritjen ndaj autoriteteve civile.

Më vonë, shkroi pamflete, ku jepte arsye biblike kundër mosbindjes civile. Tha dhe një sërë shëmbëlltyrash që nënvizonin pozicionin e tij:

“Lexojmë për një vejushë, e cila u ngrit dhe u lut për tiranin e saj me shumë përkushtim, ku i kërkoi Perëndisë që t'i jepte atij jetë të gjatë etj. Tirani e dëgjoi dhe u mahnit, sepse e dinte shumë mirë që i kishte rënë shumë në qafë asaj dhe se kjo nuk ishte lutje e zakonshme për tiranët. Njerëzit nuk luten zakonisht me këto fjalë për tiranët, kështu që ai e pyeti pse u lut ashtu për të. Vejusha iu përgjigj: ‘Kisha dhjetë lopë, kur jetonte dhe sundonte gjyshi juaj. Ai m'i mori dy dhe u luta që të vdiste, dhe që pushtetin ta merrte babai juaj. Kështu ndodhi; mirëpo, ati juaj më mori tri lopë. U luta sërish që të bëheshit ju sundues dhe që të vdiste babai juaj. Por, tani, ju më more katër lopë, ndaj po lutem për ju, sepse tani kam frikë se pasardhësi juaj do të më marrë lopën e fundit dhe gjithçka timen.’ Dijetarët tregojnë edhe shëmbëlltyrën e një lypësi, i cili ishte i mbushur me plagë. Mizat i hynin në plagë, ia thithnin gjakun dhe e thumbonin. Pastaj, aty pari kaloi një njeri i mëshirshëm dhe u përpoq ta ndihmonte, duke ia larguar mizat. Por lypësi i bërtiti dhe tha: “Çfarë po bën? Ato miza për pak

do të ngopeshin dhe s'po më binin shumë në qafë; tani, në vend të tyre do të vijnë mizat e uritura dhe do të më torturojnë shumë më keq.”

I kuptoni këto fabula? Mes ndryshimit të qeverisë dhe përmirësimit të saj ka një hendek aq të madh, sa ai mes tokës dhe qiellit. Është e lehtë ta ndryshosh qeverinë, por e vështirë të gjesh një tjetër më të mirë; madje, rreziku është se s'ke për ta gjetur dot. Pse? Sepse kjo s'është në vullnetin apo fuqinë tonë, por varet vetëm nga vullneti dhe dora e Perëndisë. Mirëpo turma e çakërdisur do më shumë që gjërat të ndryshohen, sesa që gjërat të përmirësohen. Pastaj, nëse situata përkeqësohet, do të kërkojnë diçka ndryshe. Kështu, në vend të mizave do të marrin grerëza dhe, në fund, në vend të grerëzave do të marrin grerëza të mëdha.”

Martini vazhdoi të jepte mësim dhe të luante rol aktiv në punët e manastirit. Miqësia e tij me Shtaupicin, mëkëmbësin e peshkopit, u forcua dhe më tej, por ende nuk kishte arritur të gjente paqen me Perëndinë.

5. Udhëtimi në Romë

Kur lindi një mosmarrëveshje mes mäkëmbësit të përgjithshëm dhe shtatë prej manastireve augustiniane, u mor vendimi që çështja t'i kalohej Papës për gjykim. Komuniteti augustinian ishte ndarë në dy pjesë: njëra pjesë zbatonte rreptësisht rregullat e urdhrit, ndërsa tjetra ishte më e lirshme në zbatimin e tyre. Kur u hodh propozimi për bashkimin e dy grupeve, shpërtheu mosmarrëveshja. Martinin e urdhëruan që të shoqëronte një murg tjetër, i cili do të paraqiste argumentin e palës që kundërshtonte bashkimin. Grupimi që përfaqësonte ai druhej se nga bashkimi gjithë urdhrin do ta kaplonte lëshimi ndaj rregullave.

Rrugës për në Romë

Martini duhet të jetë ndier shumë i nderuar që e caktuan të ishte një nga dy vëllezërit që do t'i çonte faktet e çështjes në Romë. Kështu, në vitin 1510 (disa thonë 1512), Martini hodhi hapin e parë drejt “qytetit të shenjtë”. Si gjithë katolikët e devotshëm, e kishte patur ëndërr të shkonte për pelegrinazh në vendbanimin e papëve, në qytetin që, me gjasë, besonte se ishte qendra e tokës.

Si prift besnik, priste të bekohej tej mase nga kjo vizitë. Për qytetin e përjetshëm kishte lexuar vetëm në libra, ndonëse kishte folur dhe me priftërinj që kishin vizituar Romën papnore. Për Martinin, qyteti i Romës ishte si “shenjtërorja e shenjtërore” në tempullin e lashtë të Jerusalemit. Po kështu, e dinte se nga ky lloj pelegrinazhi mund të fitonte shumë ndjesa të vyera. Kjo mund të arrihej, nëse besimtari vizitonte vendet e shumta të shenjta, nëse thoshte mesha dhe nëse zvarritej nëpër shkallët e njohura si Scala Sancta³⁸, ose Shkallët e Shenjta në kishën e Lateranos³⁹. Megjithatë, përpara se të kryheshin këto vepra pendese, duhej ndërmarrë një rrugëtim i gjatë.

Pa dyshim, Martini dhe sivëllai i tij ishin të entuziazmuar nga ajo që i priste. Ishin rrugëtarë të vërtetë që vinin nga frontet e Kishës Katolike dhe prisnin që së shpejti të shihnin me sytë e tyre ‘Atin e shenjtë’, papën Julin II⁴⁰.

Më në fund, rrugëtarët e rraskapitur mbërriten te një manastir i mirënjohur benediktin, që ndodhej në brigjet e lumit Po. Ishte hera e parë që Martini përballej me luksin e Kishës Katolike. Në Gjermani ishte mësuar

me jetesën kursimtare, njësoj si shumica dërrmuese e murgjve, por tani po përballej me murgj që bënë një jetë të rehatshme. Ky kuvend benediktin kishte të ardhura vjetore prej 36 000 dukatesh; pjesën më të madhe të tyre murgjit e shpenzonin për vete. Aty s'kishte qeli bosh me mobilje të pakta, si qelia e Martinit në Gjermani. Këtu qelitë ishin apartamente të shtruara me mermer, mobiloheshin vetëm me mobiliat më të mira dhe më të rehatshme, dhe mureve u jepnin hijeshi piktura të shtrenjta.

Murgjit visheshin me mëndafshin më të mirë dhe me veshje kadife, ndërsa tryezat kërcisnin nga pesha e ushqimeve të shijshme, të gatuar në mënyrën më të shkëlqyer. Gjithë kjo e tronditi Martinin, i cili ishte mësuar me qelitë e zbrazura dhe hante ushqimet më të thjeshta. E dinte se zakonet e jetesës së këtyre murgjve nuk përputheshin me pritshmëritë e Kishës dhe, ndonëse donte të fliste hapur kundër kësaj shkapërderdhjeje, nuk foli deri të premtën e parë në atë manastir. Kisha e ndalonte ngrënien e mishit në atë ditë agjërimi, mirëpo në tryeza u shtruan të njëjtat ushqime si çdo ditë tjetër të javës.

Martinin i erdhi në majë të hundës dhe ngriti zërin që ta dëgjonin të gjithë: “Në një ditë si kjo, këto gjëra nuk mund të hahen. Papa i ka ndaluar!”

Sigurisht, murgjit benediktinë s'ua varën shumë vizitorëve murgj nga Gjermania dhe vazhduan të hanin ushqimin e ndaluar. Mirëpo disa filluan të shqetësoheshin se mos u dilte nami për teprimet e tyre, kështu që bënë plane ta hiqnin qafe gjermanin problematik. Një derëtar i njerëzishëm e paralajmëroi Martinin për planet e tyre dhe ai e miku i vet u larguan pa vonesë nga manastiri.

Kur dy murgjit arritën në Bolonjë, Martini u sëmur aq rëndë, sa mendoi se do të vdiste. Në shtratin ku dergjej, në mendje i vinte vazhdimisht një pjesë e Shkrimit: “I drejti do të rrojë me anë të besimit.” Aty, i shtrirë në shtrat, kaloi kohë duke shqyrtuar thellësitë e kuptimit të këtyre pak fjalëve. Ishte i vetëdijshëm se shpëtimi vjen me anë të besimit në Krishtin, por ende s'e kishte rrokur dot doktrinën madhështore të shfajësimit me anë të besimit. Në atë kohë, Martini e kishte të pamundur të kuptonte të vërtetën madhështore se drejtësia shpëtuese vjen vetëm nga Krishti; kjo drejtësi u transmetohet të gjithë atyre që gjejnë shpëtim në Krishtin.

Kur mori fuqi aq sa të udhëtonte, u nisën të dy për në vendndalesën e radhës, që ishte Firenzeja, djepi i Rilindjes. Në atë qytet italian ishin prodhuar vepra të mëdha arti dhe, në atë vend, familja sunduese Medici

kishte mbështetur financiarisht artistët më të mëdhenj të botës. Ndërsa, për Martinin, Firenzeja njihej më mirë për një tjetër arsye: ishte qyteti ku, më 1498-n, Savonarola⁴¹ ishte djegur në turrën e druve. Krimi i tij? Kishte denoncuar hapur shprishjen e Kishës Katolike. Po kështu, kishte guxuar t'u mësonte të tjerëve se Fjala e Perëndisë ka epërsi mbi mësimin e papëve. Përpos kësaj, Savonarola kishte vënë në dyshim vlerën e veprave të mira për të fituar hirin e Perëndisë. Ai u kishte mësuar të tjerëve se njerëzit shpëtohen me anë të jetës dhe vdekjes së Jezu Krishtit. Savonarola pati shkruar: “Besimi jo vetëm që është dhuratë dhe vepër e Perëndisë, por, madje, vetëm ky besim e shfajëson njeriun, pa veprat e ligjit.”

Për ato mësimë, Savonarola kishte vdekur si martir në flakët që pati ndezur Roma. Përveç kësaj, Martini habitej nga shthurja që shihte në popull dhe në kler. Në çdo vend kryheshin krime të tmerrshme, por ajo që e tronditi mbi gjithçka ishte përçmimi që kleri shfaqte për aktivitetet fetare. Ligji i Kishës përçmohej nga krerët e Kishës, ndërsa priftërinjtë gëzoheshin që mashtronin popullin për besimin që, sipas tyre, përbënte rrugën e vetme për në parajsë.

Mbërritja në Romë

Martini dhe shoku i vet vazhduan përpara dhe, pas pak, në largësi, sytë e tyre shquan për herë të parë Romën, “Mbretëreshën e Kombeve”. Ishte fillimi i verës dhe dielli vezullonte mbi ndërtesat dhe kullat e qytetit. Me zemër të mbushur gjithë krenari dhe gëzim, me lot mahnitjeje në sy, Martini ra në gjunjë dhe bërtiti: “Romë e shenjtë, të përshëndes!”

Ata të dy kishin ardhur në Romë në emër të krerëve të vëllazërisë augustiniane. Meqë argumentimin e çështjes përpara personaliteteve kishtarë do ta kryente shoku i tij, Martini kishte shumë kohë për të vizituar gjithë vendet me vlerë shpirtërore. Gjithsesi, kaloi njëfarë kohe me shokun e vet dhe i la mbresa mënyra e kujdesshme zyrtare me të cilën po trajtohej ajo çështje. Më vonë, u shpreh: “Puna dhe aspektet ligjore të çështjes u dëgjuan, u vlerësuan, u gjykuan dhe u diskutuan në mënyrën më të rregullt të mundshme.” Por, gjithashtu, vuri re numrin e madh të punonjësve të Vatikanit, të cilët merrnin para prej atyre që kërkonin këshilla dhe vendime zyrtare. Njerëzit ishin të gatshëm të paguanin për anulimin e martesave, për përligjen e fëmijëve të lindur jashtë kurore dhe për heqjen e pengesave ndaj

martesave. Shumë shpejt Martini zbuloi se përjashtimet e rregullave të Romës siguronin një burim të vazhdueshëm dhe fitimprurës të ardhurash.

Përpjekjet për të fituar merita duke vizituar vende “të shenjta”

Ishte i vendosur të vizitonte vendet më të shenjta të Romës dhe, në këtë mënyrë, të fitonte ndjesa të vyera për pjesëtarët e vdekur të familjes. Ndjesat e fituara mund të viheshin në llogari të shpitrave që vuanin në purgator; në këtë mënyrë, u shkurtohej koha që duhej të kalonin në ato flakë të tmerrshme, pasi kështu paguhej ndëshkimi i pashlyer për mëkatet e kryera gjatë jetës.

Në Romë vizitoi dhe katakombet, ku i thanë se gjendeshin trupat e 46 papëve martirë dhe e 176 000 besimtarëve nga populli. Ai besonte se ky pelegrinazh do t'i siguronte merita të shumta për njerëzit e tij të dashur që po vuanin në purgator. I kishin thënë se fitoheshin merita të mëdha, nëse vizitonte shtatë kishat e pelegrinëve⁴². E vetmja keqardhje nga ai pelegrinazh ishte se nuk e lejuan të thoshte meshën në kishën e Lateranos, që ishte banesa më e vjetër papnore. Ai vend përbënte interes të madh për vizitorët e shumtë të Romës, por, për shkak të turmave të mëdha të pelegrinëve, Martini e pati të pamundur të thoshte meshën.

Më vonë do të thoshte me humor për këtë pamundësi: “Meqë s'i afrohesha dot, hëngra një harengë të marinuar.”⁴³ Mirëpo në atë kohë u zhgënjye së tepërmi që s'pati mundësi të kryente aktivitetet fetare.

Lateranoja besohej se ishte një dhuratë që perandori Konstandin⁴⁴ ia kishte bërë papës, si simbol i faktit se Evropa perëndimore i përkiste krishterimit, kreu i të cilit ishte papa i Romës. Me interes të madh për gjithë vizitorët ishin Shkallët e Shenjta, “Scala Sancta”, që me gjasë ishin shkallët ku pati ecur vetë Krishti, kur hyri në pallatin e Pilatit në Jerusalem. Besohej se ato shkallë ishin çuar në Romë nga engjëjt e Perëndisë. Kisha mësonte se mund të fitoje merita të shumta, nëse ecje nëpër ato shkallë. Ngjitja me gjunjë e atyre njëzet e tetë shkallëve të siguronte faljen e nëntë viteve në purgator për çdo shkallë. Njëra prej tyre, që ishte shenjuar me kryq, ishte gjoja shkalla ku ishte penguar Krishti. Ajo të siguronte një ndjesë prej tetëmbëdhjetë vitesh. Martini iu ngjit shkallëve më gjunjë, duke thënë nga

një “Pater Noster” (lutjen “Ati ynë që je në qiell”) në çdo shkallë dhe duke puthur gurët mbi të cilët kalonte.

Teksa u ngjitej dalëngadalë shkallëve të Pilatit, mendjen dhe zemrën ia kishte pushtuar një varg nga Bibla: “I drejti do të rrojë me anë të besimit.” Sërish, në mendje filloi të vinte në dyshim vlerën e asaj që po bënte. Pyeste veten nëse përfitonte ndokush vërtet nga veprat e veta? U largua duke menduar: “Kush e di nëse kjo është e vërtetë?”

Kaq të shumta ishin ndjesat që fitoi, saqë Martini u pezmatua që babain dhe nënën i kishte ende gjallë, kështu që s’mund të përfitonin dot nga përpjekjet e tij: “Ah,” - tha me vete, - “sa keq më vjen që babai dhe nëna janë ende gjallë! Sa kënaqësi do të ndieja po t’i çliroja nga zjarri i purgatorit me anë të meshave, lutjeve dhe shumë veprave të tjera të admirueshme.” Megjithatë ishte i vendosur që gjithë meritat që kishte fituar t’i transferoheshin “gjyshit Hajne”; kështu do t’i siguronte çlirimin para kohe nga flakët e purgatorit.

Martini ishte tejet i shqetësuar nga qëndrimi jofetar i klerit katolik. Meshat bërbëliteshin shumë nxitimthi dhe, kur Martini tha me qetësi dhe kujdes meshën e vet, priftërinjtë aty pari i thanë prerë: “Nxito! Përfundoje!” Në një rast tjetër dëgjoji priftërinjtë italianë që talleshin me të teksa thoshte meshën. “Shpejto,” - i bërtiti njëri, - “ktheja të Birin Zonjës sonë!” Sigurisht, ata po talleshin me transformimin e supozuar të bukës dhe verës në trupin dhe gjakun e vërtetë të Krishtit.

Por e pa punën edhe më keq, kur dëgjoji priftërinjtë që talleshin me mënyrën se si mashtronin popullin dhe përqeshnin misterin e meshës. Në vend që të shqiptonin fjalët që gjoja e ndryshonin bukën dhe verën në mishin dhe gjakun e Krishtit, disa priftërinj thoshin: “Bukë je dhe bukë ke për të mbetur; verë je dhe verë ke për të mbetur.”

Pastaj, pasi prifti ngrinte lart bukën dhe verën, bashkësia adhuronte atë që mendonte se ishte trupi dhe gjaku i Krishtit. Kur tregohej kjo histori, priftërinjtë e mbledhur gajaseshin së qeshuri. Kjo e trishtonte së tepërmi Martinin.

Kur mësoi për shthurjen e hapur të kaq shumë klerikëve, që ishin zotuar për beqari, u trondit thellë. Paraja kalonte dorë më dorë, kur kryheshin emërime kishtarë dhe, kur njerëzit caktoheshin për ofiqe kishtarë, favorizoheshin së tepërmi kushërinjtë dhe miqtë. Teksa ecte nëpër rrugët e “qytetit të shenjtë”, Martini dëgjoji shumë vizitorë që thoshin: “Nëse ekziston

ferri, mbi të është ndërtuar Roma.” Ai shtangej nga veset dhe shprishja e atij qyteti të madh. Madje, shumë vjet më vonë, tha kështu për ato që kishte parë: “Sa më shumë i afrohem Romës, aq më shumë të krishterë të këqinj takojmë.”

Brenda qytetit lulëzonte krimi. Papa Juli ishte kaq i shqetësuar për rreziqet që u kanoseshin vizitorëve, sa që e udhëzoi shefin e policisë që të ndërmernte çdo veprim të nevojshëm për t’i vënë fre dhunës. Siç bën të ditur Martini, veprimi i policisë ishte shumë i ashpër: “Gjykatësi ose kapiteni patrollojnë qytetin natë për natë majë kalit me një shpurë prej treqind vetësh; arrestojnë çdokënd që gjendet në rrugë: po hasen ndonjë të armatosur, e varin ose e hedhin në lumin Tiber. Por prapëseprapë qyteti është i mbushur me trazira dhe vrasje; ndërsa në ato vende ku Fjala e Perëndisë predikohet me drejtësi dhe dëlirësi, mbizotëron paqja dhe rendi, pa qenë nevoja për ashpërsinë e ligjit...”

Në librin *Biseda rreth tryezës*⁴⁵, Martini citon kardinalin katolik Bembo⁴⁶, që tha për Romën dhe qytetarët e saj: “Roma është një moçal i ndyrë erëqelbur, i mbushur me maskarenjtë më të ligj të botës.”

Një udhëtim për të mos u humbur

Pavarësisht gjithë këtyre ligësive, Martini ishte i kënaqur që vizitoi selinë e Kishës Katolike. Ai ishte prift i saj dhe kishte besim në doktrinat e saj. Më vonë, për vizitën e tij në Qytetin e Shenjtë, do të thoshte: “Edhe sikur të më jepnin njëqind mijë monedha floriri, s’e lija pa e parë Romën.” Megjithatë, për shkak se pa ligësitë e saj dhe ndjeu shthurjen erëqelbur të këtij qyteti, shkroi: “Shkova në Romë me qepë dhe u ktheva me hudhër.”

Si përfunduan dy javët e qëndrimit në Romë, ishte koha të kthehej në Gjermani dhe t’i raportonte mëkëmbësit të përgjithshëm augustinian, dr. Johan fon Shtaupicit, se misionin e përfunduan me sukses. Këtë e bëri si prift besnik dhe i përkushtuar që pranonte autoritetin absolut të papës së Romës.

6. Në kërkim të paqes me Perëndinë

Pasi u kthye në Erfurt, me porosinë e dr. Shtaupicit, Martinin e transferuan në komunën e Vitenbergut, e cila po fitonte gjithmonë e më tepër emër, ku do të jepte mësim në universitetin e sapothemeluar aty, si dhe do të bëhej predikuesi zyrtar i murgjve augustinianë vendas, të cilët ishin anëtarë të “Kuvendit të Zi”, emër që e kishin marrë për shkak të veladonit të tyre të zi. Në këtë qytet universitar Martini do të kalonte gjithë pjesën tjetër të jetës. Popullsia e qytetit ishte e vogël; numëronte rreth dy mijë e pesëqind banorë. Sidoqoftë, Universiteti i Vitenbergut ishte krenaria dhe gëzimi i Elektorit Frederik të Saksonisë. Ai e kishte themeluar universitetin me shpresën që ky do t’ia rriste famën emrit të tij.

Vitenbergu ishte ndërtuar në brigjet e lumit Elbë dhe aty ku s’rridhte Elba rreth tij ishte ndërtuar një hendek me ujë. Zona e pyllëzuar rreth qytetit gjallonte me kafshë gjahu, ndërsa kopshtet e shumta përbri Elbës prodhonin drithë, perime dhe fruta. Por ai që e bëri Vitenbergun komunë të famshme ishte universiteti i sapothemeluar. Aty Martini shpresonte të jetonte në paqe në kuvendin augustinian dhe do të gjente paqen e vërtetë me Perëndinë. Mirëpo rruga drejt paqes ishte e gjatë dhe gjarpëruese.

Martini e dinte se ishte mëkatar dhe se Perëndia është i zemëruar me mëkatarët. Madje, e dinte se Perëndia është “zjarr shkrumbues” për gjithë ata që s’u janë falur mëkatet. I druhej dhe Zotit Jezu Krisht, Gjykatësit të njerëzimit, sepse ai i flakte mëkatarët në ferr. Kur lexoi Biblën dhe gjeti fjalët “drejtësia e Perëndisë”, zemra iu mbush me tmerr nga Krijuesi i tij. Në atë pikë të shtegtimit shpirtëror, për Martinin “drejtësi e Perëndisë” do të thoshte zemërim, pasi drejtësia e Perëndisë kërkonte që mëkatarët të ndëshkohen për paudhësitë e tyre. Zjarri i purgatorit dhe i ferrit ishte kaq i vërtetë për të, sa që filloi ta urrente drejtësinë e Perëndisë dhe Perëndinë e drejtësisë.

Orët e kaluara në rrëfestore

Me bindjen se rrëfëstorja dhe veprat e pendesës çonin në gjetjen e paqes shpirtërore, Martini hynte pothuajse përditë në rrëfestore dhe rrëfente çdo mëkat që kishte kryer. Sigurisht, përballej me problemin se nuk mbante dot

mend çdo mëkat dhe jetonte me frikën se mos disa shkelje nuk i ishin falur. Po kështu, ishte i vetëdijshtë se njerëzit lindin me natyrë mëkatore, por nuk e kuptonte dot se si mund ta hiqte qafe atë natyrë mëkatore. Priftërinjtë e tjerë detyroheshin të uleshin përditë me Martinin dhe të dëgjonin rrëfimet e tij. Një ditë, pasi dëgjoji për gjashtë orë rrëfimin e Martininit, një prift bërtiti: “O njeri, nuk është i zemëruar Perëndia me ty, por ti me Perëndinë. Nuk e di se Perëndia të urdhëron që të shpresosh?”

Dr. Shtaupici shihte te Martini një të ri që po ecte në të njëjtin shteg që kishte përshkuar dhe ai vetë para shumë vitesh. Shtaupici e kishte gjetur paqen me Perëndinë nëpërmjet besimit në Zotin Jezu Krisht, kështu që kaloi shumë orë me Martinin duke i shpjeguar udhën e shpëtimit. Shtaupici, që e donte Perëndinë, i bëri thirrje Martininit që t’i jepte fund përlshjes me të Plotfuqishmin dhe t’i dorëzohej dashurisë së hirshme të Perëndisë që gjendet në Jezu Krishtin. Megjithatë, hera-herës Shtaupici dëshpërohej me Martinin, pasi Luteri priste që ai t’ia dëgjonte listën e pafundme të mëkateve që rendiste në mënyrë të hollësishme, në kohën e rrëfimit.

Një herë, i dëshpëruar, e mori Martinin nënqin dhe i tha: “Shiko, nëse pret që Krishti të të falë, eja këtu me diçka që ka nevojë të falet: vrasje, blasfemi, kurvëri. Jo me gjithë këto mëkate të vogla...”

Martini nisi të studionte shkrimet e Augustinit dhe u përball me mësimin për zgjedhjen hyjnore; pra, se Perëndia ka zgjedhur disa për nderim dhe lavdi, ndërsa disa të tjerë i ka lënë në mëkatet e tyre. Ai e keqkuptoi mësimin biblik për zgjedhjen dhe arriti në përfundimin se, nëse shpëtimin e dikujt e kishte vendosur Perëndia, atëherë ai njeri do të shpëtohej, pavarësisht gjithçkaje që mund të bënte. Po kështu, nëse Perëndia kishte vendosur që dikush të shkonte në ferr, ai njeri s’mund të bënte dot asgjë për të fituar parajsën.

Për dekretin e zgjedhjes së Perëndisë, tha: “A nuk bie ndesh me çdo arsye të natyrshme mendimi se, thjesht ngaqë i teket, Perëndia i braktis njerëzit, i ngurtëson, i dënon, sikur t’i bëhej qejfi për mëkatet dhe për torturat që do të pësojnë këta mjeranë në përjetësi, ndërkohë që na thuhet se ai është i mbushur me mëshirë dhe mirësi? Kjo ngjan e ligë, mizore dhe e padurueshme për Perëndinë, dhe nga kjo gjë shumë njerëz janë fyer në çdo epokë. E kush nuk do të fyhej? Edhe unë vetë, më tepër se një herë, u shtyva deri në buzë të greminës së dëshpërimit, saqë dëshiroja të mos isha krijuar kurrë. Ta doja Perëndinë? Unë e urreja!”

Ndihma nga Dr. Shtaupici

Martini gjeti ndihmë të Shtaupici, i cili e inkurajoi të fillonte studimet e doktoraturës. Më vonë, Martini tha për mikun e vet: “Po të mos kishte qenë dr. Shtaupici, do të isha fundosur në ferr.”

Një ditë, përpara se të transferohej në Vitenberg, dr. Shtaupici e mori mënjane Martinin dhe u ulën së bashku nën një pemë dardhe, në kopshtin e manastirit augustinian, për të diskutuar për të ardhmen. Ai e nxiti Martinin që të studionte për doktoraturën në teologji dhe të vazhdonte predikimin nga Shkrimet. Martini nisi ta kundërshtonte dhe i renditi pesëmbëdhjetë arsye pse duhej të mos lëvizte nga manastiri. Pikësëpari, iu qa për shëndetin e lig.

“Unë jam i dobët dhe shëndetlig,” - u ankua Martini. - “S’më mbetet shumë kohë për të jetuar. Më mirë gjej një njeri të shëndetshëm.”

Mëkëmbësi i përgjithshëm ia ktheu: “Zoti ka punë edhe në qiell, edhe në tokë. Gjallë a vdekur, i duhesh Atij.” Pastaj Shtaupici e urdhëroi Martinin: “Bëj atë që të kërkon kuvendi dhe atë që të urdhëroj unë, mëkëmbësi i përgjithshëm; sepse ti ke premtuar që do të na bindesh.”

Mirëpo Martini s’kishte mbaruar ende: “Po fakti që jam i varfër? S’e kam takatin që të përballoj shpenzimet e kësaj ngritjeje në pozitë.”

Këtij shfajësimi të ri mëkëmbësi i përgjithshëm iu përgjigj: “Mos u shqetëso për këtë, sepse princi të ka bërë nderin që të t’i mbulojë vetë të gjitha shpenzimet.”

Martinit s’i mbetej gjë tjetër veçse t’i bindej!

Luteri dhe doktoratura

Dhe, kështu, së shpejti mbërriti në Vitenberg, i gatshëm të niste punën. Iu fut me mish e me shpirt studimeve dhe, më 19 tetor 1512, Andreas Bodenshtajn fon Karlshtad⁴⁷, mjeshtri i ceremonive, i akordoi titullin “Doktor i Filozofisë”. Posti i drejtorit të fakultetit teologjik në universitet ishte i lirë, pasi miku dhe këshilluesi i tij, dr. Shtaupic, kishte dhënë dorëheqjen; ai ishte i bindur se Martini do të ishte kandidati ideal për këtë punë. Pasi lexoi nga Shkrimet, Martinit i dhanë në fillim një Bibël të mbyllur, pastaj një Bibël të hapur. Pastaj i vunë në kokë një beretë të leshtë e në gisht një unazë floriri dhe, më tej, vijoi pjesa më solemne e ceremonisë, ku ai u zotua kështu: “Betohem se do ta mbroj të vërtetën ungjillore me gjithë forcën time.”

Ngarkesa në rritje

I armatosur me Bibël, nisi t'u jepte leksione studentëve të vet nga Fjala e Perëndisë, ndonëse në atë kohë ende nuk e kishte kuptuar mësimin madhështor të “shfajësimit vetëm me anë të besimit”.

Martini nisi të jepte leksione nga Libri i Zanafillës më 25 tetor 1512 dhe më vonë vijoi me studimin e Librit të Psalmeve, si dhe me letrat e Palit drejtuar Romakëve dhe Galatasve. Detyrimisht, leksionet i jepte kryesisht në latinisht, gjuha e botës studimore, por pas pak kohe filloi të përdorte edhe latinishten, edhe gjermanishten.

Një pjesë e mirë e predikimeve ishin tematike. Demaskonte dehjen dhe shthurjen e shumë studentëve të universitetit. Këto paralajmërime bënë që të fitonte mbështetjen e banorëve të qytetit, të cilët shqetësoheshin për sigurinë e vajzave të tyre. Dënonte shpifjet, që ishin gjë e zakonshme në manastire, dhe demaskonte hapur ligësitë e kishës që kishte për zemër: Kishës Katolike! E dënonte Romën për veset, shthurjen, lakminë dhe blasfemitë që kryheshin brenda mureve të saj. Përpos kësaj, e kritikonte hapur papën Juli II për luftën kundër Venedikut⁴⁸.

Guximi i tij bëri që Martini të bëhej personalitet i njohur që tërhiqte turmat ta dëgjonin kur fliste. Pastaj, më 1515-n, dr. Shtaupici e caktoi Martinin si përfaqësuesin rajonal të Urdhrit të Augustinit, që donte të thoshte se mori si përgjegjësi mbikëqyrjen e njëmbëdhjetë manastireve. Kjo nënkuptonte vizitat, këshillimin dhe mësimdhënien gjatë kontakteve me murgjit e shumë. Në një rast, eci për dy muaj deri në Këln, që të merrte pjesë në një kuvend të urdhrit. Këtë udhëtim e pati shumë të vështirë, pasi iu desh të ecte nëpër një terren të vështirë dhe nuk ishte i pajisur siç duhej për një rrugëtim të tillë. Ky ishte vetëm një nga udhëtimet e shumta që ishte i detyruar të bënte, por angazhimet e shpeshta si folës bënë që fama t'i përhapej anembanë. Pesha e punës u bë kaq e rëndë, saqë ankohej se kishte nevojë për të paktën dy sekretarë që të përballonte gjithë punën shtesë.

Më në fund agimi vjen

Gjatë atyre ditëve të vështira, Martini përleshej ende me problemin e gjetjes së paqes me Perëndinë. Përballej me pohimet biblike që flisnin për “drejtësinë e Perëndisë”. Kur lexonte te Psalmi 71:2: “Në drejtësinë tënde ti më çliron” dhe se drejtësia e Perëndisë gjendej vetëm në ungjill, kuptonte se kishte nevojë për përndritje. Pastaj shihte në Psalmin 30:1, fjalët: “Më çliro

në drejtësinë tënde.” E dinte se ishte përpjekur që dashurinë e Perëndisë ta fitonte me anë të veprave të tij “të drejta”. Por vështirësia për Martinin ishte kjo: nëse drejtësia e Perëndisë i dënon mëkatarët, si mundet kjo drejtësi, që urren mëkatin dhe mëkatarët, t’i falë mëkatarët?

Fjalët e Romakëve 1:17 ia çudisnin vazhdimisht shpirtin e torturuar: “Sepse në të është zbuluar drejtësia e Perëndisë nga besimi në besim; siç është shkruar: I drejti do të rrojë me anë të besimit.”

Në dhomën e tij të vogël në kullën e manastirit, dikur gjatë vjeshtës së vitit 1515, i shkuan sytë te Psalmi 22:1: “Perëndia im, Perëndia im, pse më ke braktisur?” Pikërisht në atë çast iu ndriçua shpirti! Krishti ishte braktisur nga Perëndia, ngaqë ishte bërë mëkat për popullin e vet. Në mendje i erdhi furishëm kjo e vërtetë: gjykatësi, që nëpër piktura pasqyrohej i ulur mbi ylber, ishte bërë i mohuari i gozhduar në kryq. Pikërisht në aktin e gjyqimit të mëkatarit, Krishti ishte bërë si njëri prej popullit të tij mëkatar, kishte mbartur ndëshkimin e tyre dhe kishte marrë pjesë në fajin dhe turpin e tyre.

Tani Martini e kuptoi se ndëshkimin për mëkatet e popullit e kishte paguar vetë Krishti; kuptoi më qartë se kurrë më parë dallimin mes ligjit dhe hirit. Martini e kuptoi se ligji kërkonte: “Më paguaj atë që më detyrohesh!”, ndërsa hiri i Perëndisë shpallte: “Mëkatet të janë falur.” Pikërisht aty, Martini arriti të kuptonte se në Kalvar kishte ndodhur një shkëmbim: mëkatet e tij ishin vendosur mbi Krishtin, ndërsa drejtësia e Krishtit i ishte llogaritur atij. Në atë përjetim në kullë, Martini u prek nga Fryma e Shenjtë e Perëndisë. Tani e vërteta e shpëtimit i ishte shpalosur qartë në zemër dhe në mendje. Pa Krishtin e lartësuar që u bë mish, në mënyrë që të shpëtonte popullin që do të shkonte tek Ai për të marrë hirin shpëtues – dhe këtë nëpërmjet veprës së hirshme të Frymës së Shenjtë.

Tani kishte paqen me Perëndinë, sepse Perëndia ishte në paqe me të nëpërmjet Jezu Krishtit. Të tjerët, përfshi dr. Shtaupicin, kishin luajtur rolin e tyre; e kishin ndihmuar Martinin që të kuptonte doktrinën madhështore të “shfajësimit vetëm me anë të besimit”. Më vonë, ai tha për dr. Shtaupicin se ishte “babai im i parë në këtë mësim”. Kur dr. Shtaupici mësoi për paqen e sapogjetur të Martinit me Perëndinë, për shkak se kishte kuptuar doktrinën e shfajësimit vetëm me anë të besimit, dhe se po predikonte këtë të vërtetë madhështore, deklaroi: “Ti na ke nxjerrë nga gozhutat e derrave dhe na ke çuar në kullotat e jetës.”

Predikimet e tij

Tani predikimi dhe mësimet e Martinit u rigjallëruan. Iu kthye gjuhëve biblike, në të cilat ishin shkruar Shkrimet; në dorë mbante Dhiatën e Regrequisht të Erazmit⁴⁹. Ky libër e shoqëronte pareshtur. Studentët shkonin tufë që ta dëgjonin kur jepte mësim ose kur predikonte të vërtetat madhështore të Shkrimit; shoku i tij, Melanktoni, tha për këtë gjallërim të ri: “Ai i shpjegonte Shkrimet në mënyrë të tillë që, sipas gjykimit të gjithë njerëzve të përkushtuar dhe të mirinformuar, dukej sikur mbi doktrinën kishte lindur një mëngjes i ri pas natës së gjatë të errësirës. Ai nxori në pah dallimin që ekzistonte mes ligjit dhe ungjillit. Përgënjeshtroi gabimin që mbizotëronte asokohe në kisha dhe shkolla, sikur njerëzit e meritojnë faljen e mëkateve me anë të veprave, dhe se bëhen të drejtë përpara Perëndisë me anë të sjelljes së jashtme... Ai shpjegonte se mëkati falet lirisht, për shkak të Birit të Perëndisë, dhe se njeriu e fiton atë bekim me anë të besimit. Luteri nuk i ndryshoi aspak ceremonitë... Mendjet e perëndishme goditeshin dhe depërtoheshin nga ëmbëlsia e kësaj doktrine; të diturit e pranonin me gëzim.”

Sa herë i jepej rasti, Martini u mësonte të tjerëve të vërtetën madhështore të shfajësimit vetëm me anë të besimit. Më 7 prill 1516, i shkroi një mikut të dashur në kuvendin e Erfurtit, murgut Giorg Spenlain, dhe i tha: “Do të më jepte shumë kënaqësi të dija në ç’gjendje e ke shpirtin. A nuk është rraskapitur nga drejtësia e vet? A nuk po merr më në fund frymë lirisht; a nuk po beson në drejtësinë e Krishtit?... O vëllai im i dashur, mëso ta duash Krishtin, madje të kryqëzuar.... Medito me kujdes për këtë dashuri të Krishtit.... Nuk ke për ta gjetur paqen, përveçse në të; duhet të heqësh dorë nga vetja dhe nga veprat e tua. Mëso se me ç’dashuri të madhe Ai hap krahët për ty, t’i merr të gjitha mëkatet, i vendos mbi veten e vet dhe të jep gjithë drejtësinë e vet”.

Gjithsesi, Martini ishte ende anëtar i mirë i Kishës Katolike. Kishte dëshirë të zjarrtë që të shihte reformimin e Kishës që donte ende; një reformim dhe kthim të vërtetat madhështore të Shkrimit. Në fakt, me rizbulimin e doktrinës së lavdishme të “shfajësimit vetëm me anë të besimit”, Martini vendosi një nga shtyllat kryesore të Reformacionit.

Leksionet e tij i largonin dëgjuesit nga Roma dhe ritet e saj dhe i drejtonin te Krishti Shpëtimtar. Ai shpallte se njerëzit janë mëkatarë; nuk kontribuojnë

dot aspak për shpëtimin e tyre. E vërteta se të gjithë janë të vdekur në mëkat, derisa Fryma ua ndryshon zemrën, ishte mesazhi që shpallte ai, tani kryesisht në gjuhën gjermane. Një pjesë e mirë e gjuhës së Martinit do të konsiderohej e ashpër (madje e pagdhendur) sipas standardeve të sotme, por ai u fliste shumë troç mëkatarëve të kohës. Atyre që e kërkonin shpëtimin te drejtësia e tyre, dikur u tha se djalli gëzohej nga gënjeshttrat e Romës dhe u pëshpëriste: “Afrohu këtu, e dashur; po na vijnë mysafirë në ferr.” Krenarëve u thoshte: “Sa i bukur dukesh, o buf i vogël; mos të kanë dalë pendë palloi?” Ndërsa atyre që u dukej vetja të pastër në zemër, u bënte këtë pyetje: “Kur ishe fëmijë në krahët e nënës dhe në gjinjtë e saj, s’ke bërë asnjëherë diçka që mbante erë të qelbur?”

Martini u bënte pareshtur dëgjuesve thirrje për pendim dhe besim në Krishtin.

7. Teceli⁵⁰ dhe ndjesat⁵¹

Kisha e kështjellës së Vitenbergut kishte fituar famë të madhe si depo relikesh të shenjta. Më 1509-n, në katalogun e përpiluar aty ndodhej një listë me pesë mijë e pesë artikuj. Ndoshta relikja më e rëndësishme ishte një gjemb i certifikuar dhe i vërtetë i kurorës me gjemba që ushtarët romakë i kishin vënë mbi kokë Krishtit, përpara kryqëzimit. Ai nuk ishte thjesht një gjemb i vjetër nga kurora; certifikimi thoshte se ishte një nga gjembat që ia kishin shpuar vetullën Krishtit dhe e kishin gjakosur.

Aty gjendeshin dhe shumë relike të tjera: dhëmbë të Jeronimit dhe Augustinit, një qime nga mjekra e Krishtit, 4 qime nga flokët e Marisë, tri copa pëlhere nga veshja e saj, një fije kashte nga grazhdi ku ishte shtrirë Krishti foshnjë, një nga gozhdët që ia kishin ngulur në duar Krishtit kur e kryqëzuan, një copë buke nga darka e fundit, një degë nga shkurrja që digjej e Moisiut, e kështu me radhë sipas listës. papa kishte deklaruar se cilido besimtar që shkonte në kishën e Vitenbergut në Ditën e Tërëshenjtorëve, rrëfehej dhe vizitonte koleksionin e relikeve, do të merrte ndjesa për uljen e kohës në purgator (për vete ose për dikë tjetër sipas dëshirës) me 1 902 202 vite dhe 270 ditë.

Si funksiononte sistemi

Sistemi katolik kërkonte që anëtarët e kishës t'ia rrëfenin mëkatet priftit. Pasi vepronin kështu, prifti shpallte se mëkatet e rrëfyera u ishin falur. Mirëpo, pastaj, prifti i jepte mëkatarit të penduar disa vepra (pendesa) që duhet t'i kryente për të shprehur keqardhjen e vërtetë për mëkatet dhe, në të njëjtën kohë, t'i shërbenin si dënim për shkeljen e ligjit të Perëndisë. Nëse ato pendesa nuk i kryente përpara se të vdiste, shpirti i mëkatarit kalonte në purgator, ku dënimi i jepej përmes flakëve të tmerrshme dhe ndëshkuese të atij vendi të frikshëm torturash. Shpirti hynte në parajsë vetëm pasi ta kishte shlyer plotësisht dënimin.

Më 1516-n, Luteri filloi ta vinte në pikëpyetje sistemin e ndjesave. Ai shtroi një pyetje të thjeshtë: “Si mund të jetë i sigurt besimtari se dënimi i anuluar i është anuluar vërtetë?” Po kështu, shtronte pyetjen se, nëse papa kishte në dispozicion një rezervuar kaq të madh meritash, pse nuk i çlironte të gjithë shpirtrat nga purgatori në emër të dashurisë së krishterë? Po kështu, mësonte se ndjesat nxisnin moskokëçarje për mënyrën e jetesës. Argumenti

ishte ky: Pse të bësh një jetë shenjtërie, kur faljen për përmbushjen e epsheve mishore mund ta fitosh me një shumë parash?

Ndjesat provuan se ishin burim i vyer të ardhurash për Kishën në tërësi. Paratë e siguruara nga shitja e ndjesave përdoreshin për të financuar godinat kishtare, spitalet, rrugët dhe gjithçka tjetër që i tekej atij që ishte në gjendje ta shiste këtë mall të vyer shpirtëror. Madje, Frederiku i Urtë⁵² po e përdorte shitjen e ndjesave që të ndërtonte një urë shumë të nevojshme mbi lumin Elbë. Kur Martini foli hapur kundër këtij mashtrimi shpirtëror, në të vërtetë po sulmonte vetë burimin e financimit të kishës së kështjellës në Vitenberg, si dhe të universitetit ku ai jepte mësim.

Si filloi e gjitha

Më parë ndjesat u jepeshin atyre që merrnin pjesë në kryqëzata dhe rrezikonin jetën për Kishën Katolike. Me kalimin e kohës, ndjesat filluan t'u jepeshin atyre që s'ishin në gjendje të merrnin pjesë në kryqëzata, por kishin burimet financiare për të mbështetur kalorësit që shkonin në luftë. Me kalimin e viteve, shitja e ndjesave u rrit. Në fillim u dhanë si zëvendësim për pendesat që kërkonte Kisha për rrëfimin e mëkateve. Pendesat, si agjërimet, koha e gjatë në lutje, pelegrinazhet dhe, në disa raste të skajshme, dëbimet, zëvendësoheshin me pagesën e një shume parash në arkën e Kishës. Shitja e ndjesave doli se ishte thesar për Kishën. Nëse Kisha kishte në dispozicion meritat e papërdorura të Krishtit dhe shenjtorëve, këto merita mund t'u shiteshin atyre që u nevojiteshin. Në atë kohë, kur besimtarët tmerroheshin nga doktrina e purgatorit, çdo mënyrë për pakësimin e kohës që duhej të kalonin në atë gropë ferri ishte burim ngushëllimi. Kështu, shitja e ndjesave u bë burim i vazhdueshëm financash për Kishën.

Projekti për restaurimin e bazilikës së Shën Pjetrit

Pas vdekjes së papës Juli II, Mediçi (Leoni X⁵³) mori mantelin e Shën Pjetrit. Meqë i donte artet, papati u bë mbrojtësi i gjithçkaje që konsiderohej me vlerë për Evropën e kulturuar. Leoni s'donte t'ia dinte për çështjet shpirtërore; madje ai e konsideronte Kishën dhe ofiqin e papës thjesht si një përrallë madhështore që ishte përçarur nga kohët e hershme.

Leoni filloi ta përdorte Kishën për të financuar restaurimin e Romës. Juli pati nisur punën e restaurimit të kishës së Shën Pjetrit, që besohej se ishte

ndërtuar mbi eshtrat e apostujve Pjetër dhe Pal. Mirëpo i kishte dalë një problem praktik: thesari papnor ishte boshatisur, për shkak të luftërave të shumta të Julit dhe paraardhësve të tij. Leonit i nevojiteshin shuma të stërmëdha për të përfunduar projektet e tij të shumta, veçanërisht kishën e Shën Pjetrit. Kështu, meqë arka e thesarit shpirtëror ishte mbushur citë, tani kishte metodën e përsosur për të mbushur dhe arkën financiare të Kishës. Besimtarëve do t'u shiteshin ndjesat që premtonin uljen e kohës në purgator.

Në Gjermani, Alberti i Brandenburgut⁵⁴, i cili kundër ligjit të Kishës mbante dy poste peshkopi, donte të ngrihej në pozitë dhe të bëhej kryepeshkop i Maincit; me fjalë të tjera, të bëhej kreu kishtar i gjithë Gjermanisë. Pagesa për këtë ofiq ishte caktuar në shumën prej dhjetë mijë dukatesh. Alberti ra dakord që paratë që i nevojiteshin t'i merrte hua nga kompania bankare "Fugër"; pastaj do t'ia kthente të gjitha me interesa. Në atë kohë ai i kishte ende borxh papatit një shumë të stërmadhe parash për peshkopatat që kishte blerë më herët. Alberti fitoi të drejtën për të shitur ndjesat në mbarë Gjermaninë. Gjysma e të ardhurave do t'u jepej bankierëve të "Fugërit", derisa të shlyhej plotësisht borxhi; gjysma tjetër do t'i dorëzohej Leonit, për ta përdorur për ndërtimin e Shën Pjetrit. Albertit iu dha e drejta absolute për shitjen e ndjesave në Gjermani, për një periudhë tetëvjeçare.

Këto ndjesa garantonin kthimin e besimtarit që i blinte, në atë gjendje shpirtërore që kishte patur në çastin e pagëzimit: në përsosmëri! Edhe mëkatet kundër Perëndisë mbuloheshin nga këto ndjesa. Sigurisht, përpara se personi në fjalë të jepte paratë, duheshin rrëfyer mëkatet dhe prifti duhej të shpallte faljen.

Tecel dhe ndjesat

Kështu, murgut domenikan Johan Dizel ose Tecel, iu dha detyra që të shiste ndjesat në mbarë Gjermaninë. Nuk i lejohej të hynte në zonën e famullisë së Luterit; me fjalë të tjera, Vitenbergu ishte jashtë juridiksionit të tij. Që të shiteshin ndjesa "të huaja" në atë zonë nevojitej leja e Frederikut të Mençur; por ai s'kishte për ta lejuar kurrë këtë gjë, pasi kjo binte ndesh me shitjen e ndjesave në Ditën e Tërëshenjtorëve në kishën e tij. Megjithatë, Teceli ia doli të shiste ndjesa në gjithë famullitë përreth, ku shumë vetë nga bashkësia e Luterit kalonin kufirin dhe i blinin këto ndjesa të mahnitshme.

Ndjesat s'ishin të lira dhe çmimi caktohej sipas gjendjes financiare të blerësit. Mbretërit, mbretëreshat dhe princat e Kishës dhe shtetit duhej të

paguanin 25 monedha floriri. Kjo shumë, pastaj, ulej deri në 1 monedhë floriri për ata që kishin të ardhura vjetore prej më pak se njëqind monedhash floriri. Të varfrit duhej të paguanin aq sa mund t'u nxirrej nga xhepi. Ekzistonte një listë e veçantë çmimesh për një larmi mëkatesh: poligamia kushtonte 6 dukate, dëshmia e rreme, 9; vrasja, 8; ndërsa magjia, 2 dukate.

Me këtë mall të vyer, Teceli përshkoi gjithë Gjermaninë. Hynte në çdo qytet i pari, duke mbajtur një kryq të madh të kuq, i cili kishte emblemën e papës. Pastaj vinin priftërinjtë që mbanin mbi një jastëk dekretin e papës – shpalljen zyrtare të papës që jepte ndjesa me pagesë. Ata ndiqeshin nga një karvan mushkash të ngarkuara me arka; aty ishin vendosur ndjesat e shkruara, të gatshme për ata që do të paguanin.

Në portat e qytetit, aty ku mblidheshin turma të mëdha për të parë këtë cirk shëtites, bëhej shpallja: “Hiri i Perëndisë dhe i Atit të Shenjtë është përpara portave tuaja.” Pastaj, pasi hapeshin me pompozitet dhe ceremoni të madhe portat e qytetit, Teceli dhe shpura e tij drejtoheshin për te katedralja e qytetit.

Metoda e Tecelit për shitje

Teceli ishte shitës i shkëlqyer. Dinte si t'ua rripte njerëzve naivë paratë e fituara me mund. Si shpallte se në dorë kishte çelësin për portat e parajsës, valëviste një letër ndjese dhe shpallte: “Mblidhuni tani; ejani dhe blini sa kohë që keni tregun. Kur kryqi të ulet dhe tregu të mbyllet, parajsa do të largohet dhe atëherë do të filloni të trokisni dhe të vajtoni për shkak se nga marrëzia juaj nuk arritët të merrnit bekimet që do të jenë larguar prej jush.”

Këto fjalë, pastaj, vijoheshin me pretendimin arrogant: “Ndjesat janë dhurata më e vyer dhe më fisnike e Perëndisë.”

Pastaj tregonte me gisht kryqin e kuq dhe vijonte: “Ky kryq ka po aq fuqi shpëtuese sa dhe vetë kryqi i Krishtit.... Ejani dhe do t'ju jap certifikata, të gjitha të vulosura më së miri; nëpërmjet tyre do t'ju falen edhe mëkatet që keni ndërmend të kryeni.... Privilegjet e mia nuk do t'i ndërroja as me ato të Shën Pjetrit në qiell; sepse unë kam shpëtuar më shumë shpirtra me ndjesat e mia, sesa ai apostull me anë të predikimeve të tij.... Nuk ka asnjë mëkat, sado i madh, që të mos falet dot nga ndjesat; madje, edhe sikur dikush (gjë që është e pamundur) të ketë sulmuar Virgjëreshën e bekuar Mari, nënën e Perëndisë, eja dhe paguaj; por ama duhet të paguajë mirë dhe gjithçka do t'i

falet. Mendojeni pak: për çdo mëkat vdekjeprurës duhet që, pas rrëfimit dhe trishtimit të vërtetë, të bëni pendesë për shtatë vjet në këtë jetë ose në purgator; po sa mëkate vdekjeprurëse keni kryer brenda një dite, një jave, një muaji, një viti, apo gjithë jetën? Mjerë ju! Këto mëkate janë pothuajse të pafundme, kështu që kërkojnë një ndëshkim të pafundmë në zjarrin e purgatorit. Por tani, me anë të këtyre certifikatave të ndjesave, për herë të vetme në jetën tuaj ... mund të merrni faljen e plotë për të gjitha dënimet dhe gjithë mëkatet!

Pastaj vijonte duke thënë: “Por, më tepër se kaq, ndjesat kanë vlerë jo vetëm për të gjallët, por edhe për të vdekurit. O prift, fisnik, tregtar, grua, djalosh, vajzë, a nuk i dëgjoni prindërit dhe miqtë e tjerë që kanë vdekur dhe që këlthasin nga fundi i ferrit të zjarrtë: ‘Po vuajmë tortura të tmerrshme! Me një ofertë të vogël mund të na çlironi; ju e keni në dorë ta jepni, por s’pranoni.’”

Pasi thoshte dhe disa fjalë të tjera nxitëse, Teceli ecte i vendosur te kutia e vulosur dhe, me pompozitet të madh, hidhte brenda një monedhë dhe shpallte:

*“Në çastin që monedha në kuti tingëllon,
shpirti lë purgatorin dhe në qiell fluturon.”*

Pastaj, Teceli, ky matrapaz i paparë, i nxiste dëgjuesit të shisnin dhe xhaketën, po të qe e nevojshme, për të siguruar paratë që duheshin për të blerë një ndjesë. Madje, pretendonte se papa kishte pushtetin hyjnor: “Zoti, Perëndia ynë, nuk sundon më; ai ia ka dhënë gjithë pushtetin papës!”

Kjo pasohej me paralajmërimin e gjithë atyre që i kundërviheshin punës së tij në emër të papës: “I shpall të shkishëruar!”

Pastaj, si e drejtonte gishtin te priftërinjtë e gatshëm që të dëgjonin rrëfimet, përgatiste ndjesat për turmën që do të vërshte më pas. Të gjitha paratë vendoseshin në një kuti të vulosur që kishte tre kyçe. Çelësat e kyçeve i mbanin Teceli, arkëtari i bankës “Fugër” në Augsburg dhe përfaqësuesi i kryepeshkopit Albert, si dhe përfaqësuesi i autoritetit civil.

Përmbajtja e ndjesës

Përmbajtja e ndjesës shpallte:

Zoti ynë Jezu Krisht, pastë mëshirë për ty... dhe të faltë me anë të meritave të mundimit të tij të tërëshenjtë. Unë, me anë të pushtetit apostolik që më është besuar, të fal nga të gjitha dënimet, gjykimet dhe ndëshkimet kishtare që mund të kesh merituar, si dhe nga gjithë teprimet, mëkatet dhe krimet që mund të kesh kryer, sado të mëdha apo të tmerrshme të jenë, apo për çfarëdo arsye, edhe sikur të kenë qenë vetëm në dorë të Atit tonë shumë të Shenjtë, papës, dhe Selisë Apostolike.... Ta fal ndëshkimin që duhet të vuaje në purgator; të bëj sërish pjesëmarrës në Sakramentet e Kishës... dhe të rikthej në pafajësinë dhe dëlirësinë që kishe në çastin e pagëzimit. Kështu, në orën e vdekjes, do të të mbyllet hyrja në vendin e torturave dhe ndëshkimeve dhe do të të hapët dera që çon në parajsën e gëzimit. Madje, dhe sikur të jetosh për një kohë të gjatë, ky hir do të mbetet i pandryshuar deri në çastin e fundit të jetës. Në emër të Atit, Birit dhe Frymës së Shenjtë. Amen.

Frati JOHAN TECCEL, i dërguari, e ka firmosur këtë me dorën e vet.

Të gjithë qytetarët duhet të ishin të pranishëm vetë për blerjen e ndjesave; sidoqoftë, bëheshin përjashtime për të sëmurët, të moshuarit dhe gratë shtatzëna. Atyre u lejohej ta dërgonin pagesën me anë të dikujt tjetër. Bujari Tecel, madje, shkonte dhe një hap më tej; u lejonte fisnikëve që paratë t'i dërgonin me anë të shërbëtorëve. Këtë e bënte se mos atyre s'ua kishte ënda idenë e përzierjes me turmat e popullit të zakonshëm që tuboheshin për të blerë ndjesa.

Vlera e ndjesave në dyshim

Martini foli hapur kundër shitjes së ndjesave, gjë që shfrytëzonte naivitetin e popullit. Ai e dinte nga fjala e Perëndisë se vetëm Zoti mund t'i falë mëkatet. Kur famullitarët i tregonin për premtimet e mëdha shpirtërore që jepte Teceli kur i dorëzonin paratë, Martini mbushej me zemërim të drejtë. Teceli, që kishte dëgjuar për kundërshtimin e tij, e dënonte atë dhe gjithë ata që i kundërviheshin shitjes së ndjesave të papës: “Gjithë atyre që kritikojnë predikimet dhe ndjesat e mia do t'u shkulet koka dhe do të flaken të gjakosur në ferr; heretikët do t'i djeg, derisa t'u dalë tymi mbi muret e qytetit.”

Në fillim metodat e predikimit të Tecelit i sollën fitime të mëdha papatit. Mirëpo kishte raste kur premtimet e tij krijonin probleme ligjore. Një grua

nga Hagenau⁵⁵, e shoqja e një këpucari të pasur, pagoi një monedhë floriri për një ndjesë që i garantonte hyrjen e menjëhershme në parajsë, pasi të vdiste. I shoqi e kishte kundërshtuar këtë shkapërderdhje paraje. Mirëpo premtimi i Tecelit se, kur të vdiste, ajo do të shkonte drejt e në lavdinë e parajsës, pa përjetuar flakët e purgatorit, i vuri vulën kësaj çështjeje dhe ndjesa u ble: monedha e floririt u pagua. Pas vdekjes së saj, të shoqin e thirrën në gjykatë me akuzën e përçmimit të fesë, pasi s'kishte thënë meshë për të shoqen (sipas çmimit të vendosur nga prifti i kishës) për prehjen e shpirtit të saj. Kisha mësonte se thënia e meshës për të vdekurin ia ulte periudhën e kohës që duhet të kalonte në zjarrin e purgatorit.

“A të vdiq bashkëshortja?” - e pyeti gjykatësi.

“Po.” - gjegji ai.

“Çfarë bëre për të?” - e pyeti gjykatësi.

Burri i ve iu përgjigj: “Ja varrosa trupin dhe ia besova shpirtin e saj Perëndisë.”

Gjykatësi ia ktheu: “Por, a the meshë për prehjen e shpirtit të saj?”

“Jo.” - iu përgjigj burri, - “s'kishte nevojë; ajo hyri në parajsë, sapo vdiq.”

“Nga e di ti?” - e pyeti gjykatësi.

I shoqi nxori letrën e ndjesës së Tecelit dhe filloi t'ia lexonte me zë premtimin se, në çastin që do të vdiste, e shoqja do të hynte në praninë e Krishtit dhe shenjtoreve. Pastaj, tha: “Nëse shkëlqesia juaj mendon se, gjithsesi, është e nevojshme të thuhet një meshë, atëherë gruaja ime është mashtruar nga ati ynë i tërëshenjtë, papa; ose, nëse ajo s'është mashtruar, atëherë ai që po më mashtron mua është prifti.”

Gjykatësi s'i kundërvihet dot këtij argumenti, kështu që e shpalli të pafajshëm këpucarin. Gjithsesi, ky ishte shembull i mashtrimit me shitjen e ndjesave.

Në kurth nga vetë premtimet e tij të nxituara

Kur shkoi në Lajpcig, një fisnik sakson e pyeti Tecelin nëse mund të blinte faljen për një mëkat që kishte ndërmend të kryente. “Pa dyshim,” - iu përgjigj Teceli. - “Unë kam marrë fuqi të plota nga shenjtëria e tij, papa, për këtë qëllim.”

“Mirë atëherë,” - ia ktheu fisniku. - “Dëshiroj të marr pak hak ndaj njërit prej armiqve të mi, pa ia rrezikuar jetën. Do të të jap dhjetë korona, po më dhe një letër ndjese që do të më shfajësojë plotësisht.”

Pas njëfarë debati, Teceli ra dakord që ndjesën t'ia shiste për tridhjetë korona. Pastaj, bashkë me disa miq, ai fisniku e sulmoi Tecelin në rrugën midis Jyterbokut dhe Trebinit⁵⁶. Pasi e rrahën paq Tecelin, ia vodhën sëndukun me ndjesa dhe morën arratinë. Teceli u ankua në gjykatë dhe, kur të dyja palët dolën përpara gjykatësit, fisniku nxori ndjesën e firmosur nga Teceli që e falte nga ndëshkimi që mund t'i jepej. Kështu, sundimtari i atij rajoni, duka Giorg, i dha të drejtë fisnikut dhe e shpalli të pafajshëm.

Një thirrje shpirtcopëtuese

Kur po bëhej gati të largohej nga qyteti i Cvikaut⁵⁷ dhe kasafortën e vulosën pasi i numëruan gjithë paratë, autoritetet e qytetit e pyetën Tecelin nëse mund të mbulonte shpenzimet për një darkë lamtumire. Kjo ishte kërkesë e arsyeshme, por të gjitha paratë ishin siguruar në kasafortë tashmë.

Të nesërmen në mëngjes banorët e qytetit u zgjuan nga rënia e kambanës së kishës që kumbonte fort. Shumica menduan se mos kishte ndodhur ndonjë tragjedi, kështu që shkuan me vrap te kisha e qytetit. Aty gjetën Tecelin, që dukej tejet i alarmuar. “Kisha vendosur,” - shpalli ai përpara turmës së mbledhur, - “që të nisesha për rrugë sot në mëngjes; por, mbrëmë natën, u zgjova nga disa rënkime. Dëgjova me kujdes... vinin nga varrezat... Tmerr! Ishte një shpirt i gjorë që po më bënte thirrje dhe po më përgjerohej me zjarr që ta çliroja nga torturat që po e përvëlojnë! Prandaj do të rri dhe një ditë më shumë që t'i bëj thirrje dhembshurisë së gjithë zemrave të krishtera, për hir të këtij shpirti të gjorë. Vetë unë do të hedh para i pari dhe ai që nuk ndjek shembullin tim meriton mallkimin.”

Me këtë thirrje shpirtcopëtuese, Teceli hodhi në kutinë e ofertës monedhën e vet. Pas pak, kutia u përmyt nga monedhat e qytetarëve të shumtë që kishin frikë se mos ato klithje kishin ardhur nga ndonjë i afërm ose mik i tyre. Paratë e mbledhura për çlirimin e atij shpirti të gjorë e të përvuajtur paguan shpenzimet e një darke të shijshme për klerin dhe për banorët e pasur të Cvikaut.

Zhgënjimi mes njerëzve

Shumë njerëz e vunë në pikëpyetje punën e Tecelit. Kur po shiste ndjesa në Lajpcig, dy studentë, nga neveria, dhanë dorëheqjen nga kisha dhe deklaruan hapur për Tecelin dhe predikimin e tij: “E kemi të pamundur të dëgjojmë më shakatë dhe mashtrimet e këtij murgu.” Një student tjetër u

paralajmërua nga i ati: “Ndjesat e Romës janë rrjeta për të kapur argjend; ato vetëm sa mashtrojnë mendjelehtët. Falja e mëkateve dhe jeta e përjetshme nuk duhen blerë me para.”

Kur po largohej nga Anabergu⁵⁸, Teceli shpalli: “Pas pak do ta ul kryqin, do t’i mbyll portat e qiellit dhe do ta shuaj vezullimin e diellit të hirshëm që po shkëlqen para syve tuaj. Tani është koha e pranuar; ja, tani është dita e shpëtimit.... Sillni paratë, o qytetarë të Anabergut! Dhuroni bujarisht për ndjesa dhe minierat e malet tuaja do të mbushen me argjend!” Mirëpo, kur një student i varfër iu afrua dhe iu përgjërua për një ndjesë, Teceli nuk ia dha, pasi s’kishte me çfarë ta paguante. Kështu, djaloshi Mikon u largua pa marrë ndjesën që kishte shpresuar të mbante në duar.

Por, kur Mikoni u kthye në dhomën e gjumit, me sytë e mbushur me lot, ra në gjunjë dhe ia zbrazti zemrën Perëndisë. Dhe, aty për aty, përjetoi hirin e lavdishëm shpëtues të Perëndisë. Më vonë, për këtë përjetim do të shkruante: “Iu përgjërova Perëndisë që të bëhej Ati im dhe të bënte me mua çfarë të dëshironte. Ndjeva se natyra ime ndryshoi, u kthye në besim, u transformua! Gjërat që më kishin kënaqur më parë tani m’u pështirosën. Dëshira ime e vetme dhe e singertë ishte që të jetoja me Perëndinë dhe ta kënaqja.”

Shumë vetë po vinin në dyshim bazën biblike për shitjen e ndjesave. Martin Luteri citoi disa që shpallnin hapur: “Pse nuk i çliron papa njëherë e mirë të gjithë shpirtrat nga purgatori? Le të bëjë një vepër të shenjtë dashurie të krishterë, për shkak të ligësisë së tyre të madhe, meqë shpëtoka kaq shumë njerëz, me anë të parasë së prishshme dhe katedrales së Shën Pjetrit!”

Një minator nga Shnibergu⁵⁹ i përmblodhi më së miri ndjenjat e shumë gjermanëve me mend, kur tha: “Oh, çfarë njeriu mizor qenka papa, që për hir të parasë së ndyrë e lë një shpirt të varfër duke u lebetitur në flakë për kaq shumë kohë! Nëse s’ka para të gatshme, le të kursejë ca qindra mijëra korona dhe le t’i çlirojë menjëherë të gjithë këta shpirtra. Ne të varfrit do t’ia shpërblejmë menjëherë, edhe me interesa, edhe me kapital.”

Popullit të Gjermanisë i kishte ardhur në majë të hundës nga ato që Martin Luteri i quante “kryemastrimet e Romës”.

8. Tezat e Luterit

Tecelit i ishte ndalur t'i shiste ndjesat e papës brenda territorit të Elektorit Frederik, por kjo s'donte të thoshte se Martini heshti për ato që tani besonte se ishin thjesht copa të pavlera letre që mashtronin popullin e thjeshtë dhe e bënë të mendonte se shpëtimi mund të blihej me para. Shumë predikime ushtuan nga foltorja e tij dhe dënuan veprimtarinë e Tecelit dhe bashkudhëtarëve të vet. Martini e dinte se Perëndia nuk i falte mëkatet pa pendim të vërtetë. Po kështu, shumë gjermanë ishin të zemëruar që paratë e tyre i merrte një papë italian për të ndërtuar qytetin e Romës. Perandori Maksimilian⁶⁰ kuptoi se Martini mund të shërbente si thirrje zgjimi për gjermanët, që të ngriheshin kundër pushtetit civil që ushtronte Roma. Madje, një herë, i shkroi Frederikut të Saksonisë dhe i tha troç: “Kujdesu për atë murgun, Luterin, sepse mund të vijë koha kur do të na duhet.”

Teceli i afrohet Vitenbergut

Teksa jepte mësim dhe predikonte, Martinit po i mbushej zemra dhe mendja me të vërtetat madhështore të Biblës. Kur Teceli, i ngarkuar me ndjesat e tij të shumta, iu qas rrethinave të Vitenbergut, Martini foli hapur kundër blerjes së faljes. Tani konceptin e doktrinës së shpëtimit e kishte të mirëformuluar dhe meritat e shenjtoreve nuk ishin në gjendje që të hapnin dyert e parajsës për ata që donin Perëndinë. E dinte se njerëzit shpëtohen nga hiri që Perëndia i hirit e jep falas. Megjithatë, nuk kishte dëshirë të hidhte poshtë pozitën e papës, apo të shkatërronte Kishën Katolike. Ajo që donte ai ishte reformimi i Kishës nga brenda që do të çonte në kthimin te të vërtetat e Shkrimit.

Kur Teceli mbërriti në Jyterbok, vetëm disa kilometra larg Vitenbergut, famullitarët e Martinit shkuan turmë për të parë “karnavalet”. Shumë vetë lanë paratë e tyre të fituara me mundim dhe u kthyen duke mbajtur në duar letrat e çmuara. Martini u zemërua kur disa nga bashkësia e tij shkuan tek ai për rrëfim dhe, ndërsa i rrëfenin mëkate të tmerrshme, nuk pranonin të shprehnin trishtim të vërtetë. Disa rrëfenin se kishin bërë vjedhje, kurorëshkelje dhe Martini iu tha: “Duhet ta braktisni jetën tuaj të ligë, përndryshe nuk mund t’ju çliroj nga mëkati.”

Ata thjesht i tregonin ndjesat që sapo i kishin blerë, ku shpallej se parajsa ishte e tyre, pa qenë nevoja t'i kthenin shpinën mëkatit. Martini u tha se ato

copa letre ishin të pavlera dhe se, nëse nuk pendoheshin vërtet dhe nuk i kthenin shpinën mëkatit, do të vdisnin të pafalur; kështu, do të humbisnin në zjarrin e përjetshëm të ferrit.

Tani Martini fliste edhe më hapur kundër Tecelit dhe ndjesave të papës. “Me ndihmën e Perëndisë, do t’ia shpoj daullen!” - shpallte Martini.

Sigurisht, famullitarët, të cilëve Martini ua kishte mohuar faljen, ktheheshin te Teceli dhe i ankoheshin se ndjesat ishin të pavlera dhe se u kishte harxhuar kot paratë që kishin fituar me djersën e ballit. Teceli u tërbua! Ai shpalli nga foltorja e vet se nuk do ta toleronte këtë kundërshtim dhe bërtiti duke i paralajmëruar të gjithë se papa i kishte dhënë porosi të veçantë që të digjte gjithë heretikët që i kundërviheshin. Për t’i theksuar më tej fjalët e veta, i vuri zjarrin një cope letre dhe e hodhi përtokë nga foltorja, ndërsa ende digjej.

Kundërshtimi i hapur ndaj Tecelit

Por s’kishte asgjë që ta pengonte Martinin të fliste troç. Si bari i bashkësisë së vet, kishte detyrën hyjnore që t’i ruante njerëzit nga gabimi, edhe sikur ai gabim të vinte nga goja e vetë papës. Predikimet e tij ishin të mbushura me fjalën e Perëndisë: “Askush s’mund ta provojë nga Shkrimi se drejtësia e Perëndisë kërkon dënim ose shlyerje nga mëkatari.... I vetmi detyrim që vendos Shkrimi është pendimi i vërtetë, kthimi i çiltër në besim, vendimi për të mbartur kryqin e Krishtit dhe për të kryer vepra të mira....”

Pastaj foli hapur kundër blerjes së ndjesave: “Ata do të bënin shumë më mirë po të kontribuonin për hir të Perëndisë për ndërtimin e Shën Pjetrit, sesa për të blerë ndjesa me këtë synim.... Por, ju mund të thoni, atëherë nuk duhet të blejmë kurrë ndjesa? ... Jua kam thënë tashmë dhe po jua përsëris: këshilla ime është që askush s’duhet t’i blejë!”

Pastaj iu drejtua atyre që e shpallnin heretik: “Dhe po bërtiti kush se jam heretik, s’e vras mendjen fare për tërbimin e tyre. Ata janë të murrëtyer dhe me tru të sëmure; janë njerëz që s’kanë shijuar kurrë Biblën, s’kanë lexuar kurrë doktrinën e krishterë, s’i kanë kuptuar kurrë doktorët e tyre, por dergjen të kalbur në rreckat dhe zhelet e mendimeve të tyre boshe.... Perëndia na dhëntë neve dhe atyre një mendje të shëndoshë! Amen.” Me këto fjalë Martini zbriti nga foltorja. Bashkësia u mahnit nga gjuha e hapur dhe guximtare e tij. Këto predikime të thëna troç u përkthyen në gjermanisht, u shtypën dhe qarkulluan anë e mbanë.

Luteri i drejtohet kryepeshkopit

Dita e Tërëshenjtorëve po afrohej. Martini vendosi të shkonte te kryepeshkopi i Maincit dhe t'i lutej që t'i jepte fund shitjes së ndjesave. Në këtë kohë Martini s'e dinte që Alberti varej financiarisht nga shitja e ndjesave, pasi duhej të shlyente kredinë që kishte marrë për ngritjen në detyrë në postin e kryepeshkopit. Synimi i vetëm i Martinit ishte të zgjonte ndërjegjen e princave të Kishës⁶¹ për ligësitë e ndjesave që po shiste Teceli. Pas një hyrjeje shumë të përlur, Martini vijoi t'i shkruante: "Disa individë po bëjnë matrapazllëqe me ndjesat papnore anekënd vendit, në emër të Hirësisë suaj. Më shumë se britmat e këtyre predikuesve (që s'i kam dëgjuar vetë) jam gati të fajësoj idetë e gabuara të popullit të thjeshtë e të paditur, sepse këta të fundit, pasi blejnë ndjesa, mendojnë se e kanë të siguruar shpëtimin.... O Atë i shenjtë në Perëndinë, në porositë për të dërguarit, që janë botuar në emrin e Hirësisë suaj (pa dyshim, pa njohurinë tuaj), thuhet se ndjesat janë thesari më i çmuar – se me anë të tyre njeriu pajtohet me Perëndinë dhe se ata që i blejnë s'kanë nevojë për pendesë...." Pastaj vijoi duke iu përgjyruar kryepeshkopit Albert që t'i jepte fund shitjes së ndjesave.

Martini ishte kaq i shqetësuar për dëmin shpirtëror që po shkaktonte shitja e ndjesave, saqë përpiloi një listë me nëntëdhjetë e pesë propozime, të cilat donte t'i diskutonte në një forum publik në universitet. Një kopje të këtyre nëntëdhjetë e pesë tezave ia dërgoi dhe kryepeshkopit, që t'i merrte në shqyrtim. Ndërkaq, ishte gati t'i gozhdonte nëntëdhjetë e pesë tezat e veta në derën e kishës-kështjellë në Vitenberg. Synimi i veprimeve të Martinit ishte që t'i tërhiqte vëmendjen popullit me pyetjet që parashtrohte. Kjo ishte ftesë që të gjithë të takoheshin me të të nesërmen, për të diskutuar këto teza. Veprimi i Martinit s'kishte asgjë të pazakontë, pasi kjo ishte praktika normale e kohës së tij, kur parashtroheshin çështje për debat.

Ëndërra e Elektorit

1 nëntori 1517, si Dita e Tërëshenjtorëve, ishte ngjarja më e rëndësishme për Frederikun, Elektorin e Saksonisë, dhe për qytetin e Vitenbergut. Mijëra njerëz mbledheshin për të parë reliket dhe për t'u lutur. Nga kjo gjë koha në purgator do t'u ulej me 1 902 202 vite dhe 270 ditë (disa thonë se bëhej fjalë për 127 709 vite dhe 116 ditë). Pa dyshim, Martini e dinte mirë se kundërshtimi i shitjes së ndjesave do ta acaronte Frederikun, i cili

mbështetej te të ardhurat që sillnin vizitorët në Vitenberg. Mirëpo ndodhi një ngjarje që e përgatiti Frederikun për atë që do të ndodhte pas pak.

Frederiku po qëndronte tek i vëllai, duka Johan⁶², natën e 30 tetorit. Në mëngjes, Frederiku i tregoi të vëllait për një ëndërr të çuditshme që kishte parë atë natë: “Vëlla, duhet të të tregoj për një ëndërr që pashë mbrëmë dhe dua që të di se ç’kuptim ka. Më është ngulitur kaq fort në mendje, sa s’kam për ta harruar kurrë, edhe sikur të jetoj një mijë vjet; sepse e pashë tri herë dhe çdo herë me rrethana të ndryshme.”

Duka Johan: “Ishte ëndërr e mirë, apo e keqe?”

Elektori: “Së kam idenë; vetëm Perëndia e di.”

Duka Johan: “Mos u alarmo, ma trego.”

Elektori: “Kur u shtriva mbrëmë, i lodhur dhe i mërzhitur, pasi thashë lutjet, më zuri gjumi shpejt dhe fjeta i qetë për nja dy orë e gjysmë. Pastaj u zgjova dhe deri në mesnatë më shqetësuan lloj-lloj mendimesh. Mendova se si të kremtoj festën e Tërëshenjtorëve; u luta për shpirtrat e munduar në purgator dhe u luta që Perëndia të më drejtonte mua, këshillat e mi dhe popullin tim sipas të vërtetës. Pastaj më zuri gjumi përsëri dhe pashë në ëndërr sikur i Plotfuqishmi më dërgoi një murg, i cili ishte bir i vërtetë i apostullit Pal. Bashkë me të ishin gjithë shenjtorët, të bindur ndaj porosisë së Perëndisë, që të jepnin dëshmi për të dhe të më siguronin se ai s’kishte ardhur me qëllime mashtruese, por se gjithçka që do të bënte ai ishte në përputhje me vullnetin e Perëndisë. Ata më kërkuan mirësisht leje që ta lejoja të shkruante diçka në dyert e kishës së pallatit në Vitenberg. Me anë të kancelarit tim, rashë dakord. Pas kësaj, murgu u kthye aty dhe filloi të shkruante; kaq të mëdha ishin fjalët, sa isha në gjendje ta shihja që nga Shveinici⁶³ se çfarë po shkruante. Penda që përdorte ishte kaq e gjatë, sa që fundi i saj arriti deri në Romë, ku ia shpoi veshë luanit (Leoni X) që rrinte shtrirë aty dhe ia tronditi papës kurorën e trefishtë që mbante në kokë. Gjithë kardinalët dhe princat u ngritën rrëmbimthi... dhe u munduan t’ia mbanin kurorën në vend. Edhe unë e ti i ndihmuam: unë shtriva krahun.... Në atë çast u zgjova me krahun e shtrirë, shumë i alarmuar dhe i zemëruar me këtë murg, i cili s’e mbante dot pendën siç duhej. E mora sërish disi veten.... Ishte thjesht ëndërr.

Isha ende gjysmë i përgjumur dhe mbylla sërish sytë. Ëndrra m’u kthye përsëri. Luani, ende i shqetësuar nga penda, filloi të vrumbullonte me sa fuqi që kishte, derisa gjithë qyteti i Romës dhe gjithë shtetet e Perandorisë së

Shenjtë vrapuan për të mësuar se si ishte puna. Papa na bëri thirrje që t'i kundërviheshim këtij murgu dhe më foli mua posaçërisht, pasi ai frati jetonte në zotërimet e mia. U zgjova sërish, përsërita lutjen e Zotit, iu përgjérova Perëndisë që të ruante shenjtërinë e vet dhe rashë në gjumë....

Pastaj pashë në ëndërr sikur gjithë armiqtë e perandorisë, dhe ne bashkë me ta, nxituam për në Romë dhe u përpoqëm, njëri pas tjetrit, që ta thyenim atë pendë; por sa më shumë mundoheshim, aq më e fortë bëhej ajo: kërciste si të ishte bërë prej hekuri: në fund, të dëshpëruar, hoqëm dorë. Pastaj e pyeta murgun (sepse nganjëherë isha në Romë, nganjëherë në Vitenberg) se ku e kishte gjetur pendën dhe si ishte bërë aq e fortë. “Kjo pendë,” - m'u përgjigj ai, - “i përkiste një rose njëqindvjeçare nga Bohemia (bëhet fjalë për Jan Husin⁶⁴, i cili ishte martirizuar nga Roma). Ma dha një nga mësuesit e mi të vjetër. Ajo është kaq e fortë, ngaqë askush s'ia heq dot forcën, madje dhe unë vetë mahnitem prej saj.” Papritur dëgjova një britmë të fortë: nga penda e gjatë e murgut doli një ushtri me penda të tjera.... U zgjova për herë të tretë; kishte zbardhur dita.”

Duka Johan: “Si mendon, z. kancelar? Ah, sikur të kishim këtu një Jozef, ose një Daniel, që ta kishte mësuar Perëndia!”

Kancelari: “Shkëlqesia juaj e di atë proverbin e njohur, se ëndrrat e vajzave, të urtëve dhe zotërinjve të mëdhenj, në përgjithësi kanë një kuptim të fshehtë. Por për njëfarë kohe s'kemi për t'ia ditur kuptimin kësaj ëndrre, derisa të ndodhin ngjarjet për të cilat bën fjalë. Prandaj çoja këtë çështje Perëndisë dhe lër gjithçka në duart e tij.”

Duka Johan: “Mendimi im është njësoj si yti, z. kancelar; nuk na takon që të shtrydhim trutë për të zbuluar interpretimin e ëndrrës: Perëndia do ta drejtojë gjithçka për lavdinë e vet.”

Elektori: “Kështu bëftë Perëndia ynë besnik! Megjithatë, kjo ëndërr s'do të më shqitet kurrë nga mendja. Më ka shkuar ndërmend një interpretim... por do ta mbaj për vete. Ndoshta koha do ta tregojë nëse i kam rënë në të.”

Nëntëdhjetë e pesë tezat

Ndërkohë, në Vitenberg, Martini po i jepte dorën e fundit nëntëdhjetë e pesë tezave që synonte t'i mbërthente në derën e “Kishës së Tërëshenjtorëve”, pra, në kishën e kështjellës. Në atë shkrim jepte argumentin e vet kundër shitjes së ndjesave. Ndërsa e shkruante, besonte fort se papën e kishte në krahun e vet. Sulmi i tij kundër ndjesave që shiste Teceli nuk kishte qëllim

sulmin ndaj papës apo Kishës; ai i respektonte. Në fakt, Martini donte që t'i jepej fundit pretendimit të Tecelit se shitja e ndjesave ishte me porosi të papës. Ndërkaq, në kishën e universitetit, priftërinjtë ishin të zënë me përgatitjen e mijëra relikeve që do të ekspozoheshin. Gjithçka duhej bërë gati që priftërinjtë të dëgjonin rrëfimet dhe lutjet e besimtarëve që kishin ardhur nga të katërta anët e perandorisë për këtë ngjarje të shënuar.

Pastaj, në mesditën e 31 tetorit 1517, Luteri çau mes turmave dhe u nis drejt kishës. Ishte i vetëm, pasi s'ia kishte treguar askujt prej kolegëve atë që kishte në mendje. Aty, në derën e kishës, gozhdoi nëntëdhjetë e pesë tezat dhe, çështë e vërteta, shumë pak njerëz e vunë re aty për aty veprimin e tij. Të gjithë vizitorët e kishin mendjen te ndjesat që do të fitonin Ditën e Tërëshenjtorëve.

Mirëpo lajmi mori dhenë dhe brenda disa orësh çdo njeri në Vitenberg po fliste për synimin e Martinit, që të mbronte të vërtetën e asaj që kishte shkruar në universitet në Ditën e Tërëshenjtorëve. Shumë shpejt njerëzit po lexonin (në latinisht) këto fjalë:

“Debati i dr. Martin Luterit për pendesën dhe ndjesat:

Me dëshirë dhe qëllim për të zbuluar të vërtetën, në Vitenberg do të mbahet një debat për propozimet e shkruara më poshtë, nën kryesimin e atit të nderuar Martin Luter, murg i urdhrit të Shën Augustinit, Master i Arteve dhe i Teologjisë së Shenjtë, dhe lektor i rregullt në të njëjtin vend. Prandaj ai u kërkon atyre që s'mund të jenë të pranishëm për të diskutuar për këtë temë me ne gojarisht, që këtë gjë ta bëjnë me letër në mungesë. Në emër të Zotit tonë Jezu Krisht. Amen.

Pastaj vijonin nëntëdhjetë e pesë propozimet, por jo sipas ndonjë rendi të veçantë. Më të debatueshmet ishin si më poshtë:

5. “Papa s'është në gjendje që të falë asnjë ndëshkim tjetër, përveç atij që ai ka caktuar me dëshirën e vet ose në përputhje me ligjin kishtar, pra, porositë papnore.”

6. “Papa nuk fal dot asnjë dënim, por vetëm shpall dhe pohon faljen e Perëndisë, përveçse në rastet që kanë të bëjnë me atë vetë. Nëse vepron ndryshe, dënimi mbetet plotësisht i pandryshuar.”

21. “Të dërguarit e ndjesave janë në gabim, kur thonë se, me anë të ndjesës papnore, njeriu çlirohet nga çdo ndëshkim dhe shpëtohet.”

27. “Ata që thonë se, sapo monedha tringëllon në kuti, shpirti del fluturimthi nga purgatori, predikojnë vetëm marrëzi njerëzore.”

28. “Kjo është e sigurt: sapo monedha tringëllon, vjen, rritet dhe shtohet lakmia dhe dashuria për fitime.”

32. “Ata që mendojnë se e kanë të sigurt shpëtimin me anë të ndjesave, kanë për të shkuar në ferr bashkë me ata që i mësojnë kështu.”

35. “Ata që pretendojnë se s’ka nevojë për trishtim ose pendim, që shpirti të çlirohet nga purgatori ose që të blihet ndjesa, janë mësues të doktrinave kundër Krishtit.”

38. “Gjithsesi, lejen dhe faljen papnore nuk duhet ta trajtojmë me tallje, sepse kjo falje është deklaratë e faljes së Perëndisë.”

50. “Duhet t’i mësojmë të krishterët se, po ta dinte papa për zhvatjet e predikuesve të ndjesave do të donte më mirë që të digjej dhe të shkrumbohej kisha-nënë e Shën Pjetrit, sesa ta shihte të ndërtohej mbi lëkurën, mishin dhe kockat e tufës së tij.”

52. “Shpresa se do të shpëtohem me anë të ndjesave është shpresë mashtruese dhe boshe, edhe sikur i dërguari i ndjesave apo qoftë dhe papa vetë të vinte si garanci për këtë gjë shpirtin e vet.”

62. “Thesari i vërtetë dhe i çmuar i Kishës është Ungjilli i Shenjtë i lavdisë dhe hirit të Perëndisë.”

71. “Mallkuar qoftë ai që flet kundër ndjesës së papës.”

72. “Por i bekuar qoftë ai që flet kundër gjuhës së marrë dhe të pacipë të predikuesve të ndjesave.”

79. “Është blasfemi të thuash se kryqi i zbukuruar me emblemën e papës sjell të njëjtat bekime si kryqi i Krishtit.”

94. “Të krishterët duhet t’i nxisim që të tregohen të zellshëm në ndjekjen e Krishtit, kreut të tyre, nëpërmjet kryqeve, vdekjes dhe ferrit.”

95. “Sepse është shumë më mirë të hysh në mbretërinë e qiejve përmes shumë mundimeve, sesa të fitosh siguri mishore me ngushëllime që ofrojnë paqe të rreme.”

Këto teza u shoqëruan nga deklaratat e mëposhtme:

Unë, Martin Luteri, Doktor, anëtar i urdhrit të murgjve në Vitenberg, dëshiroj të dëshmoj publikisht se kam propozuar disa teza kundër të ashtuquajturave ndjesa papnore. Ndonëse, deri në këtë çast, s'jam dënuar as nga kjo shkollë e mirënjohur dhe e famshme, as nga autoritetet civile ose kishtare, gjithsesi dëgjoj se disa njerëz me frymë të palogjikshme dhe të paturpshme guxojnë të më shpallin heretik, sikur kjo çështje të ishte shqyrtuar dhe studiuar me hollësi. Por, nga ana ime, siç kam vepruar shpesh dhe më përpara, edhe tani u përgjërohem gjithë njerëzve, me anë të besimit të Krishtit, që, ose të më tregojnë një mënyrë më të mirë (nëse një mënyrë e tillë i është zbuluar në mënyrë hyjnore ndokujt), ose të paktën t'ia nënshtrojnë mendimin e tyre gjykimit të Perëndisë dhe të Kishës. Sepse unë s'jam as aq i rrëmbyer, sa të shpresoj që mendimi im të parapëlqehet më tepër se ai i gjithë njerëzve të tjerë, as aq i palogjikshëm sa të dëshiroj që fjala e Perëndisë të zëvendësohet me përrallat e shpikura nga arsyeja njerëzore.”

Nëntëdhjetë e pesë tezat e Martinit u shkruan në latinisht, në gjuhën e të arsimuarve. Megjithatë, brenda pak orësh, studentët e tij i përkthyen në gjermanisht dhe, duke patur në dispozicion shtypshkronjën që sapo ishte shpikur, shumë shpejt gjithë ata që dëshironin, mund të kishin nga një kopje të tyre. Një pjesë e mirë e parave që ishin synuar të përdreshin për blerjen e ndjesave, u përdorën që të blinin nëntëdhjetë e pesë tezat e shumëpërfolura. Njerëzit kishin ardhur nga anembanë vendit në Vitenberg për ndjesat e Ditës së Tërëshenjtorëve. Për këtë arsye, brenda dy javësh, shumica e gjermanëve panë nga një kopje të shkrimit të Martinit. Katër javë pasi Martini i kishte gozhdur ato teza në derën e kishës, ato u përhapën në mbarë botën e krishterë dhe një kopje i ra në dorë dhe papës Leon.

Tani Evropa po vlonte nga diskutimet për veprimin që duhet të merrnin autoritetet kishtare, për shkak se Martini vuri në dyshim ndjesat papnore. Martini ishte i vetmi që s'shqetësohej për këtë, sepse besonte në mënyrë të patundur se papa i Romës do t'ia mbështeste shkrimin; tek e fundit, të gjitha tezat ishin bazuar plotësisht në mësimet e Shkrimit. A s'ishte papa kreu i Kishës së Krishtit, ai që i jepte kuptim fjalës së Perëndisë? Në të vërtetë, në atë kohë, Martini besonte plotësisht se ishte shërbëtor besnik i Romës; e pranonte mësimin papnor në lidhje me ekzistencën e purgatorit dhe rolin e tij në pastrimin e mëkatarit.

Në atë kohë, Martini besonte plotësisht se ishte shërbëtor i përkushtuar i papës dhe se i shërbente Kishës së tij të dashur në manastir dhe nëpërmjet leksioneve të teologjisë në universitetin e Vitenbergut. Po kështu, ishte i bindur se çështjet që kishte ngritur ishin në përputhje të plotë me mësimet më të mira të Etërve të Kishës.

Në një letër drejtuar papës Leon më 1518-n, Martini i deklaronte se ishte i shtangur dhe i lënduar që e sulmonin duke e thërritur “heretik”, si dhe shumë epitete të tjera fyese. Ai donte vetëm të mbronte emrin e mirë të Kishës, duke diskutuar për çështjet që kishte shtruar. I tha se epoka ku po jetonin ishte e mahnitshme dhe se ai vetë ishte një nga të panxënët: “I ngadaltë nga trutë dhe i boshatisur nga dija.” Madje i tha se s’ishte veçse “një rosë që këlthet mes mjelmave”.

Ditën që Martini kishte caktuar nuk u paraqit për debat asnjë përfaqësues zyrtar, por gjithë komuniteti po diskutonte për çështjet që kishte ngritur ai.

9. REAGIMI NDAJ TEZAVE

S'kaloi shumë kohë dhe murgut domenikan, Tecel, i ra në dorë një kopje e tezave të Martinit. Ai i konsideroi si sulm ndaj shitjes shumë fitimprurëse të ndjesave të papës. Mosmarrëveshja mes të dyve u përhap me shpejtësi, sepse urdhri domenikan i konsideroi tezat e Martinit si sulm të një kreu augustinian, jo vetëm ndaj Tecelit, njërit prej anëtarëve të këtij urdhri, por edhe kundër gjithë urdhrit.

Mbështetja për Luterin

Sidoqoftë, në përgjithësi njerëzit e përshëndetën shkrimin e Martinit dhe predikimin kundër ndjesave. Duka Giorg i Saksonisë tha: “Kur Luteri sulmoi përrallën, gjithë bota e duartrokiti dhe pati miratim të përgjithshëm.” Fshehtas, Erazmi i mbështeti fjalët e Martinit dhe, më vonë, i tha Elektorit Frederik të Saksonisë: “S'jam aspak i habitur që kjo ka bërë kaq shumë zhurmë; Luteri ka sulmuar kurorën e papës dhe barkun e murgjve.”

Martini s'ishte i vetmi që vinte në dyshim mësimet e Romës papnore. Dr. Fleku⁶⁵, një anëtar i famshëm i manastirit të Shtajnlauzicit, kishte kohë që pati hequr dorë nga thënia e meshës. Kur i ra në dorë një kopje e tezave të Martinit, u gëzuar dhe bërtiti: “Ah! Ah! Më në fund ai që kishim pritur erdhi dhe ka për t'jua treguar qejfin ju murgjve!”

Pastaj i shkroi një letër Martinit, ku e inkurajonte që të qëndronte i patundur dhe të vazhdonte luftën për të vërtetën.

Kur një burrë i tha kryepeshkopit të Vyrzburgut⁶⁶, Lorenzo de Bibra, se kishte ndërmend ta fuste të bijën në manastir, mori këtë përgjigje: “Përkundrazi; gjeji burrë. Nëse të duhen para për pajën, t'i jap unë borxh.”

Ky njeri i mençur kishte qyshkur që shqetësohej pa masë për shthurjen e shumë klerikëve dhe për faktin se Roma nuk po sillte reformën e duhur shpirtërore. Edhe ai u gëzua kur i dhanë një kopje të shkrimeve të Martinit dhe, më vonë, kur Martini u bë shënjestër e sulmeve të autoriteteve kishtare, i tha hapur Elektorit Frederik: “Mos hiq dorë nga i perëndishmi doktor Martini, sepse ata po i bien në qafë kot!”

Në përgjithësi autoriteteve civile gjermane u bëhej qejfi që po sulmohej autoriteti i papës. Prej një kohe tepër të gjatë, atyre u rrëmbeheshin financat, për të mbështetur planet e papëve italianë. Perandori dhe shumë prej

princave gjermanë e respektonin së tepërmi Martinin; ata i bënë thirrje Frederikut që të kujdesej më së miri për “të përshpirtshmin doktor Martin”. Madje perandori Maksimilian tha: “Me të vërtetë, propozimet e tij s’janë të neveritshme. Ka për t’ua treguar vendin murgjve.”

Thuhet se papa Leon në fillim e trajtoi këtë çështje thjesht si mosmarrëveshje lokale gjermane mes murgjve të dy urdhrave të ndryshëm; ai mendonte se, po ta anashkalonte këtë problem, së shpejti do të eliminohej vetvetiu. Papa Leon tha kështu: “Vëlla Martini është gjeni i shkëlqyer; gjithçka që thuhet kundër tij është thjesht smirë murgjish.”

Më vonë, kur mori letra nga kryepeshkopi Albert, iu përgjigj: “Luteri është gjerman i dehur. Ka për t’u ndier më mirë, kur t’i dalë pija.”

Brenda mureve të kuvendit të Martinit në Vitenberg kishte trazira. Kur Teceli dhe domenikanët filluan të ngrinin zërin kundër tij, sivëllezërit murgj iu përgjëruan: “Të lutem, mos na e turpëro urdhërin! Urdhrat e tjerë, sidomos domenikanët, po lumturohen që tani, ngaqë mendojnë se nuk do të jenë të vetëm në turpin e tyre.”

Mirëpo Martini ua ktheu: “Etër të dashur! Nëse kjo punë s’është nga Perëndia, ka për të humbur; por, nëse është prej Tij, le të përparojë.”

Teceli djeg nëntëdhjetë e pesë tezat

Kur Tecelit i ra në dorë një kopje e nëntëdhjetë e pesë tezave të Martinit, u tërbua. Kishte shkuar nga Jyterboku në Frankfurt-mbi-Oder⁶⁷, por zbuloi se ndikimi i shkrimeve të Martinit e kishte paraprirë. Banorët e qytetit po vinin në dyshim, për shkak të Martinit, vlerën e ndjesave që shiste Tecelit.

Duke sulmuar ashpër Martinin, Teceli dhe mbështetësit e vet mblodhën, me aq sa mundën, gjithë kopjet e shtypura të tezave të Martinit dhe i bënë gati për djegie publike. Përbri një foltoreje, ai ndërtoi një skelë dhe, i veshur me shenjat dalluese të inkuizitorit të besimit, i priu procesionit që mbartte tezat dhe predikimet e Martinit. Kur arriti te foltorja, e mallkoi me tërbim Martinin dhe çdo shkrim të tijin. Tha se ishte shumë i zhgënjyer që në ato flakë s’po hidhte dot vetë Martinin, por besonte se do të vinte dita kur “ai heretiku” do të lidhej në një turrë drush në mes të flakëve papnore: “Brenda tri javësh kam për ta hedhur në zjarr heretikun....” Pastaj vendosën në skelë shkrimet dhe Martinit dhe iu vunë zjarrin.

Kundërtezat e Tecelit

Rasti e donte që Teceli t'u jepte përgjigje zyrtare deklaratave të Martinit. Që propozimet e Tecelit të fitonin njëfarë autoriteti, iu dha grada “Doktor nderi⁶⁸”. Kështu, iu vu punës dhe, me ndihmën e Konrad Vimpinës⁶⁹, teolog i spikatur dhe profesor në Universitetin e Frankfurtit-mbi-Oder, botoi një seri me njëqind e gjashtë kundërteza. Mësimi bazë i këtyre propozimeve ishte autoriteti absolut i papës në çdo çështje shpirtërore. Ai argumentoi se të gjithë duhet t'i përuleshin autoritetit të atij që ishte ulur në fronin e Shën Pjetrit – madje dhe shkrimet e Etërve të Kishës, dhe arsyeja njerëzore i ishin nënshtruar autoritetit papnor. Pastaj deklaroi se edhe Shkrimet i nënshtroheshin interpretimit të papës. Ndër tezat e tij gjejmë:

3. “Të krishterëve u duhet mësuar që papa, në gamën e pushtetit të vet, qëndron mbi Kishën mbarëbotërore dhe mbi këshillat kishtarë; dekretet e tij meritojnë nënshtrim të plotë.”

4. “Të krishterëve u duhet mësuar se vetëm papa ka të drejtën që të vendosë për çështjet e doktrinës së krishterë; se vetëm ai (dhe askush tjetër) ka pushtetin që të shpjegojë, sipas gjykimit të vet, kuptimin e Shkrimit të Shenjtë dhe të miratojë ose dënojë fjalët dhe veprat e të tjerëve.”

5. “Të krishterëve u duhet mësuar se gjykimi i papës, në gjërat që kanë të bëjnë me doktrinën e krishterë dhe janë të domosdoshme për shpëtimin e njerëzimit, nuk mund të gabojë në asnjë rast.”

17. “Të krishterëve u duhet mësuar se ka shumë gjëra që Kisha i konsideron si pika të sigurta të besimit të krishterë, ndonëse nuk gjenden në Shkrimet e frymëzuara apo në shkrimet e Etërve të hershëm.”

44. “Duhet t'i mësojmë të krishterët që t'i konsiderojnë heretikë kokëfortë të gjithë ata që shpallin me anë të fjalëve, veprave apo shkrimeve se nuk pranojnë t'i tërheqin propozimet e tyre heretike edhe sikur mbi ta të bjerë si breshër ose shi shkishërim pas shkishërimit.”

48. “Duhet t'i mësojmë të krishterët se, ata që mbrojnë gabimet e heretikëve dhe me anë të autoritetit të tyre s'lejojnë që këta heretikë të nxirren përpara gjykatësit që ka të drejtë t'i dëgjojë, duhen shkishëruar; madje, nëse brenda një viti nuk e ndryshojnë sjelljen, do të shpallen famëkeq dhe do të ndëshkohen ashpër me dënime të ndryshme sipas ligjit dhe si paralajmërim për njerëzit e tjerë.”

Pa dyshim, pika 48 ishte paralajmërim për Frederikun, Elektorin e Saksonisë, që të mos përfshihej në mbrojtjen e heretikëve (pra, Martin Luterit).

Vimpina, që ishte truri pas përgjigjes së Tecelit, shkoi dhe më tej, duke deklaruar se shpirti çlirohej nga flakët e purgatorit dhe hynte në parajsë përpara se monedha të tringëllonte në fund të arkës së ndjesave. Një tjetër element që hyri në lojë në këtë polemikë ishte nami i mbrojtur me xhelozë i dy universiteteve të profesorëve që po shkruanin kundër njëri-tjetrit. Si Vimpina, ashtu dhe Martini, lidheshin me institucione arsimore të sapothemeluara dhe të dy donin që të krijonin idenë e epërsisë intelektuale, gjë që do të ngjallte interesimin e studentëve në të ardhmen.

Tezat e Tecelit digjen nga studentët

Që ta sulmonte Martinin, Teceli dërgoi në Vitenberg bashkëpunëtorët e vet të armatosur me tetëqind kopje të kundërtezave të Tecelit, të cilëve u printe një librashitës. Ideja ishte që ato të shiteshin dhe t'u shpërndareshin gjithë atyre që donin t'i blinin, por, kur shitësit hynë në Vitenberg, u ndeshën me mbështetësit besnikë të Martinit, të cilët qeshën dhe u tallën me ta. Studentët e universitetit u zemëruan që Teceli kishte djegur veprat e profesorit të tyre, Martinit, kështu që i qortuan mbështetësit e Tecelit dhe u thanë: “Si guxoni që t'i sillni këto shkrime këtu?”

Pastaj konfiskuan kopjet e deklaratës së Tecelit dhe udhëheqësi i studentëve shpalli: “Kushdo që dëshiron të jetë i pranishëm në djegien dhe funeralin e tezave të Tecelit, të vijë te tregu në orën dy.”

Në kohën e caktuar përgatitën një pirg të stërmadh me tetëqind kopjet e deklaratës së Tecelit dhe, mes të qeshurave të studentëve dhe qytetarëve të mbledhur të Vitenbergut, u ndez një zjarr bubulak. Martini s'ishte në dijeni të asaj që po ndodhte dhe, kur mësoi për veprimet e studentëve, u alarmua. Ai vetë s'donte t'ia dinte në përgjithësi për përçartjet e Tecelit; madje, në një rast, tha: “Kur dëgjoj këto akuza, më ngjan sikur po më pëllet ndonjë gomar.”

S'kaloi shumë kohë dhe në shumë qarqe emri dhe shkrimet e Martinit lakoheshin me përçmim të madh. E quajtën doktor të pacipë, të lajthitur dhe madje disa e quajtën demon. Shumë binin dakord me këtë vlerësim: “Prisni dy javë, maksimumi një muaj, dhe ky heretik famëkeq do të digjet!”

Pas pak kohësh Tecelin e nxorën jashtë këtij debati, pasi ishte turpëruar në sytë e popullit, ngaqë kishte shkapërderdhur paratë për të blerë ndjesat e tij. Po kështu, s'ishte i aftë nga ana intelektuale që ta mposhte Martinin me argumente logjike. Madje, kur një nga shkrimet e tij i ra në dorë papës, këtij të fundit s'i la fare mbresa. Për Tecelin dhe traktin e tij tha thjesht këto fjalë: "O, ç'njeri i ndyrë."

Shitjet e ndjesave të Tecelit pothuajse kishin rënë në zero. E tallnin kur shkonte nëpër qytete dhe pas pak kohe pa se po i kundërviheshin me kaq ngulm, saqë u tërhoq në manastirin e vet në Lajpcig. Dy vjet pasi Martini pati gozhduar tezat e veta në derën e kishës, Teceli, zemërthyer, i diskretituar dhe i turpëruar, dergjej në shtratin e vdekjes. Disa personalitete të larta të Kishës dhanë mendimin që gjithë kjo çështje do të zgjidhej, nëse Teceli akuzohej për përvetësim fondesh dhe ndëshkohej rëndë.

Pastaj, ndihmësi i papës, Miltici⁷⁰, nisi të përhapte thashetheme për anën morale të Tecelit. Thoshte se vetëm veprimi i Elektorit Frederik e kishte shpëtuar Tecelin nga dënimi me mbytje⁷¹. Pastaj qarkulloi dokumente që provonin se Teceli i kishte përdorur fondet e ndjesave për vete dhe për punëtorët e vet. Kur kërkoi praninë e Tecelit, që t'u përgjigjej akuzave, Teceli, i cili sipas Milticit ishte quajtur "derr" nga papa, u tmerrua. Pastaj Miltici urdhëroi që ta izolonin në manastir dhe të gjithë ranë dakord. Teceli, i braktisur edhe nga urdhri i vet domenikan, i dënuar me burgim të përjetshëm në qelinë e vet, i trishtuar dhe i frikësuar nga ato që i kishin ndodhur, ra në depresion të thellë dhe pas pak kohe vdiq.

Pavarësisht llomotitjeve të atij njeriu që kishte shprehur hapur dëshirën ta shihte Martinin të digjej në turrën e druve, Martini i shkroi dhe i tha që të mos shqetësohej, pasi kjo çështje s'ishte pjellë e tij: "Fëmija ka baba dikë tjetër."

Letërkëmbimi me Prierion

Kur papës i ranë në dorë nëntëdhjetë e pesë tezat e Martinit, nuk e vrau shumë mendjen. Në fund të fundit ishte më i preokupuar për veprimtaritë e tij shoqërore dhe kulturore. Silvestro Macolini i Prierios⁷², përgjegjësi për censurën papnore⁷³, e nxiti Leonin që ta shpallte heretik Martinin dhe t'ia ndalonte shkrimet. Despotizmi papnor nuk duhej ta toleronte lirinë e mendimeve, shprehjes, shtypjes së librave dhe adhurimit. Më vonë, ai vetë i

shkroi Martini: “Kushdo që nuk mbështetet në mësimin e Kishës Katolike dhe papës së Romës si rregulla e pagabueshme e besimit, prej së cilës marrin fuqi dhe autoritet edhe vetë Shkrimet, është heretik.”

Letërkëmbimi që vijoi mes të dyve rrotullohej rreth pyetjes: Cili është autoriteti i vetëm në çështjet shpirtërore? Martini shpallte se ky autoritet duhej gjetur në Shkrimet, ndërsa Prierioja thoshte se autoriteti i pagabueshëm gjendet në Kishën e Romës, kreu i së cilës është papa. Vetëm ai kishte autoritetin hyjnor që të shprehej për të gjitha çështjet e besimit dhe moralit. Prierioja thoshte se Bibla është libër i vdekur. Më tej vijoi duke argumentuar se ekzistonte dhe një Bibël e dytë: pra, të gjitha deklaratat e Kishës. Kjo ishte Bibla e zhvilluar. Ajo përmbante të gjitha vendimet e Këshillit të miratuara nga papa. Sigurisht, pretendonte ai, papa bënte deklaratat të tilla vetëm kur udhëhiqej nga Fryma e Shenjtë. Ai mendonte se Index Librorum Prohibitorum, censura papnore ishte një listë me libra që konsideroheshin heretikë apo kundër klerit dhe që ishin të ndaluar nga Kisha Katolike. Bibla e shkruar është fara prej së cilës u rrit Bibla e gjallë, pra, doktrina e pastër dhe e thjeshtë papnore.

Madje Prierioja shkoi deri aty sa tha që askush nuk duhet të fliste kundër papës, edhe sikur papa të ishte femohues dhe t’i çonte njerëzit në ferr. Këtë pohim e bazonte në një dekret që thoshte: “Sikur papa të anashkalojë shpëtimin e vet dhe të të tjerëve, dhe ta mohojë aq fort të mirën, saqë të tërheqë me vete njerëz të panumërt në ferr dhe t’i flakë bashkë me atë vetë në torturat e përjetshme, prapëseprapë asnjë vdekatar nuk duhet të guxojë që ta kritikojë, pasi papa është gjykatësi i të gjithëve dhe s’mund të gjykohej prej askujt.”

Nganjëherë Prierioja fliste me përçmim për Martinin, me një gjuhë të thjeshtë, por të drejtpërdrejtë. “Nëse qentë e kanë në natyrë kafshimin,” - i shkroi Prierioja, - “mendoj se babai yt është qen.”

Kur iu përgjigj, Martini i tha troç se vetëm Bibla është fjala e pagabueshme e Perëndisë. Pastaj vijoi duke cituar apostullin Pal që shkroi: “Edhe sikur ne, ose një engjëll nga qielli, t’ju predikojë një ungjill tjetër nga ai që ju kemi predikuar, qoftë i mallkuar” (Galatasve 1:8). Martini i udhëzonte të gjithë ata që e dëgjonin që të shkonin te Krishti, i cili është zbuluar në Shkrimet, sepse vetëm aty mund të gjendet e vërteta e pagabueshme.

Për t’ia shtuar thumbin shkrimeve të tij, Martini përmendi intrigën e oborrit papnor dhe komentin fytes për të atin. Kur lexojmë fjalët e tij, shohim

se shumë shprehje të tij ishin të ashpra dhe nganjëherë fyese, por Martini ishte njeri i kohës së vet dhe shkrimet e tij pasqyronin prejardhjen e tij si klasë punëtore. Kur populli lexonte shkrimet e Martinit, e kuptonte lehtë se çfarë po thoshte.

Ai vijoi duke i thënë Prierios: “Pa dyshim që ti më gjykon sipas vetes tënde, por po të aspiroja për peshkop, me siguri që nuk do të përdorja gjuhën që ty t’i gërvisht kaq shumë veshët. Mendon se nuk e di unë se si sigurohen pozicionet e peshkopëve dhe priftërinjve në Romë? A nuk i këndojnë dhe fëmijët nëpër rrugë këto fjalë të mirënjohura:

*Nga gjithë gjirizet në këtë botë,
Vendi më i ndyrë gjendet në Romë.*

Së fundi, ti thua se papa është edhe papë, edhe perandor, dhe se ka pushtetin që të imponojë bindjen e popullit me anë të forcës së qeverive politike. Mos je i etur për gjak? ... Deklaroj se s’ke për të më trembur, as me shkrimet e tua mburravece, as me zhurmat kërcënuese të fjalëve të tua. Po më vranë mua, Krishti jeton; Krishti, Zoti im dhe i të gjithëve, i bekuar përjetë. Amen.”

Luteri nën kërcënim

Kundërshtimi ndaj Martinit dhe mësimëve të tij sa vinte e forcohej dhe shumë vetë po bëheshin gjithmonë e më të vendosur që ta dënonin ashpër murgun e Universitetit të Vitenbergut, që guxonte të sfidonte autoritetin e papës. Peshkopi i Brandenburgut vizitoi Vitenbergun dhe, pasi bisedoi me Martinin, u kthye në shtëpi i vendosur që t’i jepnin dënimin më të ashpër.

Gjatë dimrit të vitit 1518, i ulur përballë zjarrit të oxhakut në shtëpinë e vet si pallat, peshkopi mori në dorë një copë druri, e hodhi në flakët e zjarrit dhe deklaroi: “S’kam për t’u prehur në paqe pa hedhur dhe Martinin në zjarr, si këtë copë druri.”

10. Tubimi në Hajdelberg⁷⁴

Në prill 1518, në Hajdelberg do të mbahej kuvendi trivjeçar i urdhrit augustinian, pra, vetëm pak kohë pas botimit të tezave të Martinit në Vitenberg. Dr. Shtaupici, miku i ngushtë i Martinit, e thirri që të merrte pjesë dhe të mbante fjalim para murgjve të mbledhur. Emri i tij ishte përhapur me shpejtësi në mbarë botën e krishterë, kështu që mendohej e drejtë që një doktor kaq i spikatur të fliste në tubimin e murgjve augustinianë. Në këtë kuvend ishin të pranishëm dhe shumë të jashtëm nga urdhrat e tjerë murgërorë; madje dhe disa nga urdhri domenikan, të cilit i përkiste dhe Teceli.

Me gjithë paralajmërimet e miqve se mund t'i rrezikohej jeta, Martini u nis më këmbë për të rrugëtuar drejt Hajdelbergut. E shoqëronte një udhërrëfyes që mbante ato pak plaçka që i përkisnin doktorit të shquar.

Kur arritën në Vyrzburg, u takua edhe me dr. Shtaupicin dhe kryeabatin e Erfurtit. Tre ditët e fundit të udhëtimit, Martini dhe dy miqtë e tij i përshkruan me karrocë. Kur mbërritën në Hajdelberg, grupi mori ftesën nga konti palatin Volfgangu⁷⁵, duka i Bavarisë, që të vizitonin kështjellën e tij dhe të darkonin me të. Martini kishte me vete një letër për kontin palatin nga Frederiku, Elektori i Saksonisë. Pasi lexoi letrën, konti deklaroi: “Me të vërtetë që paske një letër të çmuar rekomandimi.”

Pas një takimi shumë të këndshëm, Martini me dy miqtë u ftuan sërish disa herë që të flisnin dhe të darkonin me të zotin e shtëpisë. Martini u ndie shumë i çlodhur prej atyre takimeve dhe më vonë tha: “Ishim shumë të lumtur dhe kënaqeshim me bisedat e pëlqyeshme dhe të këndshme të njëritjetrit; hanim e pinim, sodisnim gjithë bukuritë e pallatit palatin, admironim zbukurimet, armët dhe ushtarët e hipur mbi kuaj; madje gjithçka të mahnitshme që përmbante kjo kështjellë e famshme dhe vërtet mbretërore.”

Debati

Gjithsesi, Luteri kishte shkuar në Hajdelberg për të folur; debati me pesë doktorë të ditur ishte caktuar për datën 26 prill. Tema e ndjesave nuk ishte renditur për diskutim zyrtar; megjithatë, çështjet që pati ngritur Martini në predikimet dhe mësimet e veta u bënë temë diskutimesh private për orë të tëra.

Martini i paraqiti tubimit dyzet propozimet e tij që kishin të bënin kryesisht me temat e mëkatit fillestar, ligjit të Perëndisë dhe hirit të Perëndisë për shpëtimin e mëkatarëve. Lexojmë:

1. “Ligji i Perëndisë është një doktrinë e dobishme për jetën. Sidoqoftë, nuk është në gjendje ta ndihmojë njeriun që të fitojë drejtësinë; përkundrazi, e pengon.”

3. “Veprat e njeriut, sado të bukura dhe të mira të jenë, pavarësisht dukjes, nuk janë asgjë tjetër veçse mëkate vdekjeprurëse.”

4. “Sidoqoftë, veprat e mira, sado të pahijshme dhe të këqija të duken, kanë meritë të përjetshme.”

13. “Që nga rënia e njeriut, vullneti i lirë është thjesht fjalë pa vlerë; edhe sikur njeriu të bëjë maksimumin e mundshëm, prapëseprapë do të mëkatojë në mënyrë vdekjeprurëse.”

16. “Njeriu që gënjen veten se mund ta fitojë hirin duke bërë maksimumin e vet, shton mëkat mbi mëkat dhe është dyfish fajtor.”

18. “Është e sigurt se njeriu duhet të heqë dorë plotësisht nga përpjekjet e veta, që të jetë në gjendje të marrë hirin e Perëndisë.”

21. “Teologu i botës e quan të keqen të mirë dhe të mirën të keqe; por teologu i kryqit mëson gjërat e duhura në këtë çështje.”

23. “Ligji nxit zemërimin e Perëndisë, vret, mallkon, akuzon, gjykon dhe dënon çdo gjë që s’është në Krishtin.”

25. “Nuk shfajësohet njeriu që kryen shumë vepra, por ai që, pa vepra, ka shumë besim në Krishtin.”

26. “Ligji thotë bëj këtë! Por ajo që kërkon ai nuk bëhet kurrë. Hiri thotë beso në Krishtin! Dhe menjëherë bëhet gjithçka.”

28. “Dashuria e Perëndisë nuk gjen asgjë në njeriun, por krijon në të atë që do Perëndia. Dashuria e njeriut rrjedh nga Shumë i Dashuri.”

Përballë pesë doktorëve të ditur që i treguan mirësjellje të madhe, Martini u ndie i qetë dhe tregoi përlulje e durim të madh në diskutimin mes tyre. Më në fund Martinin e lanë vetëm për vetëm me një pjesëtar të panelit, dr. Giorg Niger, i cili kuptoi se propozimet e Martinit nuk mund të kundërshtoheshin. Prandaj ai deklaroi përpara profesorëve, studentëve dhe dëgjuesve të zellshëm që ishin mbledhur aty: “Po t’i dëgjonin fshatarët këto gjëra, do t’ju vrisnin më gurë.” Gjithë salla e mbushur plot e përplot

shpërtheu në të qeshura. Gjithsesi, të gjithë ata që dëgjuan diskutimet morën zemër dhe u inkurajuan nga fjalët e Martinit.

Madje disa arritën deri aty sa thanë: “Ai është në çdo aspekt si Erazmi, por në një gjë e tejkalon: Martini rrëfen haptazi atë që Erazmi mjaftohet vetëm duke e thënë me nënkuptime.”

Miqësi të reja

Të pranishëm aty ishin tre burra që u ndikuan së tepërmi nga gjithçka që tha Martini. Kështu u bënë dishepuj të tij dhe më vonë luajtën rol kryesor në përhapjen e doktrinëve të lavdishme të hirit, në mbarë botën e njohur. Njëri ishte domenikan: Martin Bucer⁷⁶. Ai zuri vend në sallë me letër, bojë dhe pendë. Synonte të mbante shënim gjithçka që thoshte Martini. Gjatë periudhave të debatit, Fryma e Krishtit e preku në zemër dhe rilindi në mbretërinë për të cilën po fliste Martini. Djaloshi i dytë ishte Johan Brençi⁷⁷ që u gëzua kur mësoi doktrinën e mahnitshme të shfajësimit vetëm me anë të besimit. I treti, Erhard Shnepf⁷⁸, gjeti në fjalët e Martinit pikërisht atë që kishte kërkuar gjithë jetën. Këta tre djem u bënë miq të ngushtë dhe shpenzuan gjithë kohën dhe energjitë e tyre për përhapjen e të vërtetave madhështore të Reformacionit.

Gjatë konferencës, Martin Buceri takoi Martinin dhe aty u formua një miqësi që zgjati gjithë jetën. Më vonë, për atë takim, do të shkruante: “Pata një bisedë miqësore dhe private me të; një gosti e shkëlqyer, jo me ushqime të zgjedhura, por me të vërteta që m’u shtruan përpara. Për çdo kundërshti që i shprehja, doktori e kishte një përgjigje dhe gjithçka ma shpjegonte me qartësi absolute. Ah, sikur të kisha patur kohë që të shkruaja më shumë gjëra!”

Edhe Martini shkroi për këtë takim: “Ai është i vetmi vëlla nga urdhri i tij që është i sinqertë; është djalosh me shumë perspektivë. Më pranoi me çiltërsi dhe foli shumë sinqerisht me mua. Meriton besimin dhe dashurinë tonë.”

Bucer i s’ishte i vetmi që i trokiti në derë Martinit gjatë qëndrimit në Hajdelberg. Atë e përmbytën vizitorët që përpiqeshin t’ia dëgjonin mësimet. Zjarri reformues që u ndez në Vitenberg filloi të flakëronte fuqishëm dhe shndritshëm në Hajdelberg, pasi Martini doli nga dera e qytetit për t’u kthyer në shtëpi.

Kurajë përballë rrezikut

Përpara se të nisej për në Vitenberg, konti palatin i dorëzoi Martinit një letër për Frederikun⁷⁹, dukën e Saksonisë. Datën e kishte 1 maj dhe pjesërisht shkruante: “... Luteri ka treguar aq shumë mjeshtëri në debat, sa që do të kontribuojë së tepërmi për emrin e shkëlqyer të Universitetit të Vitenbergut.”

Ish-heretiku famëkeq tani ishte teologu i famshëm, mësimet e të cilit po fitonin mbështetjen dhe respektin e shumë vetëve. Ndjekësit e tij, ashtu si dhe armiqtë, po shumëfishoheshin. Thashethemi për shkishërimin e tij të mundshëm u përhap tejmbanë dhe për shumë njerëz kjo donte të thoshte se jeta e Martinit ishte në rrezik të madh. Si rrjedhojë, nuk e lejuan që të kthehej në shtëpi më këmbë. Të gjithë ata që mundeshin i ofruan ta çonin me pajtonin e tyre dhe ai u largua nga Hajdelbergu me një pajton që i përkiste kuvendit murgëror. Kur mbërriti në Ajsleben, e pritën gjithë krenari murgjit augustinianë të Vitenbergut, të cilët e shoqëruan mësuesin e tyre të famshëm për në qytetin e tij.

Martini i gëzuar hyri në Vitenberg, i kënaqur që ishte kthyer shëndoshë e mirë dhe i lumtur që fjala e Perëndisë po përhapej në mbarë vendin. E dinte se jeta e tij po hynte në një periudhë rreziku të madh, por s’druhej prej asgjëje që mund t’i bënin njerëzit. Pas kthimit nga Hajdelbergu, i shkroi një miku me një ton shumë të shkujdesur: “Sa më shumë më kërcënojnë këta njerëz, aq më i sigurt ndihem. Tashmë i kam siguruar gjërat për gruan dhe fëmijën tim dhe u kam lënë trashëgim tokën, shtëpinë dhe zotërimet e mia; emri dhe reputacioni im tashmë janë bërë fërtele. E vetmja gjë që më ka mbetur është trupi im i mjerë dhe i brishtë. Le të ma marrin; maksimumi kjo do të ma shkurtonte jetën me nja dy orë; po shpirtin s’ma rrëmbejnë dot.... Para pak kohësh u predikova besimarëve për shkishërimin dhe virtytet e tij. Dënova tiraninë dhe padijen e gjithë tufës së ndyrë të zyrtarëve, të dërguarve të papës dhe përfaqësuesve të tij. Të gjithë shqyenin sytë, ngaqë s’kishin dëgjuar asnjëherë më parë diçka të tillë; tani të gjithë po presin të shohin se ç’gjë e keqe do të më ndodhë nga kjo. Kam ndezur një zjarr të ri, por kështu ndodh me fjalën e së vërtetës.”

Në atë kohë Martini s’ishte i martuar dhe nuk zotëronte asnjë pronë, por letra e tij, e shkruar disi me humor dhe teprim, tregonte se ai ishte gati të përballej me vdekjen, për hir të së vërtetës. Koha që kaloi në Hajdelberg doli

shumë e frytshme, sepse kishte mbledhur rreth vetes disa miq të palëkundur që e mbështetën më vonë në kohët e vështira.

Luteri flet kundër shkishërimit

Shumica e njerëzve i druheshin shkishërimit që përdorej shumë shpesh si kërcënim për t'i mbajtur anëtarët e kishës nën tutelë, ose si ndëshkim për ata që nuk u bindeshin urdhrave kishtarë. Shkishërimi nënkuptonte që personi në fjalë s'kishte më vend në kishë dhe në shumë raste, as në jetën e shoqërisë ku jetonte. Nënshtetasit u trembeshin më së shumti flakëve pastruese të purgatorit, por ato flakë merrnin fund kur përmbushej shlyerja e mëkateve. Ndërsa shkishërimi nënkuptonte ndarjen nga Kisha dhe si rrjedhojë mungesën e shpëtimit; njerëzit e shkishëruar i prisnin vetëm flakët e përjetshme të ferrit.

Në fillim, shkishërimi nga privilegjet e Kishës Katolike përdorej për mëkatarët më të këqinj që nuk pranonin të pendoheshin dhe të paguanin pendesat e caktuara. Mirëpo tani kishte ardhur koha kur shkishërimi përdorej si ndëshkim për mospagesën e taksave dhe tarifave të Kishës, si dhe për një larmi shkeljesh të vogla. Me shkishërim dënoheshin nënshtetasit si individë ose përfaqësuesit e Kishës; madje, në disa raste, shkishëroheshin familje të tëra, për shkak të sjelljes së gabuar të një pjesëtari të tyre. Janë regjistruar dhe raste kur këtë fat e pësonte gjithë këshilli bashkiak i qytetit, për shkak se s'kishin paguar tarifat e Kishës. Tani Martini filloi të fliste hapur kundër kësaj sjelljeje jobiblike të papatit.

Koha në Hajdelberg doli se ishte shumë inkurajuese për Martinin. Aty bëri miq për gjithë jetën dhe u kënaq në shoqërinë e sivëllezërve murgj. Ishte kuvend i vërtetë: një kohë çlodhjeje krahasuar me disa muaj më parë. Më vonë i shkroi Spalatinit⁸⁰, i cili ishte kapelani i oborrit të Frederikut të Saksonisë, dhe i tha se 1518-a kishte qenë vit i shkëlqyer për vreshtat. Martini u kthye në Vitenberg me forca të reja dhe i gatshëm për episodin e radhës në betejën kundër pushtetit të papatit.

11. Luteri takon kardinalin Gaetano⁸¹

Perandori Maksimilian organizoi një dietë⁸² : një takim sundimtarësh që do të kryhej në Augsburg⁸³. Aty u përfaqësuan të gjitha shtetet gjermane, madje kishte delegatë dhe nga mbretërit e Francës, Hungarisë dhe Polonisë.

Dieta kishte synim të dyfishtë: së pari, papa donte të merreshin masa ushtarake kundër turqve, që nënkuptonte vendosjen e taksave të rënda. Delegati i papës Leon, kardinali Gaetano, parashtoi propozimin e papës, por nuk arriti të merrte shumë mbështetje, pasi princat gjermanë e shihnin me shumë dyshim kërkesën e papës; ata shihnin si armik Romën, jo turqit.

Në një dokument që u lexua në dietë, një i deleguar lexoi (në latinisht): “Ju dëshironi t’i jepni dërmën turkut. Mirë, pra, por kam shumë frikë se jeni gabuar për armikun. Duhet ta kërkonti në Itali, jo në Azi.”

Perandori i moshuar Maksimilian donte që nipi i vet, Karli, të zgjidhej pasardhës i tij dhe të bëhej mbret i romakëve. Në debatin për zgjedhjen e Karlit si perandor, pas vdekjes së Maksimilianit, delegati i papës iu kundërvu propozimit të Maksimilianit. Ndërsa Frederiku i Saksonisë e mbështeti pozicionin e papës për këtë çështje; kjo e vuri në pozita të favorshme me papatin. Loja e pushtetit politik të kohës pati rëndësi të madhe, pasi bëri të mundur sigurinë e Martinit. Elektori Frederik ishte sundimtari politik i Martinit dhe siguria e tij varej nga qëndrimi i Frederikut.

Luteri thirret në Romë

Gjatë kohës së atij takimi, Martinin e urdhëruan të paraqitej në Romë, për t’u përballur me akuzën e herezisë. Në përpjekje për të fituar pëlqimin e papës, perandori i shkroi duke kërkuar të merreshin masa kundër Martinit, për çështjen e ndjesave. Në një pjesë i shkruante: “Nëse shenjtëria juaj dhe etërit tejet të nderuar të Kishës (pra, kardinalët) nuk ushtroni menjëherë autoritetin tuaj për t’u dhënë fund këtyre skandaleve, këta mësues të ligj, jo vetëm që do ta nxjerrin popullin e thjeshtë nga rruga e Zotit, por do të përfshijnë dhe princat e mëdhenj në shkatërrimin e tyre. Ne do të zbatojmë çfarëdolloj vendimi të dekretojë shenjtëria juaj për këtë çështje, sepse lavdia e Perëndisë së Gjithëpushtetëm duhet të zbatohet në mbarë perëndorinë.”

Kur, më 7 gusht, Martini mori fletëthirrjen që të paraqitej në Romë, e kuptoi se, po t'i bindej kësaj, kishte për të vdekur. Duke ditur se i vetmi njeri që mund ta shpëtonte ishte Frederiku, Elektori i Saksonisë, i shkroi Spalatinit, ku i përgjerohej që të përdorte ndikimin e vet të Frederiku, për t'u siguruar që seanca dëgjimore të kryhej vetëm në tokë gjermane. Ndërkaq, miqtë e nxitën Martinin që të qëndronte në Vitenberg dhe bërtitën: “Do të të djegin! Mos shko!”

Në të njëjtën kohë, autoritetet e Universitetit të Vitenbergut i shkruan papës Leon, duke i thënë për Martinin: “Dobësia e fizikut të tij dhe rreziqet e udhëtimit e bëjnë të vështirë, madje të pamundur, që ai t'i bindet urdhrit të shenjtërisë suaj. Shqetësimi dhe lutjet e tij na bëjnë që ta mirëkuptojmë. Prandaj, ju përgjerohej, o Atë i tërëshenjtë, si bij të bindur, që ta shihni Martinin si një njeri që nuk është njollosur kurrë nga doktrinat që i kundërvihen mësimave të Kishës Katolike.”

Në të njëjtën kohë i shkruan dhe administratorit të papës, Karl fon Milticit, ku i thanë kështu për Martinin: “Ati i nderuar augustinian Martin Luter është anëtar më i nderuar dhe më i shquar i universitetit tonë. Për shumë vjet kemi parë dhe kemi njohur talentet, diturinë dhe njohjen e tij të shkëlqyer të arteve dhe letërsisë, moralin e tij të panjollësuar dhe sjelljen e tij që është vërtet e krishterë.”

Nga respekti për Frederikun, papa vendosi që seanca dëgjimore për Martinin të kryhej në Gjermani, në Augsburg. Perandori Maksimilian e këshilloi Frederikun që t'i garantonte sigurinë Martinin, pasi një ditë mund t'u hynte në punë për mosmarrëveshjet me Romën. Frederiku ra dakord dhe i dërgoi Martinin njëzet gulden për përballimin e kostos së udhëtimit për në Augsburg.

Kardinali Gaetano

Papa caktoi Tomazo de Vion, i njohur më mirë si kardinali Gaetano, që të kryente rolin e prokurorit në emër të Romës. Ai ishte anëtar i spikatur i urdhrit domenikan; më vonë u bë kardinal i Kishës dhe kryetari i urdhrit domenikan. Papa Leon i shkroi: “Të urdhërojmë që të thërrasësh personalisht përpara teje, të procedosh dhe të detyrosh pa vonesë, madje që në çastin kur të marrësh këtë letër prej nesh, personin e quajtur Luter, i cili është shpallur tashmë heretik.... Nëse ai këmbëngul në kokëfortësinë e vet dhe s'e arreston dot, të autorizojmë ta shpallësh të jashtëligjshëm në çdo

pjesë të Gjermanisë; dëbo, mallko dhe shkishëro gjithë ata që shoqërohen me të; urdhëro gjithë të krishterët që t'i qëndrojnë larg.”

Porositë e papës

Luteri duhet të dilte para kardinalit më 7 tetor 1518. Në të njëjtën kohë, papa i shkroi Frederikut, duke e paralajmëruar që të mos i jepte asnjë mbështetje Martinit, të cilin e përshkroi si “bir të djallit”. Miqtë dhe ndjekësit e shumtë e paralajmëruan Martinin se jetën e kishte në rrezik. Po kështu, ishte përhapur anembanë thashethemi se disa kriminelë ishin betuar se do ta kapnin forcërisht dhe do ta mbysnin me duart e tyre ose do ta hidhnin në lumë.

Luteri përgatitet për takimin në Augsburg

Mirëpo, pa u shqetësuar shumë për jetën e vet, Martini ishte gati të merrte rrugën për në Augsburg. Më vonë do të shkruante për udhëtimin që do të ndërmernte duke iu referuar një letre të mëparshme, në lidhje më kohën në Hajdelberg: “Unë jam si Jeremia, njeri telashesh dhe polemikash; por sa më shumë shtohen kërcënimet e tyre, aq më shumë më shumëfishohet gëzimi. Gruan dhe fëmijët e mi i kam rregulluar; fushat, shtëpitë dhe pronat i kam vënë në vijë. Nderin dhe emrin e mirë ma kanë shkatërruar tashmë. Vetëm një gjë mbetet: trupi im i mjerë. Le të ma marrin; vetëm sa do të ma shkurtojnë jetën me nja dy orë. Por, ama, shpirtin s'ma marrin dot. Ai që dëshiron të shpallë Fjalën e Krishtit në botë, duhet të presë vdekjen në çdo çast; sepse bashkëshorti ynë është bashkëshort i përgjakur.” Sërish duhet vërejtur se kjo letër u shkrua përpara se Martini të martohej ose të kishte prona. Ai thjesht po thoshte se i kishte vënë në vijë punët tokësore dhe ishte gati të përballej me vdekjen.

Kur Elektori Frederik mori garanci se Martini do të trajtohej mirë, i dha disa letra prezantimi, që t'ua jepte këshilltarëve më në zë të Augsburgut.

I veshur me rrobën e përulur augustiniane, Martini u nis më këmbë për t'u takuar dhe debatuar me Tomazo de Vion. Problemi mes Martinit dhe papës s'kishte fare rëndësi për krerët e mbledhur të perandorisë. Ata kishin në mendje problematika më të mëdha, ndaj ishin të gatshëm të luanin lojëra politike dhe të forconin pozitat me çdo çmim; kjo nënkuptonte që të forconin edhe pozitat ndaj Romës.

Sapo mbërriti në Augsburg, Martinin e takoi Serra Longa, një ndihmës i kardinalit Gaetano. Në takimet paraprake, ai i bëri fuqishëm thirrje Martinit

që të pendohej dhe t'i nënshtrohej papës së Romës dhe mësimëve të Kishës. Përgjigja e Martinit mund të përmbledhet me këto fjalë: “Nëse më bindin se kam mësuar diçka kundër Kishës Katolike, do të bëhem gjykatësi i parë kundër vetes dhe do të pendohem menjëherë...”

Kur Martini u dorëzoi këshilltarëve letrat që i kishte dhënë Frederiku, e pritën me nderime. Pak më vonë, i erdhi urdhri që të dilte përpara De Vios. Mirëpo Martini s'pranonte të shkonte pa marrë garancinë e kardinalit se jeta e tij s'do të ishte në rrezik. Martini i dinte shumë mirë ngjarjet që çuan në vdekjen e Jan Husit, ndaj me vete mbante një lejekalim që i garantonte sigurinë. Kur mori garancinë për kalim të sigurt, u caktuan datat për takimet mes Martinit dhe delegatit të papës: e martë deri të enjten, 12-14 tetor 1518.

Kardinali Gaetano mbërriti në Augsburg me gjithë pompozitetin dhe ceremonitë e mundshme; tek e fundit, ai ishte përfaqësuesi personal i papës. Kishte kërkuar që më parë që dhomat ku do rrinte të ishin të mbuluara me mëndafsh të purpurt, që nënkuptonte statusin e tij. Në meshën që drejtoi ishin të pranishëm gjithë sundimtarët e perandorisë. Ai i dhuroi kryepeshkopit Albreht të Maincit një kapele kardinali, ndërsa perandorit Maksimilian një shpatë të shenjtëruar. Ishte tejet i gatshëm të bënte gjithçka mundte, që të fitonte mbështetjen e gjermanëve për taksën e veçantë që do të përdorej për të luftuar ushtritë e turqve. Mirëpo gjermanët këtë lloj takse e konsideronin thjesht si më shumë para që do të përdorehin nga Roma.

Gaetanoja kishte bindjen e plotë se gjermanët e thjeshtë ishin shtetas besnikë të Romës. Prandaj besonte se Martini, një murg i parëndësishëm, kishte për t'u mposhtur dhe do t'i dorëzohej Romës, për të marrë ndëshkimin e merituar. Mirëpo, pas shpine, kardinal Gaetanoja ishte bërë gazi i botës. Kuzhinierët që i gatuanin vaktet, pas pak kohe u thoshin të gjithëve se kardinali kërkonte që vaktet t'ia shërbenin me pjata argjendi. Po kështu, përsërisnin pa teklif ankesat e tij për ushqimet gjermane: buka ishte tepër e fortë, mishi i thëllëzës që shumë i vështirë për t'u kafshuar dhe vera, tepër e thartë.

Me vete kardinali mendonte se gjermanët ishin thjesht barbarë të pagdhendur, ndaj shprehte pakënaqësi që qytetarët e Augsburgut shfaqnin mungesë respekti ndaj tij. Poeti gjerman Ulrih fon Hutën⁸⁴, që ishte i pranishëm në atë takim, qarkulloi një dokument të vetin, ku thoshte se,

meqë Gaetanos i dukej shumë i parehatshëm moti i ftohtë, do ta shkishëronte diellin, po të mos shkëlqente fort dhe ta ngrohte Gjermaninë e ftohtë.

Përballja me Gaetanon

Martini, që e kishin këshilluar si të sillej kur të takohet me kardinalin Gaetano, u shtri përtokë përpara kardinalit, kur u takuan. Kur i thanë që të ngrihej, qëndroi i gjunjëzuar, derisa e urdhëruan për herë të dytë që të ngrihej në këmbë.

Pastaj dy burrat nisën një debat publik për pikat e debatuar teologjike. Thelbi i çështjes për t'u diskutuar ishte vlera shpirtërore e meshës dhe vlera e ndjesave. De Vioja mori në dorë tezat e Martinit, i tregoi me gisht, dhe deklaroi: “Ja, në propozimin e shtatë, ti mohon se sakramenti mund të ketë vlerë, nëse dikush s’ka besim; ndërsa, në propozimin e pesëdhjetë e tetë, ti e mohon se meritat e Krishtit janë pjesë e atij thesari nga i cili papa u fal ndjesa besimtarëve.”

Pastaj vijoi duke i kërkuar: “Duhet t’i mohosh të dyja këto gabime dhe të përqafosh doktrinën e vërtetë të Kishës....”

Pastaj, si e quajti Martinin “biri im i dashur...”, i kërkoi tri gjëra. E para, që Martini të tërhiqte gabimet; e dyta, që të mos mësonte dhe përhapte më pikëpamjet e veta; dhe, e treta, që në të ardhmen, të mos bënte asgjë që t’i prishte paqen Kishës. Gjithë këto kërkesa ia përmblodhi me një fjalë të vetme: “Pendohu!”

Përgjigjja e Martinit ishte shumë troç: “Unë kërkoj prova nga Shkrimi që e kam gabim; pikëpamjet e mia bazohen në Bibël!”

Kësaj, De Vioja iu përgjigj: “Papa ka pushtet dhe autoritet mbi gjithçka....”

Martini e ndërpreu dhe deklaroi: “Përveç Shkrimit!”

Kardinali ia ktheu: “Përveç Shkrimit?!... A e di se papa është mbi çdo këshill kishtar?”

Në përmbyllje të debatit të parë, Luteri u tërhoq në kuvendin karmelit⁸⁵, ku pa se e priste miku i tij i mirë, dr. Shtaupici. Ai s’kishte dashur që Martini të merrte rrugën për në Augsburg, pasi druhej se do ta vrisnin, por, kur përgjërimet e tij dështuan, iu duk me vend që të merrte pjesë në ato takime dhe ta mbështeste Martinin e tij të dashur. Shtaupici e nxiti Martinin që argumentet t’i hidhte me shkrim, në mënyrë që De Vioja të përballej me të vërtetën për pikëpamjet e tij. Kështu veproji dhe, ditën e dytë të intervistave, i

paraqiti kardinalit dokumentin në fjalë, ku shkruante: “Deklaroj se e nderoj Kishën e shenjtë Katolike dhe se do të vazhdoj ta nderoj.” Më tej vijonte duke i shprehur ankesën se i kishin kërkuar që të pendohej, pa e kundërshtuar më parë me anë të Shkrimeve.

Pastaj, ditën e tretë të debatit, Martini argumentoi: “Shenjtorët nuk shpëtohen me meritat e tyre, por vetëm me hirin e Perëndisë, siç kam shpallur. Këtë e pohoj dhe i qëndroj besnik. Fjalët e Shkrimit të Shenjtë që deklarojnë se shenjtorët nuk kanë merita të mjaftueshme, duhen vendosur mbi fjalët e njerëzve që thonë se shenjtorët kanë merita me tepri. Papa nuk është mbi Fjalën e Perëndisë, por nën të!”

Pastaj vijoi më tej, duke deklaruar: “Jo, meritat e Jezu Krishtit nuk janë thesar ndjesash që e përjashtojnë njeriun nga veprat e mira, por thesar hiri që e ripërtërijnë njeriun. Meritat e Krishtit i jepen besimtarit pa ndjesa, pa çelësa, dhe vetëm me anë të Frymës së Shenjtë, jo me anë të papës. Nëse dikush ka ndonjë mendim më me bazë se unë, ma bëni të ditur dhe atëherë do t’i tërheq mendimet e mia.”

Sigurisht, gjatë fjalimeve të veta, Martini citonte gjerësisht Shkrimet.

Në fund, De Vios s’i mbeti gjë tjetër, veçse të ngrinte zërin dhe ta urdhëronte Martinin: “Tërhiq! Tërhiq! Nëse s’bën kështu, do të të dërgoj në Romë, që të dalësh përpara gjykatësve të autorizuar, për të marrë vendimet për çështjen tënde. Do të të shkishëroj, bashkë me gjithë mbështetësit e tu dhe gjithë ata që të përkrahin ose mund të të përkrahin, dhe do t’i përjashtoj nga Kisha.” Pastaj vijoi duke thënë disa fjalë që i mbushën me tërbim zemrat e gjermanëve të pranishëm: “Mendon se mbrojtësit e tu do të më ndalojnë? Mendon se papës i bie ndërmend për Gjermaninë? Edhe gishti i vogël i papës është më i fortë se gjithë princat gjermanë të marrë së bashku.”

Roma, që s’e kuptonte forcën e patriotizmit gjerman, nuk bëri asnjë përpjekje të vërtetë për të fituar mbështetjen e krerëve gjermanë dhe popullit të tyre. Kjo bëri që Martini të fitonte mbështetjen e shumë njerëzve që në një epokë tjetër do t’i kishin miratuar kërkesat e papës.

I përballur me një tjetër kërkesë për t’u penduar, Martini i ktheu kurrizin kardinalit Gaetano dhe u largua. Nuk u takuan më.

Pasojat e takimit

Martinit s'i lanë shumë mbresa argumentet e kardinalit Gaetano dhe në një letër pohoi: "Sa çështë gomari i aftë t'i bjerë harpës, aq është i aftë kardinali ta trajtojë këtë çështje."

Pa kaluar shumë kohë, fjalët e Martinit u bënë publike dhe u shfaqën karikatura të papës me pamje gomari, që i binte harpës. Ndonëse ai s'e dinte, kjo periudhë shënoi ndarjen e Martinit me Romën dhe ndarjen e Romës me Martinin.

Pastaj dr. Shtaupici u takua me De Vion, i cili i kërkoi që ta bënte Martinin të pendohej. Kësaj kërkesë, dr. Shtaupici iu përgjigj: "Jam përpjekur shpesh, por s'krahsohem dot me aftësinë e tij dhe me njohurinë që ai ka për Shkrimin. Ti je përfaqësuesi i papës. Nga ty varet kjo."

Gaetano deklaroi: "S'flas më me të. I ka sytë e thellë si liqeni, ndërsa mendjen e ka të mbushur me hamendësime të mahnitshme."

Në atë kohë Martinin e çliruan nga zotimi i bindjes ndaj urdhrit augustinian. Më vonë tha: "Tri herë më shkishëruan; së pari, më shkishëroi Shtaupici; së dyti, papa; dhe, së treti, perandori."

Diskutimet kishin përfunduar. Si dëgjoi se Gaetano ishte gati ta shkelte garancinë e sigurisë që i pati dhënë, ta arrestonte dhe ta çonte në Romë, për t'u përballur me akuzat për herezi, Martini vendosi ta linte Augsburgun. Kur Shtaupici dëgjoi se mund ta arrestonin dhe atë vetë, u nis disa ditë përpara Martinit, i cili qëndroi për të biseduar më tej vetëm për vetëm me burrat që e mbështesnin.

Kur Martini kuptoi se rreziku që i kanosej jetës së tij ishte i vërtetë, vendosi të arratisesh. I siguruan një kalë dhe, ndërsa qytetarët e Augsburgut flinin, ai u arratis përmes një derëze të murit të qytetit. Kalëroi tetë orë pa pushuar, pasi donte që të krijonte një largësi të madhe mes vetes dhe armiqve. Pas kalërimit të gjatë, fjeti mbi kashtë në një stallë dhe pastaj, meqë s'kishte kohë as të hante, u nis sërish për udhë; kësaj here shkoi në Nyremberg, ku më në fund u ndie i sigurt.

Në shtëpi mbërriti më 30 tetor, ku e gjeti veten mes miqsh. Martini ishte mirë fizikisht dhe mendërisht. Për një farë kohe s'pati fare periudha melankolie, as probleme me stomakun. Udhëtimi i kishte bërë jashtëzakonisht mirë: fizikisht, mendërisht dhe shpirtërisht.

Elektorit i kërkohet të dorëzojë Luterin

Kur shkroi një raport për ngjarjet që patën ndodhur në Augsburg, Elektori Frederik mori një kërkesë nga kardinali Gaetano që të dorëzonte Martinin. Siç e kishte zakon, Frederiku e vuri mënjanë këtë letër-kërkesë dhe shpresoi se gjithë kjo çështje do të harrohej. Mirëpo një kopje ia dërgoi Martinit, ku i kërkonte mendimin. Martini i nisi një përgjigje, ku i tha: “Unë deklaroj se po largohem nga vendi im, me synimin që të shkoj kudo ku dëshiron Perëndia i mëshirshëm.”

Në përgjigjen për Elektorin Frederik dhe në materialet e tjera që botoi, Martini sulmoi pozicionin teologjik të Romës për ndjesat. Ai argumentoi se Shkrimet ishin autoriteti përfundimtar për pikat në diskutim dhe deklaroi se Bibla s’ ishte përdorur në asnjë rast nga Roma, për t’ia kundërshtuar argumentet.

Meqë Elektori Frederik nuk iu përgjigj aty për aty letrës së Martinit, ky i fundit bëri përgatitjet për t’u larguar nga Vitenbergu.

12. Debati publik me Johan

Ekun⁸⁶


Shumë gjëra po ndodhnin në Evropë në atë kohë. Mbështetësit e Martinit u shumëfishuan aq sa pothuajse tre të katërtat e popullit gjerman e mbështesnin kundër tiranisë së Kishës së Romës. Sigurisht, shumë prej atyre mbështetësve s'ishin plotësisht të vetëdijshëm për domethënien shpirtërore të gjërave që mësonte Martini, por thjesht gëzoheshin që, më në fund, kishin një udhëheqës, i cili do ta bashkonte kombin kundër papës së Romës.

Melanktoni vjen në Vitenberg

Pastaj Filip Melanktonin e caktuan anëtar fakulteti në Universitetin e Vitenbergut, gjë që pati te Martini një ndikim, i cili do të zgjaste gjithë jetën. Filipi ishte lindur në shkurt 1497 dhe në moshën 17-vjeçare (1514) kishte marrë diplomën si “Doktor i Filozofisë”. Asokohe Frederiku po kërkonte një profesor të ri të gjuhëve të lashta për universitetin e vet, kështu që ftuan si lektor Melanktonin.

Kur mbërriti, profesorëve nuk u la shumë përshtypje ajo që panë: një djalosh që dukej edhe më i ri se 21 vitet që kishte mbi supe, i shkurtër në shtat dhe tejet i turpshëm në sjellje. Për postin në Universitetin e Vitenbergut e kishin rekomanduar shumë studiues të shquar, por profesorët aty menduan se kishin bërë gabim trashanik që ia kishin dhënë atë post.

Më 31 gusht 1518, ai mbajti fjalimin përurues. Kur zbriti nga podiumi, e rrethuan shumë të pranishëm, të cilët e uruan për fjalimin e shkëlqyer. Martini i shkroi Spalatinit dhe i tha: “Katër



ditë pas mbërritjes, Melanktoni mbajti një ligjëratë me kaq nivel dhe kaq të bukur, saqë të gjithë e dëgjuan të mrekulluar dhe me admirim. E morëm veten shpejt nga paragjykimet që patëm, për shkak të trupit dhe dukjes së tij; tani ia lavdërojmë dhe admirojmë gojëtarinë.... Por druaj se trupi i tij i brishtë do ta ketë të pamundur ta përballojë mënyrën tonë të jetesës dhe do

ta kemi të pamundur ta mbajmë për një kohë të gjatë, për shkak se rrogën e ka të ulët.... O i dashuri im Spalatin, kujdes se mos ia përçmon moshën dhe pamjen. Ai njeri meriton çdo nderim.”

Aty për aty, Melanktoni nisi një seri leksionesh për Homerin dhe për Letrën e Palit drejtur Titit, të cilat u pritën me shumë mirënjohje. Rëndësi të madhe pati miqësia jetëgjatë që lindi mes Martinit dhe Melanktonit; kjo miqësi do të zgjaste deri ditën kur Martini do të vdiste. Miku i tij i ri, që e njihnte me themel greqishten, e ndihmoi së tepërmi Martinin, kur përktheu Shkrimet në gjuhën gjermane.

Miltici dhe trëndafili i artë i papës

Në atë kohë Martini po shkëmbente letra me shumë njerëz të ditur, për çështjet që pati ngritur. Universiteti i Vitenbergut fitoi nam edhe më të madh dhe njerëzit vinin nga të gjithë anët në qytetin universitar të Elektorit Frederik, që të dëgjonin Martinin.

Pas debateve me Gaetanon, Milticit (që vetë ishte sakson) iu dha detyra që t'i dhuronte Elektorit Frederik “trëndafilin e artë” të papës. Zakonisht kjo ishte një dhuratë që papa ia bënte një sundimtari të rëndësishëm, të cilin e konsideronte mik të ngushtë; zakonisht ia jepte si shpërblim për ndonjë shërbim që mund t'i kishte bërë papatit. Këtë gjë Frederiku e kishte bërë, kur pati mbështetur Romën kundër caktimit të Karlit si perandor, pas vdekjes së Maksimilianit. Për shumë vjet Frederiku i kishte lënë përshtypje papës për sjelljen e tij besnike dhe të bindur. Papa shpresonte se do ta pranonte këtë dhuratë që ishte shpërblimi më i madh që mund t'i jepte Roma një sundimtari.

Në të njëjtën kohë papati shpresonte që, nëse do të arrinte t'ia blinte mbështetjen Frederikut me këtë “trëndafil të artë”, problemet që kishin të bënë me Martinin, murgun heretik të Universitetit të Vitenbergut, i cili i përkiste Elektorit Frederik, do të përmbylleshin në mënyrë të kënaqshme.

Papa Leon i shkroi Frederikut në lidhje me dhuratën e trëndafilin të artë: “Bir i dashur, këtë trëndafil të artë dhe të tërëshenjtë e përkushtuam në të katërmbëdhjetën ditë të agjërimit të shenjtë. E vajosëm me vaj të shenjtë dhe e spërkatëm me temjan erëmbël me bekimin papnor. Dhuratën do të t'jua paraqesë biri im i shtrenjtë, Karl fon Miltici, një njeri me gjak fisniku dhe me sjellje të fisme. Ky trëndafil është simboli i gjakut të paçmuar të Shpëtimtarit tonë, me anë të të cilit jemi shpenguar. Trëndafili është lule mbi lulet; më e

bukura dhe më erëmira mbi dhé. Prandaj, bir i dashur, lejoni që aroma hyjnore të depërtojë deri në fund të zemrës së Shkëlqesisë suaj, që të mund të përmbushni çfarëdo gjëje që do t'ju kërkojë i lartpërmenduri Karl fon Miltic.”

Përveç “trëndafilin të artë”, në portofolin diplomatik Miltici mbartte dy dokumente papnore që ua hiqnin njollën e paligjshmërisë dy bijve të Frederikut, të cilët i kishte bërë me një grua që s’e kishte bashkëshorte. Paligjshmëria ishte pengesë për marrjen e posteve të larta kishtare dhe Frederiku kishte ca kohë që shqetësohej për statusin e dy bijve të tij të damkosur.

Martini ishte dënuar plotësisht nga papa. Në një letër drejtuar Frederikut, Martini ishte quajtur “bir i Satanit, bir i humbjes, dele e molepsur dhe egjër në vresht”.

Por kjo lloj gjuhe s’e lëkundti Frederikun në mbështetjen që i jepte profesorit më të shquar të universitetit. Martini kishte kohë që studionte me imtësi; po bënte një studim të veçantë të dekreteve papnore, ku i krahasonte me mësimin e Biblës. Spalatinit i shkroi: “Po lexoj dekretet e papëve dhe (këtë po ta pëshpëris në vesh), kaq shumë keqinterpretohet dhe kryqëzohet Krishti në to, sa që nuk e di nëse papa është vetë Antikrishti, apo thjesht apostulli i tij.” Më tej e quajti papën “zot të kësaj bote”, sërish një shprehje që përdorej për Satanin.

Meqë shpejt Elektorit Frederik do t’i dhurohej trëndafili i artë, De Vioja dhe të tjerët menduan se ishte koha e përshtatshme t’i kërkonin Frederikut që t’ia dorëzonte Martinin Romës. Ndërsa De Vioja mori rrugën për në Austri, që të takohej me perandorin Maksimilian, Miltici përfitoi nga mundësia që të niste diskutimet me Frederikun, me shpresën se do të zgjidhnin telashet që u kishin shkaktuar shkrimet e Martinit. Shpresonte se diskutimet do të çonin në një zgjidhje reciproke të pranueshme dhe të paqshme për këtë rrugë pa krye. Miltici ushqente shpresa se, po ta arrinte këtë synim, do t’i forcoheshin së tepërmi pozitat nga ana e papës.

Frederiku, që e donte paqen, e pranoi pa një pa dy ofertën. Nuk i druhej as Romës, as të dërguarve të saj. Ishte tejet i gëzuar që universitetit të tij në Vitenberg po i shtohej fama mbi gjithë universitetet e tjera gjermane dhe e dinte se, me rritjen e famës së Martinit, truri më i përzgjedhur i Gjermanisë do të joshej për të ardhur në fakultetet e atij universiteti. Madje Martini

pohoi: “Qyteti ynë s’i strehon dot gjithë turmat që turren drejt tij.... Numri i studentëve po rritet së tepërmi, si lumi që del nga shtrati.”

Tani shkrimet e tij botoheshin në gjuhën gjermane dhe shpërndareshin gjerësisht anekënd Gjermanisë. Pothuajse të gjitha këto shkrime i kishin rënë në dorë dhe papës Leon.

Dhe, kështu, Martini mundej që tani të nxirrte plaçkat nga valixhja, pasi s’kishte nevojë të largohej nga Vitenbergu, të paktën për aq kohë sa do të zgjasnin takimet me Milticin.

Turpërimi i Tecelit

Përpara se Miltici të fliste me Martinin, i shkoi për vizitë mikut të tij të vjetër, Spalatinit, dhe, përpara se të ngrinte problemin e Martin Luterit, u përball me ankesa për metodat e shitjeve të Tecelit dhe iu tha shumë qartë se gjithë Gjermania ia hidhte plotësisht fajin Tecelit për ndasinë e krijuar në Kishë. Në vend që të fajësonte Martinin, tani Miltici kërkoi që Teceli të dilte përpara tij, për t’iu përgjigjur këtyre akuzave të rënda.

Teceli u tmerrua kur mori fletëthirrjen që të paraqitej dhe t’u përgjigjej akuzave të ngritura kundër tij. Nuk u paraqit, me pretendimin se ishte sëmurë; druhej se i rrezikohej jeta nga gjermanët, të cilët e urrenin. Madje pretendoi se disa nga miqtë e Martinit ishin betuar ta vrisnin, sapo t’u jepej mundësia. Si burracak i vërtetë, e refuzoi ftesën e Milticit për paraqitje.

Kështu Miltici shkoi në Lajpcig, për ta përballur Tecelin me akuzat për shpërdorim fondesh. Me vete kishte dokumentet e bankës “Fugër”, të cilat tregonin se Teceli e kishte mbajtur për vete një pjesë të parave për shitjen e ndjesave, të paktën nga tetëdhjetë gulden për muaj. Përpos kësaj, një pjesë të parave të ndjesave e kishte përdorur për të mbuluar shpenzimet për tre shërbëtorët dhe tre kuajt e tij. Përveç kësaj, kishte pranuar strehim dhe ushqim falas kudo ku kishte udhëtuar; madje ekzistonte dyshimi se kishte futur edhe më tepër para se kaq në xhep.

Këtyre akuzave iu shtoheshin dhe zërat që po qarkullonin se Teceli ishte njeri i shthurur; në rininë e vet i kishte shpëtuar për fije dënimit me mbytje në lumë nga ana e gjykatësit. Madje kjo kishte ndodhur vetëm për shkak të ndërhyrjes së mëshirshme të Elektorit Frederik.

Tecelit të tmerruar i ra të fikët, kur e përballën me këto akuza dhe pastaj e dënuan me izolim në manastir. Miltici ia doli që gjithë përgjegjësinë për telashet e shkuara ta kalonte nga Martini te Teceli. Politika luajti sërish rolin

e vet në këto ngjarje, pasi Miltici besonte se, po ta shpëtonte Martinin, kjo do ta vendoste në pozita shumë miqësore me Elektorin Frederik. Ai kishte shpresë që të merrte shpërblime të mëdha, kur t'i dhuronte Frederikut “trëndaflin e artë” të papës.

Biseda e Milticit me Luterin

Pastaj, mes Martinit dhe Milticit u zhvilluan diskutime më 6 janar 1519, të cilat ishin shumë të sjellshme dhe miqësore. Pas njëfarë kohe u mor një vendim i pranueshëm, ku faji për të gjitha telashet iu vu plotësisht Tecelit.

Miltici përdori gjithë forcën bindëse të tij për të siguruar miratimin e Martinit për planin e tij për paqe. Në një darkë, ku ishin të pranishëm të dy, Miltici e mikloi Martinin me këto fjalë: “Prisja të ishe një teolog i moshuar dhe i thinjur që grindej me veten përbri vatrës. Tani po shoh se kam përpara një burrë në kulmin e rinisë. Nuk do të përpiqesha të të çoja në Romë, edhe sikur të kisha njëzet e pesë mijë ushtarë me vete!” Madje tha me shaka: “Për çdo njeri që mbështeste papën, kishte tre të tjerë që të mbronin ty dhe kundërshtonin papën.”

Kur këto përpjekje për t'i bërë qejfin Martinit dështuan, përmendi si rrezik shumë të vërtetë ndarjen e Kishës nëpër grupime, të cilat do të çonin në luftë dhe do të shkaktonin vdekje dhe mjerim. Kur tha se dhe Martini vetë do të ishte pjesërisht përgjegjës për këtë kasaphanë, Martini ra dakord për një marrëveshje.

Martini i shkroi Elektorit Frederik, duke i thënë:

“O princ i paqtë dhe zot i hirshëm; me përuljen më të madhe i njoftoj shkëlqësisë suaj si Elektor, se unë dhe Karli i Milticit kemi rënë më në fund në marrëveshje dhe i kemi dhënë fund kësaj çështjeje, duke vendosur për kushtet e mëposhtme:

1. Të dyja palëve u ndalohet të predikojnë, shkruajnë ose bëjnë diçka të mëtejshme për diskutimin e zhvilluar.

2. Miltici do ta vërë menjëherë në dijeni Atin e shenjtë për gjendjen e tanishme të diskutimeve. Shenjtëria e tij do të autorizojë një peshkop të përndritur, që ta shqyrtojë këtë çështje dhe të vërë në dukje shkrimet e rreme që duhet t'i tërheq. Nëse provojnë se jam në gabim, do t'i tërheq pa ngurrim dhe nuk do të bëj asgjë që fyen nderin ose autoritetin e Kishës së shenjtë të Romës.”

Ndërhyrja e Ekut

Pas pak, kjo paqe do të prishej nga Johan Eku, i cili ishte kancelari i Universitetit të Ingolshtadit. Ai ishte autor i Obeliskëve, ku përpiquej t'u përgjigjej disa prej argumentave të Martinit, të cilat ishin botuar nën titullin Asteriskët. Martini u shqetësua shumë nga fjalët e Ekut, sidomos për faktin se dikur kishin qenë miq të mirë. Një prej miqve të Martinit, Karlshtadi, e pati mbrojtur Martinin. Kjo i shkaktoi pakënaqësi të madhe Ekut, kështu që ky shkoi te duka Giorg, sponsori i Universitetit të Lajpcigut, dhe i kërkoi mbështetje për një debat mes tij dhe Karlshtadit. Duka Giorg ra dakord me kënaqësi që ky debat të zhvillohej në Lajpcig. E vërteta është se Eku donte të përballej me Martinin në debat të hapur, por e dinte që mënyra si të arrinte te Martini ishte nëpërmjet Karlshtadit.

Në këtë mënyrë, Roma theu armëpushimin e vendosur më herët, pasi Eku donte të debatonte për çështjen e autoritetit suprem të papës në çështjet shpirtërore dhe morale. Martini heshti për një kohë të gjatë, por më në fund, shkroi: “Perëndia e di se kisha vendosur prerazi të rrija në heshtje dhe se isha i gëzuar që kjo luftë kishte përfunduar më në fund.... Nuk i jam përgjigjur Silvestro Prieros.... Por tani doktor Eku po më sulmon, madje jo vetëm mua, por dhe Universitetin e Vitenbergut. Nuk mund të lejoj që e vërteta të nëpërkëmbet kaq turpshëm.”

Martini ishte i vendosur që të nisej për në Lajpcig dhe të merrte pjesë në debatet mes Ekut dhe Karlshtadit që ishin caktuar për në korrik 1519. Miqtë e tij, përfshi Elektorin Frederik dhe Spalatinin, druhashin se do t'i vihej jeta në rrezik, po të merrte atë udhëtim, kështu që ai i shkroi dukës Giorg, princit të zonës ku ndodhej Lajpcigu, dhe i kërkoi leje që të ishte i pranishëm dhe të merrte pjesë në diskutime. Mirëpo nuk mori asnjë përgjigje. Princi Giorg ishte mbështetës i vërtetë i Kishës së Romës, por nuk i kundërvihej hulumtimit të sinqertë të së vërtetës. Ai nuk u kundërvihej ideve të reja, thjesht sepse i kundërshtonte papa i Romës.

Diskutimi i Lajpcigut

Teologët e Lajpcigut shprehën shumë pakënaqësi për debatin e ardhshëm. Ata shqetësoheshin, sepse pozicioni i tyre teologjik varej nga aftësia intelektuale dhe debatuese e dr. Ekut. Kur dërguan përfaqësinë e tyre te duka Giorg, që të pengonte zhvillimin e këtyre debateve, ai u përgjigj: “Habitem që një peshkop paska kaq shumë tmerr nga zakoni i lashtë dhe i

lavdërueshëm i etërve tanë: hetimi i çështjeve të debatueshme në fushën e besimit. Nëse teologët tuaj nuk pranojnë të mbrojnë doktrinat e tyre, do të ishte më mirë që paratë që shpenzoj për ta t'i përdor për të ushqyer plakat dhe fëmijët e varfër, të cilët do të ishin të paktën në gjendje të thurnin lesh duke kënduar.”

Në qershor 1519, elektorët e perandorisë u mbledhën në Frankfurt⁸⁷ për të zgjedhur perandorin e ri. Kurora perandorake iu ofrua Elektorit Frederik, por ai e refuzoi; besonte se Gjermanisë i duhej një princ më i fortë, që t'i printe në ato kohë të vështira. Më në fund, delegati papnor tërhoqi kundërshtimin e vet ndaj zgjedhjes së Karlit; si rezultat, kurorën e mori nipi i Maksimilianit. Sidoqoftë, kjo nuk donte të thoshte se tani Frederiku do t'u nënshtrohej kërkesave të papatit. Më vonë, kur i kërkuan që t'ia dorëzonte Martinin Romës, u përgjigj se nuk e kishte mbrojtur Martinin; përkundrazi, Martini ishte mbrojtur gjithmonë vetë.

Madje Frederiku dha mendimin se kishte ardhur koha që Roma të dinte të vërtetën: “Tani Gjermania zotëron një numër të madh burrash të ditur, të mësuar më së miri në çdo gjuhë dhe shkencë; dhe vetë populli po fillon të kuptojë dhe të dojë Shkrimet e Shenjta. Prandaj, nëse refuzohen kushtet e arsyeshme të dr. Luterit, ekzistojnë arsye të forta që të druhemi se paqja nuk do të rivendoset më. Doktrina e Luterit është rrënjësuar thellë në shumë zemra. Nëse ju përpiqeni që ta shkatërroni me vetëtimat e autoritetit kishtar dhe jo me anë të dëshmisë së Biblës, do të dalin skandale të mëdha dhe do të ndodhin kryengritje të dëmshme dhe të tmerrshme.”

Shumë personalitete të Kishës nisën të mbërrinin në Lajpcig, për të dëgjuar debatin mes dy teologëve më të mëdhenj të kohës.

Më 21 qershor, dr. Eku hyri përmes portave të qytetit, i shoqëruar nga Poliandri, sekretari i tij, i cili kishte përgjegjësinë të mbante shënim gjithçka që do të thuhej. I veshur me rrobën që tregonte pozitën e tij të rëndësishme, ai kaloi si në paradë përpara popullit. Peter Moselani⁸⁸, profesor i greqishtes në Universitetin e Lajpcigut, i cili duhej të hapte ceremonitë, tha për dr. Ekun: “Eku është i gjatë dhe shpatullgjerë. Ka zë të fortë dhe vërtet gjerman, si dhe mushkëri kaq të forta, sa do të dëgjohej mirë në skenë, ose do të ishte tellall i shkëlqyer.... Goja, sytë dhe gjithë pamja e tij të japin më tepër idenë e një ushtari ose kasapi, sesa teologu. Kujtesën e ka të shkëlqyer dhe, sikur ta kishte dhe inteligjencën në të njëjtin nivel me kujtesën, do të ishte i përsosur.

Por i kap gjërat me vonesë dhe i mungon dallueshmëria, pa të cilën gjithë dhuntitë e tjera janë të pavlera.... Kur e sheh veten në vështirësi, del vërtik nga tema që po diskutohet dhe hidhet në një temë tjetër; madje nganjëherë huazon pikëpamjen e kundërshtarit, ia ndryshon formën e shprehjes dhe e sulmon me mjeshtëri të madhe me absurditetin e idesë që po mbronte ai vetë.”

Pastaj, më 24 qershor, mbërritën përfaqësuesit e Vitenbergut. Karlshtadi udhëtonte i vetëm në karrocën me kuaj dhe u printe udhën të tjerëve. Kur karroca e tij hyri e sigurt brenda portave të qytetit, ndodhi një aksident që shkaktoi njëfarë shqetësimi. Ndërsa kalonte përbri varrezës së Shën Palit, karrocës së tij i doli një rrotë dhe kryedhjaku përfundoi në baltë. Nuk pësoi lëndime, por iu dëmtua rëndë krenaria. Qytetarët e Lajpcigut e konsideruan këtë ngjarje si ogur të disfatës së tij në debatet që do të vijonin.

Për Karlshtadin, Peter Moselani shkroi: “Karlshtadi është më i vogël nga shtati; lëkurën e ka të errët dhe si të sëmurë, zërin e ka të shëmtuar, kujtesën e ka më të dobët dhe acarohet më lehtë sesa Luteri. Gjithsesi, ai zotëron (ndonëse në shkallë më të ulët) të njëjtat cilësi si miku i vet (Luteri).”

Ai ndiqej nga duka Barnim i Pomeranisë⁸⁹, i cili ishte student në Universitetin e Vitenbergut dhe Rektor Nderi i universitetit.

Pastaj vinte karroca e tretë, ku ishin ulur Martin Luteri dhe Filip Melanktoni. Dyqind studentë të armatosur me ushta dhe halberda⁹⁰ rrethonin profesorin e tyre të dashur, Martin Luterin. Ata kishin ardhur të mbështesnin Karlshtadin dhe të mbronin Martinin nga ndonjë dhunë e mundshme.

Për Martinin, Peter Moselani tha:

“Martin Luteri është shtatmesëm dhe kaq i rraskapitur nga studimi i mundimshëm, saqë pothuajse arrin t’ia numërosh kockat. Është në kulmin e jetës dhe zërin e ka të qartë dhe të thellë. Njohuria dhe dituria e tij për Shkrimet e Shenjta s’e kanë shokun; e zotëron shkëlqyer gjithë Fjalën e Perëndisë. Përveç kësaj, ka një thesar të tërë argumentesh dhe idesh.... Në bisedë është i çiltër dhe i sjellshëm.... Ka personalitet të këndshëm dhe të gjallëron me qëndrimin e tij pozitiv; shfaq qëndrueshmëri dhe kurrë nuk e humb mendjen nga frikësimet e kundërshtarëve, të çfarëdolloji qofshin. Njerëzit besojnë se Perëndia e ka ndihmuar në gjërat madhështore që ka

bërë. Mirëpo fajësohet se në përgjigjet e tij tregohet më ironik se ç'i ka hije një teologu, sidomos kur shpall ide të reja.”

Përpara fillimit të debatit u këndua mesha. Kjo meshë ishte një kompozim me dymbëdhjetë pjesë, krijuar posaçërisht për dukën Giorg, i cili donte që të bëhej gjithçka e mundshme për t'i rritur emrin Universitetit të Lajpcigut. Kortezhi i princave, kontëve, personaliteteve kishtare, zyrtarëve të qytetit dhe stafit të universitetit përshkoi më këmbë dhe me pompozitet rrugën deri te kisha. Kjo ecje shoqërohej me muzikë dhe me valëvitje flamujsh. Zyrtarët rretoheshin nga një trupojë prej njëqind qytetarësh të armatosur më së miri.

Pas shërbesës zyrtare, të gjithë u nisën për në kështjellën e Pleisenburgut⁹¹, ku ishte përgatitur një dhomë për debatet. Anëtarët e familjes mbretërore zunë vendet e tyre që ishin përgatitur posaçërisht për ta, ndërsa dëgjuesit e zakonshëm u ulën në stolat e vendosur në sallë. Në secilin cep të sallës ishin ngritur foltore. Në foltoren që do të zinte dr. Eku, ishte vendosur emblema e Shën Gjergjit që shkelte me këmbë dragoin. Ideja ishte që kjo të tregonte aftësinë më të lartë debatuese të dr. Ekut, në krahasim me Karlshtadin. Mbi foltoren që do të zinte më vonë Martini, ishte një pikturë e Shën Martin. Në qendër të sallës ishin vendosur tryeza për shtetasit e rëndësishëm, me qëllim që të mbanin shënim të gjitha diskutimet.

Pastaj foli kryesuesi i debatit, Peter Moselan, i cili i urdhëroi debatuesit të silleshin në mënyrë fisnike, duke u kujtuar të dy burrave që nuk ishin luftëtarë dueli, por teologë të mirënjohur. I nxiti të dy të mos harronin se fitimtare duhej të dilte e vërteta. Pastaj, nën tingujt e organos së madhe, turma e mbledhur u përgjunj dhe këndoi himnin madhështor “Veni, Sancte Spiritus”.⁹²

Debateti mes Karlshtadit dhe Ekut

Në debatet mes Karlshtadit dhe Ekut, pyetjet në diskutim kishin të bënin me lirinë e vullnetit njerëzor, përpara kthimit në besim. U debatua për efektet e mëkatit në zemrën njerëzore, si dhe tema e hirit të Perëndisë në shpëtim. Në fund, shumë qenë të mendimit se Eku, që kishte aftësi më të mira debatuese, fitoi. Gjatë debateve u diskutua dhe ideja e përdorimit të librave për të rifreskuar kujtesën. Eku deklaroi me ironi therëse për Karlshtadin: “Kujtesa e tij sështë aq e fortë sa imja!”

Gjithsesi, librat u lejuan. Karlshtadi arriti të fliste me Martinin dhe Melanktonin dhe mori prej tyre shumë këshilla të vlefshme. Eku ishte i vetëdijshëm për ndihmesën që po merrte Karlshtadi nga Filipi, pasi kishte parë që i jepte copa letre kundërshtarit të tij. Kur Filipi foli me Karlshtadin gjatë një debati, dr. Eku e vështroi i zemëruar dhe bërtiti: “Mbaj gjuhën, Filip; shih studimet e tua, mos më bjer në qafë.”

Eku fton Luterin në debat

Eku ndihej shumë i sigurt në debatin me Karlshtadin, por ajo që donte vërtet ishte të përballej drejt për drejt dhe publikisht me Martinin. Kur të dy burrat arritën në Lajpcig, dr. Eku i shkoi për vizitë Martinit dhe e hapi diskutimin me këtë pretendim: “Çështë kjo? Po më thonë se ti s’pranon të debatosh me mua!”

Përgjigjja e Martinit ishte e drejtë: “Si mund ta bëja këtë gjë, kur duka ma ka ndaluar?”

Pastaj Eku i bëri pyetjen për të cilën donte vërtet përgjigje: “Nëse s’debatoj dot me ty, s’dua t’ia di për përballjen me Karlshtadin. Unë këtu erdha për hirin tënd.... Nëse i marr leje dukës, je gati të hysh në fushën e betejës me mua?”

Martini u entuziazhua nga ajo që dëgjoji: “Po ma sigurove lejen, më ke gati për përleshje!”

Pastaj u përgatit skena për debatet. Sekretarët u urdhëruan të mbanin shënim gjithçka që do të thuhej dhe më vonë këto do të botoheshin që t’i lexonin të gjithë. Pastaj u trajtua problemi se cili do të gjykonte debatet për të përcaktuar fituesin. Miqtë e Martinit druheshin se çdo gjykatës që do të caktohej, do të favorizonte dr. Ekun. Pastaj u hodh propozimi që gjykatës të ishte vetë papa. Përgjigjja e Martinit ishte e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë: “Papa! E si mund ta pranoj dot këtë?”

Dr. Eku dhe këshilltarët e tij u propozuan disa profesorëve të universitetit që të gjykonin debatet, por sërish Martini refuzoi, duke deklaruar: “Mirë, atëherë, unë s’kam për të marrë pjesë në diskutim.”

Shumë shpejt njerëzit në mbarë Lapjcgun po thoshin: “Luteri s’pranon të debatojë!... Nuk pranon asnjë gjykatës!”

Edhe miqtë e Martinit u nxehën nga ngjarjet e asaj dite. E morën mënjane Martinin dhe i thanë: “Refuzimi yt për të pranuar gjykatësit do ta turpërojë përgjithmonë universitetin dhe kauzën tënde.”

Këtë Martini s'e pranonte dot dhe, i ngacmuar nga ky mendim, tha: "I pranoj kushtet që më janë vendosur; por rezervoj të drejtën e apelit...."

Qytetarët dhe vizitorët e Lajpcigut ishin të përçarë për mbështetjen e dy debatuesve dhe, në një sërë rastesh, mbështetësit u përleshën fizikisht. Në një hotel u pa e nevojshme që, gjatë ngrënies së vakteve, të ishte i pranishëm një oficer policie i pajisur me armë, për të mos lejuar klientët që të rriheshin me njëri-tjetrin. Për dy debatuesit u përhapën fjalë të ndryshme dhe, nëpër tavernat ku takoheshin studentët, shpërthyen shumë debate dhe përleshje. Siç ishte zakoni i kohës, studentët e të dy universiteteve mbanin me vetë shpata dhe kama që i përdornin kur vinte rasti.

As kleri s'ishte më mirë. Disa nga kundërshtarët e tij që i përkisnin klerit, thanë hapur se Martini mbartte djallin me vete, të mbyllur në një kuti të vogël. Dr. Eku e shtoi më shumë këtë thashethem, kur tha: "Nuk e di nëse djalli është në kuti apo thjesht nën mantelin e tij, por pa dyshim që është njëra nga të dyja."

Dikush vuri re se Martini mbante mbi tryezë një tufë të vogël lulesh, kryesisht karafila, të cilëve u merrte erë herë pas here. Menjëherë u përhapën thashetheme sikur gjoja Martini ecte rrugëve të Lapjcgut me një kurorë lulesh në kokë.

Debati mes Luterit dhe Eku

Kështu, më 4 korrik, në atë atmosferë të ndezur, Martini u përball me dr. Ekun. Ishte 7 e darkës, kur Martini u ngrit dhe foli para të gjithëve: "Në emër të Zotit, Amen! Unë deklaroj se respekti që kam për papën sovran do të ma kishte ndaluar të merrja pjesë në këtë diskutim, nëse nuk do të më kishte tërhequr me zor dr. Eku."

Pas kësaj deklarate fillestare, dr. Eku u hodh drejt e në thelbin e çështjes: autoriteti i epërm i papës së Romës dhe njohja e Leonit si kreu i Kishës. Martini ra dakord me dr. Ekun, kur iu përgjigj: "Kur dr. Eku deklaroi se Kisha mbarëbotërore duhet të ketë një drejtues, thotë të vërtetën. Nëse ka ndonjë prej nesh që s'bie dakord me këtë mendim, le të çohet në këmbë! Por kjo s'ka të bëjë fare me mua."

Dr. Eku e dinte se ku e kishte fjalën Martini, por i hapi rrugën sërish përmendjes së çështjes bazë. Ai tha: "Nëse militanti i Kishës nuk ka qenë kurrë pa kokë, do të doja të dija se cila mund të jetë ajo kokë, përveçse papës së Romës?"

Përgjigjja e Martinit shkaktoi trazirë në sallë, kur tha: “Kreu i Kishës në tokë është Krishti vetë, jo njeriu. Këtë e besoj nga dëshmia e Fjalës së Perëndisë. Ai duhet të mbretërojë, - thotë Shkrimi, - derisa t’i vendosë gjithë armiqtë nën këmbët e veta. Le të mos ua vëmë veshin atyre që e syrgjynosin Krishtin të Kisha triumfuese në qiell. Mbretëria e tij është mbretëri besimi. Vërtet s’e shohim dot Kreun tonë, por e kemi.”

Në atë kohë Martini ishte në atë fazë të shtegtimin shpirtëror, kur ishte i gatshëm të pranonte se papa i Romës ishte “kryegjykatësi” i Kishës në tokë, një pozicion që e mbante për shkak të zgjedhjes nga kolegji i kardinalëve. Mirëpo Martini nuk pranonte se papa i Romës ishte kreu i Kishës, për shkak të së drejtës hyjnore.

Dr. Eku citoi një sërë Etërish të Kishës që përdornin fjalët që Krishti i tha Pjetrit, për të mbështetur mendimin e vet: “Ti je Pjetri dhe mbi këtë shkëmb do ta ndërtoj kishën time.” (Mateu 16:18). Mirëpo Martini ishte shumë i ditur dhe që në gjendje të citonte shumë Etër të Kishës, të cilët kishin thënë qartazi se shprehja që Krishti i tha Pjetrit bënte fjalë për vetë Krishtin dhe për rrëfimin e besimit që Pjetri bëri për Krishtin.

Dr. Eku e dinte se s’e përballonte dot Martin Luterin. U lëshuan akuza dhe kundërakuza. Pastaj dr. Eku vendosi ta turpëronte Martinin përpara spektatorëve dhe botës katolike, duke e lidhur me bohemianin Jan Hus, një njeri që në Gjermani përçmohej prej shumë vetëve. Husi ishte djegur në turrën e druve, për interpretimin që i bënte Shkrimit.

Kështu, dr. Eku shpalli: “Që nga kohët e para, të gjithë të krishterët e mirë e kanë pranuar se Kisha e Romës e merr parësinë e vet drejtpërdrejt nga vetë Krishti dhe jo nga e drejta njerëzore. Mirëpo, më duhet të rrëfej se bohemianët, të cilët mbronin me kokëfortësi gabimet e tyre, e sulmonin këtë doktrinë. I kërkoj ndjesë atit tim të nderuar që jam armik i bohemianëve, sepse ata janë armiq të Kishës, dhe që ky diskutim më solli ndërmend këta heretikë; sepse, për mendimin tim të përlulur, përfundimet e doktorit i favorizojnë plotësisht këto gabime. Madje thuhet se husitët po mburren me të madh me këtë mendim.”

Spektatorët mbajtën frymën, duke pritur përgjigjen e Martinit: “Unë nuk jam dakord dhe kurrë s’do të jem dakord me përçarjen e Kishës. Meqë, me autoritetin e tyre, bohemianët janë ndarë nga uniteti ynë, kanë bërë gabim, edhe sikur e drejta hyjnore ta kishte shpallur të drejtë doktrinën e tyre; sepse

e drejta më e lartë hyjnore është dashuria e krishterë dhe uniteti në mendim.”

Takimi përfundoi, meqë ishte koha për darkën, dhe gjatë saj Martini u ndie i shqetësuar për drejtimin që po merrte diskutimi. Mendoi për njëfarë kohe se mos e kishte tepruar, duke dënuar ndjekësit e Jan Husit. Po kështu, e dinte se husitët përkrahnin shumë doktrina që ai mendonte se bazoheshin plotësisht në Shkrimet. Por mbështetja e mësimet të Husit do të thoshte të dënonte vendimin e Këshillit të Konstancës, që e pati dënuar Husin dhe mësimet e tij. Martini e dinte shumë mirë se Universiteti i Lajpcigut ishte themeluar prej atyre që patën kundërshtuar pikëpamjet e Jan Husit. Por e dinte se ç'duhej të bënte: duhej të thoshte të vërtetën, pavarësisht pasojave mbi veten e tij dhe mbi ndjekësit.

Kur spektatorët zunë sërish vendet e tyre në sallë, Martini u ngrit dhe shpalli pozicionin e vet, në lidhje me akuzën se përkrahte mësimet e Jan Husit. Ajo që do të thoshte pas pak, do të shkaktonte shqetësim dhe kundërshtim të madh në zemrat e shumë prej dëgjuesve: “Ndër pikat e besimit që shpallnin Jan Husi dhe bohemianët”, - tha ai, - “ka disa që janë shumë të krishtera. Kjo është qartazi e vërtetë. Për shembull, ja njëra: ‘Ka vetëm një Kishë mbarëbotërore’; ose një tjetër: ‘Nuk është e nevojshme për shpëtim, që të besojmë se Kisha e Romës është më e lartë se gjithë të tjerat’. S’ka fare rëndësi për mua, nëse këto i ka thënë Uiklifi apo Husi..., ato janë të vërteta.”

Aty për aty, salla e mbushur plot shpërtheu në diskutime. Edhe dëgjuesit e fjetur u zgjuan plotësisht. Duka Giorg, me duart në ijë, u ngrit dhe tundi kokën i neveritur. “Ai është pushtuar nga tërbimi! Ky njeri është i marrë!” - bërtiti ai.

Mendjen ia përshkuan mendimet e trazirave të mundshme civile mes shteteve gjermane, madje dhe lufta e mundshme mes kombeve. Nga ai çast, duka Giorg u bë armiku i Martin Luterit dhe mësimeve të tij.

Martini vijoi argumentin, duke shpallur se Kisha Ortodokse nuk e kishte pranuar kurrë papën e Romës si kreun e Kishës. Pastaj tha se krerët e Kishës Ortodokse s’ishin akuzuar kurrë për herezi për këtë gjë. Më tej, vijoi: “Papët e Romës nuk kanë pushtetin që të shpallin pika të reja besimi. Besimtari i krishterë nuk pranon asnjë autoritet tjetër, përveç Shkrimeve të Shenjta. Vetëm Bibla përbën të drejtën hyjnore. I përgjyerohem doktorit të nderuar që të pranojë se papët e Romës janë njerëz dhe të mos i bëjë perëndi.”

Por dr. Eku deklaroi me ironi: “Ati i nderuar është kuzhinier shumë i dobët; ka bërë një çorbë të tmerrshme me shenjtore grekë dhe me heretikë; në këtë mënyrë, era e shenjtërisë së të parëve nuk na lë të ndiejmë erën e helmatisur të të dytëve.” Martini u ngrit dhe e ndërpreu dr. Ekun, me këto fjalë: “Doktori i nderuar po fyen. Për mendimin tim, Krishti nuk ka bashkësi me Belialin⁹³.”

Pas debatit

Diskutimi zgjati pothuaj tre javë. Kur përfundoi, Martini me Karlshtadin lanë Lajpcigun, kurse dr. Eku qëndroi aty dhe për disa ditë.

Debati i Lajpcigut dha fryt. Tani u kristalizua doktrina e Martinit për autoritetin absolut të papës. Ai nuk pranoi të hiqte dorë nga Shkrimet e Shenjta, si autoriteti i vetëm shpirtëror. Tashmë shumë njerëz u bënë ndjekës të Martinit dhe të mësimit të tij në shkollën e Vitenbergut. Madje, miku dhe dishepulli i dr. Ekut, Poliandri, tani u bë mbështetës i Martinit. Më 1522-shin, ai predikoi publikisht ungjillin në Lajpcig. Edhe Giorgu i Anhaltit⁹⁴, një princ i ri i oborrit të dukës Giorg, u bind nga mësimet e Reformacionit. Shumë nga studentët e Universitetit të Lajpcigut u gëzuan nga ajo që dëgjuan nga goja e Martinit dhe u transferuan në Universitetin e Vitenbergut.

Sigurisht, kjo e gëzoi së tepërmi Frederikun, i cili pa se popullariteti i universitetit të vet po rritej dita-ditës. Në Vitenberg, Filip Melanktoni iu përkushtua studimit të hollësishëm të Shkrimeve, i bindur me gjithë zemër për të vërtetat ungjillore që mësonte Martini. Ndarja e plotë e Martinit me Romën po afrohej me shpejtësi. Ai e dinte se ishte i lirë nga zgjedha shtypëse e Romës, por kuptonte gjithashtu vështirësitë me të cilat do të përballeshin këtej e tutje ata që do të fillonin të ecnin në udhën e shtegtarit, të cilën e kishte përshtuar dhe ai vetë për shumë vite.

“Mësoni prej meje se sa gjë e vështirë është të flakësh tej gabimet që na janë rrënjësuar nga shembulli i botës dhe që, nga forca e gjatë e zakonit, na janë bërë natyrë e dytë,” - tha ai. “Unë kisha shtatë vjet që lexoja dhe shpjegoja publikisht me zjarr të madh Shkrimet e Shenjta, aq sa i kisha mësuar pothuajse përmendësh. Madje kisha dhe gjithë frytet e para të njohurisë dhe besimit në Zotin tonë Jezu Krisht. E dija që njeriu shfajësohet dhe shpëtohet jo me anë të veprave, por me anë të besimit në Krishtin; madje thosha haptazi se papa nuk është kreu i Kishës së krishterë, për shkak

të së drejtës hyjnore. Por prapëseprapë nuk arrija të shihja pasojat që rridhnin nga kjo bindje. Ajo që s'është nga Perëndia vjen patjetër nga djalli.... Nuk ia lejoj më vetes që të indinjohem me ata që ende i bashkëngjiten papës, pasi edhe unë, që për kaq shumë vjet studioja me kaq kujdes Shkrimet e Shenjta, ende mbahesha me kokëfortësi pas papatit.”

Të vërtetat e Reformacionit tani po përhapeshin gjerësisht. Reformacioni i Kishës ishte te pragu.

13. Ngjarjet që çuan në

Vorms⁹⁵

Bota po ndryshonte. Në vitin 1492 Kolombi pati lundruar nëpër Atlantik; një botë e re, si dhe gjithë pasuritë e saj, ishin gati për eksplorim dhe shfrytëzim. Perandoria pësoi vdekjen e perandorit Maksimilian⁹⁶ në janar të 1519 dhe kishte nisur kërkimi për një perandor të ri. Intrigat dhe mitëmarrjet luanin gjithmonë rol të rëndësishëm në arritjen e vendimeve dhe elektorëve gjermanë iu dukej me vend që në këtë post të rëndësishëm të zgjidhnin një njeri të tyre. Kështu, kurora iu ofrua Frederikut të Saksonisë⁹⁷. Mirëpo ai s'ishte njeri ambicioz; përkundrazi, prirej të ishte disi i ndrojtur në sjellje. Delegati papnor e mbështeti kandidimin e tij, por Frederiku e refuzoi këtë nder.

Si rrjedhojë, më 28 qershor 1519, në këtë post u zgjodh nipi i Maksimilianit. Karli i Spanjës do të kurorëzohej më vonë dhe kjo ndodhi vetëm në tetor të vitit 1520 në Eks-la-Shapel.⁹⁸ Sundimi i Frederikut gjatë periudhës së ndërmjetme bëri që puna e Reformacionit që vinte nga Universiteti i Vitenbergut, të vazhdonte e sigurt dhe me ritëm të plotë.

Zbulimi i Luterit

Martini dhe të tjerët nisën studimin e detajuar të shkrimeve të Etërve të Kishës dhe të reformatorëve përpara tyre; por, më tepër se kaq, ata i hynë një studimi të hollësishëm të Fjalës së Perëndisë në gjuhët origjinale, sepse kjo sipas tyre ishte autoriteti i vetëm në çështjet shpirtërore. Martini iu kthye shkrimeve të Jan Husit, të cilat mendonte se ishin në përputhje të plotë me mësimet e apostullit Pal. “Ato shkrime, - thoshte Martini, - shpjegojnë doktrinën madhështore të shfajësimit vetëm me anë të besimit.”

Martini deklaroi i mahnitur: “Të gjithë ne, Pali, Augustini dhe unë, kemi qenë husitë, pa e ditur!.... Perëndia do ta ndëshkojë patjetër botën, pasi e vërteta iu shpall para një shekulli, por ata e dogjën!”

Sulmet nga Roma forcojnë mbështetjen e Luterit

Në Romë, Eku dhe të tjerët po nxisnin urrejtje kundër Martinit dhe dishepujve të tij në mbarë Evropën. Serra Longa i shkroi Elektorit Frederik,

duke i thënë: “Mos e lejoni Luterin që të gjejë strehim në territoret tuaja, shkëlqesia juaj; le të hidhet poshtë nga të gjithë dhe të vritet me gurë në sytë e Qiellit!”

Por këto lloj shpërthimesh fyese vetëm sa e përforcuan mbështetjen gjermane për Martinin, pasi ai fliste me kurajë kundër tiranisë së Romës. Shumë princa gjermanë ishin gati të nxirrnin shpatat dhe të mblidhnin ushtritë për ta mbrojtur Martinin nga papa italian. Martini mbështetej nga njerëz të fuqishëm. Një kalorës i shquar, Silvestri i Shaumburgut⁹⁹, i dërgoi Martinit në Vitenberg një letër, me anë të të birit, ku i thoshte: “Nëse elektorët, princat dhe gjykatësit të lënë në baltë, eja tek unë. Me hirin e Perëndisë, do të grumbulloj aty për aty njëqind fisnikë dhe, me ndihmën e tyre, do të jem në gjendje të të mbroj nga çdo rrezik.”

Një tjetër kalorës i spikatur, Franci i Zikingenit¹⁰⁰, deklaroi: “Gjithë shërbimet, pasuritë dhe trupi im, gjithçka që kam në zotërim, i ke në dispozicion.” Ulrihu i Hutënit, i njohur më shumë për poezitë e tij, sesa si luftëtar trim, filloi të shkruante në mbrojtje të Luterit dhe të Reformacionit. Në poezinë e tij të mirënjohur, Për Trininë e Romës, Hutëni sulmoi ashpër dhe drejtpërdrejt Romën. Fjalët e tij ishin shumë therëse:

Tri gjëra e mbajnë Romën në pushtet: autoriteti i papës, kockat e shenjtorëve dhe shitblerja e ndjesave.

Tri gjëra janë të panumërta në Romë: prostitutat, priftërinjtë dhe sekretarët.

Tri gjëra tregtojnë romanët: Krishtin, fitimet që blejnë ofiqet kishtare dhe femrat.

Tri gjëra dëshiron çdokush në Romë: meshat e shkurtra, floririn e pastër dhe jetën luksoze.

Tri gjëra përçmohen në Romë: këshilli i përgjithshëm, reformimi i klerit dhe fakti se gjermanët po fillojnë të hapin sytë.

Tri gjëra vlerësohen më tepër se gjithçka tjetër në Romë: ndërgjegjja e ndotur, stomaku i sëmurë dhe kuleta bosh.

Tri gjëra e tmerrojnë më së tepërmi Romën: bashkimi i princave, hapja e syve të popullit dhe zbulimi i mashtrimeve të Romës.

Ai tha se Roma i konsideronte gjermanët si leshko që duhej ta mbështesnin papatin gjithë jetën me paratë e fituara me mund. Për të Roma ishte një hambar i stërmadh, ku mblidheshin të korrat e gjithë kombeve.

Një herë deklaroi: “Dhe në mes të saj rri ulur miza grabitqare e grurit (papa) që përlan thasët e stërmëdhenj të drithit, i rrethuar nga një mizëri bashkëpunëtorësh të tjerë, po aq grabitqarë. Ata na kanë pirë gjakun dhe na kanë gërryer mishin, derisa na kanë arritur deri në palcë; kanë për të na thyer kockat dhe do të na e copëtojnë gjithë trupin.”

Më tej ngriti çështjen e mënyrës se si përdoreshin paratë që u zhvateshin kombeve: “Ata blejnë mushka për vete, mbajnë femra dhe djem për t’u zbavitur, ndërtojnë pallate mermeri dhe, nëse njerëzit s’u bëjnë lajka dhe s’i admirojnë, i kërcënojnë me dhunë dhe tmerr.”

Pastaj vijoi duke i bërë thirrje popullit gjerman të merrte armët dhe të luftonte kundër Romës: “Vetëm me shpata dhe shigjeta, me shtiza dhe bomba mund ta shtypim tërbimin e djallit!”

Mirëpo Martini s’e pranonte kurrësi përdorimin e forcës për përhapjen e ungjillit. “Kisha u themelua vetëm me anë të Fjalës,” - shpalli ai, - “dhe vetëm me anë të Fjalës do të rithemelohej.”

Dhe vetë Erazmi i madh e mbështeti hapur Martinin. Në një letër drejtuar Albertit¹⁰¹, primatit të Gjermanisë, ai renditi shprishjet e Kishës së Romës: “Pikërisht kjo e ndezi Luterin dhe e bëri t’i kundërvihet vrazhdësisë së padurueshme të disa doktorëve. Sepse ç’motiv tjetër mund t’i veshim një njeriu që nuk kërkon nderime dhe nuk do t’ia dijë për paratë? Luteri pati guxuar të vinte në dyshim vlerën e ndjesave; por të tjerë përpara tij e patën mbështetur këtë mësim, pa u skuqur nga turpi. Ai s’pati frikë që të fliste hapur, ndonëse në mënyrë disi të tepruar, kundër pushtetit të papës së Romës; por të tjerë përpara tij e kishin lartësuar këtë pushtet pa rezerva. Ai pati guxuar t’i trajtonte me përçmim shpalljet e Shën Tomës¹⁰², por domenikanët e patën vendosur veten mbi ungjillin. Ai guxoi të fliste për dyshimet e tij për rrëfimin, por murgjit e kanë përdorur vazhdimisht këtë sakrament, si rrjetë ku të kapin dhe skllavërojnë ndërgjegjen e njerëzve. Disa njerëz të përshpirtshëm shqetësoheshin kur dëgjonin se në universitete përmendej fare pak doktrina biblike; se në asamblatë e të krishterëve dëgjohej shumë pak për Krishtin; se asgjë tjetër nuk përmendej përveç pushtetit të papës dhe mendimeve të doktorëve të Romës; gjithë predikimi

ishite thjesht çështje parash, lajkash, ambiciesh dhe mashtrimesh. Pikërisht në këtë gjendje duhet kërkuar shkaku për gjuhën e ashpër të Luterit.”

Megjithatë, ndoshta inkurajimin më të madh Luteri e mori nga letrat e disa prej miqve të tij bohemianë: “Ashtu siç ishte Husi në Bohemi në atë kohë, je ti tani në Saksoni, i dashur Martin; për këtë arsye, lutu dhe ji i fortë në Zotin!”

Disa prej mbështetësve të Martinit u shqetësuan për mënyrën se si po shkonin gjërat; madje dhe Shtaupici filloi t’i sillej ftohtë. Kjo e lëndoi Martinin dhe në një letër i tha Shtaupicit: “Ti po më braktis. Gjithë ditën kam qenë shumë i brengosur, për shkakun tënd, si fëmija i zvjerdhur që qan për të ëmën. Të pashë në ëndërr mbrëmë; po largoheshe prej meje, ndërsa unë rënkoja dhe derdhja lot të hidhur. Por ti zgjate dorën, më the të qetësohesha dhe premtove se do të ktheheshe sërish tek unë.”

Papati besonte se mund ta frikësonte Elektorin Frederik dhe ta detyronte që t’ia dorëzonte Martinin gjykatës së Kishës. Mirëpo përfaqësuesit e Frederikut i thanë shumë qartazi papës se kjo gjë s’kishte për të ndodhur.

Shkrimet e Luterit në këtë periudhë

Gjatë kësaj periudhe, Martini shkroi shumë artikuj. Atë që iu duk si më i miri, ia dedikoi dukës Johan, vëllait të Elektorit Frederik. Ky shkrim titullohej *Veprat e mira*; ishte mësim i qartë i doktrinës madhështore të shfajësimit vetëm me anë të besimit. Po kështu, provonte se veprat e drejtësisë janë fryt i veprës rilindëse të Perëndisë në zemrën e besimtarit.

Mirëpo, më vonë, do të nxirrte një shkrim me ndikim edhe më të madh. Më 23 qershor 1520, botoi të famshmen *Thirrje për madhërinë perandorake dhe për fisnikërinë e krishterë të kombit gjerman për reformacionin e krishterimit*, që ishte thirrje mobilizuese për popullin gjerman, i cili protestonte kundër ndërhyrjes së Romës në punët e tyre. “Koha për të heshtur ka përfunduar!” - deklaroi ai. - “Ka ardhur koha për të folur! Më në fund, duhet të zbulojmë misteret e Antikrishtit.”

Martini deklaroi se Roma kishte ndërtuar tri mure rreth vetes dhe përgjegjësia e tij ishte që t’i rrëzonte ato mure. Roma kishte triumfuar mbi çdo njeri dhe klasë shoqërore, kishte skllavëruar mbretërit, kishte nëpërkëmbur përgjegjësitë e këshillave të Kishës dhe kishte skllavëruar njerëzit.

Ai shkroi: “Romakët kanë ndërtuar rreth vetes tri mure për t’u mbrojtur nga çdo lloj reformacioni. A janë sulmuar nga pushteti i përkohshëm? A kanë pohuar se s’ka autoritet mbi ta dhe se pushteti shpirtëror është më i lartë se ai tokësor? A janë qortuar nga Shkrimet e Shenjta? – Ata janë përgjigjur se askush s’është në gjendje ta interpretojë Biblën, përveç papës. A janë kërcënuar me ndonjë këshill kishtar? Askush përpos papës sovran s’ka autoritet për të thirrur këshilla kishtarë.”

Si i drejtoi lexuesit te Romakëve 13:1: “Çdo njeri (dhe kjo përfshinte dhe papën) t’u nënshtrohet autoriteteve më të larta, sepse ata nuk e mbajnë shpatën më kot”, Martini argumentoi se përpara ligjit të gjithë janë të barabartë. Ky ishte një sulm kundër Romës, e cila autoritetin shpirtëror e vendoste mbi autoritetin tokësor. Në këtë mënyrë, ajo pretendonte autoritetin për të nisur luftëra, për të vrarë qytetarët e zakonshëm dhe për të sunduar mbi botën, ndërkohë që deklaronte se priftërinjtë e vet ishin mbi ligjin e vendit.

Pastaj Martini sulmoi ligjin se peshkopi i Romës ishte peshkopi kryesor dhe kreu mbi gjithë peshkopët e tjerë. Ai argumentonte se papa nuk ka mbështetje biblike për një autoritet të tillë. Vuri në dukje gabimet e hapura të dogmave papnore, si dhe shthurjen dhe ligësinë e shumë papëve.

Pastaj Martini sulmoi vetë themelin e autoritetit papnor. Meqë papa i Romës pretendonte se kishte të drejtën e vetme për interpretimin e Shkrimit, i kishte kthyer popujt e gjithë kombeve në skllevër shpirtërorë të tij. Martini e pasqyroi Romën papnore sikur ua kishte vënë këmbën në zverk mbretërve, peshkopëve dhe gjithë njerëzve.

Fjalët e Martinut u bënë jehonë shpresave kombëtariste të gjermanëve dhe të popujve të tjerë. “Si? A do të durojmë ne, gjermanët, këto lloj plaçkitjesh dhe zhvatjesh që na bënë papa?... Ah! Mirë do të ishte po të na rrëmbenin vetëm pasuritë! Por ata na shkatërrojnë kishat, rrjepin delet e Krishtit, anulojnë adhurimin fetar dhe asgjësojnë Fjalën e Perëndisë.... Nëse vjedhësit i varim dhe plaçkitësve të rrugës ua presim kokat, le të mos e lejojmë lakminë e Romës që t’ia hedhë lehtë; ajo është më e madhja e gjithë vjedhësve dhe plaçkitësve, dhe e keqja është se këtë e bënë në emër të Shën Pjetrit dhe të Jezu Krishtit! Kush mund ta durojë këtë? Kush mund të rrijë pa folur? Gjithçka që zotëron papa, a nuk e ka fituar me anë të vjedhjes? Sepse ai, as e ka blerë, as e ka trashëguar nga Shën Pjetri, as e ka fituar me detersën e ballit! Po atëherë, ku e ka gjetur gjithë këtë pasuri?”

Pastaj e ktheu vëmendjen te pretendimet papnore për Mbretërinë e Napolit dhe Siçilisë, por, së pari, sulmoi pushtetin shpirtëror papnor në Gjermani. Deklaroi: “Pikësëpari duhet të dëbojmë nga çdo shtet gjerman përfaqësuesit papnorë, bashkë me ‘përfitimet’ e dyshimta që na i shesin me flori dhe që janë kryekëput mashtrime. Ata na marrin paratë, dhe për çfarë? Për të ligjëruar përfitimet e tyre të padrejta, për ta çliruar njeriun nga çdo zotim, për të na mësuar që të mos jemi besnikë ndaj besimit, për të na udhëzuar si të mëkatojmë dhe për të na çuar drejt e në ferr.”

Pastaj Martini iu sul martesës së klerit, të cilën e shihte si mjet për mposhtjen e shthurjes tejet të përhapur që gjendej në radhët e priftërinjve dhe anëtarëve të urdhrave të tjerë klerikalë. Ai deklaroi se çdo prift duhej të kishte grua dhe citoi fjalët e Palit drejtuar Timoteut për ta mbështetur këtë argument: “Peshkopi duhet të jetë bashkëshort i një gruaje të vetme” (1 Tim. 3:2). Martini donte ta shihte Kishën të reformuar, ndaj foli hapur kundër abuzimeve të saj: “Le të anulohen të gjitha festat dhe të kremtohet vetëm e diela; ose, nëse njerëzit duan t’i kremtojnë festat e rëndësishme të krishtera, le t’i kremtojnë vetëm në mëngjes, ndërsa pjesa tjetër e ditës të jetë si çdo ditë pune e zakonshme. Sepse, meqë në ato ditë njerëzit s’bëjnë gjë tjetër veçse dehen, luajnë kumar, zhgërryhen në çdo lloj mëkati, ose bëhen përtacë, Perëndinë e fyejnë më shumë në ditët e festave se në çdo kohë tjetër.”

Në përmbyllje të artikullit të vet, Martini shkroi: “Papa, i paaftë që të manipulonte sipas dëshirës sunduesit e lashtë të Perandorisë Romake, shpiku një plan si t’ua rrëmbente titullin dhe perandorinë dhe të na e jepte neve, gjermanëve. Në këtë mënyrë, ne u bëmë skllevër të papës, i cili vuri nën zotërim Romën dhe e detyroi perandorin, me anë të një betimi, që të mos jetonte kurrë aty; për këtë arsye, perandori është edhe perandor i Romës, por pa Romën. Ne zotërojmë vetëm emrin: papa ka vendin dhe qytetet. Ne kemi titullin dhe simbolet e perandorisë, papa ka thesaret, pushtetin, privilegjet dhe liritë e saj. Papa ha frytin, ne luajmë me lëkurën. Krenaria dhe tirania e romakëve ka abuzuar gjithmonë me naivitetin tonë.”

Puthja e këmbëve të papës i ngjallte neveri Martinit, ndaj, për këtë ritual, shkroi: “Është shembull jo i krishterë, madje anti i krishterë, që një mëkatar i gjorë të lejojë që t’ia puthë këmbët dikush që është njëqind herë më i mirë se ai vetë.... Krahasojini së bashku: Krishtin dhe papën. Krishti u lau dhe thau këmbët dishepujve, por dishepujt s’ia lanë kurrë këmbët atij. Papa, që

pretendon se është më i lartë se Krishti, e ktheu përmbys këtë rregull dhe e konsideron nder të madh, kur na lejon t'i puthim këmbët....”

Pastaj vijoi: “Pikërisht për shkak të kësaj krenarie të neveritshme, papa nuk kënaqet që të udhëtojë mbi kalë apo në karrocë, por edhe kur është i shëndetshëm dhe i fortë, do që ta mbartin njerëzit si idhull, me një pompozitet të padëgjuar më parë. Miku im, a përputhet kjo krenari luçiferiane me shembullin e Krishtit që eci më këmbë, si dhe apostujt e vet?”

Fjalët e Martinit e bashkuan popullin gjerman që të qëndronte i palëkundur ndaj pushtetit dhe pretendimeve të papatit. Sa u gëzua populli, kur lexoi fjalët me të cilat ishin dakord: “A dëgjon, o papë, jo i shenjtë, por mëkatar? Kush ta dha pushtetin të ngrihesh mbi Perëndinë dhe t’ia shkelësh ligjet? Satani i lig mashtron përmes gurmazit tënd - o Zoti im Krisht, përshpejtoje ditën tënde të fundit dhe shkatërroje folenë e djallit në Romë. Aty rri ulur ‘njeriu i mëkatit’ që Pali e quan ‘biri i humbjes’”

Zhvillimi teologjik i Martinit kishte arritur në pikën ku ai nuk ngurronte ta quante Antikrisht papën e Romës. Në *Letrën drejtuar fisnikërisë së krishterë të popullit gjerman*, shkroi: “Tani që e thanë Italinë, vijnë në Gjermani dhe ia fillojnë me urtësi dhe butësi. Por kini kujdes, përndryshe së shpejti Gjermania do të bëhet si Italia.... Antikrishti duhet të marrë thesaret e tokës, siç është profetizuar.”

Kjo vepër u botua në qershor të vitit 1520 dhe brenda një kohe të shkurtër u shitën 4 000 kopje. Populli gjerman u entuziazmua që tani kishin një mbrojtës, i cili ishte i gatshëm të demaskonte abuzimet e Romës. Flakët e Reformacionit pushtuan gjithë Gjermaninë. Martini ia dërgoi një kopje të këtij fjalimi Karlit, por perandori nuk begenisi t’i kthente përgjigje murgut nga Vitenbergu.

Shkrimi i Martinit, *Robëria babilonase*, sulmoi sakramentet e Romës dhe, kur e lexoi këtë trakt Erazmi, deklaroi se çarja mes Martinit dhe Romës ishte e “pakthyeshme”. Pjesa më dëmtuese e shkrimit ishte sulmi kundër meshës, ku Martini mohonte se priftit i ishte dhënë pushteti hyjnor që ta transformonte (ndryshonte) bukën dhe verën në trupin dhe gjakun e Krishtit.

Pastaj, në mes të akuzave dhe kundërakuzave, Martini botoi një manifest 16-faqësh, me titull “*Për lirinë e të krishterit*”, të cilin ia kushtonte papës Leon. Fjalët hyrëse i bënë jehonë mendimit të çdo gjermani: “I krishteri është i lirë, plotësisht zot i gjithçkaje dhe nuk i nënshtrohet askujt.”

Kjo u vijua nga këto fjalë: “I krishteri është plotësisht shërbëtor i bindur i të gjithëve dhe u nënshtrohet të gjithëve. Ai është i lirë dhe zotëri me anë të besimit; por është shërbëtor dhe skllav, për shkak të dashurisë.” Mirëpo shumë pak gjermanë ia vunë veshin fjalisë së dytë. Erazmi e konsideroi këtë shkrim si ndarjen përfundimtare të Martinit me papatin. E dinte se Roma do ta urrente Martinin, pasi e kishte mbërthyer “papën nga kurora dhe murgjit nga barku i tyre i dhjamosur.”

Martini argumentonte se veprat e mira nuk e bëjnë njeriun të mirë, por se njeriu i mirë bën vepra të mira. I krishteri ishte njeriu që ndihmonte të tjerët nga dashuria për Perëndinë dhe njeriun, pa pritur asnjë lloj shpërblimi. Në të gjitha shkrimet e veta, argumentet i mbështeste në autoritetin e Fjalës së Perëndisë.

Kishte ardhur koha që Roma t’i përgjigjej. Papati s’i duronte dot më shkrimet fyese të Martinit. Duhej vënë nën fre. U dërguan kërkesa që Martini të shkonte në Romë dhe t’u përgjigjej akuzave për herezi. Dr. Eku, armiku i vjetër i Martinit, bëri të pamundurën që të ndodhte kjo. Autoritetet ushtruan tryzni mbi mëkëmbësin e përgjithshëm augustinian, që të përdorte ndikimin e vet, për ta detyruar Martinin të pendohej dhe të nënshtrohej. Si përgjigje, Shtaupici dha dorëheqjen nga pozita e vet.

Bula papnore

Në fund, papa Leon përpiloi dhe nënshkroi bulën papnore Exsurge Domine – “Ngrihu, o Zot”. Ky dekret dënonte mësimet e Martinit dhe paralajmëronte çdo njeri që të mos merrte asnjë kopje të shkrimeve të tij. Besnikët u urdhëruan që t’ia çonin shkrimet “heretike” priftit të famullisë, që t’i digjte në prani të tyre dhe përpara popullit të tubuar. Bula i dha Martinit gjashtëdhjetë ditë për t’u penduar për mësimet e veta dhe për të tërhequr gjithë sa kishte thënë dhe shkruar. Dr. Eku iu dha përgjegjësia që ta dorëzonte bulën në Gjermani, por nuk e priten mirë. Kur kopjet e bulës mbërritën në Vitenberg, Martini ishte ndër të fundit që e lexoi. Ai protestoi kundër bulës, pasi e kishin dënuar pa e dëgjuar. Si rrjedhojë, apeloj të mblidhej një këshill i Kishës, që të gjykonte çështjen e tij. Pastaj, për të treguar përçmimin që kishte për Romën, e cila kishte urdhëruar besimtarët që t’ia digjin shkrimet, vendosi të bënte të njëjtën gjë me shkrimet e papatit.

Në emër të Martinit, Filip Melanktoni ftoi gjithë studentët e universitetit që të ishin të pranishëm në orën 10 të mëngjesit, më 10 dhjetor 1520, jashtë Portës së Elsterit, në bregun e lumit Elbë, ku do të digjeshin kopjet e ligjit kanonik dhe të dekreteve të papëve. E pranishme në këtë ngjarje ishte një turmë e madhe dhe, kur flakët po forcoheshin, Martini hodhi në to një bulë papnore, që t'i ndizte dhe më tej. Këtë sjellje e shfajësoi, duke shkruar: “Për mua, zari është hedhur. E përçmoj njëlloj, si tërbimin e Romës, ashtu dhe pëlqimin e saj. Nuk pajtohem dhe as nuk komunikoj me ta. Le të m'i mallkojnë dhe djegin librat. Sa për mua, për sa kohë kam mundësi të nderz zjarr, do ta dënoj dhe do ta djeg publikisht ligjin kanonik.”

Gjetkë, shkroi kështu për veprimet e tij: “Meqë m'i kanë djegur librat, edhe unë do t'ua djeg. Ligjin kanonik e dogja, pasi e bën papën perëndi në tokë. Deri tani vetëm sa jam tallur me këtë punë të papës. Gjithë artikujt e mi, që dënohen nga Antikrishti, janë të krishterë. Papa rrallëherë ka mposhtur ndokënd me Bibël dhe arsye.”

Me shuarjen e flakëve, Martini dhe miqtë e tij ua lanë skenën studentëve të entuziazmuar, të cilët u gëzuan pa masë nga veprimet e profesorit të tyre të nderuar. Kur Martini u largua dhe s'i dëgjonte më, nisën të këndonin vaje funerali mbi dokumentet e djegura. Pastaj ngulën një bulë papnore në një shkop dhe një libër ndjesash në majën e një shpate dhe parakaluan nëpër rrugët e Vitenbergut, duke qeshur dhe duke u tallur me papën.

Më 31 janar 1521, u vulos shkishërimi i Martinit. Mirëpo Gjërmania po ziente, siç do ta zbulonte pas pak dhe dr. Eku. Martini ishte dalëzotësi i tyre, ndërsa Romën e përçmonin. Mendimtarët e mëdhenj të kohës, me në krye Erazmin, e trajtuan me përçmim të plotë vendimin papnor. Duka Giorg nuk pranoi që t'ia dorëzonte Martinin Romës, kurse duka i Bavarisë¹⁰³ s'pranoi të përfshihej, pasi i druhej luftës civile. Universiteti i Vitenbergut deklaroi se bula nuk kishte asnjë autoritet, ndërsa personi që e kishte sjellë, dr. Eku, ishte palë në këtë mosmarrëveshje. Në Lajpcig, dr. Eku iu desh të fshihej nga frika se mos e sulmonte populli i zemëruar. Në Erfurt, ku shtypi kopje të tjera të bulës, u përball me kundërshtimin e studentëve, të cilët ia rrëmbyen kopjet e shtypura. Studentët i quajën këto libra “bulluna” [fluska uji] dhe i hodhën në lumë për të parë nëse do të pluskonin apo do të mbyteshin.

Elektori Frederik i kërkoi Karlit, perandorit të zgjedhur, që ta falte Martinin për veprimin e nxituar të djegjes së dokumentave papnore, me

argumentin se Martini nuk duhej të ishte dënuar pa u dëgjuar - pastaj, edhe Roma ia kishte djegur shkrimet Martinit, dhe kjo gjë i bënte veprimet e tij kundërveprim “sy për sy”.

Frederiku tha se nuk e mbështeste pozicionin e Martinit, por donte vetëm një proces dëgjimor të ndershëm, që donte të thoshte se, për të hedhur poshtë mësimet e Martinit, duheshin përdorur Shkrimet, nëse diçka e tillë ishte e mundur! Elektori Frederik nuk mund të korruptohej me dhuratën e “trëndafilin të artë”. Dhe, më vonë, në Dietën e Vormsit, tregoi njëfarë përçmimi për Romën, kur e lejoi gaztorin e oborrit që të përqueshte kardinalët e Kishës dhe zyrtarë të tjerë kishtarë.

Kur dr. Eku mbërriti në Mainc, u bë një përpjekje që të digjnin shkrimet e Martinit, por dikush pyeti nëse librat e tij ishin dënuar ligjërisht. Kur një zë bërtiti “Jo!”, personi me pishtarin e ndezur u zmbraps nga pirgu i librave dhe nuk pranoi të merrte më pjesë në atë tubim. Kur kryepeshkopi Albert dha lejen që të përpiqeshin sërish të digjnin shkrimet e Martinit, caktuan një varrmihës që t’i vinte zjarrin përgut me dokumente dhe libra. Mirëpo të pranishëm ishin vetëm ca gra dhe disa rosa. Pastaj, Aleandri¹⁰⁴, nunci papnor në Gjermani, që kishte marrë leje nga kryepeshkopi për djegien e librave të Martinit, u godit me një breshër gurësh. Pas ndërhyrjes së abatit të qytetit që i shpëtoi jetën, i raportoi Romës se nëntë të dhjetat e popullit bërtisnin “Luter!”, ndërsa një e dhjeta tjetër klithte “Vdekje papës!”

U bë çdo përpjekje për ta bërë të pamundur paraqitjen e Martinit në Romë. Elektori Frederik argumentonte se bula ishte e paligjshme, pasi ishte botuar ndërsa ende vazhdonin diskutimet miqësore. Dhe vetë Luteri e vuri në dyshim vërtetësinë e këtij dekreti. “Nuk kam për të besuar në vërtetësinë e kësaj bule,” - shkroi ai, - “pa parë me sytë e mi plumbin, dyllin, spangon, firmën dhe vulën origjinale.”

Gjatë kësaj periudhe të stuhishme, nga penda e Martinit vazhduan të dilnin artikuj të tjerë. Nuk përmbahej më; madje, letra e tij Kundër bulës së neveritshme të Antikrishtit ngjalli zemërim te papati.

Çështja e Luterit në dietë

Meqë autoritetet civile kishin për të marrë vendime për perandorin, fakulteti i Universitetit të Vitenbergut dha mendimin që çështja e Martinit të diskutohej në dietën e ardhshme të Vormsit. Kur perandori Karl mori një letër nga xhaxhai i vet, Frederiku, që ia sugjeronte këtë rrugë veprimi, ra

dakord. Ishte situatë tejet e pazakontë, pasi ishte hera e parë në shekuj që një gjykatë laike do të thërriste, do të dëgjonte dhe do të merrte vendime për një çështje besimi.

Kështu, sundimtarët e perandorisë dhe Romës filluan të mblidheshin në Worms, për të marrë pjesë në dietën që u hap më 28 janar 1512. Gjithë të pranishmit do të përballeshin me dy çështje të një rëndësie madhore. Së pari, ishte e nevojshme të zgjidhnin një këshill regjence, për të qeverisur perandorinë gjatë mungesës së Karlit, kur të ishte në mbretërinë e vet në Spanjë.

Por kishin dhe një çështje e dytë: si t'ia bënin me mësimet e rrezikshme të Martin Luterit, murgut nga Vitenbergu? Karli ishte shumë i shqetësuar, sepse mësimet e Martinit kërcënonin paqen e perandorisë, gjë që mund të çonte në shpërbërjen e besimit të të parëve. Ai donte të kujtohej si perandori që e shpëtoi papatin nga ndarja e rëndë!

14. Gjithë rrugët çojnë në Vorms

Përfaqësuesit e fuqishëm të autoriteteve civile dhe shpirtërore morën rrugën për në qytetin e Vormsit, ku duheshin marrë disa vendime të rëndësishme. Aty i duhej mbyllur goja një murgu nga Vitenbergu që po shkaktonte ndasi të madhe në perandori. Për të parën herë, perandori i ri, Karli, do të përballej me përfaqësuesit e perandorisë së vet dhe të papatit. Do të kryesonte takimin e forcave më të fuqishme në Evropë.

Mbledhja e delegatëve

Krerët e qeverive shoqëroheshin me ushtarë dhe shërbëtorë, gjë që e fryu së tepërmi popullsinë e Vormsit. Ndër delegatët ekzistonte frika e trazirave, ndaj shumica ishin të përgatitur për çdo rast. Një sundimtar reformues, Filipi i Hesënit¹⁰⁵, mbërriti i shoqëruar nga gjashtëqind luftëtarë.

Perandori i ri nuk donte t'ia dinte për Martinin dhe risitë e tij teologjike, pasi ishte shërbëtor besnik i papës së Romës, ndonëse ishte i përfshirë dhe vetë në mosmarrëveshje të rënda me papatin. Karli ishte edukuar si katolik i thekur që nga fëmijëria dhe heretikët i konsideronte çrregullues të planit të Perëndisë për shoqërinë. Mirëpo ishte në situatë të vështirë, pasi donte t'i shtypte luteranët, por, në të njëjtën kohë, nuk donte ta fyente xhaxhain e vet, Frederikun, Elektori që e mbronte besnikërisht Martinin.

Frederiku kishte luajtur rol të rëndësishëm në zgjedhjen e Karlit perandor. Në një moment, Karli i kërkoi Frederikut ta sillte Martinin me vete në Vorms, por, pastaj, kur pa rrezikun që i kanosej Martinin nga autoritetet papnore, e këshilloi Frederikun që ta linte në shtëpi. Ndërsa Frederiku vetë donte thjesht lojë të ndershme për mësuesin e tij të famshëm në Universitetin e Vitenbergut; po kështu, ekzistonte ndjesia e përgjithshme se papati po e trajtonte në mënyrë të padrejtë Martinin.

Në dietë, papa përfaqësohej nga Karaçoli¹⁰⁶, specialist në çështjet politike, dhe nga Aleandri, që ishte i pranishëm për të mbrojtur interesat kishtarë të papës. Të dy këta burra më vonë u shpërblyen me postin e kardinalit, për shërbimet besnike ndaj papatit.

Punimet e dietës i hapi më 28 janar 1521 perandori njëzetvjeçar Karli V, një djalosh thatim dhe fytyrëzbehtë që vuante nga depresioni, por që ishte

kalorës me përvojë. Midis takimeve të asamblesë, vizitorët argëtoheshin me bankete, lojëra kalorsiake, gara, dyluftime dhe festime. Pati dhe shumë dehje e shthurje. Pati tallje me gjërat e shenjta; madje dhe Elektori modest, Frederiku, e lejoi gaztorin e vet, Fricin, t'i zbaviste mysafirët me një shfaqje ku imitonte papën dhe kardinalët.

Frederiku erdhi pa Martinin. I kishte shkruar Karlit, ku i shprehte shqetësimin për sigurinë e Martinit, po ta shoqëronte. Aleandri u tërbua, kur kuptoi se s'do të ishte në gjendje ta sulmonte personalisht Martinin. Pastaj u bë i vetëdijshëm për ndjenjat e princave gjermanë kundrejt papatit dhe pati frikë se mos pushteti papnor po shpërbëhej. I shkroi papës, duke i thënë: "Gjermania po ndahet nga Roma; princat po ndahen nga papa." Pastaj iu përgjyera papës t'i dërgonte para, që t'i përdorte për të korrptuar sundimtarët dhe, kështu, të fitonte mbështetjen e tyre, ndryshe kishin për ta humbur Gjermaninë.

Papa kundërshton Luterin

Papa mori masa të menjëhershme, përpara se të fillonte zyrtarisht dieta dhe, më 6 janar 1521, botoi një mallkim tjetër kundër Martinit, i cili duhej lexuar në të gjitha kishat. Ky sulm tjetër i rëndë ndaj Martinit dhe mbështetësve të vet i ndërgjegjësoi të gjithë se duhej kryer çdo përpjekje për t'i dhënë fund kësaj sherrnaje.

Zhan Glapio, që ishte rrëfestar i Karlit, organizoi një sërë takimesh që shpresonte se do ta zgjidhnin mosmarrëveshjen. Glapioja, që thoshte se kishte njëfarë simpatie për shkrimet e Martinit, dha mendimin se, nëse Martini i hidhte poshtë ato që kishte shkruar në Robërinë babilonase, problemi do të zgjidhej. Propozoi formimin e një komiteti që do të shqyrtonte mësimet e Martinit dhe para të cilit Martini do t'i lejohej të argumentonte çështjen e vet. Pastaj Martini duhej të kërkonte falje për disa nga thëniet e veta, ndërsa papa do ta falte, do t'i rikthente statusin e mëparshëm dhe gjithçka do të përfundonte mirë.

Kjo ishte thjesht një përpjekje e pushteteve shpirtërore dhe politike për ta shtypur Martinin dhe Reformacionin.

Në mes të këtyre diskutimeve, mbërriti bula papnore dhe Karli, pa u këshilluar me anëtarët e dietës, urdhëroi që porositë e bulës të zbatoheshin menjëherë. Mirëpo anëtarët e dietës nuk pranonin që t'u nëpërkëmbëshin të drejtat, pasi kishin çdo të drejtë që të përfshiheshin në vendimmarrje. Kur

Karli u detyrua që të mblidhte dietën për ta diskutuar këtë çështje, Aleandri u tërbua, kur pa se Martini mund t'i rrëskiste nga duart dhe, kështu, mund t'i shpëtonte dënimit nga sundimtarët e mbledhur.

Më 13 shkurt, foli tre orë para asamblesë, duke deklaruar se Martini po shkatërronte themelet e besimit të vërtetë dhe po e çonte perandorinë në prag të luftës civile. E përmbylli duke thënë se, nëse dieta s'merrte masa kundër Martininit, ata do të ishin përgjegjës për shkatërrimin e shoqërisë së qytetëruar. Kur u ul, u duk sikur gjithë anëtarët e dietës ranë dakord me argumentin e tij.

Fjalimi i dukës Giorg dhe thirrja për reformim

Dieta u shty për një kohë të shkurtër, por, kur u mbledhën sërish, u ngrit në këmbë duka Giorg i Saksonisë, armik i Martininit dhe i Reformacionit. Ai e donte Gjermaninë dhe ishte kundër tiranisë së Romës. “Dieta s’duhet t’i harrojë pakënaqësitë tona ndaj oborrit të Romës. Sa abuzime janë kryer në shtetet tona?” Si sulmoi papatin me këto fjalë hyrëse, vijoi duke renditur abuzimet e Romës dhe mënyrën sesi papati ia kishte zbrazur xhepat popullit gjerman dhe i kishte shpenzuar për qejfet e veta.

Si pasojë, për tmerrin e Aleandrit dhe Karaçolit, u formua një komitet për të përpiluar një listë të abuzimeve të Romës që, kur përfundoi, numëroi njëqind e një ankesa kundër papatit.

Një ankesë ishte që Martini, i cili ishte dënuar pa seancë dëgjimore, të dilte përpara dietës dhe të dëgjohej. Më tej, perandori e tërhoqi kërkesën që librat e Martininit të digjeshin dhe e zëvendësoi me urdhrin që gjithë librat e tij t’u jepeshin gjykatësve vendas për t’i ruajtur.

Reagimi i përfaqësuesve papnorë

Aleandri u tërbua nga ky ndryshim politik. Tani një gjykatë civile do të merrte vendime në lidhje me një çështje që e kishte dënuar papa. Përfaqësuesit papnorë e konsideruan këtë si ndryshim në strukturën e pushtetit mes papatit dhe sundimtarëve civilë. Tani shteti po uzurponte rolin e papës dhe kjo gjë nuk mund të tolerohej.

“Nuk është e ligjshme,” - thanë ata, - “që të vihet në dyshim ajo që ka dekretuar papa sovran.... Nëse keni vendosur ta thërrisni [Martin Luterin] përpara jush, të paktën mos e vini nën mbrojtjen e perandorit.”

Përfaqësuesit papnorë nuk e duronin dot kombëtarizmin gjerman. Madje Aleandri i shkroi papës dhe iu ankua se ishte e pasigurt që të ecte nëpër

rrugët e Vormsit. Ishte plotësisht i bindur se nëntë të dhjetat e gjermanëve e donin Martinin, kurse një e dhjeta bërtiste: “Vdekje oborrit të Romës!”

Luteri thirret në Vorms

Më 6 mars 1521, u dha urdhri që Martini të paraqitej në Vorms brenda njëzet e një ditësh. Perandori i lëshoi një leje kalimi që i garantonte sigurinë, të cilën e mbështetën me shkrim dhe Elektori Frederik, duka Giorg i Saksonisë dhe konti i Hesënit, përmes të tokave të të cilëve duhej të udhëtonte Martini. Dokumenti zyrtar i firmosur nga perandori Karl i drejtohej Martinit me fjalë shumë të sjellshme – aspak me fjalë që do t'i drejtoheshin dikujt që konsiderohej fajtor për herezi:

“Karli, me hirin e Perëndisë, perandor i zgjedhur i romakëve....

I nderuar, fort i dashur dhe i përsëpirtshëm! Ne dhe shtetet e Perandorisë së Shenjtë, të mbledhur këtu, pasi vendosëm që të nisnim një hetim për shqyrtimin e doktrinės dhe librave që keni botuar kohët e fundit, kemi lëshuar një leje kalimi tonin dhe të perandorisë për ardhjen tuaj këtu dhe kthimin në një vend të sigurt, të cilin po jua dërgojmë. Dëshira jonë e sinqertë është që të përgatiteni menjëherë për këtë udhëtim, me qëllim që, brenda njëzet e një ditëve të caktuara për lejekalimin tuaj të sigurt, të dilni patjetër përpara nesh. Mos kini frikë nga ndonjë padrejtësi apo dhunë. Ne do t'i përmbahemi në mënyrë të patundur lejekalimit të mësipërm dhe presim që ju t'i përgjigjeni thirrjes sonë. Në këtë mënyrë, do t'u bindeni dhe dëshirave tona më të sinqerta....”

Letra i drejtohej “të nderuarit, të shtrenjtit tonë dhe të përsëpirtshmit doktor Martin Luterit, i urdhrat augustinian.” Të gjithë duhet të jenë habitur që perandori Karl i akordoi kesi lloj titujsh të respektuar njeriut që papa e kishte shkishëruar. Aty për aty, kasneci i perandorit u nis për në Vitenerg; arriti më 24 mars.

Shumë druheshin se Martini nuk do të mbërrinte kurrë në Vorms dhe iu përgjëruan që ta refuzonte kërkesën e perandorit – tek e fundit, as Jan Husin së kishin respektuar. Mirëpo Martini që i vendosur që të paraqitej në Vorms. Nuk i druhej frikës, ndaj tha: “Ata në Vorms po mudohen të më detyrojnë që të tërhiqem; dhe tërheqja ime do të jetë kjo: më përpara kam thënë se papa

është përfaqësuesi i Krishtit; tani pohoj se ai është armiku i Zotit, apostulli i djallit.”

Disa shokëve të ngushtë që e kishin nxitur të rrinte aty ku ishte, u tha: “As nuk do të pendohem, as nuk do të marr arratinë. Do të shkoj në Vorms, përkundër gjithë portave të ferrit dhe princit të pushtetit të ajrit.”

Luteri në Vorms

Pasi u përshëndet me dashuri me popullin dhe studentët, Martini, i shoqëruar nga tre shokë, la Vitenbergun dhe u nis për në qytetin e Vormsit. Rugën e printe kasneci perandorak, i shoqëruar nga shërbëtori i vet. Mbanin lart emblemën e perandorit, për t’u siguruar që të gjithë ta dinin se kush ishin dhe, kështu, të drejtat e tyre të respektoheshin nga të gjithë, kur të kalonin përmes shteteve të ndryshme. Pas tyre vinte pajtoni ku udhëtonte Martini me shokët.

Gjatë rrugës Martini u mirëprit nga udhëheqësit dhe banorët e qytezave dhe qyteteve të ndryshme, përmes të cilave kalonin. Iu dha mundësia që t’u fliste turmave të mbledhura dhe ata e inkurajuan së tepërmi.

Teksa po i afrohej Vormsit, u përhapën zëra se lejekalimi nuk do të respektohej. Edhe Spalatini kishte dyshime për sigurinë e Martinin dhe i dërgoi urgjentisht fjalë që të kthehej. Mirëpo Martini s’e bënte kurrë këtë dhe ia ktheu lajmëtarin Spalatinit, me këto fjalë: “Shko dhe thuaji zotit tënd që, edhe sikur në Vorms djajtë të ishin të shumtë sa tjegullat e çative, do të hyj gjithsesi.”

Në 10 të mëngjesit, më 16 prill 1521, Martini hyri përmes portave të Vormsit. Turma të mëdha ishin mbledhur për të parë murgun që kishte sfiduar autoritetin e papatit. Princat, fisnikët, peshkopët, banorët dhe njerëz nga të gjitha anët e perandorisë, vështrojnë teksa njeriu që besonin se do të sfidonte urdhrin e perandorit për t’u paraqitur në Vorms hynte brenda mureve të qytetit. Aleandri pati shpresuar se Martini nuk do të paraqitej dhe patën qarkulluar zëra se dieta nuk do ta respektonte lejekalimin e perandorit. Entuziazmi ishte i jashtëzakonshëm, teksa turmat e popullit shihnin kasnecin dhe shërbëtorin e perandorit që prinin përpara, të ndjekur nga pajtoni i mbulur ku ishin ulur Martini, i veshur me veshjen e murgut, dhe miqtë e tij. Vargani çau mes rrugëve të mbushura me njerëz dhe ndaloi në hanin e Kalorësve të Rodit¹⁰⁷; Martini i lodhur, bashkë me miqtë e vet, hynë brenda.

Aleandri e përshkroi me këto fjalë hyrjen e Martinit:

Sapo kisha përfunduar së shkruari letrën e fundit, kur disa njerëz më thanë (megjithëse arrija ta dalloja dhe vetë nga poterja e njerëzve që vraponin) se në qytet po hynte kryeheretiku i njohur. Dërgova një nga njerëzit e mi dhe ai më informoi se deri te portat e shoqëruan njëqind kalorës, me gjasë të Zikingenit. I ulur në pajton me tre bashkudhëtarë, ai hyri në qytet i rrethuar nga tetë kalorës; bujti në afërsi të Elektorit sakson. Sa doli nga pajtoni, një prift e përqafoi dhe i preku tri herë rrobën; më pas u mburr sikur kishte prekur me dorë reliken e shenjtorit më të madh në botë. Them se, pas pak, do të thonë se ai kryen mrekulli. Sa doli nga pajtoni ky Luteri, hodhi sytë demoniakë rreth e rrotull dhe tha: “Perëndia do të jetë me mua.” Pastaj hyri në një dhomë, ku e vizituan shumë fisnikë; darkoi me dhjetë ose dymbëdhjetë prej tyre. Pas darkës, gjithë bota u mblodh për ta parë.

Në prag të paraqitjes para dietës

Karli thirri menjëherë një takim të dietës dhe tha: “Luteri ka ardhur. Çfarë të bëjmë?”

Disa thanë se Martini duhej arrestuar dhe u duhej dorëzuar përfaqësuesve papnorë, por Karli tregoi se ishte djalosht i ndershëm, kur tha: “Jo, duhet ta mbajmë premtimin!”

U vendos që Martini të dilte përpara dietës të mërkurën e 17 prillit dhe për këtë e njoftoi marshalli i perandorisë, Ulrih fon Papenhajm¹⁰⁸.

Atë natë, meqë fjeti shumë pak, Martini i ra llautës, këndoi disa himne dhe e kaloi kohën në lutje para Perëndisë që donte dhe i shërbente. Kishte shumë gjëra në mendje, pasi kishte marrë shumë këshilla nga njerëzit e shumtë që e kishin vizituar. Martini nuk i druhej vdekjes për mësimet e veta, por ndihej në siklet që do të dilte përpara një asambleje të tillë me sundimtarët e mëdhenj të perandorisë dhe Kishës. Pastaj kishte dhe pyetjen: “Po sikur mësimet e mia t’i kem gabim dhe ajo që ka mësuar Kisha për shekuj me radhë të jetë e vërtetë? Unë jam thjesht një njeri, ndërsa ata janë shumë.”

Para dietës

Kasneci i perandorit mbërriti në kohën e caktuar, që ta shoqëronte Martinin në një takim me autoritetet më të mëdha të botës. Turmat në rrugë

ishin kaq të ngjeshura, saqë Martini dhe rojat u detyruan të ecnin nëpër rrugica, rrugë anësore dhe kopshtije; me një fjalë, morën ç'rrugë mundën, që t'i shpëtonin turmës.

Sapo do të hynte në asamblenë e madhe, Giorgu i Froindsbergut¹⁰⁹ e preku Martinin në shpatull, tundi kokën dhe i tha me zë miqësor: “Murg i gjorë! Murg i gjorë! Tani ti do të bësh qëndresën më trime që kam bërë ndonjëherë unë ose çdo kapiten tjetër në betejën më të përgjakshme! Por, nëse kauza jote është e drejtë dhe je i sigurt për të, shko përpara në emër të Perëndisë dhe hiç mos u druaj! Perëndia s’ka për të të braktisur.”

Kështu Martinin e nxorën përpara perandorit Karl V. Prania e Martinin përpara sundimtarëve civilë të perandorisë ishte fitore mbi pushtetin e Romës, e cila pretendonte të drejtën e vemte për gjykimin e çështjeve teologjike. Gjithë sytë ishin ngulur te Martini ndërsa marshalli i perandorisë i pëshpëriti: “Mos thuaj asgjë pa të pyetur.” Pastaj u zmbraps dhe e la vetëm Martinin, pa ndihmë njerëzore, përballë sundimtarëve më të fuqishëm të tokës.

Duhet vërejtur këtu dhe puna e mrekullueshme e Perëndisë, i cili po i realizonte synimet e veta përmes djalit të një minatori të panjohur. Tani njeriu i Perëndisë do të shpallte të vërtetën e tij përpara një asambleje kaq të rëndësishme njerëzish, saqë do ta dëgjonte numri më i madh i mundshëm i njerëzve. Shumë shpejt gjithë Evropa do ta njihte emrin e Martin Luterit dhe të vërtetën biblike që mësonte ai.

D’Obinjeja¹¹⁰ shkroi kështu për ata që kishte përballë Martini:

Kurrë më parë s’kishte dalë njeri përpara një asambleje kaq madhështore. Perandori Karl V, sovraniteti i të cilit shtrihej mbi pjesët e mëdha të botës së vjetër dhe asaj të re; vëllai i vet, arkiduka Ferdinand¹¹¹; gjashtë elektorët e perandorisë, shumica e pasardhësve të të cilëve tani mbajnë kurora mbretërore; njëzet e katër dukë, shumica e të cilëve ishin sovranë të pavarur vendesh pak a shumë të mëdha, mes të cilëve ishin disa që më vonë do të bëheshin të frikshëm për Reformacionin; duka i Alvës¹¹² me dy bijtë e tij; tetë kontë; tridhjetë kryepeshkopë, peshkopë dhe abatë; shtatë ambasadorë, përfshi dhe ata të mbretërve të Francës dhe Anglisë; deputetët e dhjetë qyteteve të lira; një numër i madh princash, kontësh dhe

baronësh sovranë; nuncët papalë, gjithë-gjithë dyqind e katër vetë. Kjo ishte gjykata madhështore përpara se cilës doli Martin Luteri.

Mirëpo Perëndia po e ruante njeriun e vet.

Pastaj Martinin e mori në pyetje kancelari i kryepeshkopit të Trierit¹¹³, Johan Eku, mik i Aleandrit (jo Eku që ishte përballur me Martinin më parë). Pyetja e parë ishte: “Martin Luter.... Së pari, a pranon se këta libra i ke shkruar ti?” I tregoi me gisht një pirg me 25 libra mbi një tryezë.

Më tej, vijoi: “Së dyti, a je gati t’i tërheqësh dhe mohosh mendimet që ke shfaqur në to?”

Në atë çast, miku i Martinit, Shurfi¹¹⁴, e ndërpreu, duke thënë: “Le të lexohen titujt e librave.” Druante se mos ndokush kishte futur vjedhurazi ndonjë shkrim anonim dhe të rremë në mes të materialeve të Martinit.

Kur dr. Eku përfundoi leximin e titujve të njëzet e pesë librave, Martini e pranoi se lista ishte e saktë: “Perandor i shumëhirshëm dhe princa e zotërinj të shumëhirshëm, librat e sapopërmendur janë të mitë.”

Më tej Martini vijoi t’i përgjigjej pyetjes së dytë që i kishin drejtuar: “Sa për të dytën, meqë është pyetje që ka të bëjë me shpëtimin e shpirtrave dhe në të përfshihet Fjala e Perëndisë (mbi të cilën s’ka asgjë më të madhe, as në qiell, as në tokë), do të flisja me mungesë respekti, po të përgjigjesha pa shtuar dhe disa mendime të mëtejshme. I lutem madhërisë së tij perandorit, me përulësinë më të madhe, që të më japë kohë t’i përgjigjem pa e fyer Fjalën e Perëndisë.”

Pas një periudhe të shkurtër diskutimi, Martinit i dhanë një ditë kohë, përpara se të përgjigjej. Martini u përkul para asamblesë dhe doli nga salla. Pastaj Karli iu drejtua njërit prej oborrtarëve dhe i tha: “As bëhet fjalë, as bëhet fjalë që ai murg të më shndërrojë dot në heretik.”

Tani Martini ishte i detyruar të përgatiste përgjigjen për perandorin, por e kaploi një parandjenjë shumë e fortë. U ndie i braktisur dhe fillikat; mendonte se kishte ardhur në Vorms për të vdekur si martir. Pastaj i thirri Perëndisë për t’i dhënë trimëri dhe forcë në këtë kohë nevojë të tmerrshme:

O Perëndi i plotfuqishëm dhe i përjetshëm! Sa e tmerrshme është kjo botë! Ja, ajo hap gojën të më gllabërojë, ndërsa unë kam shumë pak besim në ty!... Sa i dobët është mishi dhe sa i fortë është Satani! Po e vendosa

besimin vetëm në fuqinë e kësaj bote, do të humb plotësisht! Ora ime e fundit ka ardhur dhe dënimi im është shpallur! ... O Perëndi! ... O Perëndi! Më ndihmo kundër gjithë urtësisë së botës. Bëje këtë. Duhet ta bësh.... Vetëm ti... sepse kjo s'është puna ime, por jotja.... Unë jam gati të jap dhe jetën për të vërtetën tënde... Sepse kjo është kauza e drejtësisë, është jotja! ... Kurrë s'kam për t'u ndarë prej teje, as tani, as në përjetësi! ... Edhe sikur bota të jetë e mbushur me djaj, edhe sikur trupin tim, që është ende vepër e duarve të tua, të ma vrasin, të ma shtrijnë përtokë, të ma bëjnë copë e çikë... të ma bëjnë pluhur e hi.... Shpirti im është i yti! ... Po! Fjala jote më siguron për këtë. Shpirti im të përket ty! Do të jetoj përjetë me ty... Amen! ... O Perëndi! Më ndihmo! ... Amen.

Paraqitja e dytë para dietës

Shpejt erdhi sërish koha për paraqitjen e Martinit; sërish e shoqëruan disa ushtarë për të dalë i vetëm përpara asamblesë madhështore të sundimtarëve të Evropës. Tani Aleandri shpresonte se Martini do t'i tërhiqte mësimet mbrapsht.

Dr. Eku u ngrit në këmbë, doli përpara Martinit dhe i kërkoi t'i përgjigjej pyetjes për të cilën i patën dhënë kohë të mendohej. Të gjithë të pranishmit në atë takim zgjatën qafën që të shihnin Martinin dhe të dëgjonin fjalët e tij, në fillim në gjermanisht, pastaj dhe në latinisht.

Regjistrat e Dietës së Vormsit shkruajnë: “Në atë çast, dr. Martin Luteri iu përgjigj në mënyrën më të nënshtruar dhe më të përlulur të mundshme. Nuk u ankua, as nuk foli ashpër, por me maturi, butësi, hijeshi dhe vetëpërmbajtje, me gëzim të madh dhe palëkundshmëri të krishterë.”

Martini foli qartazi për librat e vet, duke skicuar natyrën e ndryshme të gjithçkaje që pati shkruar. E pranoi se një pjesë e mirë e shkrimeve ishin kundër papatit, doktrinë së rreme dhe jetesës së mëkatshme të shumë krerëve të Romës. Pastaj tha se nuk mund ta tërhiqte mbrapsht atë që kishte shkruar për këto tema.

Kur Martini përfundoi, i kërkuan ta përsëriste gjithçka në latinisht. Perandori kishte neveri për gjuhën gjermane dhe pothuajse s'kishte kuptuar asgjë nga Martini. Mirëpo këshilltari personal i Elektorit të Saksonisë, i cili po qëndronte përbri Martinit, kur pa se ishte i rraskapitur nga të folurit, i tha butësisht: “S'je në gjendje t'i përsërisësh ato që the; kaq mjafton, doktor.”

Ai kishte qëndruar përbri Martinit, jo vetëm për inkurajim, por edhe për t'u siguruar që reformatori të mos lëndohej në asnjë mënyrë. Mirëpo Martini e përsëriti ligjëratën e vet edhe në latinisht, gjuha e të arsimuarve.

Kur përfundoi, kancelari i Trierit u ngrit dhe e tha: “Nuk iu përgjigje pyetjes që t'u bë. Nuk je thirrur këtu që të vësh në dyshim vendimet e këshillave kishtarë. T'u bë një pyetje e qartë dhe e saktë: A do t'i tërheqësh këto mendime apo jo?”

Përgjigja e Martinit u mbajt shënim që ta lexonin të gjithë:

“Meqë madhëria juaj i hirshëm dhe i fuqishëm kërkon prej meje një përgjigje të drejtpërdrejtë dhe të saktë, po jua jap. Është kjo: nuk ia nënshtroj dot besimin tim papës apo këshillave kishtarë, pasi është e qartë si drita e diellit se shpesh ata kanë gabuar dhe kanë kundërshtuar njëri-tjetrin. Prandaj, nëse nuk më bindin me dëshminë e Shkrimit ose me arsye të qarta dhe të sakta që ndërgjegjja të më shtrëngojë të pranoj gabimin tim, nuk mundem dhe nuk do të tërhiqem, pasi s'është as e sigurt, as e mençur që të bëj diçka në kundërshtim me ndërgjegjen.”

Pastaj hodhi vështrimin rreth e rrotull asamblesë së sundimtarëve dhe shtoi:

“Këtu qëndroj. S'bëj dot ndryshe. Perëndia më ndihmoftë. Amen.”

Frederiku i Urtë u mbush me krenari nga fjalët e profesorit të tij të famshëm në Universitetin e Vitenbergut. Që nga ai çast u bë mik i Martinit dhe i Reformacionit; u sigurua si kurrë më parë që Martini të kishte gjithë mbrojtjen e nevojshme.

Luteri refuzon përsëri të tërhiqet

Pastaj Martinin e urdhëruan të dilte nga asambleja, ku do të nisnin diskutimet për hapin që duhej marrë. U mor vendimi që Martinit t'i jepej dhe një mundësi tjetër për të tërhequr mësimet e veta. Kur e nxorën sërish përpara dietës dhe doli përpara fronit të perandorit, e pyetën nëse pranonte të pendohej.

Martini u përgjigj: “S'kam ç'përgjigje tjetër të jap, përveç asaj që e kam dhënë tashmë.”

Pastaj dr. Eku e mbylli takimin e dietës dhe u bëri thirrje të gjithëve që të ishin të pranishëm të nesërmen, kur perandori do të shpallte vendimin për Martin Luterin.

Teksa Martini po shoqërohej jashtë dietës, disa nga rojat spanjolle të perandorit bërtitën: “Hidheni në zjarr!”

Verdikti i perandorit

Të nesërmen, perandori deklaroi zyrtarisht se, siç patën bërë paraardhësit e tij, edhe ai do ta mbronte besimin katolik dhe autoritetin e papës. Më tej, tha: “Një murg i vetëm, i mashtruar nga marrëzia e vet, është ngritur kundër besimit të botës së krishterë. Për t’i dhënë fund një blasfemie të tillë, do të sakrifikoj mbretërinë, pasurinë, miqtë, trupin, gjakun, jetën dhe shpirtin tim. Do ta largoj augustinianin Luter. Pastaj do të marr masa kundër tij dhe ndjekësve të tij, për mosbindjen e tyre kryeneçe dhe do t’i shkatërroj me çdo lloj mënyre!”

Por, sërish, në lojë hyri politika. Perandori kishte anashkaluar të drejtat e sundimtarëve të tjerë, por ishte i nevojshëm miratimi i tyre që ky dekret të zbatohet. Aty për aty, u paraqitën dy propozime të ndryshme. Mbështetësit e Romës kërkonin që lejkalimi i perandorit të tërhiqej menjëherë dhe Martini të digjej në turrën e druve.

Grupi tjetër, që përbëhej nga princat dhe sundimtarët e Gjermanisë, kërkoi që garancia e lejkalimit të respektohej. Nëse s’ndodhte kështu, kombit të tyre do t’i njollosej përgjithmonë nderi. U dha mendimi se, nëse Martinin i bëhej keq, në Gjermani dhe gjetiu do të shpërthente lufta civile. Po kështu, dihej se në Worms, njerëz të armatosur ishin gati të nxirrnin shpatat pa një pa dy, nëse dikush ua prekte murgun nga Vitenbergu. Po qarkullonin zëra se kalorësit e shquar, Zikingeni dhe Hutëni, kishin mijëra burra të armatosur, të gatshëm të vërshonin në qytetin e Wormsit, nëse ndokush shtrinte dorën i zemëruar kundër Martinin.

Perandori Karl e kuptoi qartë rrezikun shumë real që i kanosej qytetit të Wormsit dhe perandorisë së vet; po kështu, ndërgjegjja s’ia lejonte që të shkelte garancinë e lejkalimit. Ishte në prag të luftës me Francën dhe, meqë s’ia kishte besën papës, vendosi që Luteri i gjallë do të ishte më i dobishëm se Luteri i vdekur.

Kështu Karli shpalli vendimin e vet përpara sundimtarëve, të cilët po vrisnin mendjen se çfarë do të thoshte perandori i ri: “Si dëgjova përgjigjen që dha dje Luteri në praninë time, ndiej keqardhje që kam vonuar marrjen e masave kundër tij për mësimet heretike. Nuk kam për të dëgjuar më asgjë prej tij. Synimi im është ta kthej menjëherë në Vitenberg nën mbrojtjen e një

eskorte, me marrëveshjen që ai të mos predikojë ose mësojë më doktrinën e tij heretike ose të mos nxisë revolucion. Kam vendosur që të marr masa kundër tij si heretik famëkeq dhe tani ju bëj thirrje të gjithëve të jeni të krishterë të mirë në këtë çështje dhe të më premtoni se do ta kryeni detyrën tuaj.”

Kjo shpallje u vijua nga diskutime të forta mes sundimtarëve, të cilët i kujtuan Karlit se ishte zotuar që asnjë gjerman nuk do të dënohej pa proces dëgjimor gjyqësor. Shumë elektorë ishin tejet të shqetësuar për trazirat e mundshme civile, nëse Martini do të dëmtohej fizikisht. Për të përmbushur kërkesat e elektorëve gjermanë, u formua një komitet për të mbajtur diskutime me Martinin.

Koha për t’u larguar nga Vormsi

Pas disa ditë diskutimesh të zjarra, Martini e kuptoi se nuk fitohej më dot asgjë nga bisedimet dhe u mor vendimi që ai të largohej nga qyteti i Vormsit. Po kështu, u ra dakord që lejekalimi i perandorit të respektohej, por shumë besonin se Martinin do ta vrisnin gjatë kthimit në vendin e vet.

Elektori Frederik ishte kaq i shqetësuar për sigurinë e Martinit, saqë vuri disa burra besnikë të organizonin rrëmbimin e tij dhe ta çonin në një vend të sigurt. Frederiku u kërkoi që të mos ia tregonin planet, në mënyrë që të tregohej vërtet i sinqertë me perandorin, kur t’i thoshte se nuk e dinte aspak vendndodhjen e Martinit.

Më 26 prill 1521, i rrethuar nga njëzet burra me kuaj dhe i vëzhguar nga turmat e mëdha të popullit, Martini u largua nga qyteti i Vormsit me një pajton të vogël.

Në dekretin që do të nxirrte së shpejti perandori Karl, Martini përshkruhej “jo si njeri, por si Satani vetë në formë njeriu, i veshur me petkun e priftit.”

Pasi udhëtuan disa kilometra, Martini i tha rojës së caktuar nga perandori për mbrojtjen e tij që s’kishte më nevojë për të. Teksa kalonte përmes qyteteve dhe fshatrave rrugës për në Vitenberg, Martini përfitoi nga çdo mundësi që të fliste hapur kundër ligësive të Kishës Katolike të Romës. Përfitoi nga çdo rast që t’u shkruante miqve, ku i informonte për ngjarjet që patën ndodhur dhe i inkurajonte që t’i qëndronin besnikë të vërtetës. Në këtë mënyrë nuk iu bind njërit prej kushteve të lejekalimit të perandorit.

Shpejt erdhi koha kur Martini po shoqërohej vetëm nga dy murgj, njëri prej të cilëve ishte në dijeni të planeve për rrëmbimin e tij.

Martini u rrëshqiti nga duart Romës dhe perandorit, gjë që Karlit do t'i mbetej gjithmonë peng. Më vonë, në Spanjë, kur urdhëroi djegien e disave që konsideroheshin heretikë, foli me keqardhje për vendimet që kishte marrë në Vorms në lidhje me Martinin: “Bëra gabim që nuk e vrava Martin Luterin. S’kisha asnjë detyrim ta respektoja fjalën e dhënë, pasi Luteri ishte heretik dhe kishte mëkatuar kundër një Zoti më të madh se perandori: kishte mëkatuar kundër Perëndisë! Duhej të kisha urdhëruar ta vrisnin, por nuk e bëra dhe mësimet e tij janë përhapur për shkak të gabimit tim...”

15. “I burgosuri” Në Vartburg¹¹⁵

Rrugës për në Vitenberg, Martini u prit krahëhapur në shumë qyteza dhe qytete ku kalonte. Turmat mblidheshin për ta parë dhe për të folur me murgun e madh reformator, i cili u kishte bërë ballë trimërisht kërcënimeve dhe forcës së papatit dhe ishte larguar pa u vrarë.

Dekreti i perandorit

Mirëpo jetën e kishte vërtet në rrezik, pasi perandori kishte nxjerrë një dekret kundër tij. Kjo shpallje, e përpiluar nga Aleandri, datonte më 8 maj, por u firmos vetëm më 26 maj.

Karli kishte vendosur të vepronte me autoritetin që besonte se kishte si perandor. Kishte mësuar se papa e kishte quajtur “çunaku Karl” dhe këto fjalë e fyen rëndë. Po kështu, ishte lodhur nga problemet e gjermanëve dhe donte të mbronte autoritetin e vet. Në atë kohë nuk ishte i kënaqur me veprimet që po kryheshin në Romë, pasi papa po vendoste të dërgonte trupat zvicerane për t’ia pushtuar Karlit mbretërinë e dytë, Napolin¹¹⁶.

Kur dekreti iu paraqit dietës për miratim zyrtar, shumë prej delegatëve ishin larguar tashmë; kjo donte të thoshte se s’kishin dorë në vendimin përfundimtar. Madje Karli s’kishte as numrin minimal të nevojshëm për mbajtjen e atij takimi. Shpallja thoshte se Martini ishte djalli nën një petk murgu dhe pretendonte se mësimet e tij shkaktonin “kryengritje, përçarje, luftëra, vrasje, plaçkitje, djegie dhe rënien e botës së krishterë...”

Më tej pohonte se mësimet e Martinit dëmtonin më tepër pushtetet civile, sesa papatin. Dekreti shpallte se botimi, shitja dhe leximi i librave të tij ishin të ndaluar dhe se gjithë nënshtetasve të perandorisë u ndalohej t’i jepnin çdo lloj ndihme. S’duhej t’i jepnin asnjë gllënjë ujë dhe asnjë copë bukë! Po kështu, urdhëronte që kushdo që ta kapte heretikun, duhet t’ia dorëzonte menjëherë gjykatësit të atyshëm, me qëllim që t’i jepte ndëshkimin e merituar si disident. Dekreti ofronte shpërblime për kapjen e Martinit dhe kërcënonte me ndëshkim këdo që e mbështeste.

Përfaqësuesit papnorë ishin shumë të kënaqur nga ky dekret dhe, për njëfarë kohe Roma pati marrëdhënie miqësore me perandorin e ri; ai u pati

shërbyer më së miri qëllimeve të saj.

Kur shoku i Martinit, poeti dhe patrioti gjerman Hutën, pa dekretin, deklaroi: “Më vjen turp nga atdheu im.”

Martini u shpall i jashtëligjshëm nga shteti; ishte dënuar nga papa që të përjashtohet nga shoqëria dhe t'i nënshtrohet formës më të dhunshme të vdekjes, nëse e kapnin. Mirëpo populli gjerman, në përgjithësi, e donte dhe e mbështeste reformatoren e madh.

Shërbëtori i Perëndisë vërtet po sulmohej, por kishte ende punë për të kryer dhe, derisa ta përfundonte, askush nuk mund ta prekte pa lejen e qartë të Perëndisë.

Luteri rrëmbehet

Rrugës për në shtëpi, Martini u shkoi për vizitë prindërve të tij të moshuar, të cilët ishin transferuar në qytezën e vogël të Morës. Me anëtarët e familjes dhe me njerëzit e atij vendi kaloi një kohë të mrekullueshme.

Pastaj, bashkë me vëllanë e vet, Jakobin, dhe me karrocierin, u nis përmes pyjeve të dendura të Tyringënit¹¹⁷. Papritmas, pesë kalorës të maskuar iu sulën pajtonit dhe e hodhën karrocierin përtokë (Jakobi ia mbathi dhe u zhduk në pyll), e rrëmbyen Martinin, ia lidhën sytë, e vunë mbi kalë dhe u larguan me shpejtësi nga ai vend. Pasi ecën nëpër pyll për njëfarë kohe, që të humbisnin gjurmët nga ndokush që mund t'i ndiqte, Martini dhe rrëmbyesit e tij u zhdukën në pyllin e errët. Kur u mor vesh se ç'kishte ndodhur, u përhap lajmi: “Luteri ka rënë në duart e armiqve.”

Pa rënë mesnata, grupi i kalorësve mbërriti në rrëzë të një mali të lartë, majë të cilit ndodhej një kështjellë e fortifikuar mirë. Ky ishte Vartburgu. Martinin e bënë të ngjiste shkallët e kështjellës dhe pastaj një shkallare të vogël. E futën në një qeli nga dritarja e së cilës shiheshin pyjet e qeta dhe luginat e punuara. Ia hoqën shpejt e shpejt petkun e murgut dhe pas pak po qëndronte në qelinë e vet i veshur me rroba kalorësi. I thanë se duhej të rriste flokët dhe mjekrën dhe se në të ardhmen do të njihej si Kalorësi Giorg. Martini vështroi rreth e rrotull. Ishte në vend të sigurt, por i vetmuar, në një vend që do ta quante shtëpi për dhjetë muaj.

Rrëmbimin e kishte planifikuar miku i Martinit, Elektori Frederik, i cili donte ta mbronte nga çdo forcë që mund të ngrihej kundër tij. Kishte vendosur se lëvizja më e mençur do të ishte që Martini të zhdukej nga faqja e dheut për njëfarë kohe, sa të qetësoheshin ujërat. Meqë mënyrën dhe

vendin e planit Frederiku ua kishte lënë në dorë atyre që do ta zbatonin, mund të thoshte sinqerisht se nuk dinte asgjë se ku ndodhej Martini.

Reagimet ndaj lajmit

Roma u gëzua kur mësoi për zhdukjen e Martinit dhe, ndonëse Aleandri besonte se kishte triumfuar, shprehte haptazi dyshimet e veta se në zhdukjen e murgut heretik mund të kishte patur dorë Frederiku.

Zërat për ngjarjet që patën ndodhur u përhapën shpejt. Disa mendonin se Martinin e kishin çuar në Francë, ku tani jetonte i sigurt. Të tjerët mendonin se e kishin vrarë dhe ia kishin hedhur trupin aty ku s'mund t'ia gjenin kurrë. Mirëpo pyetja në gojën e çdo njeriu ishte: “Ku është Luteri?”

U morën në pyetje shumë udhëtarë dhe u kryen hetime për gjetjen e Martinit, por dukej sikur ishte zhdukur nga faqja e dheut. Miqtë e tij betoheshin se, në një mënyrë ose një tjetër, do të merrnin hak për vdekjen e tij; një valë paniku përshkoi shtetet e Gjermanisë, për shkak se po diskutohej hapur mundësia e luftës civile.

Në Vitenberg, Melanktoni zemërthyer mori në dorë pendën dhe filloi të shkruante për përparimin e punës së Reformacionit.

Pastaj i erdhën lajme që ia entuziazmuan zemrën Filipit dhe e gëzuan pa masë: “Ati ynë i dashur jeton! Merr zemër dhe qëndro i patundur.”

Luteri në izolim

Ndërkaq, në Vartburg, Martini filloi të binte në gjendjen e kahershme të melankolisë. Më vonë u sëmur, sepse ushqimi ishte tepër i pasur për shijet e tij. Kishte qenë murg për shumë vjet dhe pati jetuar me ushqimin e keq të kuvendit. Nga izolimi e humbi qetësinë, mezi e zinte gjumi dhe filloi të ndihej i padobishëm për Perëndinë dhe për punën e reformacionit shpirtëror.

Gjatë kësaj kohe, Martini pati përballje shumë reale me Satanin. Në një rast, teksa po merrej me përkthimin e Biblës, iu duk se pa Satanin që, si luan, po sillej vërdallë dhomës. Martini rroku kutinë e bojës dhe ia hodhi vegimit që po shihte. Vegimi u zhduk dhe kutia e bojës u bë copë e çikë, kur u përplas te muri i qelisë. Shekuj më vonë, njerëzit pretendonin se mund të tregonin njollën e bojës që dukej ende qartë në murin e qelisë.

Në një rast tjetër, Martini tha se pa Satanin në formën e një qeni të zi që rrinte shtrirë mbi shtratin e tij. E mbërtheu dhe e flaku nga dritarja e hapur.

Ajo që mbajti në duar nuk bëri zë, por ishte i bindur se kishte qenë shfaqje e Satanit.

Martini e pati të vështirë t'i përshtatej jetës së qetë të kështjellës, kështu që mori pendën dhe nisi të shkruante; nuk pranonte t'ia mbyllte njeri gojën.

Më 14 maj, i shkroi një shoku: “Jam këtu gjithë ditën, i plogësht dhe i kënaqur. Po lexoj Biblën në hebraisht dhe greqisht; do ta vazhdoj përkthimin e Psalmeve dhe do të mbledh një vëllim predikimesh, sapo të kem marrë atë që dua nga Vitenbergu. Po shkruaj pa ndalim.”

Ai vazhdoi punën për shpjegimin e Psalmeve, shkroi shumë pamflete, një shkrim të gjatë kundër “antikrishtit”, si dhe shumë letra drejtuar kardinalit Albreht, peshkopit të Maincit, i cili kishte lejuar shitjen e ndjesave. Shkroi dhe një artikull (Madhështia e Virgjëreshës së Shenjtë), ku lavdëronte nënën e Krishtit dhe e shpallte të pamëkat dhe të panjollosur në lidhje me ngjizjen e Krishtit. Kjo tregonte se ai u qëndronte ende besnik disa mësimëve bazë të Romës. Vijuan një nga një pamfletet ku sulmonte meshën, zotimet murgërore, mosmartesën e klerit dhe çështje të tjera që e shqetësonin së tepërmi.

Bëri thirrje që t'u jepej fund zotimeve murgërore dhe jetës murgërore, duke thënë: “Duhet t'i përmbysim plotësisht këto manastire, si banesa të djallit.... Që manastiret të bëhen të dobishme, duhen kthyer në shkolla, ku fëmijët të edukohen deri sa të rriten; ndërsa tani, ato janë shtëpi ku të rriturit bëhen fëmijë dhe të tillë mbeten përgjithmonë.”

Përkthimi i Biblës

Puna më madhështore e Martinit gjatë kohës në Vartburg ishte përkthimi i Dhiatës së Re nga greqishtja në gjermanisht. Në vitet e mëparshme ishin bërë përpjekje për kryerjen e kësaj detyre, por të gjitha patën dështuar. Cilësia e shtypjes së librit ishte e dobët, gjuha e ngurtë dhe librat tepër të shtrenjtë që t'i blinin fshatarët, të cilët paguheshin shumë pak. Ai u shkroi miqve të vet për këtë temë të rëndësishme: “Ah, sikur ky libër i vetëm të ishte në çdo gjuhë, në çdo dorë, në sytë, veshët dhe zemrat e të gjithë njerëzve.... Shkrimi padyshim është dielli prej të cilit e marrin dritën gjithë mësuesit.”

Dhe kështu, në paqen dhe qetësinë e Vartburgut, larg nga rutina e përditshme e detyrave që i kishin marrë kohën dhe energjinë në Vitenberg, Martini i hyri kësaj pune monumentale. Përkthimin e përfundoi përpara se

të kthehej në Vitenberg, ku, pas njëfarë redaktimi nga Filip Melanktoni, e botoi në shtator 1522.

Kur puna e përkthimit kaloi te Dhiata e Vjetër, Martini krijoi një komitet, që ta ndihmonte. Komiteti vazhdoi të mblidhej edhe pas botimit, një natë në javë, për të diskutuar për probleme përkthimi dhe për kuptimet e fjalëve në gjuhët origjinale biblike. Kur e përfundoi, Martinin iu dha detyra që ta përkthente në gjuhën gjermane, gjuha e popullit. Përkthimi i Shkrimeve përcaktoi standardin e gjuhës gjermane për shekuj me radhë. Për këtë vepër thuhet se Luteri e pa njeriun e zakonshëm në “gojë” dhe shkroi në një gjuhë që mund ta kuptonin të gjithë.

Kalorësi misterioz

Izolimin e pati të vështirë dhe dalëngadalë filloi të bënte shëtitje jashtë kështjellës, çdo herë i shoqëruar nga të paktën një ushtar. Në një rast, në dhjetor 1521, u shqetësua kaq shumë nga zërat që qarkullonin për ngjarjet në Vitenberg, sa që shkoi për vizitë i maskuar. Por, kur pa se gjithçka ishte pak a shumë mirë, dhe se Reformacioni po përparonte siç duhej, u kthye në kështjellën e Vartburgut.

Më vonë, kur i erdhën lajme për disa ngjarje shqetësuese që po ndodhnin në Vitenberg, vendosi se duhej të kthehej njëherë e mirë. Kështu, më 3 mars 1522, la sigurinë e kështjellës së Vartburgut dhe u nis për në shtëpi.

Kur iu afrua qytetit të Jenës, shpërtheu një furtunë e fortë dhe u detyrua të gjente strehë në një han, të “Derri i Zi”, sapo del nga muret e qytetit. Kur u ul duke gjerbur krikon me birrë, me njërën dorë të shpata dhe me një libër të hapur përpara, dy djem hynë vërtik nga dera e hanit. Ishin lagur deri në palcë dhe ndiheshin në siklet që të uleshin me këtë kalorës të veshur mirë.

Kur Martini dalloj nga theksi se ishin zviceranë, u tha djemve (Johanes Kesleri¹¹⁸ nga Shën Gali dhe shoqëruesit të tij) se në Vitenberg do të gjenin dr. Shurfën, një bashkëpatriot të tyre. Mirëpo djemtë e pyetën nëse dinte se ku mund ta gjenin Martinin Luterin.

“Jam i sigurt,” - ua ktheu kalorësi, - “se nuk është në Vitenberg; por do të shkojë aty së shpejti.” Në bisedën që patën, i nxiti djemtë të mësonin greqishten dhe hebraishten, që ta kuptonin më mirë Shkrimin.

Pastaj Johanes Kesleri i tregoi kalorësit përse e kishin marrë atë udhëtim: “Nëse Perëndia na kursen jetën, nuk do të kthehemi në vendin tonë pa parë dhe dëgjuar doktorin Luterin; sepse për hir të tij e kemi marrë gjithë këtë

udhëtim të gjatë. E dimë se ai dëshiron të anulojë priftërinë dhe meshën; dhe meqë prindërit tanë vendosën, kur ishim të vegjël, që të na bënë priftërinj, duam të dimë qartazi mbi ç'baza e argumenton Luteri mendimin e vet."

Pasi i pyeti nëse kishin dëgjuar për Erazmin, u tha: "Miq të dashur, çfarë mendojnë për Luterin në Zvicër?"

Kesleri iu përgjigj: "Zotëri, mendimet për të janë të kundërta, si kudo tjetër. Disa e ngrenë në qiell, ndërsa disa e dënojnë si heretik të neveritshëm!"

Martini ia ktheu: "Hëm! Priftërinjtë, pa dyshim."

Atëherë djemtë vunë re se kalorësi kishte në dorë Librin e Psalmeve hebraisht. Kur njëri prej tyre i tha: "Do të jepja me gjithë qejf njërin nga gishtat e dorës për ta mësuar atë gjuhë," - Martini iu përgjigj: "Do të të plotësohet dëshira; mjafton që të bësh përpjekjen e mjaftueshme për ta nxënë."

Në atë çast i zoti i hanit i mori mënjane djemtë dhe i pyeti nëse donin të shihnin Martin Luterin. Kur iu përgjigjën "po", u tha se me Martinin po flisnin. Dy djemtë s'u besonin dot veshëve dhe mendonin se i zoti i hanit po tallej me ta ose se mund ta kishin keqkuptuar. Kur dy tregtarë mbërritën me një libër të palidhur, Martini i pyeti: "Ç'libër është ai?"

"Një komentari për disa ungjij dhe letra të apostujve nga doktor Luteri," - gjegjën ata.

Martini u tha se së shpejti do të merrte dhe vetë një kopje të atij libri. Teksa flisnin, i zoti i bujtinës i lajmëroi se dreka ishte gati, por dy djemtë i thanë që t'u shërbente diku tjetër, sepse nuk ua mbante xhepi të hanin me dy tregtarët e pasur dhe me kalorësin, që mendonin se ishte Ulrihu i Hutënit. Kur Martini vuri re sikletin e tyre, e kuptoi ku ishte problemi dhe tha se do t'ua paguante ai drekën.

Teksa hanin, njëri nga tregtarët tha: "Luteri duhet të jetë ose engjëll nga qielli, ose djall nga ferri. Do të isha gati të jepja dhjetë monedha floriri që ta takoja dhe t'i rrëfeja mëkatet."

Më vonë, pas drekës, Martini piu nga dy gota me djemtë dhe, teksa po bëheshin gati të niseshin për në Vitenberg, u tha: "Kur të mbërrini në Vitenberg, jepini dr. Shurfit të falat e mia."

"Më gjithë qejf," - iu përgjigjën ata, - "por çfarë emri t'i japim?"

"Thuajini vetëm kaq:" - u tha Martini, - "Ai që po vjen, të përshëndet."

Pastaj doli nga hani dhe pak më vonë u nis për të përfunduar udhëtimin.

Rikthimi në Vitenberg

Kur mbërriti në Bornë¹¹⁹, një fshat pranë Lajpcigut, i shkroi Elektorit Frederik, ku i bënte të ditur se më në fund po hynte në territorin e tij dhe e falënderonte për dashamirësinë që kishte treguar ndaj tij; theksonte se nuk do të bënte asgjë për të dëmtuar pozitën dhe autoritetin e Elektorit.

Më 7 mars 1522, Martini hyri në Vitenberg mes lavdërimeve dhe gëzimit të madh të banorëve.

Tani Martini përballej me vështirësi të mëdha që duhej t'i zgjidhte. Gjatë mungesës së tij, Gabriel Cvillingu¹²⁰ bashkë me Filip Melanktonin kishte vazhduar punën e Reformacionit që pati nisur Martini. Mesha si flijim ishte ndaluar dhe në vend të saj kremtohej sakramenti, ku përdorej buka dhe vera¹²¹; priftërinjtë, murgjit dhe murgeshat po martoheshin; kishin treguar se purgatori s'ekzistonte dhe kjo ua kishte hequr njerëzve tmerrin nga vdekja; adhurimi dhe lutja e shenjtoreve dhe e Marisë ishin flakur tej, ikonat ishin hequr dhe në shumë raste ishin shkatërruar. Miku i Martinit, Karlshtadi, ishte bërë ekstremist në disa pikëpamje dhe po mundohej të sillte shumë ndryshime që Martini i konsideronte tepër të nxituara për dobinë e Gjermanisë. Ndonëse binte përgjithësisht dakord me mësimet e Karlshtadit, nuk donte të përballej me revolucion dhe gjakderdhje.

“Profetët” nga Cvikau

Një problem më i madh ishte prania e disa profetëve nga Cvikau. Atyre u printe Nikolaus Shtorku¹²², një endës, i cili thoshte se kishte patur një vegim, ku engjëlli Gabriel i kishte shpallur se do të ulej në fronin e tij. Këta “anabaptistë” mohonin një pjesë të mirë të mësimave protestante; madje thoshin se pagëzimi i fëmijëve ishte shpikje e Satanit. Kështu ata kërkonin që të gjithë të ripagëzoheshin. Shtorku i anashkalonte mësimet e Biblës, pasi pretendonte se ishte nën udhëheqjen e Frymës së Shenjtë. Kështu imaginata njerëzore i kishte zënë vendin Fjalës së Perëndisë, si autoritet për gjithë vendimet që duhen marrë.

Martini nuk donte të shkaktonte asnjë trazirë të madhe civile në Vitenberg, kështu që nisi një seri predikimesh për të vërtetat e mëdha që pati mësuar më herët. Foli për veprën e hirshme shpëtuese të Perëndisë në Krishtin, si dhe për nevojën për pendesë dhe jetesë të perëndishme. Pastaj predikoi për

autoritetin e Shkrimit, pa i përmendur asnjëherë profetët heretikë nga Cvikau.

Pas një takimi të shkurtër me dishepujt e Shtorkut, këta të fundit mblodhën plaçkat dhe ikën nga Vitenbergu. Martini u kërkoi që t'ia provonin të vërtetën e mësimit të tyre, duke kryer një mrekulli. Atëherë një nga heretikët shpalli se Martini po fillonte t'u besonte mësimeve të tyre. Sigurisht, Martini u tha se doktrinën e vet e merrte nga Bibla, por në Fjalën e Perëndisë s'gjente asgjë nga mësimet e tyre. I vështroi ata burra dhe u tha: "Perëndia të ndëshkoftë, Satan!"

Atëherë profetët heretikë bërtitën: "Fryma, Fryma!" Kurse Martini ua ktheu: "Satan, ta godas frymën m'u në feçkën prej derri!" Shpejt dishepujt e Shtorkut u larguan nga Vitenbergu. Fitoi vetëpërmbytja.

Martini do të mirëpriste dhe dy vizitorë të tjerë, pak pasi u kthye: dy djem zviceranë. Ndërsa po fliste me miqtë e ngushtë, përfshi Shurfin dhe Melanktonin, dy djemtë i sollën në dhomë. Aty djelmoshat u mahnitën disi, kur e gjetën veten në prani të të madhit Martin Luter; sidomos kur kuptuan se ai kishte qenë kalorësi i hanit "Derri i Zi". Martini tregoi me gisht Filip Melanktonin dhe u tha: "Ky është Filip Melanktoni, të cilin ua përmenda." Ata qëndruan gjithë ditën me Martinin dhe kolegët e tij, duke përthithur gjithçka që thuhej aty. Më vonë Kesleri shkroi një rrëfim për atë kohë të mrekullueshme.

Puna vazhdon

Tani vepra e Reformacionit mund të vazhdonte përpara në gjithë lavdinë e vet. Priftërinjtë e sapokthyer në besim predikonin të vërtetat e lavdishme dhe çliruese të Fjalës së Perëndisë, kurse Martini me të tjerët predikonin, jepnin mësime dhe shkruanin. Përkthimi i Dhiatës së Re nga Martini doli në shitje në shtator 1522 dhe shumë shpejt u shitën tre mijë kopje në dy vëllime. Bibla e plotë u përkthye në gjermanisht dhe më 1534-rën, u vu në dispozicion të të gjithë lexuesve. Në 40 vitet e mëvonshme (1534 deri më 1574), u shitën mbi njëqind mijë Bibla dhe për atë kohë ky ishte numër i stërmadh.

Martini kishte shumë punë për të bërë, por frerët po i merrnin në dorë edhe të tjerë. Shpejt do të martohej dhe do të bëhej "plaku" i Reformacionit, të cilin e pati nisur në qelinë e vogël të një manastiri.

16. Trazirat civile

Më vonë do të ndodhnin disa ngjarje që do ta bënin Martinin të papëlqyeshëm për shumë gjermanë. Gjatë jetës së tij, fshatarët kishin pësuar padrejtësi të mëdha, për shkak të pronarëve të pasur të tokave dhe sundimtarëve. Ata ishin pothuajse si skllavër; punonin shtatë ditë në javë dhe nuk e shijonin frytin e mundimit të tyre. Ishin të rënduar shumë me taksa të tepruara dhe vuanin për shkak të klasave të mesme dhe të larta.

Kur Martini nisi të fliste për liritë e mëdha që gjendeshin në ungjill, duke i bërë thirrje Romës që të flakte tej prangat e papatit, shumë grupe fshatarësh menduan se kjo lloj lirie vlente edhe për situatën e tyre të shtypur.

U formuan aleanca fshatarësie që kërkonin kushte më të mira pune dhe jetese. Lidhja e fshatarëve të Shvebit¹²³ nxori një listë me dymbëdhjetë kërkesa që shpresonin se sundimtarët do t'ua plotësonin.

Së pari, ata donin të drejtën të zgjidhnin një pastor sipas dëshirës së tyre. Më tej, kërkonin liri për të mos paguar të dhjetën për gjedhët (sepse paguanin tashmë të dhjetën e të korrave); t'i jepej fund bujkrobërisë, pasi të gjithë njerëzit janë të lirë në Krishtin; kërkonin lirinë për peshkim dhe gjueti për t'u ushqyer; të drejtën e familjeve për të përdorur drurin e pyjeve të përbashkëta; fundin e shërbimit të detyruar ushtarak; pagesën për punën e kryer përtej asaj që kërkonte kontrata; uljen e çmimit të qirasë; kthimin e tokave që ishin marrë nga komunat dhe të drejtën e vejushave dhe jetimëve për të marrë trashëgimitë, pa paguar taksat e larta.

Fshatarët ranë dakord që pretendimet e tyre t'i nënshtroheshin shqyrtimit të Biblës dhe u shprehën të gatshëm të hiqnin dorë nga të gjitha pretendimet që s'ishin në përputhje me mësimet e Fjalës së Perëndisë.

Kur këto pretendime u hodhën poshtë menjëherë nga sundimtarët, shpërthyen trazirat. Grupe të çorganizuara fshatarësh të paarmatosur u shtypën dhunshëm nga forcat e plotfuqishme të zotërinjve të tyre.

Qëndrimi i Luterit ndaj trazirave civile

Për shkak të luftës së Martinin kundër pushtetit të Romës, ata prisnin mbështetjen e tij për reformat që kërkonin, madje dhe përmes përdorimit të forcës, nëse dështonin përpjekjet paqësore. Mirëpo kjo nuk ndodhi, pasi Martini ishte kundër kryengritjeve të armatosura ndaj pushteteve civile. Ai pranonte se shumë nga kërkesat e fshatarëve ishin shumë të drejta dhe i nxiti

sundimtarët që të bënin lëshime, por i paralajmëroi fshatarët për kërcënimin që u jepte Fjala e Perëndisë, nëse do të bënin kryengritje: “... gjithë ata që marrin në dorë shpatën, nga shpata do të vdesin” (Romakëve 13:1). Po kështu, i nxiti të gjithë që të merrnin parasysh urdhërimin e Perëndisë në Romakëve 13:1-7, sipas të cilit gjithë qytetarëve u bëhet thirrje të jenë të bindur ndaj autoriteteve civile që janë caktuar nga Perëndia. Kjo duhet t’u jetë dukur e çuditshme fshatarëve, pasi vetë Martini refuzonte t’u bindej autoriteteve “të caktuara nga Perëndia”, kur situata e kërkonte diçka të tillë.

Pastaj Martini mori në dorë pendën për të shkruar kundër atyre fshatarëve që përdornin forcën, për të arritur synimet e tyre të arsyeshme. Më 1525-n doli artikulli i tij i shkurtër, Kundër hordhive plaçkitëse dhe vrasëse të fshatarësisë; aty Martini thoshte se ata kishin hequr dorë nga çdo drejtë, kur përdorën dhunë. Foli ashpër kundër anarkisë së dhunshme dhe tha: “Kryengritja bën që vendi të mbushet me vrasje dhe gjakderdhje, i kthen njerëzit në vejusha dhe jetimë dhe përmbys gjithçka si fatkeqësi e rëndë. Prandaj, kushdo që ka mundësi të godasë, të vrasë dhe të therë (hapur apo fshehur), duhet të mos harrojë se nuk ka asgjë më të helmatisur, të dëmshme dhe djallëzore sesa kryengritësi. Ai duhet vrarë njësoj si qeni i tërbuar; nëse nuk e godet, do të të godasë ai; madje gjithë vendin bashkë me ty.”

Vijoi duke shkruar se njeriu që vdiste duke luftuar në krahun e sundimtarit do të vdiste si martir në sytë e Perëndisë. Për fshatarin që vdiste duke luftuar për ato që besonte se ishin të vërteta dhe të drejta, Martini shkroi: “Nga ana tjetër, ai që vdes në anën e fshatarëve do të digjet përjetësisht në ferr, sepse ngre shpatën kundër Fjalës së Perëndisë dhe nuk i bindet atij, por është në aleancë me djallin.... Thereni, goditeni, vriteni, kushdo prej jush që ka mundësi. Nëse vdisni në këtë përpjekje, shumë mirë! Vdekje më të bekuar se kjo nuk ka, sepse do të vdisni duke iu bindur Fjalës së Perëndisë dhe urdhërimit të Romakëve 13....”

Në trazirat që vijuan, dhjetëra mijëra fshatarë të armatosur si mos më keq, u therën dhe lanë pas vejusha dhe jetimë pa ndihmë dhe përkujdesje. Revolucioni dështoi; si rezultat, kushtet e jetesës për shumicën dërrmuese të fshatarëve u përkeqësuan më tepër se kurrë.

Disa sundimtarë e kuptonin se fshatarët kishin të drejtë, por prapëseprapë i shtypën për t’i vënë nën zgjedhë. Elektori Frederik, mikun e Martinut, vdiq (5 maj 1525) gjatë kryengritjeve të fshatarësisë dhe, në shtratin e vdekjes, i thirri shërbëtorët dhe u rrëfeu: “Bij të dashur, nëse i kam rënë më qafë dikujt

nga ju, ju përgjërohem të më falni për hir të Perëndisë; ne, princat, bëjmë shumë ligësi ndaj popullit të varfër.”

Mbështetja e Martinit për sundimtarët dhe shkrimet e tij që nxisnin për reprezalje të tmerrshme kundër fshatarëve, bënë që ta humbiste së tepërmi mbështetjen e klasës punëtore gjermane.

E vërteta e ungjillit vazhdon të përhapet

Ndërsa trazirat civile po zienin, Martini vazhdonte të shkruante, të predikonte dhe të jepte mësim para një numri gjithmonë e më të madh studentësh, të cilët binin në dashuri me Fjalën e Perëndisë dhe me të vërtetat që mësonte ai. Reformacioni po përhapej me shpejtësi në gjithë Evropën dhe tani këtë të vërtetë po e mësonin dhe teologë më të kulturuar dhe më të ditur. Filip Melanktoni mori në dorë pendën për ta mbështetur Martinin (ishin miq të ngushtë) dhe, si mblodhi të gjitha shkrimet protestante që mundi të gjente, botoi librin: Vende të përbashkëta, i cili i vendoste shkrimet e tyre në rend sistematik.

Shtypshkronjat punonin me kapacitet të plotë dhe njerëzit me aftësi përkthyes bënë të mundur që shkrimet e Martinit dhe të tjerëve të qarkullonin anekënd Evropës. Shitësit udhëtonin lart e poshtë, duke shitur librat që dilnin nga shtypshkronjat, dhe shumë priftërinj të kthyer në besim tani qëndronin në foltoret e tyre, me Bibël në dorë, duke predikuar të vërtetat madhështore të hirit shpëtues të Perëndisë.

Edhe studentët e Universitetit të Vitenbergut shkonin sa në një vend në tjetrin, duke predikuar dhe mësuar Fjalën e Perëndisë. Në komunën e Goslarit¹²⁴, një student luteran nga Vitenbergu nisi të predikonte në një fushë të mbjellë me pemë qitroje. Turma të tëra shkonin ta dëgjonin kur predikonte dhe, kur mbështetësit e tij u shtuan, u bënë të njohur me emrin “Vëllezërit e Qitros”.

Martini s’dilte nga Vitenbergu, pasi dekreti i perandorit e bënte shumë të mundshme kapjen dhe dorëzimin e tij tek autoritetet e Romës, nëse dilte nga Saksonia. Shpallja e perandorit kundër tij ishte ende në fuqi; po kështu dhe deklarata e papës se ai ishte heretik dhe si i tillë duhej dënuar me vdekje, nëse kapej.

Dieta e parë në Nyremberg

Në dhjetor 1521, papa Leoni X vdiq dhe fronin papnor e zuri një papë tjetër, Adriani VI¹²⁵. Pastaj u mor vendimi se ishte e nevojshme një dietë tjetër për të përballuar kërcënimin e përparimit të turqve, si dhe problemin e shkaktuar nga Martin Luteri dhe nga numri gjithmonë e më i madh i luteranëve. Kjo dietë u mbledh në Nyremberg, më 23 mars 1522; e kryesoi Ferdinandi¹²⁶, vëllai i perandorit Karl.

Kur Kieregati¹²⁷, përfaqësuesi i papës, hyri në Nyremberg, zbuloi se foltoret e qytetit i kishin zënë njerëz me të njëjtat bindje dhe karakter si Luteri; ata u predikonin të vërtetën e Fjalës së Perëndisë bashkësive të mëdha të banorëve.

Kur filloi të ankohej për këtë, i kujtuan se Nyrembergu ishte qytet i lirë; shumica e autoriteteve ishin luteranë dhe ai s'kishte asnjë autoritet në atë qytet!

Në vend që të lexonte fjalimin e papës, ku kërkonte shkatërrimin e luteranëve, përfaqësuesit papnor i dorëzuan një listë me ankesa kundër Romës; e paralajmëruan se princat do të merrnin vetë masa, nëse këto kërkesa nuk përmbusheshin menjëherë. Nunci papnor u largua nga Nyrembergu për t'i raportuar papës Adrian, i cili u tërbua nga këto fjalë, sidomos kur mësoi se princat gjermanë nuk pranonin ta zbatonin Dekretin e Vormsit kundër Martinit. Ai kërkoi luftë kundër të gjithë princave që kundërshtonin Romën dhe, kur u rimbledh dieta, parashtroi kërkesën që Luteri të vritej.

“Ne,” - tha Kieregati, - “duhet ta këpusim nga trupi këtë gjymtyrë të gangrenizuar. Etërit tuaj vranë Jan Husin dhe Jeronimin e Pragës¹²⁸..., por ata po jetojnë sërish në Luterin. Ndiqni shembullin e lavdishëm të paraardhësve tuaj dhe, me ndihmën e Perëndisë dhe Shën Pjetrit, korrni një fitore madhështore kundër dragoit të ferrit, Satanit.”

Duka Giorg tha: “Tani që e dimë se ku mund ta kapim, le të zbatojmë vendimin e Vormsit.”

Kur i dëgjoi këto kërcënime, Frederiku i Saksonisë vuri dorën në shpatë, pasi do të bënte gjithçka që mundej për ta mbrojtur Martinin dhe Reformacionin..., si dhe rëndësinë gjithmonë e më të madhe të universitetit të tij të dashur.

Frika e luftës civile rrinte pezull mbi gjithë të pranishmit në dietë; si rezultat, tubimi i tyre nuk pranoi ta ripohonte Dekretin e Vormsit kundër Martinit dhe luteranëve.

Dieta e dytë e Nyrembergut

U caktua një dietë tjetër për në janar 1524; do të mbledhej sërish në qytetin e Nyrembergut. Ndërkaq, papa Adrian ishte zëvendësuar nga Klementi VII¹²⁹ që përfaqësohej në dietën e re të Nyrembergut nga kardinali Kampexho¹³⁰.

Kur ai i kujtoi asamblesë se duhej të shkatërronin krerët e Reformacionit, sundimtarët gjermanë e pyetën se çfarë ishte bërë me listën e ankesave që populli gjerman ia kishte paraqitur papës.

Kardinali Kampexho tha se papa nuk kishte marrë asnjë komunikatë zyrtare për këtë çështje, por e kishte parë listën. Raportoi se papa nuk e besonte kurrë se një listë e tillë ankesash mund të kishte ardhur nga anëtarët e shquar dhe besnikë të kësaj diete.

Kur anëtarët e dietës dëgjuan këto fjalë, u zemëruan. Tani nuk do ta pranonin kurrë kërkesën papnore që t'ia dorëzonin Martinin Romës. U miratua mocioni se shtetet duhej t'i bindeshin Dekretit të Vormsit në lidhje me Martin Luterin “aq sa të mundeshin”.

Pastaj u mor vendimi që të thirrej një asamble laike në Shpajër¹³¹ për trajtimin e disa çështjeve shpirtërore. Kur papa Klementi dëgjoi për këtë vendim, u tërbua. Papati pretendonte se ishte i vetmi që kishte të drejtën hyjnore për të thirrur asamble për vendimmarrje në çështje shpirtërore, dhe tani këtë të drejtë po ia minonin shtetet gjermane. Si rrjedhojë, papati nisi një sërë takimesh për t'u përgatitur për takimin e dietës së radhës.

Takimi i parë u bë në Regensburg¹³², ku u formua një konfederatë¹³³ kundër të gjitha shteteve që mbështesnin Reformacionin luteran. Tani Gjermania ishte vërtet e përçarë. Por edhe gjithë Evropa po zgjidhte anën e vet në betejën kundër papatit. Sundimtarët donin që askush të mos ua shkelte të drejtat – për shumë prej tyre, këtu përfshihej dhe papati!

Atëherë perandori ndërhyri dhe deklaroi se vetëm papa mund të thërriste një asamble për trajtimin e çështjeve shpirtërore.

Një udhëheqës i ri për Saksoninë

Ndërkohë, në Saksoni, Frederiku i Urtë vdiq, më 5 maj 1524; dhe u pasua nga Johan i Patunduri, i cili e donte Fjalën e Perëndisë dhe u dha mbështetje të plotë reformatoreve. Motoja e tij ishte “Fjala e Perëndisë qëndron përjetë.”

Për këtë sundimtar, Martini shkroi: “Atij i shërbenin gjashtë pazhë¹³⁴. I lexonin Biblën gjashtë orë përditë. Shpesh e zinte gjumi, por, kur zgjohej, në gojë kishte gjithmonë ndonjë pjesë biblike. Gjatë predikimeve mbante shënime në një fletore. Qeverisja e Kishës dhe çështjet laike administroheshin siç duhej. Perandori kishte për të vetëm fjalë të mira. Kishte trup të fortë (kalit mund t’i hipte vetëm me ndihmën e një makinerie), dhe pati vdekje të vështirë. Gjëmonte si luan.”

Ai ishte princi i parë që firmosi protestën në Dietën e Shpajetit në vitin 1529 dhe Rrëfimin e Augsburgut në vitin 1530.

17. Martesa dhe jeta familjare

Pak pas martesës me Katerina fon Borën¹³⁵, më 13 qershor 1525, Martini i shkroi një miku: “Papritur, ndërsa isha zënë me mendime të tjera, Zoti më krodhi në martesë.”

Për vite të tëra Martini i kishte kthyer shpinën çdo mendimi martese. Nuk ishte kundër martesës, por kishte shqetësime të mëdha për të ardhmen e tij. Madje, deri më 30 nëntor 1524, i shkruante mikut të vet Spalatinit: “Në bazë të asaj që mendoj deri tani, nuk do marr kurrë grua. Jo se jam i pandjeshëm ndaj mishit apo seksit (s’jam as prej druri, as prej guri); por martesa s’do të ishte gjë e mençur, sepse unë pres përditë të më vrasin si heretik.” Por beqaria e tij nuk do të zgjaste dhe për shumë kohë.

Tani që ndarja me Romën ishte kryer përfundimisht, shumë priftërinj dhe murgjer po martoheshin dhe Martini e nxiste këtë veprim. Ai vazhdoi të jetonte në manastirin e vjetër augustinian në Vitenberg, që tani ishte pothuajse bosh, pasi fondet që nevojiteshin për mirëmbajtjen e vendit kishin shteruar. Kushtet e jetesës së Martinit ishin primitive, por kishte aq sa i nevojitej. Lexojmë që shtrati i ishte kalbur nga djersitja. Hante ushqime të thjeshta dhe vazhdimisht punonte, shkruante, përgatiste predikime dhe fliste me turmën e vazhdueshme të vizitorëve që i shkonin për vizitë dhe inkurajim. Martini ishte i bindur se martesa ishte gjendja normale e jetesës dhe, pa dyshim, duhet të ketë filluar ta ndiente nevojën për një bashkëshorte që ta ndihmonte me punën e vet.

Nuse për Martinin

Në prill 1523, një grup me dymbëdhjetë murgesha u arratis nga kuvendi i Nimpçit¹³⁶ dhe shkuan në Vitenberg. Tri prej tyre u kthyen në shtëpinë e prindërve, ndërsa nëntë të tjera i mori nën përgjegjësi Martini. Ia doli t’i martonte të gjitha, përveç njërës – njëzetegjashtëvjeçarja Katerina fon Bora, një vajzë e zgjuar, e shëndetshme, me karakter të fortë dhe me fytyrë normale, e cila kishte hyrë në kuvend në moshën nëntë ose dhjetëvjeçare dhe, pas gjashtë vitesh, kishte bërë betimin si murgeshë. Meqë shumica e vajzave gjermane martoheshin në moshën pesëmbëdhjetë ose gjashtëmbëdhjetëvjeçare, Katerinës po i kalonte mosha për shumicën e burrave që kërkonin nuse.

Filluan të qarkullonin zëra se Martini mbante murgesha në shtëpinë e vet në Vitenberg dhe manastiri filloi të quhej “haremi i Luterit”. Kur Katerina i tha se ishte gati të martohej me Martinin, ai vendosi: “E mora Katerinën për grua, përpara se të vdes, për inat të djallit.”

Dhe, kështu, më 13 qershor 1525, në prani të disa miqve, Martini dyzetedyvjeçar u martua me Katerinën e tij. Më 27 qershor u bë celebrimi publik i martesës, ku ishin të pranishëm shumë miq dhe të afërm. Ai që u gëzua më shumë për vendimin e të birit që të martohej ishte i ati i Martinit.

Katerina nuk kishte pajë, por çiftit të lumtur i dhuruan para, verë dhe një fuçi me birrën më të mirë gjermane. Madje dhe kryepeshkopi Albreht i dërgoi Katerinës si dhuratë njëzet gulden floriri. Martini dhe Katerina u vendosën në kuvendin e vjetër augustinian që përdorej për konferenca, leksione; aty kishte dhoma ku mund të jetonin dyzet studentë dhe përgjithësisht shërbente si vend ku personalitetet kryesore të Reformacionit mblidheshin për të diskutuar çështje teologjike dhe taktikat e arritjeve të synimeve të tyre.

Jeta në familjen Luteri

Kjo shtëpi u bë vend sigurie dhe lumturie për familjen e Luterit; dhe martesë i ndryshoi vërtet gjërat për Martinin. I shkroi një miku: “Përpara se të martohesha, askush s’më rregullonte shtratin për një vit të tërë. Kashta po më kalbej nga djersa. Rraskapitesha nga puna gjatë ditës dhe bija në shtrat si i vdekur.”

Një tjetër miku i shkroi për këtë ndryshim në jetë: “Zgjoresh në mëngjes dhe gjen mbi jastëk një palë gërsheta që më parë s’kishin qenë aty.”

Tani Martini kishte me kë e ndante shtratin, kishte shtrat të pastër dhe jastëk! Megjithatë, për çiftin e sapomartuar u përhapën thashetheme mizore. Thuhej, sipas një tradite, se i parëlinduri i tyre do të ishte antikrishti.

Ky thashethem i ndyrë për foshnjën që do të lindte nga martesë e një murgu me një murgeshë besohej nga shumë vetë në popull. Erazmi u tall me këtë thashethem; deklaroi se, po të ishte e vërtetë, në Gjermani duhej të qarkullonin tashmë mijëra antikrishtër.

Martini dhe Katerina mësuan ta donin njëri-tjetrin. Ai e dinte se ajo kishte të metat e saj, por gjithmonë thoshte se kishte më pak të meta se çdo grua tjetër. Po kështu thoshte se e donte aq shumë, sa që nuk do ta këmbente as me mbretërinë e Francës, as me gjithë pasuritë e venedikasve. Në letrat që i

shkruante Katerinës, Martini e quante “shtëpiakja ime shumë e dashur dhe e hirshme, e lidhur kokë e këmbë me shërbesën plot dashuri ndaj meje, Katerina, zonja Luter, zonja Doktore, Zonja e Zulsdorfit, Zonja e Tregut të Derrave, dhe gjithçka tjetër që mund të jesh.”

Kur i shkruajti një miku, tha për të shoqen: “Katerina, brinja ime e dashur, të përshëndet.... Falë Perëndisë, ajo është e butë, e bindur dhe më dëgjon për gjithçka, përtej asaj që kisha shpresuar.”

Megjithatë, ndonjëherë Katerina shfaqte shpirtin e saj kryeneç dhe në ato momente Martini e quante “zoti Katerinë”, ndërsa veten e quante “shërbëtori i saj i bindur”. Një herë, kur Katerina e kundërshtoi gjatë darkës, tha: “Po të martohesha sërish, do të gdhendja nga guri një grua të bindur.”

Katerina drejtonte punët e familjes dhe solli rregull në jetën e Martinit. Nuk ishin kurrë të pasur, por Katerina mbikëqyrte shpenzimin e parave dhe, me kalimin e kohës, ia dolën të kursenin disi. Martini e kishte të pamundur ta trajtonte me kujdes paranë, pasi ishte tepër bujar; një herë tha: “Perëndia e ndau dorën në gishta, në mënyrë që mes tyre të rrëskiste paraja.” Ai ia besoi Katerinës të ardhurat e familjes dhe e lavdëronte për mënyrën ekonomiqare të jetesës. Dikur e lavdëroi, duke thënë: “Bekimi më i madh është të kesh një grua që mund t’ia besosh punët e tua.”

Katerina ishte kopshtarë e mahnitshme dhe, kur Martini bleu një fermë të vogël, ajo mbikëqyrte rritjen e perimeve, pemishten frutore dhe prodhimin e qumështit dhe mishit. Kujdesej për gjedhët, derrat dhe shpendët që përfundonin në tenxheren e gatimit. Kultivonte kulpër të butë dhe prodhonte gjithë birrën e nevojshme për familjen dhe numrin e madh të njerëzve që u shkonte për vizitë.

Martinit i pëlqente vera, por Katerina dalëngadalë ia ktheu në birrë, pasi vera ia acaronte menjëherë stomakun. Me Katerinën në krye të shërbëtorëve dhe drejtimit të shtëpisë, Martini filloi të hante mirë dhe shpejt nisi të shtonte në peshë.

Shpesh gjente kohë që të vërente mrekullinë e krijimit të Perëndisë, kur e ndihmonte Katerinën me kopshtarinë. I pëlqente shumë larmia e ngjyrave që shihte te lulet dhe kënaqej kur u merrte erë aromave të shumta të trëndafilave dhe luleve të tjera që rriteshin në kopshtin e Katerinës. Kur binte shi, e dinte se kjo vinte nga dora e Perëndisë, që të prodhoheshin drithi dhe ushqimet: “Shirat e mbarë,” - tha dikur, - “sjellin qindra mijëra gulden, grurë, thekër, elb, tërshërë, verë, lakra, bar dhe qumësht.”

Martinit i pëlqente shumë t'i binte llautës dhe të këndonte këngë; ishte tregimtar i shkëlqyer për fëmijët e vet. I pëlqenin shumë legjendat dhe fabulat; madje u mor dhe me përkthimin e disa fabulave të Ezopit.

Kur shohim jetën familjare në shtëpinë e Martinit, nuk mund të mos vëmë re dallimin e madh mes fëmijërisë së tij të vështirë dhe jetës gazmore e të kënaqshme që ai u krijoi gruas dhe fëmijëve të vet. Ndaj familjes së vet shfaqte një natyrë të ndryshme nga qëndrimi i tij, kur luftonte betejat e Zotit në një botë që e urrente Perëndinë. Martini s'ishte mirë nga shëndeti, pasi vuante nga reumatizma, gurët në veshka, dhimbjet e kokës, marramendja, të fikët, rrufa, hemorroidet, kaspllëku, madje dhe nga kumbimi në vesh. Megjithatë, ushqimi i mirë dhe shoqëria e Katerinës e ndihmonin të ishte shumë i qeshur dhe, kështu, iu zhduk gjendja melankolike. Zhveshi veladonin murgëror dhe filloi të vishte një rrobë klerike që e kishte dhuratë nga Elektori. I ndërtuan dhe një korsi bulingu, të cilën e përdorte rregullisht për t'u shtruar fizikisht.

Njëzet e një vitet e martesës ishin të mbushura me gëzim të vërtetë martesor. Shtëpia iu bë vend sigurie dhe strehim i vërtetë nga sprovat me të cilat përballej në botën e jashtme. Në shtëpi, armiku i fortë dhe i spikatur i papatit ishte i butë si qengj.

Bisedat e tavolinës

Studentët që jetonin në manastir hanin me familjen e Luterit; kështu bënë edhe vizitorët dhe lypsarët që i trokisnin në derë. Të shumtë ishin teologët, studentët, princat, fisnikët dhe të tjerët që donin të takoheshin me reformatoren e madh; ndaj, ndonëse zakonisht vaktet i hanin në heshtje, të gjithë prisnin me padurim të dëgjonin fjalët e mençura të Martinit, pasi hanin dhe kafshatën e fundit. Të pranishmit në tryezë mbanin shënim ato që thoshte Martini; më vonë thënie të tij i botuan nën titullin "Biseda tryeze". Shpesh fjalët i kishte të çuditshme, të vrazhda dhe madje vulgare për veshët tanë, por ato pasqyrojnë epokën kur jetoi ai, si dhe prejardhjen e tij nga klasa punëtore. Studentët e nxisnin gjithmonë që të fliste për një larmi temash; kishte dhe momente kur Katerina i vinte fre gjuhës së tij, madje dhe e qortonte, duke i thënë: "Mjaft tani; kjo ishte shumë e rëndë." Në një moment Katerina u përpoq të mblidhte pagesa nga studentët që mbanin shënim gjithçka që thoshte Martini. E dinte se ata do t'i botonin dhe do të

nxirrnin fitime të majme, ndaj mendonte se i takonte njëfarë shpërblimi financiar. Mirëpo Martini u tha “Jo!” planeve të saj.

Vaktet ishin kohë për t’u qetësuar me miqtë dhe Martini ndihej gjithmonë më i lumtur pasi kishte ngrënë, pirë dhe folur me të ftuarit në tryezë.

Luteri dhe fëmijët e tij

I lindën gjashtë fëmijë, por dy vajza i vdiqën të vogla. I donte tej mase fëmijët e vet dhe gjithmonë gjente kohë për të luajtur me ta. U këndonte këngë, u tregonte histori dhe në përgjithësi u shprehte dashurinë e një babai të përkushtuar.

Dita e Martinit fillonte gjithmonë me kohën personale që më pas vijohej nga një kohë adhurimi dhe mësimdhënieje në familje. Ngrihej herët dhe kalonte të paktën tri orë me Zotin në lutje, meditim dhe studim të Biblës. Pastaj përsëriste me familjen Dhjetë Urdhërimet, Besoren e Apostujve, Lutjen e Zotit dhe këndonin së bashku një psalm. Sigurisht, kalonte gjithmonë një kohë lutjeje me familjen që e donte me gjithë shpirt.

Por ai ishte udhëheqësi i një vepre të madhe të Perëndisë: Reformacioni vazhdonte dhe Martini punonte në tryezën e studios shumë orë përditë. Në një rast u kyç në studio dhe nuk doli për tri ditë rresht. Katerina, e acaruar nga izolimi i të shoqit, i tha shërbëtorit ta hiqte derën, që të fliste me Martinin dhe të kalonte kohë me të. Kur Martini pa se dera ishte hequr, thjesht e pyeti: “Pse e bëre? S’po bëja asgjë të keqe.”

Një portret të Martinit familjar e shohim në letrën që i shkroi të birit katërvjeçar, Hansit. Martini kishte shkuar në Dietën e Augsburgut më 1530-n, një konferencë tejet e rëndësishme, por gjithsesi gjeti kohë t’i shkruante:

“Biri im i shtrenjtë, u gëzova kur më thanë se po mëson mirë dhe po lutesh shumë. Vazhdo ashtu, biri im, dhe, kur të kthehem në shtëpi, do të të sjell disa dhurata. Di një kopsht të bukur, ku shumë fëmijë me uniforma të florinjta mbledhin nën pemë mollë të kuqe flakë, dardhë, qershi dhe kumbulla. Këndojnë, kërcenë dhe janë shumë të lumtur. Kanë kuaj të vegjël të bukur me frerë floriri dhe shalë argjendi. E pyeta xhaxhi kopshtarin se cilët ishin ata fëmijë dhe m’u përgjigj: “Këta janë fëmijët që kanë qejf të luten, të mësojnë dhe të jenë të mbarë.” Unë i thashë: “O miku im i dashur, unë kam një djalë dhe e quajnë Hans Luter. A mund të vijë dhe ai në këtë kopsht dhe të hajë mollë të kuqe flakë me ata fëmijët?” Ai

m'u përgjigj: "Nëse i pëlqen të lutet, të mësojë dhe të jetë i mbarë, patjetër që dhe ai mund të vijë në këtë kopsht, bashkë me Lipusin dhe Jostin [dy shokë të Hansit], dhe, kur të vijnë të tre këtu së bashku, do t'u jap bilbila floriri, daulle dhe harqe të bukura prej argjendi." Por ishte ende shumë herët dhe fëmijët s'kishin ngrënë akoma mëngjes, kështu që s'prisja dot sa të fillonin kërcimin. I thashë atij xhaxhit: "Do të iki menjëherë dhe do t'i shkruaj birit tim të dashur, Hansit, dhe do t'i them të punojë fort, të lutet mirë dhe të jetë i mbarë, që edhe ai të vijë në këtë kopsht. Por ai ka dhe një kujdestare të shtrenjtë, Lenën; do ta sjellë dhe atë me vete." "S'ka problem fare," - më tha ai xhaxhi. - "Shko dhe shkruaji."

Kështu, biri im i shtrenjtë, studio, lutu shumë dhe thuaji edhe Lipusit me Jostin të bëjnë kështu; pastaj të tre do të mund të shkoni dhe të luani së bashku tek ai kopshti i bukur. Perëndia i shtrenjtë u kujdestë për ty. Jepi përshëndetjet e mia Lenës dhe puthe për mua.

Babai yt i dashur,
Martin Luteri."

Martini i donte shumë fëmijët e vet dhe, kur bija e tij katërmëdhjetëvjeçare, Lena (Magdalena), po vdiste, kaloi shumë kohë përbri shtratit të saj duke e ngushëlluar. Ajo i shprehu besimin në Jezu Krishtin dhe, kur po i afrohej vdekja, Martinin e gjeje aty, të përgjunjur përbri shtratit të saj, duke u lutur i përlotur për shpëtimin e saj.

Kur kuptoi se asaj po i afrohej me shpejtësi vdekja, i shkroi me dashuri Hansit që ishte në shkollë, ku i kërkonte mësuesit ta dërgonte në shtëpi. Letra e tij tregon dashurinë që kishte për fëmijët e vet:

"Hir dhe paqe, i dashuri im Mark [mësuesi]! Të përgjërohem të mos i tregosh tim biri, Hansit, ato që po të shkruaj tani. Ime bijë, Magdalena, po mbaron dhe së shpejti do të niset tek Ati i saj i vërtetë në qiell, përveçse nëse Perëndia e sheh të arsyeshme ta kursejë. Ajo ka shumë mall ta shohë të vëllanë, kështu që kam dërguar një karrocë që ta sjellë. Ata e duan fort njëri-tjetrin, kështu që, mbase, po e pa, ajo do të ripërtërihet. Po bëj të pamundurën që zemra ime si baba të mos shqyhet më pas nga trishtimi. Prandaj mos i trego gjë Hansit, por dërgoje në shtëpi menjëherë. Do të ta kthej sapo ajo të bjerë në gjumë në Zotin ose t'i rikthehet shëndeti. Mirë

mbetsh në Zotin. Thuaji Hansit që duhet të flasim për diçka vetëm për vetëm.”

Lena e Martinit shkoi në prani të Krishtit dhe në varr babai i saj vuri këtë mbishkrim:

Këtu, pushoj unë, Lena, bija e Luterit,
Në shtratin tim po fle me gjithë të bekuarit.
Në mëkat dhe shkelje u linda;
Përjetë do të kisha humbur,
Por tani jetoj dhe gjithçka është mirë –
Krishti më shpëtoi me gjakun e tij.

Martini ishte shembull perëndishmërie në familje, një shembull që duhet ta ndjekin të gjithë prindërit e krishterë. Familja e tij ishte plot dashuri dhe siguri për gjithë anëtarët. Gjente gjithmonë kohë për Katerinën e tij të shtrenjtë dhe për fëmijët e vet që i donte me shpirt.

Të shumta ishin orët që fëmijët kalonin duke luajtur rreth babait, teksa ai punonte në studio, nëpër të cilën ishin shpërndarë libra, dorëshkrime, letra dhe shumë gjëra interesante që ai i kishte mbledhur me kalimin e viteve.

Shpesh puna e largonte nga shtëpia, por ai gjithmonë mezi priste të kthehej. Një herë i shkroi një miku, pa dyshim duke patur ndërmend jetën e vet familjare: “Gruaja duhet ta bëjë burrin të gëzohet kur kthehet në shtëpi; kurse ai duhet ta bëjë gruan të trishtohet kur largohet.”

18. Dietat e Shpajerit

Takimi i dietës që ishte caktuar të zhvillohej në qytetin e Shpajerit, u hap më 25 qershor 1526. Perandori, që s'ishte i pranishëm, dërgoi porosi që të merreshin masa të menjëhershme për ndëshkimin e kujtqë që s'pranonte t'i bindej Dekretit të Vormsit për Martin Luterin. Donte që çështja e murgut heretik të përmbyllej menjëherë.

Në vend që të prisnin më të keqen nga pjesëmarrja në asamble, princat protestantë u nisën për në Shpajer të shoqëruar nga pastorët e tyre, të cilët nevojiteshin që të predikonin besnikërisht Fjalën gjatë rrugës, si dhe në qytetin e Shpajerit. Këta princa luteranë nuk druheshin nga ajo që mund t'u bënte njeriu; përkundrazi kishin një druajtje të shenjtë nga Perëndia i tyre i Gjithëpushtetshëm.

Mbështetja nga princat

Princat, pastorët dhe kalorësit që i shoqëronin kishin veshur rroba mbi të cilat ishin qëndisur shkronjat V.D.M.I.AE¹³⁷. Këto nistore kishin kuptimin: “Fjala e Perëndisë qëndron përjetë.”

Në Shpajer çdo sundimtar protestant i vendosi ato shkronja mbi derën e shtëpisë ku rrinte. Kishte ikur koha kur një njeri i vetëm, Martin Luteri, pati bërë qëndresë kundër forcës së Romës dhe perandorit.

Këta burra trima nuk pranuan të merrnin pjesë në meshën zyrtare të dietës apo të agjëronin në ditët e caktuara nga Kisha Katolike. Madje qëndrimin e tyre ndaj këtyre ditëve të agjërimit e treguan duke i urdhëruar shërbyesit që të çonin haptazi, në sy të të gjithëve, pjata me mish në tryezat e tyre. Këta burra nuk pranonin të përkuleshin përpara kërkesave të papatit të paperëndishëm ose urdhrave të perandorit Karl, që e donte shumë katolicizmin!

Perandori ndryshon qëndrim

Meqë perandori Karli i V s'mund të ishte i pranishëm në takimin e dietës, kishte caktuar si kryesues vëllanë e vet, Ferdinandin e Austrisë. Kur Ferdinandi pa vendosmërinë në fytyrat e sundimtarëve protestantë, vendosi që s'ishte me vend të lexonte përpara sundimtarëve të pranishëm kërkesat e perandorit. Sigurisht, perandoria po përballlej me probleme të tjera: turqit po trokisnin në dyert e botës së krishterë dhe perandori ishte i përfshirë në një mosmarrëveshje të rëndë me papën.

Perandori Karl që e kuptonte natyrën serioze të marrëdhënieve ndërkombëtare, i çoi fjalë Ferdinandit: “Ta pezullojmë Dekretin e Vormsit; le të fitojmë me butësi mbështetjen e përkrahësve të Luterit; le të arrijmë fitoren e së vërtetave ungjillore, me anë të veprimeve të mençura.” Në të njëjtën frymë, ai kërkoi që të gjitha kombet t’i vinin në dispozicion luftëtarë, për të marrë pjesë në betejat kundër turqve. Përveç kësaj, të gjithë ishin të vetëdijshëm se paqja me Romën po shkatërrohej.

Oportunizmi e detyronte perandorin që t’i toleronte luteranët, për të fituar mbështetjen e tyre në luftën kundër turqve. Dekreti i Vormsit nuk mund të përsëritej, por situata ishte e tillë, saqë nuk ekzistonte asnjë mundësi për zbatimin e asaj rezolute. Kështu, më 27 gusht, u paraqit kjo rezolutë: “Le t’i lejojmë çdo njeriu të bëjë siç i duket e përshtatshme, derisa një këshill të rivendosë unitetin e shumëpërdësuar me anë të Fjalës së Perëndisë.”

Kjo nënkuptonte që çdo shtet mund të vazhdonte ta adhuronte Perëndinë sipas dëshirës së sundimtarëve të vet. Gjithsesi nuk ekzistonte liri fetare brenda territorit të çdo sundimtari, pasi ishte ai që vendoste se cila doktrinë fetare do të ndiqej.

Forcat e perandorit pushtojnë Romën

Situata politike në Evropë bëri që ushtritë e perandorit Karl të hynin në qytetin e Romës më 6 maj 1527 dhe e detyruan papën të arratiset.

Trupat gjermane dhe spanjolle që luftonin për Karlin, hynë në Romë dhe i shkaktuan dëme të mëdha kryeqytetit botëror të sistemit papnor. Trupat gjermane parakaluan në rrugët e Romës të veshur si kardinalë dhe priftërinj; me gjithçka që mundën të vidhnin nga shtëpitë e klerit dhe hierarkisë papnore. Pastaj, për ta poshtëruar Romën papnore, ushtarët gjermanë parakaluan nëpër rrugë, duke shpallur se tani papë i Romës do të ishte Luteri!

Dieta e dytë e Shpajerit

Në shkurt 1529 u mblodh në Shpajer një dietë tjetër, por shumica e delegatëve mbërritën në mars. Ishte arritur paqja mes Karlit dhe Romës dhe tani perandori ishte i vendosur që ta shtypte lëvizjen e Reformacionit, duke zbatuar Dekretin e Vormsit për Martin Luterin.

Sundimtarët protestantë i shihnin me shumë dyshim synimet e perandorit dhe këtë ua përforcoi një dritë e fortë (aurora borealis¹³⁸) që u shfaq mbi qiejt e Gjermanisë në janar. Edhe Martini druhej se ky ishte paralajmërim

nga Perëndia se së shpejti do të ndodhnin ngjarje të rëndësishme; madje besonte se kjo ishte shenjë qiellore se kthimi i Zotit Jezu Krisht ishte afër. U përhapën dhe shumë zëra të tjerë për ngjarje të çuditshme që kishin ndodhur në mbarë Gjermaninë; madje dhe vetë Melanktoni u shqetësua nga ato që shihte dhe dëgjonte, dhe tha: “Gjithë këto ngjarje po më shqetësojnë tej mase.”

Gjithsesi, delegatët u mbledhën në Shpajër, sipas kërkesës së perandorit Karl. Elektori Johan i Patunduri i Saksonisë shoqërohej nga Filip Melanktoni. Protestanti Filip i Hesënit mbërriti me dyqind kalorës. Pala papnore mbërriti me pompozitet dhe ceremoni; e dinin se në këtë dietë do të dilnin triumfues dhe prisnin që rezoluta e dietës së mëparshme të Shpajërit të anulohet. Kështu, të gjithë do të ktheheshin në shtëpi pas një dy orësh debat.

Përfaqësuesit e papës folën shumë ashpër ndaj reformatoreve. Njëri që quhej Faber, deklaroi: “Turqit janë më të mirë se luteranët, sepse turqit zbatojnë ditë agjërimi, ndërsa luteranët i shkelin. Nëse duhet të zgjedhim mes Shkrimeve të Shenjta të Perëndisë dhe gabimeve të vjetra të Kishës, duhet të hedhim poshtë Shkrimet.”

Princat protestantë argumentuan se ligji i perandorisë lejonte lirinë dhe tolerancën fetare, dhe ky lloj ligji nuk mund të anulohet. Shumica e delegatëve ishin shumë të vetëdijsëm se kthimi te situata që pati shkaktuar vendimi i Dietës së Vormsë do të thoshte luftë.

Rrjedhoja e këtyre diskutimeve ishte një rezolutë që ruante gjendjen e mëparshme; kjo nënkuptonte se ato shtete që shijonin frytet e Reformacionit do të vazhdonin si më parë. Megjithatë kjo nënkuptonte gjithashtu se Reformacioni nuk mund të zgjerohej përtej kufijve të atyre vendeve që shijonin liri të tilla.

Protesta e princave

Më 15 mars u anulua rezoluta e Shpajërit që lejonte lirinë fetare; kjo do të thoshte se duhej zbatuar vendimi i Vormsë në lidhje me Martinin. Martini u dënua sërish dhe u vu nën dënimin me vdekje si heretik; kështu, Reformacioni duhej shkatërruar. Princat protestantë që nuk e toleronin dot këtë lloj vendimi, u mbledhën për të diskutuar pasojat e tij. E dinin se Fjala e Perëndisë i urdhëronte që ta shpallnin ungjillin në mbarë botën. Kështu, qëndruan të patundur e të bashkuar, të gatshëm të sakrifikonin gjithçka për

hir të ungjillit, dhe bërtitën: “Ta hedhim poshtë këtë dekret. Në çështjet e ndërgjegjes, shumica nuk ka fuqi!”

Asamblesë iu bë thirrje t’i kthehej gjendjes së rezolutës së vitit 1526 në Shpajer, e cila në të vërtetë lejonte që ungjilli të shpallej kudo. Por shumica e anëtarëve vendosën që u duhej dhënë fund diskutimeve. Ferdinandi u shpreh se do të nxirrte një shpallje perandorake në lidhje me këtë çështje; kështu do t’i jepte këtij vendimi fuqi të plotë ligjore për t’u zbatuar në të gjitha territoret e perandorisë. Sundimtarët protestantë kërkuan sërish më tepër kohë për zhvillimin e diskutimeve të mëtejshme, por Ferdinandi iu përgjigj shumë qartë: “Mbaroi. E vetmja gjë që mbetet është bindja.”

Të nesërmen, më 19 prill 1529, në ditën e fundit të dietës, sundimtarët protestantë u ngritën dhe lexuan para delegatëve të mbledhur një protestë kundër vendimit që pengonte predikimin e ungjillit në mbarë botën. Meqë Ferdinandi ishte larguar nga Shpajeri, nuk ishte i pranishëm që të dëgjonte leximin e kësaj proteste.

Në Dietën e Vormsit Martin Luteri kishte qenë i vetëm kundër tiranisë së Romës dhe perandorit; kurse tani Martini që mungonte përfaqësohej dhe mbështetej nga një numër i madh sundimtarësh besimtarë.

Disa pjesë të rëndësishme të protestës thoshin:

“Nuk mund t’i nënshtrohem anulimit të tij [dekretit të 1526]... Sepse kjo do të thoshte të mohonim Zotin tonë Jezu Krisht, të mohonim Fjalën e Tij të Shenjtë, dhe kështu t’i japim atij çdo arsye që të na mohojë përpara Atit të Tij, siç ka kërcënuar...

Po kështu, në lidhje me dekretin që shpall se predikuesit do të predikojnë ungjillin, duke e shpjeguar sipas shkrimeve të pranuar nga Kisha e shenjtë e krishterë; kërkojmë që, në mënyrë që ky urdhër të ketë vlerë, të biem së pari dakord se çfarë nënkuptohet me Kishën e shenjtë dhe të vërtetë. Tani duket që ka një larmi të madhe mendimesh në këtë aspekt; se e vetmja doktrinë e sigurt është ajo që përputhet me Fjalën e Perëndisë; se Zoti e ndalon mësimin e çdo doktrine tjetër; se çdo pjesë e Shkrimit të Shenjtë duhet shpjeguar me anë të pjesëve të tjera dhe më të qarta të tij; se ky libër i shenjtë është i nevojshëm në gjithçka për të krishterin, është i lehtë për t’u kuptuar dhe është llogaritur për të larguar errësirën; ne jemi të vendosur, me hirin e Perëndisë, që të mbajmë vetëm predikimin e pastër të Fjalës së tij të Shenjtë, e cila përmbahet në librat biblikë të Dhiatës së Vjetër dhe të

Re, pa i shtuar asgjë që mund të jetë në kundërshtim me të. Kjo Fjalë është e vetmja e vërtetë; është rregulla e sigurt e çdo doktrine dhe e gjithë jetës, dhe nuk mundet kurrë të gabojë apo të na mashtrojë. Ai që ndërton mbi këtë themel do t'u bëjë ballë gjithë fuqive të ferrit, ndërsa gjithë mësimet kryeneçe njerëzore që ngrihen kundër kësaj Fjale, do të bien rrëzohen përpara Perëndisë.

Për këto arsye, shumë të dashur zotërinj, xhaxhallarë, kushërinj dhe miq, ju përgjyrohemi fort që të peshoni me kujdes ankesat dhe motivet tona. Nëse nuk bindeni nga kërkesa jonë, NE PROTESTOJMË... përpara Perëndisë, të vetmit Krijues, Ruajtës, Shpengues dhe Shpëtimtar, i cili një ditë do të jetë Gjykatësi ynë dhe i gjithë njerëzve e krijesave, se ne, për ne dhe për popullin tonë as nuk biem dakord, as nuk do të pranojmë kurrësi dekretin e propozuar në çfarëdo gjë që bie ndesh me Perëndinë, me Fjalën e tij të Shenjtë, me ndërgjegjen tonë të ndriçuar, me shpëtimin e shpirtave tanë dhe me dekretin e fundit të Shpajërit.”

Më 24 prill, princat u mbledhën sërisht dhe aty protesta u nënshkrua zyrtarisht nga këta protestues: Johani, Elektori i Saksonisë; Filipi, konti i Hesënit; Giorgu, markonti i Brandenburgut; Ernesti dhe Franci, dukët e Luneburgut dhe konti i Anhaltit. Pastaj protestuesve iu bashkuan dhe disa nga gjykatësit e qyteteve të lira, të cilët firmosën protestën. Nga ajo ditë reformatoret u njohën me emrin “protestantë”.

Kur i treguan Martinit për ngjarjet që ndodhën, ai tha se asambleja s'kishte arritur asgjë. S'ë kuptonte dot rëndësinë e protestës së shprehur përpara sundimtarëve të perandorisë. Tani kërkohej liri fetare dhe e vërteta që duhej predikuar ishte ajo që bazohej në Fjalën e Perëndisë. Tani shpallej se ndërgjegjja njerëzore u nënshtrohej vetëm mësimëve të Shkrimit. Mirëpo Martini, prapëseprapë, e kishte të pamundur të linte sigurinë e Saksonisë, pasi shumë vetë e donin të vdekur.

Kundërshtimi i reformimit vazhdon

Ndonëse sundimtarët protestues u betuan gjithashtu se do të mbroheshin kundër kujtqdo që guxonte të minonte lirinë e sapofituar të ndërgjegjes, kundër këtyre protestuesve po mblidheshin forca të fuqishme. Madje, në kurorëzimin e vet në Bolonjë, më 24 shkurt 1530, perandori u betua se do ta mbronte dhe do ta ruante papën e sapozgjedhur.

Dieta e re u caktua për në qytetin e Augsburgut, ku sërish tema kryesore e diskutimit do të ishte çështja e braktisjes së Kishës Katolike të Romës.

19. Një takim me reformatörët zviceranë

Për të patur sukses, uniteti mes reformatörëve konsiderohej i një rëndësie bazë; ndonëse grupet protestante kishin gjëra të përbashkëta, ekzistonte një ndasi e madhe në lidhje me doktrinën e Darkës së Zotit. Ishin botuar shumë shkrime që rendisnin doktrinën e mbajtur nga autorët dhe shumë korrespondenca ishin qarkulluar mes krerëve të Reformacionit, në përpjekje për të gjetur terrenin e përbashkët. Shpesh një pjesë e mirë e letrave ishin fyese dhe nuk sillnin aspak harmoni mes pikëpamjeve të kundërta.

Martini, që s'donte unitet me ata që kishin pikëpamje të kundërta me të, i shprehu shumë qartë mendimet e veta, kur shkroi: "Dakord! Meqë ata fyejnë çdo arsye, do t'iu jap një paralajmërim luteran! I mallkuar qoftë ky bashkim! E mallkuar qoftë kjo dashuri! Flakeni poshtë, deri në gropën e pafundme të ferrit! Sikur të të vrisja babanë, nënën, gruan, fëmijën dhe pastaj me dëshirën që të të vrisja dhe ty, të të thosha: 'Le të bëjmë paqe, i dashur miku im!,' çfarë përgjigje do të më jepje? Kështu ndodh me entuziastët, të cilët vrasin Jezu Krishtin, Zotin tim, Perëndinë Atë, dhe krishterimin, nënën time, duan të më vrasin dhe mua, dhe pastaj të thonë: 'Le të bëhemi miq!'"

Cvingli, që ishte shumë më tolerant se Martini, në një nga artikujt e vet, iu drejtua me këto fjalë: "Duhet të të vlerësojmë si një enë nderimi dhe këtë gjë e bëjmë me gëzim, pavarësisht të metave të tua."

Thirrje për një takim mes dy palëve

Filipi i Hesënit, që kërkonte me gjithë shpirt unitetin, me qëllim që t'i bënë ballë pushtetit të Romës dhe perandorit, vendosi të organizonte një takim të drejtuesve kryesorë protestantë, në përpjekje për të gjetur terrenin e përbashkët në lidhje me doktrinën e Darkës së Zotit.

Martinit iu dërgua ftesa që të shkonte në kështjellën e Marburgut, ku do të kryheshin diskutime me reformatörët zviceranë, Cvingli dhe Ekolampadi^{[139](#)}.

Martini, që me kalimin e moshës dhe me një larmi sëmundjesh ishte bërë edhe më përçmues ndaj atyre që kishin pikëpamje të ndryshme nga të vetat, s'donte t'ia dinte dhe aq për këtë lloj takimi. Ai e përçmonte Cvinglin, por, pas trysnisë së Elektorit të vet, mbërriti në Marburg^{[140](#)}, më 30 shtator 1529.

Në atë kohë ishte i sëmurë dhe shfaqte qëndrim kokëfortë kundrejt kujtdo që i kundërvihej në çdo lloj mënyre.

Kur u takua me Bucerin, me që cilin kishte qenë shumë miqësor, buzëqeshi dhe tha: “Sa për ty, ti je njeri kot dhe faqezi!” Mëkati i Bucerit? Tani binte dakord me mësimin e Cvinglit për Darkën e Zotit.

Filipi i Hesënit donte paqe mes dy grupeve reformatore dhe bëri të pamundurën që të siguronte vendin më të mirë të mundshëm për diskutimet, por qëndrimi i ashpër dhe i ftohtë i Martinit shkaktoi shumë trishtim.

Diskutimet rreth Darkës së Zotit

Në përpjekjen për të gjetur njëfarë terreni të përbashkët, raundi i parë i diskutimeve u zhvillua veçmas: Martini u takua me Ekolampadin, ndërsa Melanktoni me Cvinglin. Më 2 tetor diskutimet ishin të hapura për publikun. Me miqtë e ulur pas tyre, reformatorët kundërshtarë u ulën përballë njëri-tjetrit dhe, që nga fillimi, Martini shfaqti qëndrimin e vet të paepur kundrejt pikëpamjeve të të gjithë të tjerëve; mori një copë shkumës dhe shkroi mbi mbulesën e kadifenjtë të tryezës fjalët: “Hoc est meum corpus” – “Ky është trupi im.” Dhe nuk pranoi kurrsesi të lëvizte sadopak nga ai këndvështrim.

Një nga parimet kryesore të interpretimit të Biblës është se pjesët më të paqarta të Shkrimit duhen interpretuar nga ato që kuptohen më lehtë. Cvingli argumentoi nga Fjala e Perëndisë se fjalët e Krishtit nuk duhen marrë në mënyrë të fjalëpërfjalshme; tek e fundit, Krishti kishte thënë edhe se ishte “hardhia”, “shkëmbi”, e kështu me radhë. Ai tha se Krishti është i pranishëm shpirtërisht në shërbesën e kungimit dhe se sakramenti është vula e bashkimit që ekziston mes Krishtit dhe besimtarit. Cvingli tha se trupi i Krishtit ishte ngritur në qiell dhe nuk mund të ishte në dy vende në të njëjtën kohë.

Ndërsa Martini tregonte vazhdimisht me gisht fjalët që kishte shkruar në mbulesën e tryezës. Ai ra dakord me disa nga argumentet e parashtruara nga Cvingli, por tha se në këtë rast nuk vlenin për fjalët e Krishtit.

Martini argumentoi se trupi i Krishtit ishte vërtet i pranishëm në bukën dhe verën, dhe nuk lëkundej nga ai pozicion. Në një rast, gjatë diskutimeve, bërtiti: “Ky është trupi im! Ky është trupi im! As vetë djalli nuk më largon dot nga kjo! Po u përpoqa ta kuptoj, i bie të largohem nga besimi!”

Në një rast tjetër, iu përgjigj Cvinglit: “Unë besoj se trupi i Krishtit është në qiell, por besoj se është edhe në sakrament. S’dua t’ia di nëse kjo bie ndesh me natyrën, mjafton që të mos jetë kundër besimit. Krishti është po aq në sakrament, sa dhe kur u lind nga Virgjëresha.”

Të dyja palët ishin dakord se Darka e Zotit është një vakt kujtese, por nuk ranë dot dakord për praninë trupore ose jo të Krishtit në bukën dhe verën e përdorur në sakrament. Në një rast, Martini tha: “Sapo shqiptohen fjalët e shenjtërimit mbi bukën, aty bëhet i pranishëm trupi, sado i lig të jetë prifti që i shqipton.”

Kësaj Cvingli ia ktheu: “Tani ti po rivendos doktrinën e papës.”

Gjatë konferencës, shpërtheu sëmundja (Sëmundja e Djersës¹⁴¹) dhe kjo u dha fund diskutimeve përpara kohës së planifikuar. Cvingli donte që grupet të ndaheshin duke pranuar njëri-tjetrin si vëllezër në Krishtin, por Martini, që ishte bërë grindavec, nuk pranoi të binte dakord. Filipi i Hesënit, që kishte thirrur konferencën, donte unitet dhe u bëri thirrje burrave të takoheshin sërish, për të gjetur njëfarë terreni të përbashkët. Reformatorët përballeshin me forcat e bashkuara të Romës dhe me perandorin e vendosur që ta shtypte lëvizjen reformatore. Njerëzit po vdisnin nga murtaja dhe Cvingli e dinte se uniteti ishte thelbësor për suksesin e lëvizjes reformatore. Tha: “Le të shpallim bashkimin tonë në të gjitha gjërat që biem dakord; sa për të tjerat, le ta tolerojmë njëri-tjetrin si vëllezër në Krishtin.”

Filipi u gëzua pa masë nga këto fjalë dhe tha: “Po, le të bashkohemi; le të shpallim unitetin.”

Si dëgjoi këto fjalë, u duk sikur Martinin filloi t’i shkrihej ftohtësia e akullt. Cvingli e vuri re dhe shpërtheu në lot; besoi se do të vendosej paqja. Eci drejt Martinin me krahun e shtrirë përpara, i gatshëm t’i shtrëngonte dorën. Iu përgjërua Martinin dhe i tha “vëlla”, por përgjigja e tij ishte vetëm kjo: “Fryma juaj është e ndryshme nga jona.”

Pas disa diskutimesh të mëtejshme, Martini tha kështu për reformatorët zviceranë: “Ne ju pranojmë si miq; nuk ju konsiderojmë vëllezër dhe anëtarë të Kishës së Krishtit. Por as nuk ju përjashtojmë nga ajo dashuri e përgjithshme që ua kemi për borxh edhe armiqve.”

Pas disa fjalëve të tjera, Martini iu afrua Cvinglit dhe Ekolampadit, dhe tha me dorën e shtrirë drejt tyre: “Ne biem dakord që t’ju japim dorën e paqes dhe dashurisë.... Dora e Krishtit largoftë dhe pengesën e fundit që na ndan.

Tani kemi një marrëveshje miqësore mes nesh dhe, nëse vazhdojmë në lutje, do të vijë dhe vëllazëria.”

Deklaratë e përbashkët besimi

Pastaj u mor vendimi që të përgatitej një rrëfim besimi, i cili do të nënshkruhej nga anëtarët e të dyja palëve. U ra dakord për çështjet e natyrës hyjnore dhe njerëzore të Krishtit, vdekjen dhe ringjalljen e tij, mëkatit fillestar, shfajësimin vetëm me anë të besimit, veprën e Frymës së Shenjtë dhe Fjalën e Perëndisë, veprat e mira, pagëzimin, rrëfimin, shtetin dhe vendin e traditës. Martini dhe miqtë e tij u çuditën disi që ishin në harmoni për të gjitha këto tema të rëndësishme.

Por Martini e mbajti deri në fund këtë çështje ndasie:

Në lidhje me Darkën e Zotit, të gjithë besojmë se duhet kremtuar në të dyja llojet, siç ndodhi kur u krye për herë të parë; se mesha nuk është një vepër me të cilin i krishteri arrin faljen e mëkatit për dikë tjetër, i vdekur apo i gjallë qoftë; se sakramenti i altarit është sakramenti i vetë trupit dhe gjakut të Jezu Krishtit; dhe se ngrënia shpirtërore e këtij trupi dhe gjaku është tejet e nevojshme për çdo të krishterë të vërtetë.

Në të njëjtën mënyrë, në lidhje me dobinë e këtij sakramenti, biem dakord se, ashtu si Fjala, edhe Darka e Zotit është caktuar nga Perëndia i Plotfuqishëm, me qëllim që ndërgjegjja jonë e dobët të na forcohet me anë të Frymës së Shenjtë të besimit dhe dashurisë.

Kur zviceranët dëgjuan këto fjalë nga goja e Martin Luterit, u entuziazmuan. Pastaj Martini vijoi të lexonte si më poshtë:”

Më në fund, të dyja palët ranë dakord të kishin dallime, por gjithsesi të ruanin unitetin. Pastaj erdhi nënshkrimi zyrtar i dokumenteve, që ndodhi më 4 tetor 1529. Ekolampadi, Cvingli, Bucer dhe Hedioja¹⁴² nënshkruan një kopje të marrëveshjes, ndërsa kopja tjetër u firmos nga Luteri, Melanktoni, Jonasi¹⁴³, Oziandri¹⁴⁴, Brenci¹⁴⁵ dhe Agrikola¹⁴⁶. Pastaj i shkëmbyen dy kopjet dhe i nënshkruan të gjithë sërish. Tani të dyja grupet e reformatoreve mund të largoheshin, secili duke mbajtur pikëpamjet e veta për praninë e Krishtit në elementet e Darkës së Zotit; prania fizike ose prania shpirtërore.

Pastaj të dyja palët u kthyen në shtëpi, me bindjen se kishin triumfuar. Shumë vëzhgues të konferencës raportuan se gjithçka kishte qenë shumë

miqësore, por e vërteta është se u tregua gjithsesi shumë armiqësi, sidomos nga Martini kundrejt reformatorëve zviceranë. Disa nga laikët që dëgjuan debatet, u bindën nga pozicioni i reformatorëve zviceranë. Madje, pak kohë më vonë, në vitin 1538, edhe Martini shprehu mendimin se Cvingli, në Marburg, i ishte dukur “njeri shumë i mirë”.

Uniteti u arrit në letër, por ndarjet mbetën gjithsesi, sepse u lejuan nga klauzola e “lirisë së ndërgjegjes”, që u vendos me kërkesën e luteranëve. Sidoqoftë, tani ishte përgatitur mirë rruga për dietën e ardhshme të Augsburgut.

Perandori Karl s’ kishte aspak problem që t’i përkulej papës së Romës dhe të zotohej se do ta mbështeste papatin për përmbysjen e heretikëve në Vitenberg dhe në vendet e tjera, ku kishte zënë rrënjë Reformacioni.

Reformatorët përballeshin me një forcë të përbashkuar, ndërsa mes vetes ishin ende të përçarë shpirtërisht.

20. Në Augsburg¹⁴⁷

Më 21 janar 1530, perandori Karl thirri gjithë sundimtarët e perandorisë për t'u mbledhur në Augsburg, me qëllim që të përmbyllnin dy çështje që vazhdonin ta shqetësonin perandorinë. Çështja e parë ishin mësimet fetare të protestantëve (luteranëve) dhe të tjerëve, të cilat trazonin harmoninë shpirtërore të perandorisë; e dyta ishte nevoja për formulimin e një politike për përballimin e pushtuesve turq. Thirrja e perandorit kërkonte bashkëpunimin e të gjithë delegatëve, për trajtimin e këtyre dy problemeve që përbënin shqetësim të madh për të gjithë.

Ndërkohë, Karli ishte takuar me papa Klementin në një takim zyrtar, ku papa e kurorëzoi mbret të Lombardisë më 22 shkurt; pastaj, në një ceremoni pompoze, më 24 shkurt, papa e kurorëzoi Karlin perandor të Perandorisë së Shenjtë Romake. Gjatë ceremonisë së kurorëzimit, papa Klementi drejtoi një meshë, pas së cilës e vajosi perandorin e sapokurorëzuar Karl me vaj të shenjtë, i dhuroi një shpatë të zhveshur dhe e urdhëroi: “Përdore për mbrojtjen e Kishës kundër armiqve të besimit.”

Në ceremoni Karli puthi dhe kryqin e bardhë të qëndisur në shapkën e kuqe të papës, që ishte shenjë e nënshtimit të tij ndaj autoritetit të papatit.

Udhëheqësit mblidhen në Augsburg

Ndërsa 20 qershori, data e hapjes së dietës po afrohej, sundimtarët, të shoqëruar nga ndjekësit dhe mbrojtësit e tyre, nisën të mblidheshin në Augsburg. Martini, që ende ndodhej nën kërcënimin e vdekjes, për shkak se ishte ende në fuqi Dekreti i Vormsit, vendosi të qëndronte në kështjellën e Koburgut¹⁴⁸. Kjo donte të thoshte se ai ishte aq afër Augsburgut sa duhej për të marrë informacione, por edhe aq larg sa duhej për të qenë pak a shumë i sigurt që s'do ta rrëmbenin ushtarët e perandorit dhe Romës.

Shumë nga luteranët kishin frikë se rezultati i Dietës në Augsburg mund të nënkuptonte vdekjen e palës reformatore. Mirëpo Martini i nxiti që të merrnin pjesë në dietë me forcën e Perëndisë dhe të rrëfenin Krishtin para të gjithëve. Për t'i nxitur bashkëreformatorët e vet, shkroi himnin madhështor: Ein' feste Burg ist unser Gotte, “Kala e pamposhtur është Zoti ynë”, ku u bënte thirrje të gjithëve t'i mbanin sytë te Perëndia, për udhëheqje dhe ndihmë.

Ky himn u këndua nga udhëtarët, gjatë rrugës për në Augsburg, gjatë dietës, si dhe në gjithë kishat e Saksonisë.

Më 2 maj, Elektori Johan i Saksonisë hyri në Augsburg, i ndjekur disa ditë më vonë nga Filip i Hesënit, i cili shoqërohej nga rreth dyqind kalorës. Ishin përhapur tej mase zëra se perandori, me ndihmën e palës papnore, shpejt do t'i detyronte luteranët t'i përuleshin papës Klement. Thuhej kështu: “Të gjithë këta heretikë do të bien përtokë dhe do të zvarriten deri te këmbët e papës.”

Nunci papnor, Vinçenco Pompinelo, kryepeshkopi i Rrosanos¹⁴⁹, e këshilloi kështu perandorin Karl, në predikimin që mbajti gjatë një meshe: “Mos ngurro; konfiskojua pronat, vendos inkuizicionin dhe ndëshkoji këta heretikë kokëfortë me zjarr dhe shpatë.... Mprihe shpatën, o princ i lavdishëm, dhe bjeru këtyre kundërshtuesve!”

Qëndrimi publik i princave protestantë

Papati besonte se fitorja do t'i takonte atij. Ndihej i sigurt se perandori Karl do ta thyente fuqinë e sundimtarëve protestantë gjermanë dhe do ta rivendoste një herë e përgjithmonë besimin katolik të perandorisë.

Mirëpo kjo s'do të ndodhte kurrë. Tani ungjilli i shpëtimit do të mbrohej dhe me gjakun e luteranëve. Për të arritur synimet e tyre, të dyja palët organizuan takime veçmas, me qëllim që të planifikonin taktikën që do të ndiqnin në dietë.

Përfaqësuesit e papatit bënë kërkesën që princat protestantë të ishin të pranishëm në meshën që do të mbahej para fillimit të dietës. Përveç kësaj, u shpallën porosi se predikuesve protestantë nuk do t'u lejohej të predikonin ungjillin. Këtyre kërkesave, Elektori i Saksonisë, iu përgjigj: “Nëse Madhëria e tij e ndalon predikimin e ungjillit, unë do të kthehem menjëherë në shtëpi.”

Markonti Giorg i Brandenburgut¹⁵⁰ i tha perandorit se ishte gati të humbiste dhe kokën, por Zotin s'do ta mohonte: “Në vend që të lejoj të marrin Fjalën e Zotit apo që të mohoj Perëndinë tim, jam gati të gjunjzohem përpara madhërisë suaj dhe të ma prisni kokën.”

Martini u dërgoi lajme reformatorëve që të binin dakord me kërkesat e perandorit për çështjet civile, por të mos e mohonin kurrë Zotin e tyre dhe ungjillin që e donin aq shumë.

Në meshën që shënoi hapjen e dietës, dy princa protestantë qëndruan në këmbë, kur gjithë të tjerët u gjunjëzuan. Në fillim markonti i Brandenburgut u përkul, por, kur pa se miqtë e tij protestantë po qëndronin drejt, u ngrit dhe ai bashkë me ta dhe rrëfyeu besimin në ungjillin e tyre të dashur.

Pastaj vijoi procesioni i *Korpus Kristi*¹⁵¹, ku të gjithë duhet të merrnin pjesë në parakalimin pas “ostes” së ngritur lart. Pastaj perandori u bëri thirrje reformatoreve që t’i bashkoheshin kortezhit, sidomos për faktin se nuk e kishte penguar predikimin publik të ungjillit. Por, sërish, reformatoret qëndruan të palëkundur dhe i thanë: “Krishti nuk urdhëroi që ky sakrament të adhurohej.”

Në datën 16 qershor, kur ndodhi kortezhi, perandorin e shoqëruan vetëm njëqind qytetarë. Kohët kishin ndryshuar!

Rrëfimi i besimit

Për të diskutuar mësimet doktrinare të “protestantëve”, u bë kërkesa që reformatoret të nxirrnin një rrëfim me shkrim të besimit të tyre. Melanktoni, me ndihmën e Martinit (në Koburg) dhe teologëve të tjerë reformatore, iu fut punës për ta përpiluar këtë dokument tejet të rëndësishëm që do t’i parashtrohej dietës.

Në kohën e duhur, kur përfundoi përpilimi i Rrëfimit, sundimtarët protestantë dolën përpara dhe hodhën firmat në këtë deklaratë besimi. Pastaj erdhi dita për leximin e Rrëfimit para dietës: data 25 qershor 1530.

Rrëfimin e lexoi në gjermanisht dr. Bajeri¹⁵², zëvendëskancelari i Elektorit të Saksonisë. Leximi zgjati dy orë dhe gjatë kësaj kohe perandorin e zuri disa herë gjumi.

Reagimi ndaj rrëfimit

Kur përfundoi leximi i Rrëfimit, shumë nga katolikët u çuditën nga toni i butë i gjithçkaje që ishte thënë. Gjithë të pranishmit ishin të vetëdijshtë për rëndësinë e asaj ngjarjeje. Para trembëdhjetë vitesh, një murg i vetmuar pati qëndruar përpara forcës së Evropës dhe pati shpallur një gabim të Romës. Tani një grup shumë më i madh burrash po qëndronte i patundur përpara perandorit dhe Romës papnore dhe po mbronte ungjillin.

Pastaj perandori mori dy kopje të Rrëfimit dhe e shtyu dietën, pasi i nevojitej kohë për të shqyrtuar përmbajtjen e asaj që ishte lexuar para tij. Martini shkroi për atë ngjarje: “Jam tejet i entuziazmuar që kam jetuar deri

në këtë çast, kur Krishti është lartësuar botërisht nga këta rrëfimtarë të shquar dhe në një asamble kaq të lavdishme.”

Në diskutimet e mëtejshme peshkopi i Augsburgut¹⁵³ deklaroi: “Gjithçka që kanë thënë luteranët është e vërtetë. S’e mohojmë dot.”

Pala papnore u pështjellua, kur duka i Bavarisë¹⁵⁴ i pyeti: “E mohoni dot me arsye të shëndosha Rrëfimin që bënë Elektori dhe aleatët e tij?”

Eku iu përgjigj: “Me shkrimet e apostujve dhe profetëve? Jo! Por a e mohojmë dot me shkrimet e Etërve dhe këshillave të Kishës? Po!”

Duka ia ktheu: “E kuptoj. E kuptoj! Sipas jush luteranët kanë doktrina që përputhen me Shkrimet, ndërsa ne jo.”

Në një letër për Melanktonin, të datës 15 shtator 1530, Martini thotë: “Ju keni rrëfyer Krishtin, keni ofruar paqe, i jeni bindur perandorit, keni duruar lëndime, ju kanë mbytur me fyerje dhe nuk e keni kthyer të keqen me të keqe. Shkurt, keni bërë denjësisht punën e shenjtë të Perëndisë, siç u ka hije shenjtoreve. Prandaj jini të lumtur në Zotin dhe gëzohuni, o të drejtë. Keni shumë kohë që vajtoni në botë; ngrini sytë, çoni kokën, sepse shpengimi juaj po afrohet. Do të të kanonizoj si anëtar besnik të Krishtit. Ç’lavdi më të madhe mund të kërkojë? Është gjë e vogël që i ke dhënë Krishtit shërbesën tënde besnike dhe e ke treguar veten anëtar të denjë të tij.”

Por duhet të vëmë në dukje se, kur reformatorët që ishin ndjekës të Cvinglit shprehën dëshirën që të firmosnin gjithçka, përveç pikës për Darkën e Zotit, u refuzuan dhe kështu u detyruan të dorëzonin një rrëfim tjetër për besimin e tyre. Toleranca fetare kishte ende rrugë të gjatë përpara.

Dieta caktoi një komision për t’iu përgjigjur rrëfimit të reformatorëve; u kryen dhe diskutime në përpjekje për të vendosur marrëdhënie harmonie mes të gjitha palëve. Dolën se ishin përpjekje të kota, kështu që dieta u përmyll zyrtarisht më 22 shtator, me premtimin se do të kryheshin diskutime të mëtejshme në dietën e radhës, që do të mbledhej në prill të vitit 1531.

Teksa Elektori i Saksonisë po bëhej gati të largohej, perandori Karl iu afrua dhe i tha: “Xhaxha, xhaxha, s’e prisja këtë prej teje.”

Martini ishte shumë i acaruar që dieta u përmyll pa shfuqizuar Dekretin e Vormsit, i cili e vendoste nën urdhrin ndalues të perandorisë. Ishte ende nën mallkimin papnor dhe, si i tillë, armik i Romës dhe perandorisë.

Por fitorja ishte e tij! Reformacioni ishte përhapur me shpejtësi rrufeje. Krishti po përlëvdohej dhe pushteti i papës po sulmohej nga të gjitha anët. Zëri i Martinit kishte zgjuar botën e fjetur dhe besimin e gjallë. Melanktoni e quante Elia i protestantizmit dhe e konsideronte Pal të dytë. Martini theu tiraninë e Romës dhe i dha botës së errësuar shpirtërisht ungjillin e shpëtimit dhe leximin e Fjalës së Perëndisë në një gjuhë të kuptueshme lehtësisht për njeriun e zakonshëm.

Karakteri trim i Martini shihet në himnin e tij *Ein' feste Burg ist unser Gotte*.

*Kala e pamposhtur është Zoti ynë,
Mbrojtje dhe armë e fortë;
Na çliron nga gjithë ligësitë,
Asgjë nuk do të na mposhtë.
Armiku ynë i vjetër, vrastar,
Synon të godasë për fitore,
Ka forcë dhe shumë dinakëri,
Të frikshme e ka parzmoren,
Në tokë s'është askush si ai.*

*Me forcën tonë, s'bëjmë dot asgjë;
Do të kishim marrë fund shpejt.
Por për ne lufton Heroi,
Që e solli Zoti vetë.
Kush është ky, pyesni ju?
Është vetë Jezusi, Mesia,
Zoti i fortë i ushtrive,
Shpëtimtari, Perëndia,
I plotfuqishëm në betejë.*

*Dhe në mbushshin djajtë botën,
Që patjetër t'na përpijnë,
Zemra tona s'kanë pse tremben,
Kurrë s'do munden të na fshijnë.
Princi i ferrit dhe errësirës,
Sado të fryhet me tërbim,*

*Nuk na prek dot asnjë flok,
Është vulosur fati i tij:
Një fjalë e vetme e shpartallon.*

*Fjala e Zotit nuk dorëzohet
Para asnjë lloj krijese;
Ai na mbron në fushëbetejë,
Me hir dhe Frymë jep përkujdesje.
Le ta marrin plaçkën, famën,
Jetën, fëmijët apo gruan,
Le të marrin, pra, gjithçka,
Prapë, në fund, asgjë s'fituan:
Mbretëria Jote mbetet.*

Dekreti i perandorit

Pasi dr. Eku paraqiti përgjigjen papnore për Rrëfimin e Augsburgut, perandori Karl e deklaroi çështjen të mbyllur, sepse ishte i bindur se pozicioni protestant u mposht. Nxori një dekret që të gjithë sundimtarët protestantë t'i nënshtroheshin autoritetit të Romës dhe u dha afat deri më 15 prill 1531 që t'i përgjigjeshin pozitivisht dekretit të tij, përndryshe do të plaste lufta!

Kthimi në besimin protestant ndalohej me dekret nga perandori dhe gjithë pronat që i ishin konfiskuar forcërisht Kishës Katolike duhej t'i ktheheshin. Po kështu, ai urdhëronte që të kremtoheshin ceremonitë e mëparshme dhe ditët e agjërimit. Të gjithë princat që nuk pranonin t'u bindeshin këtyre porosive, paralajmëroheshin ashpër se nuk do t'u lejohej që të mbanin vendet e tyre në dietat e perandorisë, pasi do të konsideroheshin të jashtëligjshëm. Tani ishin në fuqi të gjitha kërcënimet e perandorisë dhe Romës kundër reformatorëve dhe dekreti i perandorit shkaktoi një valë frike nëpër tokat protestante. Melanktoni druhej se mos shpejt Reformacionit do t'i vinte fundi.

Mirëpo Martini nuk u lëkund; i nxiti gjithë princat reformatorë dhe ndjekësit e tyre që të mblidheshin në Shmalkald¹⁵⁵, gjatë periudhës së Krishtlindjes, në vitin 1530. Aty u themelua Lidhja e Shmalkaldit¹⁵⁶, e cila do t'i kundërvihej çdo përpjekjeje të Dekretit të Augsburgut. Më tej u mor vendimi që Lidhja të vepronte për një periudhë gjashtëvjeçare.

Sidoqoftë, kur protestantët zviceranë kërkuan anëtarësim në këtë Lidhje, aplikimi iu refuzua; ngriti kokën sërish çështja e ortodoksisë në lidhje me Darkën e Zotit. Martini nuk e toleronte bashkimin me ata që i konsideronte ende të padenjë t'i quante “vëllezër”.

Më në fund paqe

Kur mbërriti dita që perandori të merrte masa ushtarake kundër shteteve protestante, ndërroi mendje. Rreziku ushtarak i turqve ishte ende shumë i pranishëm dhe ai po kalonte vështirësi shumë të mëdha me taksimin e shteteve anëtare të perandorisë.

Si rrjedhojë, u ndërmjetësua paqja me luteranët, e cila ndodhi në Nyremberg, më 23 korrik 1532, dhe u ratifikua në Dietën e Regensburgut, më 3 gusht 1523. Aty shteteve protestante iu garantua e drejta që të adhuronin Perëndinë, sipas asaj që mendonin se ishte në përputhje me mësimet e Shkrimit.

Kjo solli një periudhë qetësimi për Kishën në Gjermani. Përndjekja e luteranëve mori fund dhe vijoi një periudhë paqeje për rreth pesëmbëdhjetë vjet.

21. VITET E FUNDIT

Martin Luteri, armiku i papatit dhe perandorisë, vdiq në moshën 63-vjeçare. Kjo ishte moshë e thyer, nëse kemi parasysh jetëgjatësinë mesatare të kohës. Ishte tërhequr nga shërbesa aktive, për shkak të shëndetit të dobët, por vazhdonte të zinte vendin e vet në foltore, prej nga predikonte për temat e shpëtimit që i donte me gjithë shpirt.

Megjithatë, me kalimin e moshës filloi të shtonte në peshë dhe sëmundja iu bë shoqëruese e përditshme. Vazhdoi të udhëtonte lart e poshtë me një karrocë të vjetër që ndoshta ia trondiste keq trupin nga rrugët shumë të këqija që përshkonte. Trajtimi që merrte për problemet e ndryshme, nuk mund t'i bënte dobi, pasi zakonisht ai merrte ilaçe që bëheshin me një larmi substancash të çuditshme, si urina dhe bajgat. Po kështu, trupit i merrej shpesh gjak, sepse kjo mendohej se largonte shumë sëmundje.

Ai u bë gjithmonë e më jotolerant ndaj pikëpamjeve të njerëzve të tjerë të përgjegjshëm dhe të përendishëm; ishte i papërkulshëm për doktrinat që vazhdonte të predikonte. Në një rast, i tha kështu Melanktonit për Darkën e Zotit dhe doktrinën e tij për praninë reale të trupit të Krishtit në elementet e bukës dhe verës: “Bashkë me bukën hahet dhe përtypet me dhëmbë trupi i Krishtit.”

Në pjesën e fundit të jetës mori pjesë në diskutime me përfaqësues të papatit, për të arritur në njëfarë marrëveshje, por këto përpjekje dështuan. Në disa aspekte u bë kryeneç, pasi thoshte se ende ushtronte ndikim të madh te populli i zakonshëm. Në një rast u mburr se, po të donte, mund t'i kthente pa shumë mundime banorët e Vitenbergut te Kisha e Romës.

Në ditët e fundit të jetës, Martini harxhoi shumë kohë në mosmarrëveshje të parëndësishme me Elektorin e Saksonisë dhe nuk arrinte ta vlerësonte faktin se siguria e tij bëhej e mundur për shkak të mbështetjes së Elektorit të tij. Dëshpërohej nga fakti se studentët e universitetit nuk e donin ungjillin, sa çë kishte dashur ai. Madje, sa më shumë dëgjonte për trazirat shoqërore, politike dhe fetare në shtetet gjermane, aq më i sigurt ishte se kthimi i Krishtit po afrohej. Besonte se forcat turke do ta pushtonin me sukses botën e krishterë përpara kësaj ngjarjeje madhështore dhe se Perëndia do ta përdorte këtë pushtim për të ripërtërirë zemrat e të krishterëve, dhe se ky pushtim do të bëhej shkak që shumë të shpëtoheshin.

Vuante nga periudha depresioni dhe shkruante me gjuhë shumë të ashpër, madje fyese, kundër Kishës së Romës. Një artikull, *Për papatin e themeluar nga djalli*, kishte gjuhë shumë të ashpër. Në një shkrim tjetër, me titull *Për judenjtë dhe mashtrimet e tyre*, sulmoi popullin jude, duke i fajësuar se po shkaktonin probleme monetare ndër popujt dhe kombet e krishtera. Po kështu, pretendonte se farmacistët judenj përgatisnin ilaçe që dëmtonin shëndetin e të krishterëve.

Shkrimet i merrnin ende një pjesë të madhe të kohës; puna e tij madhore vijoi të ishte rishikimi i vazhdueshëm i përkthimit të Shkrimeve në gjermanisht. Martini ende nderohej nga shumë njerëz të rëndësishëm, të cilët i shkonin rregullisht për këshilla dhe udhëheqje dhe kjo i pëlqente tej mase. E donte shumë shoqërinë.

Letërkëmbimi me Shtaupicin

Marrëdhënia me mikun e ngushtë, Shtaupicin, sa erdhi e u ftoh me kalimin e viteve. Shtaupici la urdhrin augustinian dhe u bashkua me benediktinët. Kur Martini u përpoq ta bindte që t'i bashkohej lëvizjes reformatore, nuk mori dot përgjigje pozitive. Kështu, i shkroi mikut të vet, Shtaupicit, duke iu drejtuar me fjalët “Eprori im në Zotin, ati dhe mësuesi im.” Pastaj e nënshkroi letrën me fjalët: “Yt bir, Martini.”

Në përgjigjen e vet, Shtaupici iu drejtua Martinit me fjalët: “Shumë i dashuri Martin”, dhe vijoi duke i shprehur dashurinë për të dhe për punën që po kryente. Megjithatë e nxiti Martinin që t'i trajtonte qytetarët e thjeshtë me butësi dhe të mos dënonte apo shqetësonte ata që ishin të sinqertë në besim. E mbylli letrën duke i thënë se, ndryshe nga Martini, ai kishte karakter të ndrojtur. Për këtë arsye nuk mori pjesë në lëvizjen reformatore.

Pak pas shkëmbimit të këtyre letrave, Shtaupici ndërroi jetë dhe u varros pa fanfarë dhe ceremoni. Më së shumti kujtohet për këshillën e urtë që i dha Martinit, në kohën kur Fryma e Shenjtë e kishte bindur thellë për mëkat.

Plaku ndërroi jetë dhe shkon te Krishti

Për shkak se Martinin e respektonin ende, i kërkuan të ndërmjetësonte dhe të rikthente marrëdhëniet e mira, kur në Mansfeld shpërthyen trazira mes kontëve për një trashëgimi prone.

Martini kishte ca kohë i sëmurë; kishte shumë dhimbje, për shkak të disa gurëve në veshka. Po kështu, vuante nga periudha të përsëritura këputjeje

mendore dhe fizike. Për shkak të sëmundjeve, acarohesh lehtë dhe bëhesh edhe më jotolerant.

Në janar 1546 i bënë thirrje për ndihmë dhe shpejt u nis për rrugë në një zonë të Gjermanisë që e njihte mirë dhe e donte shumë; qytetet e lindjes dhe fëmijërisë ishin gjithmonë të vyera për të. Gjatë udhëtimit u sëmur gjithmonë e më shumë dhe u detyrua të pushonte për njëfarë kohe; por, kur e mori veten mjaftueshëm, vazhdoi rrugëtimin. E dinte se ishte i sëmurë dhe u thoshte miqve të vet bashkudhëtarë: “Këtu jam lindur dhe jam pagëzuar. E çfarë pastaj, nëse qëndroj këtu dhe vdes?”

Një tjetri i tha se, po të kthehesh ndonjëherë në Vitenberg, do “ta hidhte një doktor trashalug që ta hanin krimbat”.

Kur grupi i tij i vogël iu afrua Mansfeldit, i dolën përpara dhe e shoqëruan mbi dyqind kalorës. Martini ishte shumë rëndë dhe ndihej mjaft i rraskapitur nga udhëtimi; megjithatë kaloi kohën e nevojshme për t’i bërë kontët që t’i zgjidhnin me sukses vështirësitë mes njëri-tjetrit, predikoi në kishën e atyshme dhe vizitoi disa vende të një rëndësie të veçantë. Por shëndeti sa vinte e i përkeqësohej.

Një natë kishte dhimbje të forta stomaku dhe doktori e porositi të pinte një gotë verë me pluhur briri njëbrirëshi; pas kësaj, e zuri gjumi. Mirëpo shpejt u zgjua me dhimbje të tmerrshme në gjoks dhe e kuptoi se po i afrohej fundi. Në shtrat, në shoqërinë e të bijve dhe disa miqve, iu lut Perëndisë për ngushëllim:

“O Perëndi, Ati im qiellor dhe Ati i Zotit tonë Jezu Krisht, Perëndia i çdo ngushëllimi; të falënderoj që më ke zbuluar Birin tënd, Jezu Krishtin, në të cilin kam besuar; të cilin e kam rrëfyer; të cilin e kam dashur; të cilin e kam shpallur dhe predikuar; të cilin papa i Romës dhe turma e të paperëndishmëve e përndjek dhe e turpëron; të përgjërohem, o Zoti im, Jezu Krisht, prano shpirtin tim. O Atë qiellor, ndonëse do të më rrëmbejnë nga kjo jetë, ndonëse tani duhet të dorëzosh trupin tim, e di me siguri se do të banoj me ty përjetë dhe se asnjë njeri nuk më shkul dot nga duart e tua.”

Zëri sa vinte e i dobësohej; disa herë përsëriti fjalët: “Në duart e tua e dorëzosh shpirtin tim; ti më ke shpenguar, o Perëndi i së vërtetës!”

Natën midis 17 dhe 18 shkurtit Martin Luteri kaloi qetësisht në prani të Zotit dhe Shpëtimtarit të tij, Jezu Krishtit. Kaloi jetë të trazuar, por në çastet

e fundit u mbush me paqe dhe qetësi në Krishtin.

Martin Luteri ndërroi jetë!

Kontët e Mansfeldit donin ta varrosnin në mauzoleun e familjes së tyre, por Elektori Johan i Saksonisë urdhëroi që trupi i Martinit të kthehej në Vitenberg, për t'u varrosur në vendin ku kishte punuar pa u lodhur dhe për shumë kohë.

Kështu trupin e Martinit e vunë në një arkivol prej plumbi, të mbuluar me kadife të zezë. Si e vendosën arkivolin në një karrocë që e ngisnin katër kuaj, kortezhi u nis për në Vitenberg. Gjatë rrugës kortezhin funebër e shoqëroi një grup i madh njerëzish: princa, fisnikë, gjykatës dhe njerëz të zakonshëm u bashkuan për t'i dhënë nderimet e fundit reformatorit të madh e të shumëdashur. Teksa kalonin përmes fshatrave dhe qyteteve, këndonin himne lavdërimi dhe dukej sikur një hero fitimtar po kthehej në shtëpi me festë fitoreje.

Më 22 shkurt, kortezhi iu afrua portave të qytetit të Vitenbergut, ku turmës i ishte bashkuar dhe Katerina fon Bora, gruaja e shtrenjtë e Martinit. Bashkë me të bijën dhe disa mikesha, ajo ishte ulur në karrocën që ndiqte atë që mbartte trupin e Martinit.

Të nesërmen trupin e Martinit e vunë të prehej poshtë foltores së Kishës së Tërëshenjtorëve; në atë kishë ku, shumë vite më parë, kur kishte qenë murg i ri, pati gozhduar nëntëdhjetë e pesë tezat e tij.

Pomerani¹⁵⁷ mbajti një fjalim të mirë; pas këtij doli Filip Melanktoni dhe foli me respekt për mikun dhe bashkëpunëtorin e tij të shtrenjtë. Pastaj, në heshtje, e cila thyhej nga ngashërimet e shumë miqve, trupin e Martinit e vunë të prehej me shpresën e sigurt dhe të patundur të ringjalljes në lavdi.

Në gurin e varrit ishte shkruar në latinisht ky mbishkrim:

“Këtu prehet trupi i Martin Luterit,
Doktor i Teologjisë,
që ndërroi jetë në vendlindjen e tij, në Ajsleben,
më 18 shkurt, viti 1546 pas Krishtit;
jetoj 63 vjet, 3 muaj dhe 10 ditë.”

Pas një viti, përbri varrit të Luterit qëndroi perandori Karli V. Ai kishte pushtuar vendin dhe i kishte nënshtuar princat kryengritës. Teksa qëndronte përbri varrit të armikut të vet, e këshilluan që kufomën e Martinit

ta nxirrnin nga varri dhe pluhurin t'ia merrte era. Karli tregoi se ishte njeri i ndershëm, kur deklaroi: “Unë luftoj me të gjallët, jo me të vdekurit.”

Vitet e fundit të jetës së Katerinës

Martini la pas gruan e tij të ve, e cila vuajti një skamje të tmerrshme. Zbuluan një testament, ku ai e lavdëronte Katerinën dhe e linte në mbrojtjen e Perëndisë. I la zotërimet e tij, por nuk kishte para të gatshme për të shlyer borxhet dhe testamenti i tij ishte i pavlefshëm, pasi nuk e kishte lënë trashëgiminë në përputhje me ligjin e kohës. Madje ai mund të ketë qenë i vetëdijshëm për disa vështirësi të mundshme, pasi paragrafi i fundit i testamentit, shkruante: “I lutem zotit tim të hirshëm, Elektori Johan Frederik që ta vërtetojë dhe pranojë këtë testament, edhe sikur të mos jetë saktësisht në formën që e kërkon ligji.”

Një vit pasi i vdiq i shoqi, Katerina u detyrua të arratisesh nga Vitenbergu, pasi ushtritë e perandorit Karl po afroheshin me shpejtësi. Kur trazira përfundoi dhe u rikthye qetësia, u kthye në Vitenberg, por u shtrëngua sërish të largohej në vitin 1552, kur shpërtheu murtaja. Madje gjithë universiteti e transferoi konviktin në Torgau¹⁵⁸, ku shkoi dhe Katerina.

Rrugës kuajt që tërhiqnin karrocën e saj vrapuan papritur dhe ajo u hodh jashtë, ose kërceu në përpyekje për të shpëtuar. Rënien ia zbuti fakti që përfundoi në ujë, por kjo i shkaktoi një ftohëmë, nga e cila pati probleme shumë të rënda me mushkëritë. Katerina shkoi në prani të Krishtit më 20 dhjetor 1552 në Torgau.

Fjalët e saj të fundit ishin: “Do t'i ngjitem Krishtit si rrodhja palltos.”

Katerina tregoi se ishte e krishterë dhe grua e dashur dhe e përkujdesur, me një karakter që çoi në martesë të lumtur me reformatorin e madh. Martini e shprehte shumë shpesh dashurinë e vet për Katerinën, por në një rast, shkroi: “Katerina, ti ke një burrë të perëndishëm që të dashuron; je perandoreshë!”

Mirënjohje ndaj Luterit

Martini vdiq, por Reformacioni që nisi ai tani po arrinte lartësi që do të ndryshonin botën. Gjithë ata që duan Perëndinë dhe jetojnë me besim në Birin e Perëndisë i detyrohen murgut nga Vitenbergu një borxh të madh mirënjohjeje. Ai ishte njeriu i Perëndisë që bëri qëndresë kundër fuqisë shpirtërore të Romës dhe shpalli sërish të vërtetat madhështore të shpëtimit me anë të besimit në Krishtin Jezu.

Bibliografia

Atkinson, J., *The Great Light*, Paternoster Press, 1968.

Bainton, R., *Here I Stand - A life of Martin Luther*, A Mentor Book, 1960.

Bainton, R., *The Reformation of the Sixteenth Century*, Hodder and Stoughton, 1963.

D' Aubigné, J. H. Merle, *History of the Reformation of Sixteenth Century*, Oliver and Boyd, Edinburgh, 1846 (në 5 volume).

D' Aubigné, J. H. Merle, *The Life and Times of Martin Luther*, Moody Press, 1978.

Friedenthal, R., *Luther*, Weidenfeld and Nicolson, London, 1970.

Green, V., *Renaissance and Reformation*, Edward Arnold Publishers, London, 1982.

Heick, O., *A History of Christian Thought*, Fortress Press, 1965.

Latourette, K., *A History of Christianity*, vol. 2, Harper and Row, 1975.

Pittenger, W. N., *Martin Luther - The Great Reformer*, Franklin Watts, Inc., 1969.

Schaff, P., *History of the Christian Church*, AP & A, USA (Pa datë publikimi. Në 3 volume).

Wylie, J. A., *The History of Protestantism*, Cassell and Co, Ltd.,

1 Bëhet fjalë për *papën Gregori V*, i cili u zgjodh papë më 3 maj 996 dhe qëndroi në post deri më 18 shkurt 999, kur vdiq. Lindi më 2 prill 972. Emrin e vërtetë e kishte *Brunoja i Karintias*, krahinë në jug të Austrisë, i biri i Salian Oto I, duka i Karintias, dhe nip i perandorit gjerman të Perandorisë së Shenjtë Romake Oto I, i njohur ndryshe si Otoja i Madh.

2 *Elektor ose zgjedhës*, ndryshe dhe princ-elektor, quhej një princ gjerman që kishte të drejtën të merrte pjesë në kolegjin zgjedhor që zgjidhte perandorin e Perandorisë së Shenjtë Romake (*Sacrum Imperium Romanum*), e cila kishte filluar që në mesjetën e hershme me Karlin e Madh dhe vazhdoi deri në vitin 1806. Kjo perandori përfshinte Mbretërinë e Gjermanisë, Mbretërinë e Bohemisë, Mbretërinë e Burgundit (territor në Provansë dhe në alpet franceze), Mbretërinë e Italisë dhe disa territore të tjera. Filloi si praktikë në fund të shek. XII dhe fillim të shek. XIII. Në një letër të papës Urban IV e vitit 1257, ai sugjeron 7 elektorë, për të shmangur votat e barabarta. Tre elektorë ishin klerikë: kryepeshkopi i Maincit, kryepeshkopi i Trierit dhe kryepeshkopi i Këlnit, ndërsa katër ishin laikë: mbreti i Bohemisë, konti palatin i Rinit, duka i Saksonisë dhe markonti i Brandenburgut.

3 *Trieri*, ishte një principatë klerikale që nga fundi i shek. IX. Në kohët romake ka qenë njohur si kryeqytet i provincës së rëndësishme Augusta Treverorum. Ka qenë qysh herët seli peshkopale dhe gjatë kohës së Karlit të Madh u bë kryepeshkopatë. Kryepeshkopi mbante edhe titullin e princit.

4 *Konti palatin i Rinit*, ishte sundimtari i territorit gjerman në të majtë të rrjedhës së sipërme të Rinit, në kufi me Francën, i quajtur Konteja Palatine e Rinit, e cila më vonë u njoh thjesht si Elektorati Palatin. Titulli kont palatin (palatin vjen nga fjala latine palatinus, pallat), u vendos së pari nga mbretërit frankë të dinastisë meroviane. Konti palatin në fillim ishte një nëpunës i oborrit që e ndihmonte mbretin në çështjet juridike. Më vonë, sipas nevojës, këta nëpunës u dërguan në territore të ndryshme të perandorisë, si qeveritarë apo si gjykatës dhe territori i tyre mori emrin Palatinat. Gjatë jetës së Luterit kanë qenë tre kontë palatinë, Filipi (1476-1508), Luigji V, i biri i Filipit (1508-1544) dhe Frederiku II, vëllai i Luigjit V (1544-1556).

5 *Markont* ishte një titull i trashëgueshëm në Perandorinë e Shenjtë Romake. Ishte një titull që i jepej një komandanti ushtarak që mbronte kufijtë e perandorisë. Në hierarkinë e titujve ishte më poshtë se titulli markez dhe më lart se titulli kont palatin dhe kont. Në vitet 1499-1535 ka qenë markont i Brandenburgut Hoakimi I Nestori, kurse në vitet 1535-1571 ka qenë markont Hoakimi II Hektori. Brandenburgu është një rajon në Gjermaninë verilindore, në kufi me Poloninë. Quhej ndryshe edhe Elektorati i Brandenburgut, sepse qeverisej nga një princ-elektor që kishte të drejtë të votonte për zgjedhjen e perandorit të ri të Perandorisë së Shenjtë Romake.

6 Në mitologjinë dhe folklorin gjerman përshkruhen si qenie të mbinatyrshme me trajtë njerëzore që bënin keq.

7 Një gjë e tillë është e pranishme edhe në botën shqiptare.

8 Qytet në shtetin Saksoni-Anhalt në Gjermani. Ndodhet në lindje të malit Harc dhe është pranë qytetit Ajzleben që do ta ndeshim më vonë në libër.

9 Harci është mali më i lartë në Gjermaninë veriore, 1141 metra mbi nivelin e detit. Shtrihet në territoret e Saksonisë së Poshtme, Saksonisë-Anhalt dhe të Tyingënit. Emri vjen nga gjermanishtja e mesme e lartë dhe do të thotë “kodër e pyllëzuar”.

10 Kështjella e Mansfeldit ose ndryshe Schloss Mansfeld, është një kështjellë e rrethuar me pyje dhe e ndërtuar në një shkëmb mbi qytetin e Mansfeldit. Përmendet për herë të parë në vitin 1229.

11 Magdeburgu është kryeqyteti dhe qyteti i dytë më i madh i Saksonisë-Anhalt. Është i vendosur mbi lumin Elbë dhe gjatë mesjetës ka qenë një nga qytetet më të rëndësishme dhe kryepeshkopatë.

12 *Ilfeldi* është një qytezë në rajonin Nordhausen, në veri të shtetit Tyingën.

13 Frat domenikan, italian, prift, filozof, teolog dhe jurist. Kishte gradën “Doktor”. Është një nga filozofët më me ndikim në mendimin perëndimor. Shkroi librat *Summa contra Gentiles* (i njohur edhe

si *Libri i të vërtetave të besimit katolik ndaj gabimeve të paganëve*) dhe *Summa Theologiae*, një përmbledhje e teologjisë së Kishës Katolike. Gjithashtu është i njohur edhe për himnet e tij eukaristike që përbëjnë një pjesë të liturgjisë së Kishës.

[14](#) *Xhon Danz Skocezi* (1266-1308), një nga filozofët teologë më të rëndësishëm të periudhës së mesme të mesjetës. Ai bëri një argumentim të plotë të ekzistencës së Perëndisë dhe solli prova në mbështetje të konceptit të Marisë pa mëkat.

[15](#) *Uilliami i Okamit* (1287–1347), frat françeskan anglez. Ishte filozof dhe teolog. Një nga figurat e mëdha të mendimit në mesjetë. Është i njohur për parimin metodologjik të zgjidhjes së problemit që quhet “Brisku i Okamit”, sipas të cilit midis hipotezave duhet të zgjidhet ajo që ka më pak supozime.

[16](#) Erfurti është kryeqyteti dhe qyteti më i madh i shtetit të Tyringenit në Gjermaninë qendrore. Ndodhet 100 km në jug-perëndim të Lajpcigut. Në Perandorinë e Shenjtë Romake bënte pjesë në Elektoratin e Maincit. Universiteti i Erfurtit u themelua në vitin 1379 dhe ishte i pari universitet në këtë zonë. Luteri filloi studimet aty në vitin 1501.

[17](#) *Filip Melanktoni*, lindi më 16 shkurt 1497 si Filip Shvarcert në Breten pranë Karlsruhes. Ishte një nga bashkëpunëtorët e ngushtë të Martin Luterit dhe i pari teolog sistematik i reformatonit protestant dhe një nga udhëheqësit e tij. Vdiq në Vitenberg më 19 prill 1560, në moshën 63-vjeçare.

[18](#) *Shën Bonaventura* (1221-1274), frat italian, françeskan. Emri i vërtetë ishte Xhovani di Fidanca. Ishte studiues, teolog dhe filozof. Gjithashtu ishte kardinal dhe peshkop i Albanit.

[19](#) *Mark Tul Ciceroni* (106-43 para K.), një nga oratorët më të mëdhenj të Romës. Publ Virgjl Maroni (70-19 para K.), një nga poetët më të mëdhenj të letërsisë latine të periudhës së perandorit August. Shkroi poemën e famshme Eneida, e cila tregon peripecitë e largimit nga Troja të princit trojan Eneut dhe vendosjen e tij në Itali. Tit Livi (64 ose 59 para K. – 12 ose 17 pas K.) historian romak që shkroi historinë e Romës.

[20](#) *Vilhelmi i Anhaltit* (1457-1504), ishte një nga djemtë e Adolfit I, princ i Anhalt-Këtenit. U bë murg françeskan dhe hoqi dorë nga e drejta e trashëgimisë së principatës gjatë mbretërimit të të atit.

[21](#) Shërimit.

[22](#) *Corpus Iuris Civilis*, përmbledhje e ligjeve të Perandorisë Romake, nga ana e perandorit Justinian I, në vitet 529-534 pas K. U quajt ndryshe dhe Kodiku i Justinianit (*Codex Iustinianus*). Ajo është një nga veprat themelore në jurisprudencë. Libri përbëhet nga tri pjesë: *Kodi*, një përmbledhje e ligjeve dhe dekreteve perandorake; *Antologjia*, një enciklopedi shkrimesh me pjesë të shkurtra nga shkrimet e juristëve romakë; *Institucionet*, një libër më tepër për studentët ku bëhet një paraqitje e ligjit dhe shpalosen një sërë elementesh konceptuale të trajtuara pak në *Kodin* dhe *Antologjinë*.

[23](#) *Benediktinë* quheshin anëtarët e urdhrit fetar katolik të Shën Benediktit (*Ordo Sancti Benedicti*). Jetonin si murgj nëpër manastiret e tyre dhe secili manastir ishte autonom. Quheshin ndryshe edhe “murgjit e zinj” për shkak të rrobës së zezë që mbanin veshur. U themelua nga Benedikti i Nursias (lat.) apo i Norças (it.) në Umbria, Itali rreth vitit 529 pas K. Motoja e tyre ishte: *Ora et labora* (Lutu dhe puno).

[24](#) *Domenikanë* quheshin anëtarët e një urdhri fetar katolik që rronte duke lypur. U themelua në vitin 1216, në Francë, nga një prift spanjoll nga Kastija i quajtur Domeniku i Kaleruegës, aprovuar nga papa Honori III, me anë të bulës papnore *Religiosam Vitam*. Kishin qëllim predikimin e ungjillit dhe ishte kundër herezive. Motoja e tyre ishte: *Laudare, Benedicere, Praedicare* (Të adhurojmë, të bekojmë, të predikojmë). Urdhri njihej për traditën e tij intelektuale dhe kishte nxjerrë shumë teologë dhe filozofë.

[25](#) *Kartuzianë* quheshin anëtarët e urdhrit fetar katolik kartuzian (*Ordo Cartusiensis*), i cili njihej ndryshe edhe si Urdhri i Shën Brunos. U themelua nga Brunoja i Këlnit në vitin 1084 dhe përfshinte murgj dhe murgesha. Jetonin në manastire të mbyllura dhe e theksonin jetën në komunitet brenda manastirit. Emrin e morën nga mali Shartrez në alpet franceze në jug-lindje, ku Shën Brunoja ndërtoi së pari strehën e tij eremite.

[26](#) *Françeskanë* quheshin anëtarët e një urdhri fetar katolik të themeluar në vitin 1209 nga Shën Françesku i Asizit. Bënin një jetë të thjeshtë dhe zakonisht e fitonin bukën duke lypur. Motoja e tyre ishte Pax et bonum (Paqe dhe mirësi).

[27](#) *Servitë* quheshin anëtarët e urdhrit fetar katolik të servitëve apo të shërbëtorëve të Virgjërshës Mari (*Ordo Servorum Beatae Mariae Virginis*). Ishte një komunitet që kishte murgj dhe murgesha. Kishin si qëllim shenjtërimin e anëtarëve, predikimin e ungjillit dhe propagandimin e Marisë. U themelua në vitin 1233 nga një grup tregtarësh nga Firenceja, të cilët lanë qytetin, familjet dhe punën dhe u tërhoqën në malin Monte Senario, jashtë qytetit për t'iu kushtuar një jete në varfëri dhe pendim. Ashtu si françeskanët dhe dominikanët, edhe këta jetonin duke lypur.

[28](#) *Augustinianë* quheshin anëtarët e urdhrit fetar katolik të Shën Augustinit, peshkopit të Hipos. Ky urdhër njihej ndryshe dhe si *Ordo sancti Augustini*, ose *Ordo eremitarum sancti Augustini*. Urdhri u themelua në vitin 1244. Edhe murgjit e këtij urdhri jetonin duke lypur. Kishin në fokus punën pastorale, misionet, arsimin dhe veprimtarinë intelektuale. Ata bënë shumë për të rritur ndikimin e Kishës Katolike dhe propagandonin besimin katolik. Kishin një adhurim të veçantë për Marinë dhe e quanin *Mater boni consilii* (Zoja e Këshillit të Mirë).

[29](#) *Tit Mak Plauti* (254-184 para K.), komedian romak, një nga më të njohurit.

[30](#) Fjala *tonsurë* vjen nga latinishtja: *tōnsūra* që do të thotë qethje. Zakonisht murgjit ose priftërinjtë në mesjetë e rruanin kokën, duke lënë vetëm një shirit flokësh rreth e qark kokës, si shenjë përkushtimi dhe përulësie. (Shih edhe: *Fran Luli, Fjalor biblik dhe i termave kishtarë*, “Camaj-Pipa” Shkodër, 2004, fq. 465.)

[31](#) *Augustini i Hipos* (354-430 pas k.) ishte një nga teologët e hershëm të krishterë dhe filozof. Ishte peshkopi i Hipos në Afrikën veriore dhe një nga Etërit e Kishës. Shkrimet e tij patën një ndikim shumë të madh në krishterimin perëndimor dhe në filozofinë perëndimore. Librat e tij më të njohur janë *Qyteti i Perëndisë* dhe *Rrëfimet*.

[32](#) *Zhan-Sharlie dë Zherson* (1363-1429), ishte mësues, studiues, teolog, reformator dhe poet francez. Ishte kancelar i Universitetit të Parisit. Në Këshillin e Konstancës (1414-1418) ishte një nga teologët më të spikatur. Ishte një nga individët e parë që mbrojti Zhan d'Arkën dhe e shpalli thirrjen e saj të mbinatyrshme si autentike.

[33](#) Njihej ndryshe edhe si *Giorg Mjekroshi*. Lindi në vitin 1471. Ishte i biri i Albertit “Trim” të Saksonisë. Qëndroi në pushtet nga viti 1500, deri sa vdiq në Drezden në vitin 1539. Ishte anëtar i urdhrit të kalorësve “Bashka e Artë”, një urdhër kalorsiak katolik themeluar në Bryzh, në vitin 1430, nga Filipi i Mirë, për të kremtuar martesën e tij me princeshën portugeze Izabela. Ishte një nga urdhërit kalorsiakë më me emër në Evropë.

[34](#) *Gulden*, monedhë e artë në Gjermaninë dhe Holandën mesjetare. Fjala vjen nga gjermanishtja e mesme-e lartë dhe do të thotë “e artë”.

[35](#) *Jeronim Shulci* u zgjodh peshkop i Brandenburgut në vitin 1507. Më 12 prill 1521 u emërua peshkop i Havelbergut. Vdiq një vit më vonë më 29 tetor 1522.

[36](#) *Johan fon Shtaupic* (1460-1522). Rridhte nga një familje e vjetër nga Saksonia me origjinë çeke. Ishte abat dhe anëtar i urdhrit augustinian. Studioi në Lajpcig. Në vitin 1500 mori gradën “Doktor në Teologji” dhe në vitin 1503 u zgjodh vikar i përgjithshëm i Kongregacionit Gjerman të Augustinianëve. Ishte dekani i parë i fakultetit të teologjisë në Universitetin e Vitenbergut, themeluar në vitin 1502.

[37](#) Në Kishën Katolike, *vikari i përgjithshëm* është përfaqësuesi i peshkopit, mëkëmbës, zëvendës i tij në çështjet ligjore dhe administrative. Vikari i përgjithshëm ushtron mbi një dioqezë një juridiksion të ngjashëm me peshkopin.

[38](#) *Shkallët e Shenjta* janë 28 shkallë prej mermeri të bardhë, të cilat ndodhen në kishën e Shën Johanit (San Xhovani) në Laterano, kryebazilika e papëve në Romë. Sipas traditës së Kishës Katolike,

këto janë shkallët që të çonin në pretoriumin e Ponc Pilatit në Jerusalem, ku qëndroi Jezusi kur e nxorën përpara tij. Mendohet se shkallët u sollën në Romë nga Shën Helena në shek. IV.

[39](#) *Bazilika apo kryebazilika e San Xhovanit në Laterano* është kisha katedrale e Romës dhe fronti i papës. Mendohet se është kisha më e vjetër në Romë dhe në perëndim. Daton rreth vitit 324 pas K.

[40](#) *Juli II* (1443-1513) u mbiquajt “Papa i Tmerrshëm” dhe “Papa Luftëtar”. U zgjodh papë më 1 nëntor 1503 deri sa vdiq më 21 shkurt 1513. Ishte i njohur për aktivitetin në politikën e jashtme, për projektet ambicioze në ndërtim dhe si patron (mbrojtës) i arteve. Urdhëroi shkatërrimin dhe rindërtimin e Bazilikës së Shën Pjetrit dhe dekorimin e tavanit të Kapelës Sistine nga Mikelanxheloja.

[41](#) *Xhirolamo (Jeronim) Savonarola* (1452-1498), ishte një frat dominikan, italian, dhe predikues në periudhën e Rilindjes në Firence. Ai denoncoi prishjen e klerit, qeverisjen despotike dhe shfrytëzimin e të varfërve. Ai profetizoi se po vinte një përmbajtje biblike dhe një Kir i ri po vinte nga veriu që do të reformonte Kishën. Bashkëpunoi me mbretin francez Karli VIII që pushtoi Italinë dhe e shpalli Firencën “republikë” popullore, duke flakur tej qeverisjen e Mediceve. Refuzoi të bashkohej me papën Aleksandri VI në Lidhjen e Shenjtë kundër francezëve. Papa e shkishëroi dhe opinionin iu kthye kundra. Më 23 maj 1498 Savonarola u ekzekutua me vendim të autoriteteve kishtarë dhe civile.

[42](#) Këto kisha ishin: Bazilika e Shën Pjetrit në Vatikan, Bazilika e Shën Palit, Bazilika e Shën Johanit në Laterano, Bazilika e Shën Mërisë së Madhe, Bazilika e Shën Lorencit, Bazilika e Kryqit të Shentë të Jerusalemit dhe Altari i Zonjës së Dashurisë Hyjnore, që më parë quhej Bazilika e Shën Sebastianit.

[43](#) Një nga specialitetet e kuzhinës gjermane, holandeze dhe nordike. Në fillim harenga shkohej në kripë, që t’i hiqej uji dhe pasi i hiqej kripa, marinohej me erëza, uthull, kripë, shurup dhe shtoheshin piper kokërr, dafinë dhe qepë e freskët.

[44](#) *Flavius Valerius Aurelius Constantinus Augustus*, ose Konstandini i Madh (pas vitit 280-337 pas K.). Lindi në Naissus të Myzisë, sot Nish në Serbi. Mendohet se është me origjinë ilire. Përpara se të bëhej perandor, shërbeu në oborrin e perandorit Dioklecian në Nikomedia, në Perandorinë Romake të Lindjes. Në vitin 312 pas K., pasi mundi Maksentin, rivalin e tij, në betejën e Urës Milvian pranë Romë, u bë perandor i Perandorisë Romake të Perëndimit. Në vitin 324 pas K., pasi theu Licinin në Adrianopol dhe Krisopol shturi në dorë edhe perandorinë e lindjes. Njihet si perandori që hoqi persekutimin ndaj të krishterëve dhe bëri krishterimin fe zyrtare të perandorisë.

[45](#) Ky libër është një përmbledhje e thënieve të Luterit në tryezën e ngrënies në shtëpinë e tij, po edhe në vende të tjera, të mbajtura shënim nga studentët e tij, në vitet 1531-1544.

[46](#) *Pietro Bembo* (1470-1547), studiues italian, poet, kritik letrar, kalorës i urdhrit të spitalit të Shën Johanit të Jerusalemit dhe kardinal.

[47](#) *Andreas Rudolf Bordenshtajn fon Karlshtad* (1486-1541), teolog i krishterë, një nga përkrahësit e Reformacionit protestant. Në vitin 1510 mori gradën “Doktor në Teologji” në Universitetin e Vitenbergut. Ishte një nga miqtë e Luterit.

[48](#) Papa Juli II kishte si një nga çështjet kryesore të pontifikatit të tij ringritjen e shtetit papal (territoret që njihnin si sovran të vetëm papën) të tkurrur dhe shkatërruar gjatë sundimit të familjes italo-spanjolle Borxhia. Një pjesë të territoreve i kishte shtënë në dorë Venediku. Në fillim mori Peruxhian dhe Bolonjën në vitin 1508. Më pas, në vitin 1509, kur bënte pjesë në Lidhjen e Kambrait (aleancë ushtarake e krijuar kundër osmanëve), bashkë me Luigjin XII të Francës që në atë kohë zotëronte edhe Milanon, perandorin Maksimilian I dhe Ferdinandin II të Aragonës, mbret i Napolit, i mundën trupat venedikase pranë Kremonës dhe papa i mori përsëri territoret e veta.

[49](#) *Erazmi i Roterdamit* (1466-1536), prift katolik, mësues dhe teolog, i cili veproi gjatë periudhës së Rilindjes në Holandë. Jetoi në periudhën e Reformacionit dhe, megjithëse ishte kritik ndaj abuzimeve që ndodhnin brenda Kishës Katolike, qëndroi larg Luterit dhe Melanktonit, duke vazhduar të njohë autoritetin e papës dhe duke mos pranuar theksimin që i bënte Luteri besimit.

[50](#) *Johan Tecel* (1465-1519), frat katolik gjerman, dominikan, dhe predikues. Kishte studiuar teologji dhe filozofi në Universitetin e Lajpcigut. Ishte Inkuizitori kryesor për herezitë në Poloni dhe më pas u

caktua Përfaqësuesi kryesor për indulgjencat në Gjermani.

[51](#) *Indulgjencat ose ndjesat* në Kishën Katolike ishin një e drejtë e akorduar nga papa për faljen e ndëshkimeve të përkohshme në purgator, si rezultat i mëkateve të kryera nga njerëzit. Indulgjenca ishte një dokument që “vërtetonte” se papa t’i kishte falur mëkatet e bëra dhe, si rezultat, në varësi të pagesës, të zbriteshin vite dënimi në purgator. Ishte një abuzim i pastër, të cilin Luteri e kundërshtoi me forcë, mbështetur në Bibël, se hiri i Perëndisë që na u dha me anë të vdekjes së Krishtit në kryq për mëkatet tona, mjafton për shpëtimin e njerëzve që besojnë në të.

[52](#) *Frederiku III, Elektori i Saksonisë* (1463-1525), i njohur si Frederiku i Urtë. Ishte një nga mbrojtësit e hershëm dhe më të fuqishëm të Martin Luterit dhe Reformacionit.

[53](#) *Papa Leoni X* (1475-1521), emrin e vërtetë e kishte Xhovani di Lorenzo de Medici. Hipi në fron më 9 mars 1513 dhe ndenji derisa vdiq më 1 dhjetor 1521 në moshën 45-vjeçare.

[54](#) *Albert fon Brandenburg* (1490-1545), cardinal, Elektor, kryepeshkop i Maincit në vitet 1514-1545 dhe kryepeshkop i Magdeburgut në vitet 1513-1545.

[55](#) *Hagenau*, qytet në krahinën e Rinit të Poshtëm në Alsasë. U themelua në shek. XII nga dukët e Svabias, të cilët ndërtuan aty një shtëpizë, në një ishull në lumin Moder, që ta kishin kur dilnin për gjah. Në vitin 1154, perandori I Perandorisë së Shenjtë Romake, Frederiku I Barbarosa, i dha statusin e qytetit. Ai e pëlqente shumë si vend dhe ngriti aty një pallat perandorak. Në atë pallat ruheshin xhevahiret e kurorës perandorake, si kurora, skeptri, globi dhe shpata e Karlit të Madh.

[56](#) Fshatra në veri-lindje të Gjermanisë, në rajonin e Brandenburgut.

[57](#) Qytet në Saksoni, kryeqytet i rajonit të Cvikaut. Ndodhet në një luginë në rrëzë të maleve Ecgebirge, midis qyteteve Lajpcig, Drezden dhe Chemnitz.

[58](#) *Anaberg-Buholc*, qytet në Saksoni pranë maleve Ecgebirge.

[59](#) Edhe ky qytet në Saksoni pranë maleve Ecgebirge.

[60](#) *Maksimiliani I*, Perandori i Shenjtë Romak (1459-1519). Ishte austriak, i biri i Perandorit Frederiku III nga dinastia e Habsburgëve. Ishte mbret i romakëve dhe i gjermanëve dhe arkidukë i Austrisë. Qëndroi në postin e perandorit në vitet 1508-1519. Nëpërmjet martesës së të birit, Filipi i Mirë, me mbretëreshën Joana të Kastijës, ndihmoi në vendosjen e dinastisë së Habsburgëve në Spanjë. Më vonë djali i tyre dhe nipi i perandorit, Karli, mbajti fronin e Kastijës dhe të Aragonës dhe u zgjodh perandor, pas vdekjes së Maksimilianit.

[61](#) Kardinalët në Kishën Katolike quhen princa të Kishës, sepse është kolegji i kardinalëve ai që zgjedh papën e ri prej tyre, gjatë një kohe që quhet konklavë. Ata janë për Kishën njësoj si princat elektorë në Perandorinë e Shenjtë Romake.

[62](#) Njihej ndryshe edhe si *Johan i Patunduri*. Ishte Elektori i Saksonisë në vitet 1525-1532. Ai vazhdoi ta mbështeste Reformacionin edhe pas vdekjes së të vëllait.

[63](#) Fshat në veri-lindje në shtetin Saksoni-Anhalt, Gjermani.

[64](#) Prift çek, filozof, dekan dhe rektor i Universitetit “Karl” në Pragë. Pararendës i protestantizmit dhe i Reformacionit bohemian. Dënoi ashpër ndjesat (indulgjencat) dhe kryqëzatat. U thirr në Këshillin e Konstancës, qytet gjerman në kufi me Zvicrën, dhe u gjykua pabesisht si heretik dhe vdiq në turrën e druve më 6 korrik 1415. Ndjekësit e mësimave të tij u quajtën husitë.

[65](#) Ishte *igumeni* apo *kryemurgu* i manastirit të Shtajnlauzicit.

[66](#) Qytet në krahinën e Frankonisë së Poshtme në Bavarinë veriore.

[67](#) Qytet në shtetin e Brandenburgut, Gjermani, pranë lumit Oder, në kufirin gjermano-polak.

[68](#) Doktor Honoris Causa.

[69](#) Emri i tij i vërtetë ishte *Konrad Koh*. Ishte katolik gjerman, teolog dhe humanist. Ishte kundër doktrinės së Luterit dhe shkroi një sërë traktatesh kundër saj.

[70](#) *Karl fon Miltic* (1490-1529). Rridhte nga një familje e vogël fisnikësh saksonë. Studioi në Mainc, Trier, Köln dhe Bolonjë, por latinishtja e tij linte për të dëshiruar. Arriti të bëhej shambellan dhe sekretar i papës. Më 15 tetor 1518, papa Leon X e zgjodhi nunc papal (të dërguarin e tij) për t’i

dorëzuar Frederikut të Urtë “Trëndafilin e Artë të Virtytit” , akorduar nga papa, me qëllim që ai të ndikonte te Luteri për çështjen e ndjesave (indulgjencave).

[71](#) Në atë kohë ishte një metodë ekzekutimi për shumë shkelje.

[72](#) Teolog. Lindi në Priero, Piemont (1456/57-1527). I përkiste urdhrit domenikan. Është një nga teologët e parë që sulmoi publikisht doktrinën e Martin Luterit.

[73](#) *Index Librorum Prohibitorum*, censura papnore ishte një listë me libra që konsideroheshin heretikë apo kundër klerit dhe që ishin të ndaluar nga Kisha Katolike.

[74](#) Qytet universitar në Baden-Vurtemberg, në jug-perëndim të Gjermanisë në rajonin e Karlsruhes. Qendra e Elektoratit Palatin. Universiteti i Hajdelbergut u themelua në vitin 1386 nga Ruperti I, Elektori Palatin, dhe është universiteti më i vjetër në Gjermani dhe një nga më të vjetrit në Evropë. Ky universitet luajti një rol udhëheqës në epokën e Humanizmit dhe të Reformacionit.

[75](#) Fisnik gjerman që përkrahu Luterin dhe reformacionin. Mbante titullin kont palatin dhe dukë i qytetit Cvajbryken (Dy-Urat) në Palatinatin e Rinit. Në vitin 1548, perandori, Karli V, ia pushtoi territoret e tij protestante dhe riktheu ritin katolik.

[76](#) Ishte murg domenikan. U ndikua nga doktrina e Luterit dhe e braktisi urdhrin. Filloi të punonte për Reformacionin. U shkishërua nga Kisha Katolike dhe u detyrua të ikte në Strasburg ku u takua me reformatorë të tjerë. Shërbeu si ndërmjetës midis Luterit dhe Cvinglit në debatin e tyre për eukaristinë (Darkën e Zotit).

[77](#) Teolog gjerman dhe reformator protestant nga dukati i Vyrtembergut.

[78](#) Teolog gjerman, luteran, pastor dhe reformator. Studioi në Universitetin e Erfurtit dhe më vonë në atë të Hajdelbergut. Mbajti katedrën e hebraishtes në Universiteti e Jenës.

[79](#) Frederiku i Urtë.

[80](#) *Giorg Spalatin*, ishte pseudonimi i *Giorg Burkhartit* (1484-1545), ishte humanist gjerman, teolog dhe reformator. Ishte sekretar i Elektorit Frederiku i Urtë dhe një figurë e rëndësishme e Reformacionit.

[81](#) I njohur ndryshe edhe si *Tomazo de Vio* (1469-1534). Lindi në Gaeta, pjesë e Mbretërisë së Napolit, me emrin Jakopo Vio. Teolog dhe filozof italian. I përkiste urdhrit domenikan. Në moshën 30-vjeçare mori doktoraturën në Padova. Njihet për kundërshtimin që i bëri doktrinës së Luterit dhe Reformacionit, kur ishte i dërguari i papës në Vitenberg.

[82](#) Fjala *dietë* vjen nga latinishtja mesjetare dhe do të thotë “asamble parlamentare”. Ky term është përdorur kryesisht në Perandorinë e Shenjtë Romake. Dieta ishte një mbledhje ku diskutoheshin probleme dhe nxirreshin ligje dhe dekrete që i rregullonin këto probleme. Që nga viti 1489 dieta kishte tri kolegje: kolegjin elektoral, i cili përbëhej nga shtatë princat-elektorë, nën kryesinë e kryepeshkopit të Maincit, kryekancelar i Gjermanisë; kolegjin e princave dhe kolegjin e qyteteve.

[83](#) Qytet në krahinën e Shvabias, në Bavari.

[84](#) Ulrih fon Hutën (1488-1523) ishte dijetar gjerman, poet, satirist dhe reformator. Ishte kritik i njohur i Kishës Katolike dhe përkrahës i Reformacionit. Ishte udhëheqësi Kalorësve Perandorakë të Perandorisë së Shenjtë Romake.

[85](#) “Urdhri i Vëllezërve të të Bekuarës Virgjëreshës Mari të Malit Karmel”. Një komunitet eremitësh që fillimisht jetonin në malin Karmel.

[86](#) *Johan Majer fon Ek* (1486-1543), ishte dijetar gjerman, teolog dhe prelat katolik. Një nga kundërshtarët më të hershëm të teologjisë së Luterit dhe një nga kundër-reformatorët e parë.

[87](#) Zgjedhja u bë më 28 qershor në Frankfurt-mbi-Main. Perandori i ri u zgjodh Karli V. Papa Klementi VII e kurorëzoi perandor të Perandorisë së Shenjtë Romake 11 vjet më vonë, më 22 shkurt 1530 në Bolonjë. Ishte perandori i fundit që kurorëzohej nga papa.

[88](#) *Petrus Mosellanus Protegensis* (1493-1524), ishte dijetar humanist gjerman. Emrin e vërtetë e kishte Peter Shade. U bë i njohur me veprat mbi retorikën: *Tabulae de schematibus et tropis* dhe

Paedologia. Ishte profesor në Universitetin e Lajpcigut.

[89](#) *Barnimi XI*, duka i Pomeranisë (1501-1573). U bë dukë në vitin 1523, pas vdekjes së të atit. Ishte një nga fisnikët që e pranoi doktrinën e Luterit. Pomerania shtrihet në bregun jugor të detit Baltik, midis Gjermanisë dhe Polonisë. Emri vjen nga sllavishtja që do të thotë, *vend pranë detit*.

[90](#) E njohur edhe si *sëpata zvicerane*. Mendohet që fjala ka origjinë gjermane, Halm = shtizë dhe Barte = sëpatë. Armë e përdorur veçanërisht në shek.XV-XVI, e cila përbëhej nga një sëpatë lufte e vendosur në një shkop rreth 1.8 m të gjatë që kishte në majë një ushtë.

[91](#) U ndërtua në shek XIII nga markonti Ditrih dhe u emërtua Pleisenburg, për hir të lumit Pleise që rrjedh aty pranë. Në kapelën e kështjellës, Luteri kreu ceremoninë e parë ungjillore në vitin 1539, të Dielën e Pentakostit.

[92](#) “Eja, Frymë e Shenjtë” (shënim i përkthyesit). Quhet edhe “Sekuenca e Artë” dhe në liturgjinë romane thuhet të Dielën e Pentakostit.

[93](#) Fjalë në Biblën hebreje që personifikonte djallin. Ndonjëherë del edhe në formën Beliar. Shfaqet së pari te Ligji i Përtërirë 13:14: “Dolën bijtë e *Belialit* prej mesit tënd dhe i ndashënnyen banorët e qytetit të vet...”, Bibla, përkth. Dom Simon Filipaj, “Drita”, Ferizaj 1994, fq. 232, por e gjejmë edhe te Letra e Dytë drejtuar Korintasve 6:15: “Çfarë përkimi ka Krishti me *Beliarin*?”, fq. 1632.

[94](#) *Giorg III, princ i Anhalt-Desaut* (1507-1553). Ishte djali i tretë i princit Ernest I. Studioi në Universitetin e Lajpcigut. Në vitin 1524 u shugurua prift nga i afërmi i tij, Adolfi, peshkop i Merzeburgut. Studioi Biblën dhe shkrimet e Etërve të Kishës, me qëllim që të kundërshtonte doktrinën e luteranëve, por më vonë, në Dietën e Augsburgut, ai bashkë me vëllezërit e tij u bashkua me luteranët.

[95](#) Qytet në Palatinatin e Rinit, në rrjedhën e sipërme të lumit Rin, rreth 60 km në jug-jugperëndim të qytetit Frankfurt-mbi-Majn. Ka qenë kryeqyteti i Mbretërisë së Burgundit në shek. V dhe përmendet shpesh në eposin “Këngët e Nibelungëve”. Ka qenë peshkopatë katolike të paktën që nga viti 614 dhe ishte një Palatinat i rëndësishëm i Karlit të Madh.

[96](#) Perandori Maksimiliani I vdiq më 12 janar 1519 në qytetin e Velsit në Austrinë e Sipërme, pranë Linzit.

[97](#) Frederiku III, Elektori i Saksonisë, ose Frederiku i Urtë.

[98](#) Qyteti *Ahen* (Aachen) në Vestfalinë e Rinit të Veriut, pranë kufirit belgo-holandez. Ka qenë rezidenca e perandorit Karli i Madh (742-814).

[99](#) Ishte një nga kalorësit më të fuqishëm dhe më me influencë në rajonin e Frankonisë.

[100](#) *Franc fon Zikingen* (1481-1523), kalorës gjerman, një nga figurat më të shquara të periudhës së parë të Reformacionit. Ishte mik i ngushtë me Ulrihun e Hutënit. Sipas Hutënit, kështjella e tij u bë mbrojtëse e drejtësisë. Shumë nga reformatorët gjetën strehë aty.

[101](#) Kryepeshkopi i Maincit, një nga shtatë elektorët.

[102](#) *Tomazo d'Akuini* ose *Thoma d'Akuini* (1225-1274), prift katolik dhe frat domenikan, filozof, teolog dhe jurist. Kisha Katolike e konsideron një nga filozofët dhe teologët më të mëdhenj dhe më me ndikim në botën perëndimore.

[103](#) Frederiku i Urtë.

[104](#) *Xhirolamo Aleandro* (1480-1542), ishte kardinal italian. Në vitin 1520 u dërgua në Gjermani si nunc apostolik (ambasador i papës) në kurorëzimin e perandorit Karli V. Në Dietën e Vormsit drejtoi kundërshtimet ndaj Luterit dhe propozoi masat më të rrepta ndaj doktrinës së reformatorëve.

[105](#) *Filipi I* (1504-1567), i quajtur *der Großmütige* (Shpirtmadhi). Ishte kont i Hesënit me kryeqytet Marburgun. Ishte një nga mbrojtësit më të mëdhenj të Reformacionit dhe një nga sundimtarët më të hershëm protestantë në Gjermani.

[106](#) Marino Karaçoli (1469-1538), prelat italian. Papa Leon X e caktoi protonoter apostolik (kryesekretar). Në vitin 1519 shkoi në Gjermani si i dërguari i papës, që të uronte perandorin, Karlin

V, dhe ta nxiste të merrte masa kundër Luterit. Në vitin 1535, papa Pali III e bëri kardinal-dhjak në kuri. Pas vdekjes së dukës së Milanos, perandori ia besoi atij qeverisjen e dukatit.

[107](#) Urdhër kalorsiak. I njohur filimisht si “Urdhri i Kalorësve të Shën Johanit të Jerusalemit”, më pas si “Urdhri i Kalorësve Spitalorë” ose thjesht “Spitalorët”. Mbanin veshur mantele të zeza me kryq të bardhë dhe flamurin e kishin të kuq me kryq të bardhë. U themelua në Jerusalem nga tregtarët italianë amalfitanë, rreth vitit 1070 pas K., për t’u kujdesur për Spitalin e Shën Johanit, i cili qe ndërtuar për pelegrinët që vizitonin Vendet e Shenjta. Në vitin 1130 pas K., u kthye në forcë ushtarake, në modelin e Kalorësve Tempullorë. Në vitin 1291 u transferuan në Qipro; në vitet 1310-1522 u transferuan në ishullin e Rodit dhe u quajtën “Kalorësit e Rodit”; pastaj u transferuan në Maltë dhe u quajtën “Kalorësit e Maltës”.

[108](#) *Kristof Ulrih fon Papenhajm* (1546-1599) ishte marshalli i perandorisë dhe përfaqësuesi i fundit i linjës Papenhajm-Grefental.

[109](#) *Giorg fon Froindsberg* (1473-1528), ushtarak gjerman në shërbim të Perandorisë së Shenjtë Romake, të kombit gjerman dhe të shtëpisë perandorake të Habsburgëve. Nuk dihet nëse e braktisi Kishën Katolike, por i doli krah Luterit dhe e mbeshteti.

[110](#) *Zhan-Henri Merl d’Obigné* (1794-1872) ishte pastor protestant zviceran dhe historian i Reformacionit. Shkroi një sërë librash për Luterin dhe historinë e Reformacionit.

[111](#) *Ferdinandi I* (1503-1564) nga dera e Habsburgëve, perandor i Perandorisë së Shenjtë Romake pas Karlit V, mbret i Bohemisë, i Hungarisë dhe i Kroacisë. Në kohën kur Karli V ishte perandor, ishte arkiduka i Austrisë dhe përfaqësuesi i Karlit në Gjermani.

[112](#) *Fernando Alvarez de Toledo* (1508-1582), I njohur edhe si Duka i Madh i Alvës në Spanjë dhe si Duka i Hekurt në Holandë. Ishte fisnik spanjoll, gjeneral dhe diplomat. Mbante gjithashtu edhe një sërë titujsh fisnikërie, si dhe ishte anëtar i Urdhrit të Kalorësve të Bashkës së Artë. Ishte këshilltar i Mbretit të Spanjës Karli I (perandori Karli V), qeveritar i disa territoreve, si qeveritar i Holandës, nënmbret i Napolit dhe i Portugalisë etj. Nga historianët është cilësuar si gjenerali më i madh i kohës së tij dhe një nga më të mëdhenjtë e të gjitha kohëve.

[113](#) Kryepeshkopi-Elektor i Trierit ishte *Rikard fon Greifnklau cu Folrad* (1467–1531) që e mbajti këtë post në vitet 1511-1531. Augustin Shurf (1495-1548), mjek gjerman dhe natyralist, lindur në qytetin e Shën Galit (Sankt Galen) në Zvicër. Ishte mik i Luterit.

[114](#) *Augustin Shurf* (1495-1548), mjek gjerman dhe natyralist, lindur në qytetin e Shën Galit (Sankt Galen) në Zvicër. Ishte mik i Luterit.

[115](#) *Vartburgu* është një kështjellë e ndërtuar në mesjetë, rreth vitit 1067 pas K. Është ndërtuar mbi një kodër-shkëmb 410 m të lartë, rrethuar me pyll, pranë Ajzenahut në shtetin e Tyingënit në Gjermani.

[116](#) *Karli V*, perandori, dhe mbreti i Spanjës me emrin Karli I, e trashëgoi Kurorën e Aragonës, ku bënte pjesë edhe Mbretëria e Napolit, Mbretëria e Sicilisë dhe Mbretëria e Sardenjës.

[117](#) Shtet federal në Gjermaninë qendrore me kryeqytet Erfurtin. Është quajtur zemra e gjelbër e Gjermanisë.

[118](#) *Johanes Kesler* (1502-1574) ishte teolog, kronist dhe reformator.

[119](#) *Borna* është sot kryeqytet i rajonit të Lajpcigut në Saksoni, Gjermani. Ndodhet 30 km në jug të Lajpcigut.

[120](#) *Gabriel Cvillingu* (1487-1558), ishte luteran gjerman dhe përkrahës i Reformacionit. U arsimua në Vitenberg dhe në Erfurt. Ashtu si Luteri ishte murg i urdhrit augustinian, nga i cili u largua në vitin 1521.

[121](#) Mesha konsiderohej si flijim, sepse supozohej që kryqëzonte Jezusin fizikisht, kurse sakramenti është fundi i meshës, kur ofrohet buka dhe vera, pra, Darka e Zotit. (*Shën. i përkthyesit.*)

[122](#) *Nikolaus Shtork* (1500-1536) endës dhe predikues radikal nga Cvikau në Saksoni. Ai dhe ndjekësit e tij të quajtur “Profetët e Cvikaut”, u shfaqën për pak kohë në fillimet e Reformacionit. Ata

shihen nga shumë studiues si pararendës të anabaptistëve.

[123](#) Rajon në Gjermaninë jug-perëndimore.

[124](#) Qytet në Saksoninë e Poshtme.

[125](#) *Adrian Florens* (1459-1523), u zgjodh papë më 9 shtator 1522 dhe ndenji në fron deri më 14 shtator 1523. Është i vetmi papë holandez. Lindi në peshkopatën princërore të Utrehtit. Në vitin 1507 ishte tutor i perandorit të ardhshëm Karli V. Në vitin 1516 u zgjodh peshkop i Tortosës në Spanjë dhe shpejt u caktua Inkuizitori kryesor për Mbretërinë e Aragonës dhe të Kastijës. Në kohën kur u zgjodh papë kishte filluar Reformacioni dhe bota perëndimore kërcënohej nga osmanët. Ai kërkoi me forcë dënimin e Luterit si heretik.

[126](#) *Ferdinandi I* (1503-1564) nga dera e Habsburgëve, perandori i Perandorisë së Shenjtë Romake pas Karlit V, mbret i Bohemisë, i Hungarisë dhe i Kroacisë. Në kohën kur Karli V ishte perandor, ishte arkiduka i Austrisë dhe përfaqësuesi i Karlit në Gjermani.

[127](#) *Françesko Kierigati* (1479-1539), peshkop dhe nunc apostolik në Angli në vitet 1515-1517. Ishte i dërguari i papës në Dietën e Nyrembergut.

[128](#) *Jeronimi i Pragës* (1379-1416), dijetar dhe filozof çek, teolog, reformator dhe profesor. Ishte një nga ndjekësit kryesorë të Jan Husit dhe u dogj bashkë me të në Këshillin e Konstancës, i akuzuar për herezi.

[129](#) Emri i tij i vërtetë ishte *Xhulio di Xhuliano de Mediçi* (1478-1534). Ishte kushëri me papën Leon X, i cili e caktoi kryepeshkop të Firences dhe më pas kardinal. Pas vdekjes së papës Leon shihej si kandidati më i mundshëm për papë, por u zgjodh papritur holandezi Adrian VI. Pas vdekjes së atij u zgjodh papë dhe qëndroi në fron në vitet 1523-1534.

[130](#) *Lorenzo Kampexho* (1474-1539), kardinal italian, humanist dhe jurist. Me të hyrë në shërbimin kishtar më 1510, u bë një nga përfaqësuesit më të vlefshëm të papatit. Nga viti 1511 ishte vazhdimisht nunc apo i dërguar i papës. Shërbeu nën pesë papë.

[131](#) Qytet në Palatinatin e Rinit. Është një nga qytetet më të vjetër në Gjermani, themeluar nga romakët rreth vitit 500 pas K.

[132](#) Qytet në jug-lindje të Gjermanisë në Bavari, pranë Mynihut, Nyrembergut dhe Augsburgut.

[133](#) Bashkim shtetesh.

[134](#) Shërbyes, djem të rinj.

[135](#) *Katerina fon Bora* (1499-1552), gruaja e Martin Luterit. Ajo rridhte nga një familje pronare tokash në Saksoni. Pas vdekjes së Luterit në vitin 1546, ajo jetoi në vështirësi financiare edhe pse kishte toka dhe prona.

[136](#) Nimpçi ishte një qytet në Silezinë e Poshtme, në jug-perëndim të Polonisë.

[137](#) Lat. *Verbum Dei manet in æternum*.

[138](#) *Aurora borealis* ose *agimet polare*. Dukuri që ndodh në pole dhe shkaktohet nga përplasja e elektroneve të lëshuara nga dielli me gazet si oksigjeni dhe azoti, kur hyjnë në atmosferën e Tokës, duke shfaqur në qiell një ngjyrë të gjelbër të lehtë ose rozë. Dukuria që ndodh në Polin e Veriut quhet *aurora borealis* (*agimet e veriut*), kurse ajo që ndodh në Polin e Jugut quhet *aurora australis* (*agimet e jugut*).

[139](#) *Johann Oecolampadius* (1482-1531) ose Johannes Huszgen. Ishte humanist, predikues gjerman dhe dijetar. Ishte mik i ngushtë i reformatorit zviceran Ulrih Cvingli. Studioi në Hajdelberg. Në vitin 1506 u bë kujdestar i fëmijëve të Elektorit Palatin. Njihte mirë greqishten, latinishten dhe hebraishten. Në vitin 1515 shkoi në Bazel, ku ndihmoi Erazmin e Roterdamit në përgatitjen e botimit të Dhiatës së Re. Përktheu vetë disa nga Etërit e Kishës. Shërbeu si lektor dhe profesor në Universitetin e Bazelit, ku edhe kishte marrë gradën “Doktor”. Qytet universitar në shtetin e Hesënit, Gjermani.

[140](#) Qytet universitar në shtetin e Hesënit, Gjermani.

[141](#) Quhej ndryshe edhe *Sëmundja Angleze* e *Djersës*, sepse u shfaq së pari në Angli. Nuk dihetin shkaqet. Fillonte me dhimbje koke, marrje mendsh, pafuqi. Pas 1-3 orësh fillonin djersët, vazhonte

dhimbja e kokës, përçarja, pulsi i shpejtë. Vdekja vinte pas 3-18 orësh pas shfaqjes së simptomave. Nëse pacienti mbijetonte për 24 orë, atëherë s'kishte më rrezik dhe pastaj e merrte veten plotësisht.

[142](#) *Kaspar Hedio* (1494-1552), ishte historian dhe teolog gjerman, reformator protestant. Studioi në Frajburg dhe më pas për teologji në Bazel, ku u njoh me Ulrih Cvinglin. Përktheu pjesë nga Etërit e Kishës dhe botoi një kronikë për Kishën e hershme.

[143](#) *Just Jonasi* (1493-1555) ishte teolog gjerman, luteran dhe reformator. Ishte gjithashtu jurist, profesor dhe autor himnesh. Është i njohur për përkthimin e shkrimeve të Luterit dhe Melanktonit. Iu ndodh pranë Luterit në çastet e fundit.

[144](#) *Andreas Oziander* (1498-1552) teolog gjerman, luteran.

[145](#) *Johan apo Johannes Brenc* (1499-1570), teolog gjerman dhe reformator protestant.

[146](#) *Johan ose Johannes Agrikola* (1494-1566), luteran gjerman dhe reformator. Ishte ndjekës dhe mik i Martin Luterit.

[147](#) Qytet në rajonin e Shvabias në Bavari.

[148](#) Një nga kështjellat më të larta në Gjermani. Është vendosur në një kodër mbi qytetin e Koburgut në Frankoninë e Sipërme, në Bavari. Përmendet për herë të parë në vitin 1056 pas K.

[149](#) *Rrosano* është një qytet në provincën e Kozencës, në Kalabri, Itali. Ndodhet 3 km larg nga Gjiri i Tarantos. Emri i vjetër është *Roscianum*.

[150](#) *George of Brandenburg-Ansbach* (1484-1543), quhej ndryshe dhe Giorg Piu. Qeverisi në vitet 1536-1543. Ansbahu është një qytet në Frankoninë lindore, në Bavari. *Brandenburg-Ansbach* nuk duhet ngatërruar me Brandenburgun, rajonin në kufi me Poloninë.

[151](#) Dalja e bukës dhe verës për kungim. Në Kishën Katolike ky moment kremtohet me solemnitete të madh, pasi në doktrinën e saj besohet se ndodh transubstanciacioni, të shndërruarit e bukës dhe verës në trup dhe gjak të Jezu Krishtit. Buka dhe vera mbeten të pandryshueshme, por në thelb janë shndërruar në gjakun dhe trupin e Krishtit. (Shih: Fran Luli, Fjalor biblik dhe i termave kishtarë, "Camaj-Pipa" Shkodër, 2004, fq. 466.)

[152](#) *Christian Beyer* (1482-1535), ishte Doktor në shkencat juridike.

[153](#) *Kristof fon Shtadion* (1478-1543). Ishte princi-peshkop i Augsburgut në vitet 1517-1543. Mori doktoraturën në jurisprudencë në Universitetin e Ferrarës, Itali. Nuk arriti dot ta ndalonte përhapjen e ideve protestante në Augsburg.

[154](#) *Vilhelmi IV* (1493-1550), dukë i Bavarisë në vitet 1508-1550. Në fillim e simpatizoi Reformacionin, por më pas ndërroi mendje, kur popullariteti i tij po rritej. Pas marrëveshjes me papa Klementin VII, në vitin 1524 u bë një nga udhëheqësit politikë të Kundër-reformacionit gjerman, megjithëse politikisht ishte kundër Habsburgëve. Mbështeti Karlin V në luftën kundër Lidhjes së Schmalkaldit.

[155](#) Qytet në rajonin e Schmalkalden-Mainingenit, në pjesën jug-perëndimore të Tyingënit.

[156](#) Ishte një aleancë ushtarake mbrojtëse e princave luteranë në Perandorinë e Shenjtë Romake, me qëllim mbrojtjen e interesave politike dhe fetare të anëtarëve të saj. Themeluesit e saj ishin Filipi I, konti i Hesënit, dhe Johan Frederiku I, Elektor i Saksonisë, dy sundimtarë protestantë të fuqishëm të kohës.

[157](#) *Johanes Bugenhagen* (1485-1558), i quajtur *Dr. Pomerani* nga Martin Luteri. Përhap Reformacionin protestant në Dukatit e Pomeranisë dhe në Danimarkë. Një nga arritjet e tij më të mëdha ishte formimi i kishave luterane në Gjermaninë veriore dhe në Skandinavi. Ai u quajt edhe *Apostulli i Dytë i Veriut*. Në Vitenberg ishte pastori dhe rrëfëstari i Martin Luterit. Gjithashtu ishte pjesë e grupit të Luterit që përkthye Biblën nga greqishtja dhe hebraishtja në gjermanisht.

[158](#) Qytet në brigjet e lumit Elba në Saksoninë veri-perëndimore.



Luteri rrugës për në shkollë në kurrizin e atit të tij.



Martini Student



Pamje nga Vitenbergu



Pamje nga Firenze



Luteri duke predikuar në kishë (Vitenberg)



Papa Leoni X



Frederiku i Urtë



Luteri duke gozhduar tezat në dyert e kishës në Vitenberg



Martin Bucer



Përballja e Luterit me Gaetanon

Filip Melanktonin



Përballja në Lajpcig



www.any.com - B. RAKY

Erasmus



Luteri djeg bulën papnore



Karli V



Katerina fon Bora



Princat e Reformuar gjatë rrugëtimit për në Shpajër



Cvingi



Prezantimi i deklaratës para perandorit